


Abdulhamid Ebu Sulejman


Civilizimi islam

Rënia dhe ripërtëritja e tij



CIVILIZIMI ISLAM
RËNIA DHE RIPËRTËRITJA E TIJ
- Rrënjët kulturore dhe edukative -

Abdulhamid Ahmed Ebu Sulejman



© **LOGOS·A**
S H K U P
PRISHTINË
T I R A N Ë
2 0 2 1

BOTON: LOGOS-A
BIBLIOTEKA: MENDIMI ISLAM

Për botuesin: Adnan Ismaili
Kryeredaktor: Husamedin Abazi
Redaktor biblioteke: Nexhat Ibrahimimi
Redaktor: Ziber Lata

Redaktor gjuhësor: Shkëlzen Halimi
Redaktor artistik & disenji: Edib Agagjyshi
Redaktor teknik: Naser Fera
Mbikëqyrës i shtypit: Kemal Ismaili
Shtypi: Focus Print
Rr. Pellagonia 3 - Shkup

www.logos-a.com
ISBN 978-9989-58-849-5 Paperback
Copyright©Logos-A, 2021
©Center for Advanced Studies
©The International Institute of Islamic Thought (IIIT)

Tirazhi: 1000

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jofitimprurës.

Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit apo edhe për afirmim të kulturës së leximit në përgjithësi.
Por, nuk lejohet riprodhimi, transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi pa lejen paraprake të Logos-A.



CIVILIZIMI ISLAM

RËNIA DHE RIPËRTËRITJA E TIJ

- Rrënjët kulturore dhe edukative -

Abdulhamid Ahmed Ebu Sulejman

PËRKTHEU NGA ARABISHTJA:

Naser Ramadani

TITULLI I ORIGINALIT:

عبد الحميد أحمد أبو سليمان

انهيار الحضارة الإسلامية وإعادة بناءها: الجذور الثقافية والتربوية

Abdulhamid Ahmed Ebu Sulejman

Inhijar'ul-hadaret'il-islamijjeh:

El-Xhudhur'eth-thekafijjetu ve't-terbevijjeh

The International Institute of Islamic Thought (IIIT), 2016, Herndon, USA



LOGOS·A

Ky libër u botua me mbështjen e
Institutit Ndërkombëtar të Mendimit Islam (IIIT)



PËRMBAJTJA:

Fjala e botuesit.....	9
Parathënie	11
KAPITULLI I PARË.....	15
Problemi i hulumtimit dhe rrënjët e krizës.....	17
1.1. Problemi dhe shkaqet e hulumtimit	17
1.2. Metodologjia	21
1.3. Rrënjët e krizës	33
KAPITULLI DYTË.....	45
Identifikimi i sëmundjes.....	47
2.1. Deformime dhe devijime në mënyrën e të menduarit dhe kulturën e umetit	47
2.2. Rezultatet e hidhura dhe pasojat e devijimeve ideologjike në formimin psikologjik të umetit	103
KAPITULLI I TRETË.....	107
Fëmija: Bazamenti i nisjes.....	109
3.1. Lëvizjet reformuese islame dhe nevoja për vlerësim.....	110
3.2. Pozita e mendimit në raport me problemet e mëdha të umetit.....	122
3.3. Ndryshimi shoqëror dhe diskursi (komunikimi) pedagogjik....	141

KAPITULLI I KATËRT 155

Zgjidhja bazike: Formimi i fëmijërisë	157
4.1. Rruga e reformave dhe përballimi i sfidave	158
4.2. Problematika kulturore: Përfundimi i konflikteve iluzore dhe përmirësimi i koncepteve	160
4.3. Problemi pedagogjik: metoda dhe pikënisja.....	185
4.4. Mes të kaluarës dhe të tashmes: bazamentet dhe pikënisjet pedagogjike	189

KAPITULLI I PESTË..... 207

Familja muslimane është burim i ndjenjave.....	209
5.1. Sekretet e shariatit në formimin e familjes: themelet dhe metodat	209
5.2. Shenjat e rrugës në “Sinan” e kohës	225

KAPITULLI I GJASHTË..... 247

Plani i punës.....	249
6.1. Frontet e veprimit.....	249
6.2. Plani i shkollës “islamizimi i diturive” dhe zhvillimi i mendimit bazik islam	258

Përfundim	273
-----------------	-----

Literatura	281
------------------	-----

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ

قال الله تعالى:

(إِنَّ اللّٰهَ لَا يُغَيِّرُ مَا بِقَوْمٍ حَتَّىٰ يُغَيِّرَ مَا بِأَنْفُسِهِمْ)

“Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli derisa ai nuk e ndryshon gjendjen e tij”.

(Err-Rra’ d:11)

قال رسول الله صلى الله عليه وسلم:

"الْتَّاسُ مَعَادِنُ خِيَارُهُمْ فِي الْجَاهِلِيَّةِ خِيَارُهُمْ فِي الْإِسْلَامِ إِذَا فَقَهُوا"

“Njerëzit janë sikur xehet. Të dalluarit në periudhën e xhahilijetit (inJORANCËS) janë të dalluar edhe në Islam, nëse bëhen të

kuptueshëm (mësojnë)”

(Transmeton Buhariu)

Fjala e botuesit

Libri që keni në duar paraqet një vepër të rëndësishme që flet për thelbin e shkaqeve të tatëpjetës dhe ngecjes së civilizimit islam, ndonëse ai në të kaluarën gëzonte prestigj në skenën e historisë së njerëzimit dhe kontribuues i pashoq i tij. Në të vërtetë, autori i kësaj vepre ofron shembuj të vyer që janë udhërrëfytes për ne dhe që shpijnë në rindërtimin e këtij civilizimi dhe i cili bart mesazhin e lartë hyjnor, mesazh ky mbarëkombëtar dhe universal, i cili i dedikohet njerëzimit mbarë dhe që për bazë ka vëllazërinë, drejtësinë, paqen dhe mëshirën. Autori nuk e përjashton komunikimin ndërmjet civilizimit islam dhe atij perëndimor, mirëpo ai fton që ky bashkëveprim ndërcivilizues nuk duhet të jetë në mënyrë të çorientuar, pa pasur bazament metodologjik.

Autori Ebu Sulejman thekson se, për shkak të dominimit të përfaqësjes materialiste dhe raciste, padrejtësitë dhe tragjeditë në të ardhmen do të jenë edhe më të padrejta, më të vrazhda dhe më të ashpra. Andaj, epoka në të cilën jetojmë ka nevojë për ndërhyrje dhe riorganizim të pajisur me vlera hyjnore dhe universale. Kjo vepër pa dyshim që e pasuron bibliotekën mbi veprat që flasin për civilizimin islam, për atë civilizim që mendimtari Ahmed Davutogllu e radhit në kategorinë e *civilizimit të fortë dhe fleksibël*.

Ky libër të cilën SHB "Logos-A" ia sjell lexuesit realizohet në bashkëpunim dhe me mbështetje të *Institutit Ndërkombëtar të Mendimit Islam* – Uashington dhe *Qendrës për Studime të Avancuara* në Sarajevë, andaj u jemi mirënjohës pa masë.

Botuesi
Maj, 2021

*Në emër të Allahut, të Gjithmëshirshmit,
Mëshirëplotit!*

Parathënie

Ky libër nuk është rezultat i rastit, por është rezultat i një munde të madh në hulumtime dhe eksperimente. Krahas librit “Ezmetul’ aklil’ muslimi”¹ - është një përpjekje për të kuptuar shkaqet që penguan deri sot suksesin e projektit rreth reformave të civilizimit islam dhe sjelljen e ndryshimit të pritur te umeti islam², edhe pse kanë kaluar më shumë se nëntë shekuj nga thirrja e Ebu Hamid Gazaliut në librat: “Tehafu’tul-felasife” dhe “Ihjau ulum’id-din”. Po ashtu, ka kaluar më shumë se një shekull nga mendimi i Kevakibiut për avancimin e parimeve, intencave, qëllimeve dhe vlerave të Islamit në librin e njohur të tij “Ummu’l-Kura”, si dhe akuzat dhe hidhërimin e tij ndaj librit: “Eslu’d-dai ve ussi’l-belai” në librin e tij më të njohur: “Tabai’u’l-istibdad”. Megjithatë, deri më sot, as ëndrra nuk është realizuar, e as krimi nuk është evituar!

Ky hulumtim sqaron se akoma mungon një dimension në projektin e reformave islame. Pa këtë dimension, projekti civilizues nuk do të mund të sjell ndryshimin e pritur, që do të shpërthente energjinë e umetit dhe do të lëvizte fuqinë e fshehur emocionale. Ky dimension është fëmija, i cili do të përcaktonte llojin e pemës dhe shijen e frytit.

¹ Vepra këtu e përkthyer “Inhijar’ul-hadaret’il-islamijeh: El-Xhudhur’eth-thekafijjeti ve’t-terbevijjeh” është përmbledhje e veprës më të vëllimshme, me titull “Ezmet’ul-iradeti ve’l-vixhdan’il-muslim”, Damask, 2004. (Redaksia)

² Me shprehjen “umeti islam” kemi për qëllim të gjithë popujt muslimanë, pa marrë parasysh racën dhe nacionalitetin. Kështu do të përdoret gjatë gjithë tekstit (vërejtje e përkthyesit).

Ky libër është një përpjekje për të kuptuar mungesën e anës psikologjike dhe emocionale në shkrimet edukative islame rreth fëmijës, me qëllim që ky kuptim të jetë një bazament për ngritjen e fuqisë kreative në formimin psikologjik dhe emocional. Ky libër gjithashtu është një përpjekje për të njohur dimensionet kulturore dhe mendore që sollën këtë çrregullim, si dhe për të mësuar konceptet dhe pikënisjet që i mundësojnë umetit plotësimin e kësaj mangësie. Rikthimi i këtij faktori është i patjetërsueshëm në procesin e ndryshimit shoqëror dhe civilizues, i cili shpie në rikthimin e unifikimit mes anëve njohëse, psikike dhe emocionale në formimin e personalitetit të fëmijës. E gjithë kjo do të ndihmonte në ngritjen e energjisë kreative dhe shkencore në esencën e natyrës së fëmijës musliman dhe formimin e tij psikoemocional.

Për realizimin e këtij qëllimi, ky libër sqaron mjetet e nevojshme metodologjike dhe kulturore për reforma edukative, duke nxjerrë në pah themelet dhe pikënisjet më të rëndësishme të këtyre reformave. Libri në fjalë tërheq vëmendjen drejt institucionit “familje” dhe rolin qendror dhe natyral që ka ajo në realizimin e reformave edukative dhe ndryshimit shoqëror dhe civilizues, gjë që familjen e bën faktorin më të rëndësishëm në këtë kohë, me kusht që mendimtarët, pedagogët dhe institucionet tjera edukative të kryejnë punën e tyre në ngritjen e vetëdijes dhe mbështetjen e saj me çështjet e nevojshme edukative. Gjithashtu të mundësojnë që iniciativa për vënien e themeleve për ndryshim të jetë në duart e umetit, të përfaqësuar nga meshkujt dhe femrat. E gjithë kjo, duhet të merr në konsideratë dashurinë natyrore që gjendet te prindërit ndaj fëmijëve të tyre, për t’u sjellë atyre çdo të mirë dhe për të realizuar interesin e tyre shpirtëror dhe material, që është themel i formimit të umetit të fuqishëm dhe fisnik.

Është i domosdoshëm ballafaqimi serioz me tri krizat: kriza e mendjes dhe metodologjisë, kriza e mendimit dhe kulturës dhe kriza e emocioneve dhe edukatës. Pa tejkalimin e këtyre krizave, nuk ka asnjë mundësi për të realizuar mundësinë e umetit për rritjen e energjisë, ripërtëritjen dhe realizimin e qëllimeve të larta, duke u bazuar në ruajtjen e baraspeshës mes anës politike, mendore dhe edukative në përpjekjet e lëvizjeve reformiste, me qëllim të realizimit të fuqisë, lirimit psikologjik të muslimanit dhe ngritjes emocionale të tij.

Përgjegjës për këtë çështje janë mendimtarët dhe pedagogët. Çelësi më i rëndësishëm për të nxitur ndryshimin paqësor emocional është motivi natyror që gjendet në zemrat e prindërve dhe kujdesi i tyre amnor, të cilët nuk kursejnë asgjë për të realizuar interesin e fëmijëve të tyre, të cilët janë fuqia e së nesërme, materia e shoqërisë dhe brezi i së ardhmes.

Shpresoj që ky libër të hapë derën e dialogut serioz dhe konstruktiv, që cilësohet me sinqeritet dhe guxim, pa pasur frikë nga injoranca e injorantëve e as qëndrimet e qëllimkëqijve. Të hulumtohet hollësisht në thellësinë e problemeve mendore, kulturore dhe edukative të umetit, me qëllim që mendimtarët islamë të njihen me sëmundjet e fshehta të umetit, t'i njoftojnë besimtarët dhe udhëheqësit e tyre me realitetin e sëmundjeve psikologjike, devijimet mendore dhe praktike, si dhe të përgatisin për umetin projektin rreth metodologjisë së shëndoshë shkencore, mendore dhe edukative, që e vë iniciativën në duart e bijve dhe mendimtarëve të saj, duke u bazuar në energjinë natyrore të fshehtë në brendinë e tyre si themel për fillimin e aktiviteteve.

Ky është mesazhi i librit dhe ky është pikësynimi i tij, me shpresë që sado pak të kontribuon në menaxhimin e dialogut dhe përplotësimin e mjeteve të suksesit të projektit të

shumëpritur për reforma të civilizimit islam, si dhe rritjen e nevojës së njerëzisë për te.

Lusim Allahun të sjell suksesin për umetin, t'i sjell sukses mendimtarëve dhe aktivistëve. T'i ndihmon ata dhe të na udhëzojë të gjithëve në rrugën e drejtë. Tek Ai mbështetemi dhe tek Ai është kthimi jonë. Fundi i takon të devotshmëve, ndërsa falënderimet e plota Allahut, Zotit të botëve.

KAPITULLI I PARË

Problemi i hulumtimit dhe rrënjët e krizës

1.1. Problemi dhe shkaqet e hulumtimit

Problemi i këtij hulumtimi është njohja e shkaqeve të rënies dhe dobësisë së gjendjes së umetit. Po ashtu njohja e rrugëve që shpijnë drejt ripërtëritjes dhe rikthimit të fuqisë, si dhe hulumtimi - duke filluar nga roli qendror i fëmijës - drejt suksesit të projektit reformues. Anashkalimi dhe moskuptimi real i rolit të fëmijërisë, si dhe paaftësia për të nxitur energjitë e fshehta të kësaj periudhe, është prej shkaqeve më të rëndësishme të krizës së umetit.

Sipas këtij hulumtimi, dukuria e anashkalimit dhe moskujdesit për fëmijërinë në projektin reformues ka dy arsye:

I pari: çrregullimi që goditi metodologjinë e mendimit islam, ngase anashkaloi dimensionin njohës, gjithëpërfshirës dhe analitik, që ndërlidhet me njohjen e “ligjeve hyjnore”³ në natyrën psikologjike dhe hapësinore dhe në bashkëveprimin mes faktorëve, vertikalisht dhe horizontalisht në kohë dhe vend.

Për këto ligje hyjnore (ligje natyrore) jep shenjë Muhamedi alejh’is-selam ku thotë: “Njerëzit janë sikur xehet. Të dalluarit në periudhën e xhahilijetit (inJORANCËS) janë të dalluar edhe në Islam, nëse bëhen të kuptueshëm (mësojnë).”⁴ Kjo le të kuptohet se edukimi dhe zhvillimi ka themele psikike, të cilat janë ligje hyjnore dhe se mënyrat e bashkëveprimit me to përcaktojnë llojin e formimit psikologjik të

³ Qëllimi i shprehjes “ligje hyjnore” në natyrën e krijesave të gjalla dhe gjësëndeve është ajo që në mendimin materialist perëndimor njihet me shprehjen “ligjet natyrore”.

⁴ Muhamed ibn Ismail Buhariu, *Sahih’ul-Buhari*, Recensent: Musatafa El Buga, Bejrut, Dar Ibn Kethir, 1407 h/ 1987, vëll. 3, fq. 3194, nr. i hadithit 3132.

individit si dhe formojnë fuqinë dhe energjinë e tij, siç janë trimëria, frika, besnikëria, tradhtia etj. Këto energji shfrytëzohen në shoqëri - në këtë apo atë drejtim - varësisht se çfarë kahe i jep shoqëria. Ushtari dhe mafia, që të dy patjetër duhet të jeni besnik dhe trima, për të pasur sukses në punën e tyre, mirëpo ushtari këtë e shfrytëzon për të mbrojtur sigurinë e umetit, ndërsa mafia e shfrytëzon për të dëmtuar njerëzit.

Si rezultat e çrregullimit në metodologjinë e të menduarit vërejmë vetëdijen e ulët rreth rëndësisë së studimit shkencor, atij teorik dhe praktik të formimit psikologjik të njeriut, rolin e periudhës fëmijërore, llojin e diskursit psikologjik dhe pedagogjik të përshtatshëm për secilën fazë të periudhës fëmijërore, si dhe ndikimin e gjithë kësaj në formimin psikologjik të individit musliman. Kjo i ofron motive emocionale dhe psikologjike të nevojshme për të, me qëllim që rinia të jenë faktor efektiv në reforma dhe ndryshim, në përmirësimin e pikëpamjeve universale natyrore dhe shoqërore, evitimin e gjitha devijimeve, rikthimin e fuqisë për kryerjen e detyrës me përpikëri dhe përbalimin e gjitha sfidave në mënyrë optimiste dhe efektive.

Arsyeja e dytë: mungesa e diskursit (komunikimit) të shëndoshë psikologjik, pedagogjik, shkencorë, i cili është i patjetërsueshëm për formimin psikologjik të fëmijës musliman. Kjo mungesë ka bërë që ai të zhvillohet si njeri, të cilit i mungon dimensionimi emocional efektiv dhe i nevojshëm për të lëvizur tek ai energjinë, përpjekjen dhe optimizmin që është kusht i detyrueshëm për posedimin e fuqisë për përbalimin e suksesshëm të sfidave me të cilat ballafaqohet umeti.

Diskursi i shëndoshë psikologjik, pedagogjik, shkencor është i domosdoshëm gjithashtu për të përmirësuar devijimet dhe anomalitë që gjenden si tek individët ashtu edhe në shoqëri. Çrregullim në metodologjinë e mendimit. Për

këtë, kjo mungesë është ajo që sqaron paaftësinë e muslimanit dhe umetit islam deri më sot për t'iu përgjigjur kërkesave të projektit reformues dhe civilizues islam, për përmirësimin e devijimeve, për arritjen e unitetit dhe përpikërinë në zbatim, edhe pse qëllimet e këtij projekti dhe vetëdija njohëse të rriturit e këtij umeti janë të qarta dhe të shëndosha.

Për këtë arsye, është e rëndësishme të perceptojmë se arsyeja e dytë e shkaqeve të pamundësisë së umetit për të reformuar gjendjen e çrregullimit të diskursit pedagogjik, është rezultat i arsyes së parë e që është mangësia metodologjike e mendimit islam. Kjo mangësi është si rezultat i izolimit dhe largimit të njerëzve fetarë dhe prijësve të umetit nga angazhimi në jetën politike dhe shoqërore, si dhe nga studimi dhe testimi i saj. E gjithë kjo rezultoi në zvogëlimin e rolit të burimit të dytë të njohjes islame, respektivisht njohjes njerëzore për të perceptuar ligjet dhe natyrat kozmike dhe njerëzore, ngjarjet kohore dhe vendore dhe shfrytëzimi i tyre në mënyrë praktike dhe efektive për menaxhimin e politikës së umetit dhe çështjet e saj, me qëllim të realizimit të intencave universale të udhëzimit hyjnor për njeriun, të ngritur mbi bazën e shëndoshë shkencore dhe njohëse.

Mungesa e burimit të njohurive njerëzore në ligjet dhe natyrën e çështjeve ka rezultuar përhapjen e mentalitetit imitues. Më pas edhe paaftësinë e perceptimit të natyrës së ndryshimeve, humbjen e fuqisë për të bashkëvepruar në formimin, zhvillimin dhe përgatitjen e psikikës njerëzore në fazat e ndryshme të fëmijërisë.

Gjatë këtyre fazave, formohet lloji i shtytësve psikologjik dhe emocional, konceptet njohëse dhe metodologjike, të cilët formojnë mentalitetin e anëtarëve të shoqërisë në aspektin psikologjik dhe emocional. E gjithë kjo tek ata

mundëson një formim original që rezulton kuptimin e gjitha risive që sillen përreth tyre dhe përballimin e sfidave.

1.1.1. Shkaqet e hulumtimit

Shkaqet e hulumtimit në këtë çështje kognitive dhe edukative përfshihen në ndjenjën e nevojës prioritare për ripërtëritjen e formimit psikologjik islam dhe rikthimin e fuqisë dhe energjisë etike, civilizuese dhe kreative. E gjithë kjo me qëllim të arritjes së suksesit në projektin civilizues islam dhe realizimit të objektivave fisnike.

Kjo çështje ka dimensione të shumanshme. Disa ndërli-dhem me vetë Islamin, nga fakti se është mesazh i lartë hyjnor. Disa ndërli-dhen me vetë njerëzinë e ndëshkuar, e habitur dhe e konfliktuar. Ndërsa disa të tjera ndërli-dhen me muslimanët, të cilët në tërësi janë të dobët, konfliktuoz, të shtypur dhe të robëruar.

Dëmet e prapambetjes, dobësisë, përçarjes dhe paaftësisë së umetit islam nuk kufizohen vetëm në umetin islam, por ato gjithashtu pengojnë dritën e mesazhit islam që të bëhet mitër e një civilizimi të vërtetë, e lumturisë shpirtërore dhe materiale dhe e dobishme për këtë botë dhe botën tjetër. Themi kështu, ngase mesazhi islam është mbarëkombëtar, udhëzimi i tij është universal shpirtëror dhe etik, që ka për qëllim realizimin e njëshmërisë në besim, hilafetin në tokë, vëllazërinë, paqen, drejtësinë dhe mëshirën.

Pengimi i mesazhit islam civilizues në kohën e pjekurisë së komponentëve dhe potencialeve botërore në jetën e njerëzve, llogaritet krim i madh, mëkatin e të cilit do ta bartë umeti islam në përgjithësi dhe njerëzit e kulturuar dhe mendimtarët në veçanti.

Ajo që e ka goditur njerëzinë - për shkak të dominimit të përqaesjes materialiste dhe raciste - me luftëra dhe konflikte botërore, padrejtësi dhe tragjeditë e “kolonializmit”, në të

ardhmen do të jenë edhe më të padrejta, më të vrazhda dhe më të ashpra! Këto padrejtësi do të zmadhohen me zmadhimin e mjeteve të të fortëve, në një botë ku dominon diskriminimi, lakmia e materiales, ashpërsia e garës dhe mendjemadhësia e të fortëve.

Shpëtimi i umetit islam nuk është shpëtim vetëm i 1/5 të njerëzve në tokë, por është shpëtim i njerëzisë në përgjithësi, të cilën e kërcënon egërsira e ligjit të malit, era e keqe e racizmit dhe rritja e fuqisë së shkatërrimit. Shpëtimi i umetit islam nuk është vetëm çështje emocionesh dhe dëshirash, por gjithashtu është çështje e një veprimi dhe mundi shkencor metodologjik, i sistemuar dhe me kritere, që shpie në pastrimin e Islamit nga çështjet e traditave të trashëguara, devijimet në zbatim, mitet e paraardhësve gjatë tërë historisë islame, të cilët janë në kundërshtim me Islamin burimor.

Për të pastruar Islamin, kulturën islame dhe konceptet elementare të tij, është e domosdoshme rikthimi i të kuptuarit të Kur'anit, perceptimi i ecurisë së tij në historinë e umetit dhe njohjen e faktorëve dhe pikave kthesë që kanë formuar ecurinë e umetit dhe ecurinë e mendimit dhe kulturës islame. Atëherë, umeti do t'i kuptojë shkaqet e ndotjes kulturore dhe devijimet shoqërore në ecurinë historike të tij, si dhe do të njihet me rrjedhën e këtyre ndotjeve dhe devijimeve, me qëllim që të jetë në gjendje të përmirësojë drejtimin.

1.2. Metodologjia

1.2.1. Gjithëpërfshirja dhe pjesëmëria në metodologji

Ky hulumtim ka për qëllim t'i hulumtojë në mënyrë objektive ligjet hyjnore në hapësirë dhe në krijesa. Kjo metodologji është plotësisht islame në objektivat universale, shpirtërore dhe etike. Ajo kështu është metodologji gjithë-

përfshirëse, analitike, historike dhe me kritere që i përmbahet objektivave islame.

Gjithëpërfshirja në hulumtimet shoqërore është e domosdoshme, ngase synon njohjen e dukurive dhe perceptimin e shkaqeve të fshehta. Çdo hulumtim i pjesshëm në këto sfera, që kanë formim të ndërlikuar dhe shkaqe të shumta, hutojnë hulumtuesin dhe çrregullojnë çështjen e dukurive në atë mënyrë që rezulton perceptime të përafërta me trillime dhe iluzione.

Pamja e lidhshmërisë mes hulumtimit të pjesshëm dhe atij gjithëpërfshirës në studimet shoqërore, është e ngjashme me atë person i cili sjell një letër dhe mbi të hedh ngjyrë, ku më pas fillon të meditojë me syrin e iluzioneve në gjitha ato forma, vizatime dhe forma të cilat në realitet nuk ekzistojnë. Nuk prishë punë derisa ai e ka të qartë se ato forma nuk janë gjë pos ngjyrë e hedhur në mënyrë të pakontrolluar mbi një letër të bardhë.

Metodologjia e pjesshme - për ata që nuk dinë përdorimin e tij dhe nuk kuptojnë kufijtë e efikasitetit të tij - shpesh herë shpie në perceptime dhe rezultate të pasakta, që nuk ndërlidhen fare me realitetin. Hulumtuesit që përdorin këtë metodologji ndodh të nervozohen dhe të kundërshtojnë mospranimin e mendimeve të tyre, të cilat me seriozitetin më të madh i shohin si të vërteta.

Ngjashëm me këtë dallim mes hulumtimit gjithëpërfshirës dhe atij të pjesshëm, është edhe gjykimi ndaj çështjeve pa marrë në konsideratë rrethanat kohore dhe vendore. Kështu gjykohet mbi bazë të pjesshme dhe përshtypje vetjake, pa u mbështetur në hulumtim të përgjithshëm, e as perceptim të shëndoshë në relativitetin e kuptimeve në rrethanat dhe ndërhyrjet me faktorët tjerë bashkëveprues. Shembull për këtë kemi thënien kuturi se shuma një milion është shumë e vogël apo e madhe! Nëse kjo shumë është rrogë

mujore për ndonjë person, atëherë është shumë e madhe, por nëse bëhet fjalë për buxhet të ndonjë organizate apo shteti, atëherë me siguri se bëhet fjalë për një shumë të vogël.

Për këtë, trajtimi i krizës së umetit, paaftësia e popujve islamë dhe pamundësia e projektit civilizues për të realizuar objektiva të larta, gjatë shumë shekujve, e obligon hulumtuesin që sa më shumë të mbështetet në gjithëpërfshirjen analitike, kur bëhet fjalë për dukurinë e përçarjes, dobësisë dhe prapambetjes, nga të cilat vuan umeti islam.

Dobësia e guximit etik dhe qëndrimit kritik, si dhe ngulitja e frikës te anëtarët e umetit, ka bërë që shumica e trajtimeve të tyre të cilësohen si sipërfaqësore, emocionale dhe false, duke penguar hulumtimin e thellë dhe analizën serioze, deri sa mendimi dhe mendimtari islam bashkëkohor shfaqen sikur të jenë kafshë të egra që shfaqen në cirke, të cilat nga frika si rezultat i trajnimit të gjatë të tyre, veprojnë në kundërshtim me natyrën e tyre. Kështu mendja dhe mendimi i muslimanit - bazuar në këto përmbajtje kulturore - është bërë vetë rojtari i burgut dhe prift i tempullit të prapambetjes dhe paaftësisë së tij.

Vlen të merren si shembull që sqaron këtë dukuri psikologjike, përmbajtjet kulturore dhe besimet e hindusëve, si dhe pasojat e këtyre besimeve që kanë sjellë frikë psikologjike tek ithtarët e tyre përgjatë shumë shekujve. Kështu, si rezultat i këtyre përmbajtjeve kulturore hinduse, vërejmë se mijëra miliona njerëz të shtresave të ulëta në Indi janë rojtarrë të gjendjes së mjerueshme të tyre.

Sa është e dhembshme dhe për të ardhur keq, kur sheh një numër të madh të mendimtarëve islamë përmbahen nga shprehja e mendimit, përpos brenda kufijve të zakonshmes. E gjithë kjo për shkak të ngulitjes së përmbajtjeve kulturore të trashëguara në brendinë e tyre, nga frika e reaksionit

psikologjik jo logjik, i cili gjatë një kohe të gjatë është përsëritur dhe thelluar në mendjet e popullatës. Një gjendje e tillë nuk do të lejojë dialog të shëndoshë, i cili do të jep hapësirë për shprehjen e mendimeve të reja dhe ixhtihadit, i bazuar në themelet dhe çështjet e pandryshueshme dhe bazike në besim dhe intenca, e jo në çështjet e trashëguara dhe të devijuara nga kohët e mëhershme.

Është e domosdoshme që mendimtari musliman të pajiset me guxim në shprehjen e mendimit dhe me renovim në mendim dhe hulumtim, me qëllim që të ecë baras me ndryshimet që ndodhin në jetë. Ai duhet të ketë në konsideratë njohuritë dhe përvojat e mundshme, sfidat e llojllojshme dhe ndryshimet që ndodhin, me qëllim që këto parime dhe vlera, në mënyrë praktike dhe efektive t'i zbres në jetën reale të njerëzve, në marrëdhëniet, bashkëveprimet dhe ngritjen e institucioneve të tyre.

1.2.2. Gjithëpërfshirja dhe formimi i prioriteteve

Hulumtimi gjithëpërfshirës analitik nuk merr në konsideratë - pa argument - vetëm një faktor ndikues në çfarëdo dukuri shoqërore, por sipas tij, në esencë analiza bazohet në disa faktorë. Mbështetja e pjesshme - për shkaqe kulturore, emocionale ose përzgjedhje të rastësishme - vetëm në një faktor të caktuar ndaj një numri të faktorëve dhe shkaqeve, duke injoruar shkaqet tjera objektive dhe të rëndësishme që ndër lidhen me forma të ndryshme me atë dukuri, është thjeshtëzim i tepruar. Gjithashtu, thjeshtëzim i tepruar është edhe mbështetja në rezultatet e hulumtimit të pjesëm, e cila zakonisht është e përmbushur me elemente emocionale të trashëguara për të mposhtur mendjet dhe ndjenjat e masës. E gjithë kjo vë pengesa metodologjike dhe ndalon mendimin kritik dhe serioz, dialogun e qetë dhe të fortë, për të penguar perceptimin e realitë të çështjeve, ndrit-

jen e mendjeve, zgjidhjen e problemeve dhe përballimin e sfidave.

Njohja e faktorëve të rëndësishëm dhe ndikues, si dhe njohja e ndërlikohjes së këtyre faktorëve, vertikalisht dhe horizontalisht, në cilën do çështje apo sferë, është çështje shumë e rëndësishme për të kuptuar dukurinë shoqërore, ndjekjen e gjurmëve dhe vënien e zgjidhjeve efektive për të bashkëvepruar me to. Megjithatë, kjo nuk pengon radhitjen e prioriteteve dhe zgjidhjen e problemeve në bashkëveprim me këta faktorë.

Gjatë studimit të ndonjë çështje apo dukurie shoqërore, nuk është e rëndësishme të hulumtohen vetëm faktorët ndikues ose njohja e llojit të bashkëveprimit mes këtyre faktorëve, por është e domosdoshme ndarja mes shkaqeve rrënjësore dhe komplikimeve që vijnë si rezultat i tyre. Shumë prej mendimtarëve merren me komplikimet dhe nuk i kushtojnë rëndësi të mjaftueshme çështjeve elementare. Kështu, përpjekjet e tyre sillen rreth disa çështjeve të pafundme të trajtimeve sterile dhe të përsëritura. Shembulli i këtyre njerëzve është sikur shembulli i atij personi që harxhon skajshmërisht energjinë e tij për të mjekuar të sëmurët nga bilharzia, pa u kujdesur fare për esencën e sëmundjes dhe për të luftuar hedhjen e mbeturinave në burimet e ujit, të cilat ndotin ujin dhe e bëjnë shkak të vazhdueshëm për sëmundje dhe përhapjen e infeksionit. Pengimi i komplikimeve është çështje që nuk zëvendëson pengimin e çështjeve elementare. Pengimi i kolonializmit, globalizmit dhe çështjeve që ndërlikohen me to, siç është sundimi hegjemon ndërkombëtar tiran, nuk nënkupton në asnjë mënyrë që ne në mënyrë të pamjaftueshëm të pengojmë shkaqet sensibilizuese të kolonializmit, si dhe përballimin e fuqishëm ndaj shkaqeve të dobësisë dhe prapambetjes së umetit.

Kështu, e rëndësishme për ne në këtë hulumtim është perceptimi i fotografisë së përgjithshme, njohja e faktorëve esencial ndikues në krizën e prapambetjes, përçarjes dhe dobësisë së umetit, kuptimi i llojit të ndërhyrjes mes këtyre faktorëve, perceptimi i elementeve që ndikojnë dhe ndikohen mes tyre, vertikalisht dhe horizontalisht, në kohë dhe vend dhe grumbullimi i komplikimeve të brendshme dhe të jashtme të ndërlidhura me to.

Perceptimi gjithëpërfshirës i shëndoshë ndaj gjithë këtyre faktorëve merr në konsideratë konotacionin e vërtetë anësor të ndikimeve kalimtare, të cilat nuk ndryshojnë drejtimin elementar të linjës grafike gjatë ngritjes apo uljes. Këto valë kalimtare - në të shumtën e rasteve - nuk merren në konsideratë gjatë përcjelljes së lëvizjes universale të linjës grafike dhe njohjen e orientimit të lëvizjes universale në te.

Çështja e këtyre valëve anësore dhe kujdesi për to është i rëndësishëm në sferën e praktikave empirike, që nuk ndërlidhen me studime dhe hulumtime, të cilat ndjekin orientimet e civilizimeve në ngritje dhe rënie. Thellimi në brendinë e këtyre çështjeve pamundëson pamjen, ç'orienton kuptimin dhe ngulfat mendimin në rërë të zezë dhe lëvizje zhgënjyese, gjë që shpie në hulumtim steril që i ngjanë vrapimit të të çmendurit pas hijes së tij apo përpjekja e maces për të zënë bishtin e saj.

Ne mendojmë se kemi të drejtë kur themi se boshllëku i "fuqisë" civilizuese dhe "kryerjes - performansës" së dalluar, me kalimin e kohës po shtohet edhe më shumë mes umetit islam dhe popujve përparimtarë. E gjithë kjo për shkak të përshpejtimit të mundësive shkencore dhe teknike bashkëkohore te këta popuj, gjë që u mundëson për të ushtruar pushtetin dhe sundimin ndaj umetit dhe pasurive të tyre, gjë e cila edhe më shumë shton urrejtjen, injorancën, sëmundjet dhe prapambetjen e umetit.

Në periudhën e sfidimit perëndimor dhe dobësimin e shtetit osman, shtet i fundit i madh islam, vërejmë se përpjekjet reformuese në botën islame janë të llojllojshme dhe të shumta gjatë afër tre shekujve. Duke filluar me lëvizjen e reformave fetare nga Muhamed ibn Abdulvehabi (vd. 1792) në Gadishullin Arabik, Shah Velijullahu (vd. 1936) në Indi, sulltani osman Selimi III (vd. 1807). Po ashtu lëvizjet reformuese fetare, siç ishin ajo e Muhamed ibn Ali Senusi (v. 1859) në Libi, Muhamed Mehdi (vd. 1885) në Sudan, Muhamed Ali Pasha (vd. 1849) në Egjipt, ministri osman Hajredin Pasha në Tunisi (vd. 1890), Sejid Ahmed Han (vd. 1898) në Indi, Xhemaledin Afagani (vd. 1879), Imam Muhamed Abduhu (vd. 1905), Abdurrahman Kevakibi (vd. 1902), Muhamed Reshid Rida (vd. 1935), Hasan Bena (vd. 1949), Ibn Badis (vd. 1943) dhe Ibn Ashur (vd. 1973).

Kësaj i bashkëngjiten edhe lëvizjet e pavarësisë në shumë prej vendeve islame që nga mesi i shekullit XX dhe deri më sot. Në këtë periudhë u shfaqën përpjekjet urbane civile, lëvizjet kombëtare laike dhe çdo gjë që lindi si rezultat i këtyre mendimeve, lëvizjeve dhe përpjekjeve, duke përfshirë ndryshime mendore, kulturore dhe urbane. Megjithatë, krejt në fund - nga ajo që po shihet - nuk kanë arritur të kenë sukses në zbulimin e sëmundjeve reale të umetit, e as të japin recetën e duhur për nxjerrjen nga prapambetja, si dhe ndihmën për t'u përballuar me sfidat e mëdha të kohës!

Për ta realizuar këtë çështje, duhet të perceptojmë pikënisjet e këtij mendimi në kohën e tashme. Këto pikënisje, në aspektin ideologjik të drejtpërdrejtë ndërlidhen me pikënisjet e shejh Abdurrahman Kevakibit dhe mendimin e tij në librat: "Umm'ul-Kura" dhe "Taba'ul istibdad". Në librin e tij "Umm'ul-Kura", ai paraqet një sërë parime të mëdha islame dhe vlera të larta elementare. Këtyre parimeve

iu prijnë parimi i tevhidit, vlerat e drejtësisë, solidaritetit dhe konsultimit. Ndërsa në librin “Tabai’ul-istibdad”, për prapambetjen e umetit qorton qeveritë, duke theksuar se udhëheqjet janë të zhytur në diktaturë dhe korrupsion.

Është me rëndësi në aspektin metodologjik të vëresh se edhe krahas asaj se kanë kaluar më shumë se njëqind vite nga dalja e këtyre dy librave në dritë, kalimi i më shumë se shtatëdhjetë e pesë vite nga lindja e lëvizjeve reformiste politike islame, si dhe përpjekjet e njëpasnjëshme të qeverive civile dhe lëvizjeve laike, nuk mund të hasim se umeti është më afër realizimit të qëllimeve se sa ishte më parë.

Pyetja metodologjike që mund të lindë këtu është: për çka, gjatë gjithë kësaj kohe, këto përpjekje dhe këto lëvizje nuk patën sukses në realizimin e pjesës më të madhe të objektivave?

Hulumtimi shkencor i sistemuar është shpresa që shpie - me ndihmën e Allahut - në zgjidhje të plotë, në mbështetjen e përpjekjeve për përballimin e krizës dhe tejkalimin e pengesave për realizimin e synimeve dhe përmirësimin e gabimeve. Kjo nuk do të thotë se çdo gjë që është realizuar deri më sot ishte gabim, por sigurisht se nuk ishte e mjaftueshme për të sjellë ndryshimin dhe reformat e synuara.

Me siguri se përpjekjet në hulumtim dhe thellim mendor dhe metodologjik duhet të vazhdojnë të kryejnë rolin e tyre në mënyrë edhe më të thelluar, me mund dhe guxim edhe më të madh, pa tejkalar kufijtë e themeleve metodologjike shkencore islame. E gjithë kjo me qëllim që hulumtuesi të perceptojë çështjet e pandryshueshme nga ato të ndryshueshmet, larg çdo supozimi mashtrues. Kjo, në aspektin metodologjik, kur bëhet fjalë me çështjen të cilën jemi duke e diskutuar, le të kuptohet se ka faktorë të panjohur, prej të cilave varet aktivizimi i përpjekjeve dhe bashkëveprimi me faktorët tjerë. Kjo le të kuptohet gjithashtu se përpjekjeve

mendore duhet dhënë lirinë e mjaftueshme për hulumtim, si dhe kjo çështje, në këtë kohë të vështirë për umetin, të jetë me prioritet në mesin e përpjekjeve të mendimtarëve dhe të interesuarve.

1.2.3. Rëndësia e perceptimit të veçorive akaidore dhe ideologjike

Çështje të parë që e vëren hulumtuesi në shumë prej pikënisjeve të renesancës dhe projekteve reformuese të vonuara të umetit - pa marrë parasysh shkaqet dhe motivet - është se ato pikënisje nga fillimi janë imitim, ose në drejtim të historisë me diskurs të përmbushur me simbole emocionale, ose në drejtim të imitimit të të huajve. Është e qartë se imitimi, trillimi dhe përngjasimi nuk ka aktivizuar energjinë, e as nuk ka lëvizur motivet. As nuk do të bëjë një gjë të tillë. Kështu, puna e muslimanit do të mbetet e mangët, e dobët dhe e tretur, deri sa umeti dhe orientimet e projekteve të mbeten në formë imitimi dhe përngjasimi, ngase ato as nuk kthejnë historinë e as nuk lëvizin energjinë e fshehtë.

1.2.4. Gabimet e “pllenimit” ideologjik mes dje dhe sot

Umeti që nga fillimi i saj nuk ka arritur të kursejë përpjekjet e mëdha të nevojshme për plotësimin e shkrirjes kulturore dhe edukative të popujve, të cilët kanë depërtuar në brendinë e saj. E gjithë kjo për shkak të sasisë së madhe dhe shpejtësisë marramendëse, si dhe përshpejtimit të ngjarjeve si rezultat i zgjerimit të territoreve.

Në shumë prej rasteve, mendimi i umetit, në atë periudhë të hershme, ka gabuar, ose nuk ka arritur të përcaktojë prioritetet dhe të kursen gjërat e nevojshme gjatë ballafaqimit me çështjet e trashëguara të fiseve dhe popujve dhe çështjet e miteve dhe filozofive të ndërlidhura me Zotin. Kjo, në fund ishte e patjetërsueshme të sjell pasoja të rrezikshme, të cilat harxhojnë energjinë e umetit, shtrembërojnë

pamjen e tij dhe sjellin përçarje, çrregullime dhe devijime të institucioneve. E gjithë kjo në fund sjell dobësi në energjinë akaidore dhe ideologjike, humbjen e argumentit akaidor dhe kornizën metodologjike ideologjike, të cilat llogariten si veçori dhe fuqi për ripërtëritje, përmirësim të ecurisë së lëvizjes shoqërore dhe zhvillimin e institucioneve.

Për të kuptuar konceptin e veçorive të popujve dhe dimensionet civilizuese, është me rëndësi të perceptojmë se çdo gjë në hapësirë është e sistemuar. Duke filluar nga qeliza, atomi e deri te galaktika. Çdo sistem ka karakteristikat, rregullat e veprimit dhe kufijtë e energjisë. Nëse nuk kontrollohen këto karakteristike, rregulla dhe kufij, atëherë sistemi do të shkatërrohet.

Shembull më i përafërt dhe praktik për këtë çështje kemi trupin e njeriut. Njeriu ka një sistem që ka karakteristikat, rregullat dhe kufijtë e energjisë. Nëse njeriu thithë një sasi të caktuar të oksigjenit nga hunda, ajo do t'i sjell dobi. Po nëse përmes hundës merr një injeksion në venë -qoftë edhe një centimetër - do ta mbytë menjëherë. Pra, çështja nuk ndërlidhet vetëm me atë se çka merr ose jo sistemi, por edhe me formën se si merren ato dhe si i pranon sistemi. Ngjashëm me këtë është edhe çështja mes kulturave dhe civilizimeve. Është patjetër vrotimi i karakteristikave, vlerave dhe intencave në atë që merr dhe lenë, mënyrën se si e merr dhe e lenë. Këtë çështje, mendimtarët musliman nuk e kanë hulumtuar me një metodë të mprehtë shkencore, e as nuk ia kanë kushtuar rëndësinë e merituar.

Sot umeti, gjatë përballjes së mendimit të tij të ngushtë dhe sistemit të tij të dobët me mendimin e huaj të fortë dhe me institucionet e tij të zhvilluara vazhdimisht, është i habitur me fuqinë e sukseseve, gjë që është bërë pengesë mes tyre dhe njohjes së natyrës së sistemit të mendimit dhe karakteristikave të ekzistencës së tyre.

Harmonizimi mes ndërgjegjes dhe emocioneve të umetit islam nga njëra anë dhe natyrës së mendimit, synimet e lëvizjes dhe sistemit të tij nga ana tjetër, është detyrim për shpërthimin e energjisë dhe nxitjen e entuziazmit të muslimanët. Me siguri se periudha e shpalljes së Kur'anit dhe periudha e halifëve të drejtë, është shembulli më i mirë ndriçues në historinë e umetit.

Sa i përket mendimit islam bashkëkohor, atij i mungon udhëzuesi i vizionit. Ai vepron në mënyrë të çorientuar, pa pasur bazament metodologjik për bashkëveprim me civilizimin perëndimor, ashtu siç ndodhi me bashkëveprim e çorientuar dhe jometodologjik gjatë periudhës emevite dhe abasite, mes sistemit mendor dhe civilizimit islam me sistemin mendor dhe civilizimin grek, gjë e cila e falimentoi atë dhe ia humbi rolin. Ky bashkëveprim, edhe pse i ndihmoi civilizimit islam të mëson industrinë dhe shkencat fizike, megjithatë e dëmtoi shpirtin e civilizimit islam në dimensionin shpirtëror, akaidor dhe metodologjik shkak-pasojë. Ngadalësoi lëvizjen e tij dhe përfundoi në turbullimin e vizionit hapësinor islam, logjikën formale dhe humbjen e metodologjisë shkencore eksperimentale islame.

Kështu mbizotëruan tek umeti islam israilizmat, besëtytnitë, legjendat dhe magjitë, që në fund sollën shuarje dhe vdekje. E njëjta gjë po përsëritet sot në formë tjetër, mes sistemit mendor dhe civilizimit islam me sistemin mendor dhe civilizimit materialist perëndimor, pa pasur kujdes në gabimin e madh metodologjik që e bëmë më herët dhe pa marrë mësimin e merituar.

1.2.5. Mendimi pedagogjik dhe ndryshimi shoqëror

Bazuar në atë se çështja e fazës fëmijërore dhe mendimi pedagogjik që ndërlihet me te, llogaritet pikënisje themelore për realizimin e ndryshimit shoqëror, atëherë qëllimi i

këtij hulumtimi është vënia e kësaj çështje në tavolinën e studimit, mendimit dhe hulumtimit. Krahas kësaj, hulumtimi do të përfshijë edhe çdo gjë tjetër të ndërlidhur me temën, siç janë çështjet e pastrimit të kulturës islame, pastrimit e rrethanave pedagogjike, përplotësimi i mendimit islam me mjete metodologjike për studimin e ligjeve dhe realitetit në kohë dhe vend, në kuptimin e civateve kur'anore dhe pejgamberike, kuptimin e historisë, perceptimin e mësimave që nxirren nga tekstet dhe historia në atë mënyrë që përshtatet me kohën dhe vendin.

Kështu, këto studime kontribuojnë në mënyrë pozitive dhe efektive në formimin e mentalitetit të fëmijës musliman, si dhe në formimin e tij në aspektin psikologjik dhe emocional. Në këtë mënyrë, ai zhvillohet i pastër nga deformimet dhe devijimet që prishin vizionin hapësinor të muslimanit, dobësojnë tek ai shpirtin shkencor dhe energjinë kreative, si dhe çrrënjosin krenarinë, dinjitetin, vëllazërinë dhe bashkëpunimin në formimin e tij psikologjik dhe mental.

Faza fëmijërore, duke kuptuar domethëniet shkencore dhe psikologjike për të shkaktuar ndryshim shoqëror, është dimension i themelor dhe i fshehur në shkaktimin e ndryshimit psikologjik, kolektiv dhe të detyrueshëm për të rikthyer vizionin, për të lëvizur energjinë emocionale dhe për të përballuar sfidat.

Rëndësia e këtij hulumtimi fshihet në nxjerrjen në dritë të këtij dimension i të fshehur, në sqarimin e bashkëveprimit të tij me faktorët tjerë, njohjen e rrugëve praktike dhe shkencore për përplotësimin e kësaj mangësie, si dhe mbylljen e kësaj vrimë. E gjithë kjo, krahas edhe përpjekjeve tjera, me qëllim të ngritjes së projektit reformues, përplotësimin e mjeteve, në shërbim të umetit dhe mbarë njerëzisë, si dhe zbardhjen e mesazhit islam në sistemin e fshatit botëror bashkëkohor.

Me siguri se faktorët e dobësisë që na kapluan, na vënë në fund të karvanit. Për këtë, shpresojmë që lexuesi të kupton qëllimin e kritikës, ngase hulumtimi ka për qëllim vetëm përplotësimin e mangësive dhe grumbullimin e përpjekjeve. Vlerësimi dhe respekti ndaj të parëve tanë ose dëshira për të prezantuar mendimin tonë në formën më të mirë, nuk duhet të jetë pengesë për njohjen e pikave të dobëta në çështjet që ishin para nesh. E gjithë kjo me qëllim që të realizohet synimi i shpresuar inshaAllah.

Është gabim të gjykohet e kaluara me rrethanat e realitetit bashkëkohor. Nëse dëshirojmë që vlerësimi të jetë real dhe i baraspeshuar, atëherë e kaluara duhet gjykuar me rrethanat e kohës së tij. Kemi të drejtë që me admirim të plotë të vlerësojmë kontributin e civilizimit islam gjatë historisë njerëzore, me kusht që ta gjykojmë atë nën hijen e realitetit dhe rrethanave të kohës së tij.

Civilizimi islam paraqet një periudhë të ndritshme dhe një ndryshim gjigant në historinë njerëzore. Për këtë dëshmojnë gjurmët e këtij civilizimi, ndryshimet që solli në jetën e popujve musliman dhe kontributin që solli në trashëgiminë e civilizimit njerëzor bashkëkohor, përfshirë bazamentet, metodologjitë dhe pikënisjet. Me siguri se çarjet dhe dobësitë e ngritjes së civilizimit islam kanë ndodhur për shkak të humbjes së pikënisjeve të udhëzimit islam në çështjet shpirtërore, etike dhe shoqërore, gjë që përpiqemi sot ta kuptojmë dhe rikthejmë.

1.3. Rrënjët e krizës

Pa dyshim umeti islam është në krizë. Botës islame nuk i mungojnë resurset dhe burimet materiale dhe njerëzore. Ata janë afër një miliardë e pesëqind milionë muslimanë, ose 1/5 e popullatës në tokë. Asaj nuk i mungojnë vlerat e as

parimet, si dhe objektivat dhe qëllimet e larta me të cilat është i pasur Islami.

Atëherë, çka e goditi umetin islam? Si devijoi nga rruga e saj? Si u shtrembërua motivi fetar islam derisa përfundoi në këtë gjendje të dobët dhe të prapambetur? Përse përpjekjet reformuese dhe projektet për ndryshim, gjatë disa shekujve, nuk patën sukses në rikthimin e gjendjes normale dhe drejtimin e ecurisë?

Në lidhje me pyetjet e lartpërmendura, mund të themi se e gjithë kjo nuk ka qenë për shkak se ka munguar dëshira për përmirësim dhe reformim! Në këtë drejtim është shpenzuar dhe vazhdon të shpenzohet shumë. Mirëpo, është e qartë se faktorët e pengesës dhe devijimit kanë qenë të shumtë dhe me rrënjë të thella, si dhe ndodhitë ishin shumë të shpejta. Ishin më të mëdha se sa energjia e disponueshme për ta ndjekur atë, e mos të flasim për tejkalimin ose kontributin për të shënuar ecurinë e tij. Kështu, veprimet ngjanin më shumë se reaksion, të cilat nuk lejonin kontroll ndaj rrethanave, thellim në meditim ndaj çështjeve, e as për të kuptuar natyrën e tyre dhe mënyrat e përballimit me to.

Nëse udhëzimi islam nuk është i kufizuar vetëm me një popull, e as vetëm me një kohë, por është udhëzim për mbarë njerëzinë deri në mbarimin e ekzistimit njerëzor në tokë, atëherë është e drejtë e çdo individ, çdo popull dhe çdo brezi të merr prej tij sipas mundësisë dhe aftësisë dhe t'u sjell dobi të tjerëve.

Periodha e shpalljes ishte mishërim dhe zbatim i parimeve dhe vlerave në jetën praktike të njerëzve. Ishte argument për mbarë njerëzinë se zbatimi i tij dhe zbatimi i parimeve dhe vlerave në vëllazërim, drejtësi, solidaritet e tjera në jetën e njerëzve është i mundur.

Islami nuk është vetëm mendime, filozofi, ëndrra, mendime dhe iluzione, siç bëjnë filozofët idealistë, por ai

është mesazh i vërtetë dhe udhëzim për mbarë njerëzinë. Islami sqaron çështjet universale, furnizon njeriun me vlera dhe parime, ia ndriçon rrugën dhe e orienton në drejtim të duhur. Në këtë çështje janë të barabartë të gjithë njerëzit dhe të gjithë brezat.

1.3.1. Energjia e motivit imanor-civilizues dhe akumulimi material-ndërtimor

Kur shikojmë ecurinë e motivimit të parë islam dhe atë që solli vizioni islam dhe brezi i parë në trungun e umetit dhe civilizimit islam gjatë historisë, si dhe në mënyrën se si më pas u pengua dhe u dobësua ecuria e mesazhit islam në jetën praktike të umetit, na duket sikur vlerat, vizioni dhe shpirti islam në vëllazërim, drejtësi, shpenzim dhe përpikëri në punë, pothuaj janë jashtë përdorimit në jetën reale të umetit islam sot.

Këtu, në të kuptuarit e historisë, duhet të mos përziejmë mes dy gjërave: mes fuqisë së motivimit specifik, nga njëra anë dhe mes akumulimit ndërtimor dhe përparimit material, nga ana tjetër. Edhe pse fuqia e motivimit mund të jetë në zvogëlim e sipër, akumulimi ndërtimor dhe përparimi material, për një kohë më të gjatë, nën ndikimin e kohës dhe munit, është në rritje e sipër, në të shumtën e rasteve.

Vazhdon kjo pamje çorientuese në kuptimin e historisë deri sa padrejtësia, dobësia, devijimi dhe korrupsioni në trungun e umetit të arrijë atë nivel sa që të shter burimet dhe t'i shkatërrojë pikënisjet e iniciativës, kreativitetit dhe ripërtëritjes. Kështu shkatërrohet ndërtesa, shemben institucionet dhe shkapërderdhen shenjat. Vetëm atëherë i bëhet e qartë njeriut, pa fije mundi, lidhshmëria mes dobësisë së shpirtit motivues, zhvillues dhe ripërtëritës nga njëra anë dhe devijimi i ecurisë, korrupsionit dhe rënies së civilizimit nga ana tjetër.

Nëse devijimi i ecurisë së umetit islam nga linja e zbatimit ideal, të cilin e kishin shënuar praktikat e Islamit, pas përfundimit të periudhës së Muhamedit alejh'is-selam dhe mbarimit të kohës së sahabëve, ka filluar herët, shkak për të ishte se njerëzve, pas periudhës pejgamberike, u është lënë në dorë që me përpjekjet e tyre të praktikojnë mesazhin hyjnor. Kështu, çdo brez është i lidhur ngushtë me energjinë e individëve, varësisht rrethanave kohore dhe vendore, si dhe mundësive, ndryshimeve dhe sfidave të kohës së tyre.

Kjo çështje ishte e qartë gjatë ecurisë historike të mesazhit islam. Proporcionaliteti ishte në formë të kundërt mes fuqisë së motivit hyjnor dhe llojit të zbatimit, nga njëra anë, dhe akumulimit të ndërtimit, trashëgimisë dhe dukurive civilizuese, nga ana tjetër. Me fjalën proporcionalitet të kundërt kemi për qëllim se fuqia dhe zhvillimi i njërës anë nënkupton dobësinë dhe tkurrjen e anës tjetër. Kështu, në kohën kur dobësohet shpirti islam, rritet pasuria dhe lulëzon ndërtimtaria.

Mesazhi islam ka zbritur tek arabët në një gjendje kur ata ishin beduinë dhe injorantë. Nuk kishin as shtet, as sistem, as ndërtimtari, as shkencë, e as përparim material. Në të kundërtën ishin fqinjët e tyre të civilizimit persian, romak, indian, si dhe civilizimet e mëhershme të Mesopotamisë, Egjiptit dhe Sirisë.

Në kohën kur shtetet dhe civilizimet persiane, romake dhe indiane fundoseshin në korrupsion, padrejtësi dhe amoralitet, erdh mesazhi islam për mbarë botët me vizionin hapësinor që shpreh njëshmërinë e pastër dhe të lartë ndaj Zotit, me vlerat, parimet dhe konceptet civilizuese. Kështu, ky mesazh solli horizonte të gjëra dhe programe shkencore të ngulitura, të cilat në përgjithësi formojnë baza të forta për motivim njerëzor dhe hapi dyer të reja në sferat e shkencave humane dhe hapësinore. Si rezultat i saj nxori arabët, me

ta edhe njerëzinë nga injoranca, primitivizmi, korrupsioni dhe padrejtësia në një fazë të re të civilizimit në historinë njerëzore. Në këtë civilizim bashkohet dhe harmonizohet shpirtërorja me materialen, racionalja me emocionalen dhe shkencoren, si dhe e fshehura (gajb) me të dukshmen.

Ishte normale që mesazhi islam në burimet e saj në periudhën e shpalljes dhe të sahabëve të fillonte fuqishëm, gjë që i mundësoi shtetit islam në një periudhë më pak se tre dekada të sundojë një pjesë të madhe të botës së qytetëruar. Islami bëri ndryshim rrënjësor dhe të paparë te popujt që i sundoi, duka ua ndryshuar gjuhën popujve në veri të Gadishullit Arabik, si dhe në veri dhe lindje të Afrikës, në atë mënyrë që gjuha kurejshe arabe të bëhet gjuha amtare e tyre.

Nëse motivimi dhe ndryshimi islam i shpirtit, mendjes dhe emocioneve ishte i madh, ishte krejtësisht normale që në botën primitive të Gadishullit Arabik ndikimi ndërtimor në fillim të ishte i kufizuar. Mirëpo, me kalimin e kohës dhe me hyrjen e popujve nga bijtë e perandorive dhe civilizimeve në Islam, filloi të rritet dhe të zgjerohet pronësia dhe të lulëzojë ndërtimtaria.

Me kalimin e kohës, për shkak të traditave, filozofive dhe besimeve të mëhershme që kishin bartur popujt që kishin përqaftuar Islamin, ishte gjithashtu normale të dobësohet shpirti islam. Kështu, besimi i pastër, vizioni hapësinor dhe kulturor, sistemi i gjykimit dhe lidhjet shoqërore të ndikohen nga ndotja ideologjike dhe të depërtojnë padrejtësia, tirania, iluzionet dhe devijimet. Kështu, mendimi, sistemi dhe praktikat e popujve islamë u bënë një përzierje mes çështjeve bazike islame dhe asaj që kishin bartur me vete si pjesë e kulturës së tyre, përfshirë traditat, trashëgiminë dhe racizmat e mëhershme.

1.3.2. Si filloi dobësimi i energjisë në besim dhe etikë?

Historikisht është e njohur në mënyrë të prerë se fillimi i devijimit është shfaqur në periudhën e passhpalljes dhe pas periudhës së halifëve të drejtë. Kështu, sahabët, të cilët cilësoheshin me qëllime dhe synime të pastra dhe të sinqerta, nuk ishin më elita e ushtrisë së hilafetit, mbrojtësit e sistemit, e as epiqendra e shtyllës politike.

Ky ndryshim substancial, ku beduinët u bënë ushtria e shtetit dhe shtylla e tij politike, bënë që hilafeti të shndërrohet nga periudha e drejtë në "mbretëri tirane", i cili në shumë raste është ngritur në formë të grabitjes dhe shtypjes racionale dhe fisnore. Me kalimin e kohës, tek umeti, kjo çështje edhe më shumë u rrit me përhapjen e nacionalizmeve, filozofive dhe miteve. Për këtë ishte normale të ndryshon gjendja pas shpalljes dhe gjatë shekujve nga gjenerata në gjeneratë në lidhje me atë se sa iu kanë përmbajtur shpirtit të shpalljes, sa kanë pasur energji për bartjen e misionit dhe sa kanë bërë dobi me te sipas gjendjes dhe rrethanave me të cilat janë ballafaquar, dhe sipas fuqisë për ndryshim, adaptim, përpjekje dhe ripërtëritje, që i përgjigjet kërkesave të udhëzimit, parimeve dhe vlerave të larta të mesazhit islam. E gjithë kjo duke pasur në konsideratë sfidat me të cilat ballafaqohet umeti islam në periudha të ndryshme.

Prej shkaqeve më të rëndësishme që shpien drejt devijimit të drejtë nga vizioni islam hapësinor dhe nga vlerat dhe parimet e tij të larta ishte përpjekja e pamjaftueshme për riedukimin e fëmijëve të fiseve beduine, të cilët pas dobësimit të gjeneratës së sahabëve, përbënin ushtrinë çlirimtare dhe dalëngadalë dolën nga dora e ushtrisë së shtetit. Përveç kësaj, ngjarjet dhe ndryshimet e mëdha që ndodhën, përfshirë hyrjen e shumë popujve dhe fiseve në Islam, me një vrull dhe shpejtësi të madhe, që ishte më e madhe se fuqia e

shtetit për t'i menaxhuar ato dhe për t'u përballuar me kërkesat për "edukim" dhe ndryshim.

Ushtarët e fiseve dhe beduinëve cilësoheshin me fuqi dhe trimëri në xihad dhe mbrojtje të umetit. Mirëpo, ata nuk kishin rast për riedukim. Kështu, ndryshoi natyra e ushtrisë, natyra e popullit dhe natyra e bazës politike, që me kalimin e kohës ndodhën ngjarje të përshpejtuara dhe të befasishme, që në mënyrë të detyruar i dhanë fund periudhës së halifëve të drejtë, e me këtë të përfundon edhe mënyra e sundimit dhe sistemimit. Krejt në fund çështja të kalojë në duart e udhëheqjes së re, e cila në kuadër të strukturës së ngritjes së shoqërisë islame dhe institucioneve të saj, të praktikojë shumë prej koncepteve, traditave, padrejtësive, fanatizmave dhe racizmave fisnore të trashëguara, mbi të cilat janë edukuar dhe zhvilluar.

Kështu, për shkak të ndryshimit të bazës politike dhe ushtarake, çështja kalon në duart e mbretërve emevit. Dobësinë e supozimit se në kohën e halifëve Othman ibn Afanit dhe Ali ibn Ebi Talibt radijallahu anhuma, kanë ndodhur devijime dhe gabime, e hedhë poshtë edhe ajo se në sistemin politik dhe mbretëror të Muaviut r.a., kanë ndodhur gabime të shumëfishuara se sa në kohën e halifëve të drejtë. Megjithatë, çështja kaloi në duart e Muaviut r.a. Zhdukja e kohës së halifëve të drejtë, nuk ka koment ndryshe, pos ndryshimit të bazës politike dhe ushtarake, ku ushtrinë çlirimtare e përbënin beduinët dhe bijtë e fiseve.

Rënia e sistemit të halifëve të drejtë, si ngjarje historike në kuadër të rrethanave të asaj kohe, ishte ajo që solli çarjen e parë në shtetin islam dhe sistemin e tij, përfshirë këtu pasojat ideologjike, politike, shoqërore dhe ekonomike që goditi shpirtin islam dhe vizionin e tij. E gjithë kjo turbulloi kthjelltësinë e vlerave dhe parimeve të tij, në kohë kur zgjerohej dhe rritej hapësira e shtetit islam me anë të çliri-

meve, rritej numri i besimtarëve, trashëgimtarë të industrive dhe arteve të civilizimeve dhe perandorive në veri të Gadishullit Arabik, persianëve, romakëve dhe indusëve.

1.3.3. Politika, etika dhe feja: përçarja e udhëheqjes dhe lindja e shkollës teorike

Në kuadër të zhvillimit të këtyre ngjarjeve, nëse ndjekim ecurinë e orientimit ideologjik të umetit, do të vërejmë se gjeneratën e parë e kishte marrë përsipër vetë Muhamedi alej'h'is-selam për ta edukuar dhe këshilluar sipas udhëzimeve të shpalljes hyjnore. Për këtë, ky brez dallohej me vizion, shpirt dhe fuqi të lartë civilizuese, që përputhej me natyrshmërinë e fiseve arabe të cilësuar me fuqi, trimëri, aftësi dhe dinjitet. Kështu, lindi një brez civilizues dhe efektiv. Madhështia e sukseseve të këtij brezi ishte sipas formimit të shëndoshë edukativ dhe lartësisë së koncepteve ideologjike, politike dhe etike.

Me rënien e periudhës së halifëve të drejtë dhe dominimit të fuqisë fisnore, filloi të dobësohet roli udhëheqës i burrave të shkollës së shpalljes. Kështu, pas njëqind viteve nga konfliktet e përgjakshme, dalëngadalë përfundoi çështja në anashkalimin e rolit të tyre politik, që më pas gradualisht të shndërrohen në një grup që përfaqësojnë shkollën teorike, të izoluar në xhami dhe shkolla, në kohë kur kanë filluar të shtohen aktivitetet dhe traditat fisnore dhe të rriten fërkimet racore, ku si rezultat i saj të rritet shpirti i sundimit dhe tiranisë dhe të zgjerohen sferat e padrejtësisë dhe korrupsionit.

Me thellimin e dijetarëve në izolim, pasi ishin trashëgimtarët e shkollës së mesazhit hyjnorë, ishte plotësisht normale të dobësohet kontakti i tyre me realitetin shoqëror, të dobësohet ndikimi i tyre në ecuritë politike, praktike dhe ripërtëritjen e institucioneve. Përveç kësaj, si pasojë e izoli-

mit të tyre, gjurmët shihen edhe në mendimet dhe programin kulturor të tyre. Kështu, tek ata u dobësua aftësia e ripërtëritjes dhe ixhtihadit, të shndërrohen shkollat profesionale dhe punës në shkolla racionale, më pas shkollat racionale në ato tekstuale dhe në fund shkollat tekstuale të përfundojnë në shkolla të imitimit.

Për shkak të kundërshtimit dhe izolimit të dijetarëve dhe të kulturuarve nga ana e elitës politike, disa grupe të kësaj elite miratuan alternativën tjetër filozofike që kishte depërtuar nga kulturat e huaja, pa pasur ndonjë metodologji të shëndoshë gjithëpërfshirëse, që percepton karakteristikat e umetit dhe elementet vizionare, racionale dhe psikologjinë ideologjike dhe civilizuese. Kështu janë fundosur, dhe së bashku me ta, edhe një grup i rëndësishëm i mendimtarëve dhe popullatës islame nëpërmjet filozofisë, apologjetikës, fraksioneve dhe sufizmit të huaj, në iluzionet, devijimet dhe paqartësitë e metafizikës greke dhe logjikën e saj formale.

Në të njëjtën kohë, dijetarët dhe të besueshmit e mesazhit hyjnor kishin përfunduar në ngurtësinë e tekstualitetit të shkencave dhe njohurive të fikhut. E gjithë kjo u shfaq në vazhdimin e elitës politike në korrupsion, injorancë dhe padrejtësi. Me largimin dhe izolimin e dijetarëve të fesë dhe shkencës, elita politike humbi bazën dhe mbështetjen e saj. Kështu nuk mbeti për ta bazë ideologjike dhe kulturore që i mbështet dhe e orienton ata, dhe si pasojë e kësaj gjendje u fundos umeti në degjenerim, ngurtësi dhe tirani, ndërsa masa e gjerë iu dorëzua sufizmit filozofik i përmbushur përplot iluzione, që i dha fund dhe e zhduki shumicën e asaj që kishte mbetur prej energjisë civilizuese.

E gjithë kjo rezultoi në thellimin e terrorizmit material për shkak të tiranisë së udhëheqësve të umetit dhe elitës politike sunduese. Kjo u kurorëzua me pamundësinë e umetit për t'u përballuar me ndryshimet dhe sfidat. Kështu,

kërcënimi me zhdukje dhe shkatërrim, si dhe çrrënjësia e opozitës, ishte rrugë e vetme e elitës politike për të ruajtur sundimin dhe për të realizuar kontrollin dhe qëndrimin në postet e tyre.

Sa i përket elitës së kulturuar dhe dijetarëve, ajo për shkak të rënies së fuqisë shkencore, dobësisë së aktiviteteve praktike dhe ngurrimit nga njohja e ligjeve dhe natyrave të njerëzve, është bërë sikur të ishte shkollë e artizanateve, ngase nuk i ka mbetur rol tjetër në shoqëri, përpos orientimit të jetës individuale, ushtrimi i detyrës së muftiut, gjykatësit dhe imamit të xhamisë. Për kryerjen e këtij roli, ishte patjetër të mbështeten në terrorizmin shpirtëror, të shenjtërojnë çdo gjë që flitet, duke e mbështetur me simbole dhe tekste aty-këtu, deri sa nuk kishte mundësi të ngritët këmba, e as të bëhet asnjë hap pa ndonjë fetva ose leje paraprake.

1.3.4. Pasojat e përcarjes, rënia e institucioneve dhe anashkalimi i dimensionit kolektiv

Kështu përfundoi çështja e umetit në rënien e institucioneve dhe sundimin e elitës. Muslimani u bë individ, i cili në aspektin shpirtëror dhe material, nga të gjitha anët frikësohet nga tirania politike dhe diskursi i frikësimit fetar, me qëllim që ai dhe i tërë umeti të tërhiqen në vete dhe të bëhen negativ. Kështu, nga zemra e tij të tërhiqen ëndrrat e umetit, përfshirë motivet e përpikërisë, ndërtimtarisë dhe civilizimit.

Çështja edhe më shumë u bë e paqartë kur elita e mendimtarëve të umetit, nuk u kujdesën në mënyrë shkencore dhe efektive se rruga e suksesit për reforma dhe ndryshim, në rend të parë, vjen nga brendia e umetit dhe shoqërisë. Fillon nga substanca e qenies dhe burimi i mendimit dhe emocioneve. Ajo është riedukimi. Kështu, ata humbën rrugën kur menduan se rruga e reformave është rruga e konflikteve dhe dhunës, gjë që luhati stabilitetin e umetit,

shqeu lidhshmërinë shoqërore dhe rriti mundësinë e shkaqeve të padrejtësive, shtypjes, tiranisë dhe përçarjes.⁵

Kjo është fotografia e madhe e rrjedhave të historisë së umetit, gjë që përfundoi në ngrirje, negativitet, përçarje dhe dobësi.

Krahas gjithë kësaj, duhet të mos harrojmë se gjendja e umetit në shumë raste të historisë dhe shumë vende, nuk kanë qenë në të njëjtin nivel. Nëse gjendja në një vend ka qenë në nivel të ulët, ajo në vend tjetër ka qenë në gjendje më të mirë.

Në kohën kur u shua drita e shpirtit të arabëve dhe u shkatërruan muslimanët në Andaluzi, energjia islame filloi të lulëzojë përsëri përmes fiseve turke, të cilat kishin pranuar Islamin me plot fuqinë dhe trimërinë e tyre, të furnizuar me shpirtin e lirisë dhe krenarisë, për ta mbjellë Islamin në tokat e Anadollit dhe prej aty të dalin pionierët e shtetit osman.

Dobësimi i energjisë së mendimit dhe kreativitetit në mesin e umetit, si rezultat i dobësimit të shpirtit civilizues, nuk do të thotë se do të pengohet lindja e gjenive të dalluar mendor, shkencor dhe reformues, qoftë edhe në periudhat më të vështira të konflikteve dhe përçarjeve. Në mesin e këtyre gjenive veçojmë: Ebu Hamid Gazaliu, Ibn Hazmi, Ibn Rushdi, Ibn Tejmije dhe Ibn Halduni në shkencat fetare dhe shoqërore. Përveç këtyre ka edhe shumë tjerë në fushat e filozofisë, fizikës etj. Kjo është një pjesë e asaj që ka mbetur nga esenca e fuqisë motivuese, si rezultat i reagimit ndaj sfidave dhe përballimi i sëmundjeve, si dhe nga natyrshmëria e njeriut për reforma dhe përparim. Këto dukuri edhe sot e kësaj dite i vërejmë gjurmët në shpirtin dhe ambiciet e umetit, si dhe përpjekjet për reformim në te.

⁵ Abdulhamid Ebu Sulejman, *El-Unfu ve idaret'us-sira'is-sijasij'il-islamiji bejne'l-mebdei ve'l-hijari: ru'jetun islamijetun*, Damask, Dar'ul-fikri, 2002.

Mirëpo, kjo nuk ndryshon natyrën e fotografisë së madhe të historisë së këtij umeti dhe ecurisë civilizuese të tij, që shpjen në dobësimin e motivit të shpirtit islam, shuarjen e energjisë, turbullimin e pastërtisë së vizionit hapësinor dhe civilizues, thyerjen e unitetit islam, gjë që mundëson përhapjen e korrupsionit dhe tiranisë në trungun e tij. Kështu, popujt islamë cilësohen si të paaftë dhe negativë, pa ide për iniciativa dhe nuk dëshirojnë tjetër pos kafshatën e gojës dhe shëndetin e trupit.

Ishte patjetër që umeti të zgjohet nga gjumi i rëndë, për të kuptuar se sa është lënduar shpirti i tij. Gjatë shekujve, shpirti islam ka përballuar, kur lindën armiq me fuqi civilizuese dhe me shkathtësi materiale dhe teknike, të mbështetur nga metodologji shkencore dhe energji psikologjike kreative. Kështu, pushtuesit dhe kolonizatorët, së bashku me xhelatët e umetit, ushtruan ndaj popujve të tyre gjitha llojet e padrejtësisë dhe poshtërimit.

KAPITULLI DYTË

Identifikimi i sëmundjes

Në pjesën e mësipërme dhamë një pasqyrë të përgjithshme rreth rrjedhave të regresionit në nxitjen e shpirtit civilizues islam tek umeti. Ndërsa ajo që kërkohet sot, është njohja e asaj që është realizuar saktësisht, përfshirë ndryshimet dhe devijimet në mendime, psikologji dhe ndjenjat e umetit, si dhe ndikimi i gjithë asaj në jetën e muslimanit, qoftë si individ apo shoqëri. Gjithashtu, njohja e anëve të dobëta të cilat kontribuuan në pengimin e përpjekjeve reformiste. Kështu, në këtë mënyrë, hulumtimi do të përfundojë në përpjekje për të kontribuar në trajtimin dhe përplotësimin e mjeteve, derisa umeti të arrijë respektin dhe vlerësimin e gjithë njerëzve, si dhe të gjejë veshë që dëgjojnë vlerat e larta dhe sfidat shpirtërore dhe etike të prezantuara nga ai.

2.1. Deformime dhe devijime në mënyrën e të menduarit dhe kulturën e umetit

Pyetje e rëndësishme që mund të parashtrohet tash është: cilat janë deformimet dhe devijimet ideore dhe kulturore? Si përgjigje të kësaj pyetjeje do të sjellim gjashtë lloje të tyre të cilat do t'i sqarojmë në faqet në vazhdim.

2.1.1 Deformimi i parë: deformimi i vizionit gjithëpërfshirës

Deformimi i parë dhe më i rrezikshëm ishte deformimi i vizionit gjithëpërfshirës islam, i cili nënkupton kornizën e mendimit dhe kulturës së umetit. Kështu, pas deformimit nuk kemi një vizion që bazohet në njëshmërinë e Zotit, i

përgjithshëm, pozitiv dhe i fuqishëm që sjell argument dhe orientim të përgjithshëm për mendimin, ndërgjegjen, raportin dhe sistemin e muslimanit.

Vizioni gjithëpërfshirës islam për njeriun në mënyrë të shkurtër mund të përfshihet në tri çështje të përgjithshme bazike:

- Në çështjet e besimit të gajbit (metafizik): besimi në Allahun, Krijues, i Vetëm dhe i Pashoq;
- Në çështjen e jetës: ndjenja e përgjegjësisë, synimi i dobisë dhe drejtësisë dhe përpjekja për përmirësim dhe ndërtim;
- Në çështjen e ahiretit: përballimi me përfundimin dhe veprat e bëra që të jenë sipas parimit: “Nëse ke bërë mirë do të gjesh mirë, po nëse ke bërë keq do të gjesh keq”.

Për këtë, sipas vizionit gjithëpërfshirës kur’anor, besimi dhe veprat e mira nuk ndahen. Qëllimi i besimit është realizimi i veprave të mira, ndërsa vepra të mira llogariten të gjitha veprat e gjymtyrëve të njeriut. Këtu nuk ka dallim mes një vepre dhe tjetrës, po edhe nëse është e vogël sa një grimcë. Lloji dhe dimensionimi i tij shpirtëror përcaktohet sipas qëllimit të mirë dhe përpjekjes për të qenë i përpiktë në te. Për gjithë këtë, premtimi i Allahut për besimtarët se do të jenë sundues në tokë, ishte i kushtëzuar me besim të shoqëruar me punë, ndërsa puna të jetë e mirë që në vete ngërthen shpirtin e bamirësisë, përpikërisë dhe përpjekjes.

Për të merituar sundimin në tokë, nuk mjafton vetëm qëllimi (nijeti). Për qëllimin, ka shpërblim në ahiret. Ndërsa, sundimi në tokë dhe sukcesi në punë në këtë botë është i kushtëzuar me bamirësi, përpikëri dhe përpjekje. Kjo është metodologjia që shpie me ndihmën e Allahut drejt njohjes së ligjeve, drejttimeve të duhura, realitetit në kryerjen e detyrave dhe suksesit në punë. Allahu në Kur’an thotë:

وَعَدَ اللَّهُ الَّذِينَ ءَامَنُوا مِنكُمْ وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَيَسْتَخْلِفَنَّهُمْ فِي الْأَرْضِ
 كَمَا أَسْتَخْلَفَ الَّذِينَ مِن قَبْلِهِمْ وَلَيُمَكِّنَنَّ لَهُمْ دِينَهُمُ الَّذِي ارْتَضَى لَهُمْ
 وَلَيُبَدِّلَنَّهُم مِّن بَعْدِ خَوْفِهِمْ أَمْنًا يَعْبُدُونَنِي لَا يُشْرِكُونَ بِي شَيْئًا وَمَن كَفَرَ
 بَعْدَ ذَلِكَ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْفَاسِقُونَ

“Atyre nga mesi juaj të cilët besuan dhe bënë vepra të mira, Allahu u premtoi se do t’i bëjë zotërues në atë tokë, ashtu si i pat bërë zotërues ata që ishin para tyre dhe fenë të cilën Ai e pëlqeu për ta, do ta forcojë, e në vend të frikës Ai do t’ju dhurojë siguri. Ata më adhurojnë Mua e nuk më shoqërojnë asgjë. E kush edhe pas kësaj mohon, të tillët janë ata më të prishurit.”⁶

Ky vizion i përgjithshëm dhe i qartë, përmes një numri të madh të mendimtarëve të izoluar, të cilët nuk kanë vazhduar studimet dhe hulumtimet e tyre teorike, por janë koncentruar vetëm në raste individuale, është goditur nga deformime të rrezikshme, të cilat - edhe krahas qëllimit të mirë dhe gjatë një kohe të gjatë - kanë kontribuar në tkurrjen e shpirtit islam dhe fuqinë e vizionit të umetit. Gjithashtu, kanë mundësuar faktorët e prapambetjes për të bërë punën e tyre, në atë mënyrë që të shuhet energjia e ripërtëritjes, duke iu dorëzuar umeti gjendjes së negativitetit dhe destabilizimit. Këto deformime gjithashtu kanë ndihmuar që të vritet vullneti për hulumtime, ripërtëritje dhe përparim dhe t’i dorëzohet tatëpjetës së imitimit, të shkatërrohet kuptimi i kolegialitetit, umetit dhe solidaritetit mes tyre, të bien institucionet dhe të shkatërrohet uniteti.

Këtë e shohim qartë në vizionin që e ofron fikhu dhe ilmul-kelami, të cilat llogariten themele të formimit pedagogjik dhe psikologjik për individin musliman. Ky vizion në

⁶ En-Nur: 55

esencë është vizion individual, jo vizion kolektiv, vizion i cili del nga natyra e raportit mes dijetarëve dhe masës së thjeshtë, të cilat ndërlidhen me çështjet personale, jo me çështjet e përgjithshme, e as me sistemet, parimet dhe natyrën e komponentëve të tij. Në një vizion dhe mendim të tillë, pedagogjia, pjesëmarrja politike, raportet shoqërore, çështjet e gjykimit dhe rregullat e vëllazërisë, drejtësisë dhe konsultimit, nuk kanë asnjë rol në ecurinë e jetës së përgjithshme të umetit. Krejt në fund, ky vizion është vizion negativ që nuk bashkëvepron me të gjitha dimensionet e jetës, nuk përcjell rrjedhat dhe ndryshimet, e as nuk shtynë përpara rrotën e punës civilizuese.

I gjithë interesi dhe preokupimi i personit që gjendet në xhami është kujdesi i tij për “dhikr” dhe “kryerje të ritualeve”, të cilat sipas logjikës së këtyre personave të izoluar në dhikr dhe leksione në xhami janë të përkufizuar në “ibadete”, siç potencohet në terminologjinë e shkencës së fikhut. Kështu, ata zgjerohen në pikat më të detajuara të këtyre çështjeve, duke u ndarë në shkolla dhe grupime të ndryshme. E gjithë kjo është drejtuar në çështjet e jetës individuale, duke lënë anash çështjet e përgjithshme ose ato politike dhe duke e emërtuar me termin “muamelat” (e drejta civile), ashtu siç potencohet në shkencën e fikhut.

Shprehja “muamelat” ka për qëllim një sërë trajtimesh dhe kriteresh juridike ndaj çështjeve bashkëvepruese, përfshirë edhe rregullat dhe kontratat të jetës individuale të muslimanit. Kështu, pothuaj i gjejmë të zhveshura nga dimensionit shpirtëror, ngase kryerja ose moskryerja e çdo veprimi është çështje e kësaj bote dhe nuk ndërlidhet, nëse veprohet, me shpërblim, e as nuk sjell, nëse nuk veprohet, ndonjë mëkat apo dënim.

Ky vizion fikhor dallon tërësisht nga vizioni kur’anor, i cili shikon njeriun në mënyrë të përgjithshme, duke mos

bërë dallime mes përgjegjësive të tij individuale të ndërli-
dhura me mbrojtjen e jetës dhe përgjegjësive të tij kolektive
në mbrojtjen e shoqërisë dhe umetit. Dimensioni shpirtëror
përfshin të gjitha veprat e njeriut, duke bërë të gjitha veprat
e tij, pa dallim, qofshin edhe çështje që ndërlidhen me ep-
shin, “ibadet-adhurim”, varësisht nga qëllimi dhe synimi.
Sipas vizionit islam, e tërë jeta e muslimanit mund të
shndërrohet në “dhikr”, “xhihad” dhe “ibadet-adhurim”.

Jeta e muslimanit në namaz, lutje, agjërim, zeqat, lexim
të Kur’anit dhe kryerja e ibadeteve ngjallë ndërgjegjen e tij,
si dhe e ndihmon për të kryer obligimet dhe për të zbatuar
premtimet. Allahu thotë:

إِنِّي أَنَا اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنَا فَاعْبُدْنِي وَأَقِمِ الصَّلَاةَ لِذِكْرِي

“Vërtet, vetëm Unë jam Allahu, nuk ka zot tjetër pos Meje,
pra Mua më adhuro dhe fal namazin për të më kujtuar Mua.”⁷

فَاذْكُرُوا اللَّهَ عِنْدَ الْمَشْعَرِ الْحَرَامِ وَاذْكُرُوهُ كَمَا هَدَيْتُكُمْ وَإِنْ كُنْتُمْ مِنْ
قَبْلِهِ لَمِنَ الضَّالِّينَ

“... përmendeni Allahun në vend të shenjtë (Muzdelife), përmendeni Atë ashtu si u ka udhëzuar Ai, sepse më parë ishit të humbur.”⁸

وَاذْكُرُوا اللَّهَ فِي أَيَّامٍ مَّعْدُودَاتٍ فَمَنْ تَعَجَّلَ فِي يَوْمَيْنِ فَلَا إِثْمَ عَلَيْهِ وَمَنْ
تَأَخَّرَ فَلَا إِثْمَ عَلَيْهِ لِمُنَاتَقَىٰ وَاتَّقُوا اللَّهَ وَأَعْلَمُوا أَنَّكُمْ إِلَيْهِ تُحْشَرُونَ

“Allahun përmendeni në ditët e caktuara (në ditët e bajramit).
Kush ngutet (të largohet prej Mines) për dy ditë, nuk bën mëkat,
po edhe ai që e shtyn (edhe për një ditë) nuk bën mëkat, këto

⁷ Ta Ha: 14

⁸ El-Bekare: 198.

rregulla janë për atë që do të jetë i përpiktë. Pra, kini kujdes Allahun dhe dijeni se ju te Ai tuboheni.”⁹

قَدْ أَفْلَحَ مَنْ تَزَكَّىٰ وَذَكَرَ اسْمَ رَبِّهِ فَصَلَّىٰ

“Ka shpëtuar ai që është pastruar. Që e përkujton madhërinë e Zotit të vet dhe falet.”¹⁰

فَإِذَا أَمِنْتُمْ فَأذْكُرُوا اللَّهَ كَمَا عَلَّمَكُم مَّا لَمْ تَكُونُوا تَعْلَمُونَ

“Por kur të jeni të siguruar, përkujtojeni (me namaz) Allahun ashtu si u mësoi Ai për atë që ju nuk dinit.”¹¹

أَتْلُ مَا أُوحِيَ إِلَيْكَ مِنَ الْكِتَابِ وَأَقِمِ الصَّلَاةَ إِنَّ الصَّلَاةَ تَنْهَىٰ عَنِ الْفَحْشَاءِ
وَالْمُنْكَرِ وَلَذِكْرُ اللَّهِ أَكْبَرُ وَاللَّهُ يَعْلَمُ مَا تَصْنَعُونَ

“Ti lexo atë që po të shpallet nga libri (Kur’ani), fal namazin, vërtet namazi largon nga të shëmtuarat dhe të irrituarat, e përmendja e Allahut është më e madhja (e adhurimeve); Allahu e di ç’punoni ju.”¹²

وَالَّذِينَ إِذَا فَعَلُوا فَحِشَةً أَوْ ظَلَمُوا أَنْفُسَهُمْ ذَكَرُوا اللَّهَ فَاسْتَغْفَرُوا لِذُنُوبِهِمْ
وَمَنْ يَغْفِرِ اللَّهُ لَنْ يَسْرِ إِلَّا اللَّهُ وَلَمْ يُصِرُّوا عَلَىٰ مَا فَعَلُوا وَهُمْ يَعْلَمُونَ

“Edhe ata të cilët kur bëjnë ndonjë (mëkat) të shëmtuar ose i bëjnë zullum vetvetes, e përmendin Allahun dhe kërkojnë falje për mëkatet e tyre - e kush i falë mëkatet përveç Allahut? - dhe që duke ditur, nuk vazhdojnë në atë që kanë punuar (në të keqen).¹³

⁹ El-Bekare: 203

¹⁰ El-A’la: 14-15

¹¹ El-Bekare: 239

¹² El-Ankebut: 45

¹³ Alu Imran: 135

Jeta e muslimanit është punë dhe përpjekje sipas vizionit kur'anor në të gjitha çështjet private dhe publike të jetës së tij. Është përpjekje dhe xhihad në çdo çështje që e vepron, në kërkim të diturisë, në kërkim të furnizimit, në edukimin dhe pastrimin e tij, gjatë përpjekjes për të zbatuar drejtësinë, duke ruajtur të dobëtit, duke plotësuar nevojat e umetit, duke mbrojtur vendet muslimane, duke bërë thirrje në besim dhe fe të vërtetë etj.

Ky xhihad dhe kjo përpjekje në çështjet e jetës islame është prej qëllimeve më të rëndësishme të dhikrit në jetën e muslimanit, ngase jeta e muslimanit është një tërësi që nuk përpjesëtohet në synimin e të mirës. Allahu thotë:

قُلْ إِنِّي هَدَانِي رَبِّي إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ دِينًا قِيَمًا مِثْلَهُ إِبْرَاهِيمَ حَنِيفًا وَمَا كَانَ مِنَ الْمُشْرِكِينَ قُلْ إِنَّ صَلَاتِي وَنُسُكِي وَمَحْيَايَ وَمَمَاتِي لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ لَا شَرِيكَ لَهُ وَبِذَلِكَ أُمِرْتُ وَأَنَا أَوَّلُ الْمُسْلِمِينَ

“Thuaj: “Vërtet Zoti im më udhëzoi në rrugë të drejtë, që është fé e drejtë, fé e Ibrahimit, që ishte larg besimeve të kota. Ai (Ibrahimi) nuk ishte idhujtar! Thuaj: “Namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për Allahun, Zotin e botëve. Ai nuk ka shok (nuk adhuroj tjetër). Me këtë (thjeshtësi të adhurimit vetëm për Zotin) jam i urdhëruar dhe jam i pari i muslimanëve (i pari që pranoj dhe bindem!)”¹⁴

Aq sa më shumë të jetë vizioni islam i pastër, efektiv, gjithëpërfshirës dhe optimist, aq më shumë vizioni i kohës së izolimit në aspektin ideologjik do të bëhet vizioni i mbyllur në vete në pjesën më të madh të praktikave, ngase ajo është e mangët, e pjesshme, negative dhe praktikisht në jetën e njerëzve ishte fisnore, nacionale, individuale dhe egoiste. Do të shohim më vonë pasojat e këtyre deformime-

¹⁴ El-En'am: 161-163

ve të rrezikshme në konceptet kulturore të umetit, në formimin psikologjik dhe zbatimin civilizues, deri sa ka arritur gjendja në atë që jemi sot, të dobët, të prapambetur dhe të nënçmuar.

2.1.2. Deformimi i dytë: deformimi metodologjik

Deformimi i dytë ishte si rezultat i izolimit të dijetarëve dhe mendimtarëve, i cili në rastin më të mirë ishte deformim njohës metodologjik. Ky deformim shndërroi mendimin islam në mendim teorik, i fundosur në meditime teorike fraksionale, që nuk gjen dot rrugën drejt jetës shoqërore me hulumtim, vërtetim dhe eksperimentim. Ky deformim shpiu në një sterilitet të rrezikshëm metodologjik, i cili bëri njohjen si proces i të mësuarit përmendësh dhe imitim, duke i munguar çdo gjurmë efektive, elementit kohor dhe atij vendor, si dhe njohjes së ligjit të kriterëve të krijesave.

Krahas izolimit, këtij deformimi i ka ndihmuar edhe natyra teorike metafizike e filozofisë dhe logjikës greke, e cila ka ndikuar fuqishëm ndaj klimës ideologjike të umetit, duke e dobësuar mendimin praktik eksperimental, për të cilin kanë nxitur konceptet islame: për meditim, hulumtim, zbulim në tokë dhe analogji. E gjithë kjo ka përfunduar në dobësinë e mendimit dhe zgjerim në kërkimin e teksteve, duke i llogaritur si të shenjta, si formë për të justifikuar dobësinë mendore të tyre. Po ashtu, janë dobësuar edhe mjetet e ixhtihadit dhe metodat e detyrueshme për prodhimin e shkencave humane, të cilat përplotësohen me njohuritë e përfituara nga vahji-shpallja, të cilat bashkërisht do të prodhonin njohuritë e nevojshme për zhvillimin e umetit dhe kontrollimin e çështjeve të ndryshueshme, duke e furnizuar atë me mendim të fuqishëm për t'i përballuar sfidave të jetës.

Për shkak të këtij deformimi njohës dhe metodologjik, kanë mbetur shkencat shoqërore në mendimin islam vetëm në formë të titujve dhe parimeve abstrakte, si dhe si burime dytësore në fushën e shkencave të fikhut dhe usuli-fikhut, duke u përkufizuar efekti teorik i tij vetëm në jetën individuale.

Derisa edhe kur iu dha mundësia njerit prej dijetarëve të medhhebit maliki, për shkak të angazhimit të gjerë në jetën politike dhe publike, për të hapur derën e njohurive humane dhe shoqërore para mendimit islam, si dhe të zbulojë shumë gjëra të çmueshme nga sekretet e fshehta, të kupton karakteret dhe faktorët e bashkëveprimit dhe të njohë format e ndikimit në librin e tij të dalluar, “El-Mukaddimeh”,¹⁵ ky mendim i mrekullueshëm, për shkak të mentalitetit të izoluar është anashkaluar, ashtu siç janë anashkaluar mendimet e shumë prej mendimtarëve tjerë.

Libri i Ibn Haldunit nuk ishte nga leximet e dijetarëve, e as temat e trajtuara në të nuk ishin pjesë e interesimeve të tyre. Projekti hulumtues në argumentet shkencore dhe njohuritë e ligjeve mbeti një projekt i lënë pas dore dhe nuk doli në dritë, vetëm pasi u zgjua umeti para thesareve të njohurive shoqërore në Perëndim, të cilat ishin të ngritura mbi bazat e mendimeve të Ibn Haldunit dhe metodologjisë së tij në sferat e shkencave shoqërore, në histori, filozofi të historisë, sociologji, ekonomi dhe pedagogji, të cilat i hapën Perëndimit dyert dhe horizontet që i mundësuan popujve të tyre t’i furnizojnë të rinjtë me shpirtin inicues, fuqinë kreative, organizimet shoqërore dhe përballimi i sfidave.

Këtu ia vlen të sjellim një shembull që sqaron pasojat e deformimit të metodologjisë në vizionin, interesimet dhe

¹⁵ Ebu Zejd Abdurrahman ibn Haldun (732-808 h./ 1332-1406). Autor i librit El Mukaddimeh. (Ky libër është përkthyer edhe në gjuhën shqipe, kurse në vitin 2016 u botua nga Shtëpia Botuese Logos-A. shën. i përkthyesit)

metodologjinë e studentëve në trajtimin e çështjeve shoqërore, gjë e cila shpalos realitetin e izolimit të tyre vetëm në të mësuarit përmendësh. Njëri nga myftinjtë në një shtet islam mbajti ligjëratën e ditës së xhuma, në të cilën trajtoi problemin e pastërtisë. Ai trajtoi problemin me një metodë të lartë stilistike, ku sqaroi para dëgjuesve kuptimet e pastërtisë dhe dispozita e tij sipas rregullave dhe dispozitave të paraqitura në librat e fikhut.

Pas namazit të xhumasë, përshëndeta Myftiun, u ula me të dhe i tregova atij në formën më të mirë të mundshme gëzimin tim rreth ligjëratës së xhumasë, mënyrën e prezantimit dhe gjithëpërfshirjen e dispozitave të fikhut, duke i treguar se ligjëratës, sipas meje, i mungonte pjesa e pastërtisë dhe mënyra e mbrojtjes nga ndyrësitat në mënyrë të kompletuar, duke i treguar se mospërfshirja e këtij elementi mund të shpie në atë drejtim ku masa e thjeshtë do të neglizhojnë pastërtinë dhe nuk do të jenë të vetëdijshëm për rëndësinë e saj, duke i llogaritur si çështje të dorës së dytë. Ndoshta disa çështje përmes të cilave trajtoi problemin, lënë të kuptohet se disa papastërti nuk dëmtojnë, siç janë gëlbazi, i cili në aspektin e fikhut nuk është i papastër, por në aspektin shëndetësor mund të bartë me vete sëmundje ngjitëse. Kështu, në këtë mënyrë, në përpiqemi t'ua mësojmë pastërtinë, ndërsa në realitet ua kemi mësuar moskujdesin për papastërtinë dhe çështjet që kërkohen për të ruajtur shëndetin e përgjithshëm.

Biseda jonë ishte vëllazërore dhe shkencore. Myftiu pranoi vërejtjet me zemërgjerësi, që le të kuptohet se kemi nevojë për këmbimin e mendimeve, zgjerimin e rrethit të njohurive, kuptimin e problemeve të jetës dhe kulturës tonë, reformimin e metodologjisë së njohurive, mënjanimin e izolimeve dhe largimi nga njëanësimi i njohurive.

Është me rëndësi të theksohet këtu se disa njerëz kur bisedojnë për çështjen e pastërtisë, përkufizohen vetëm në zbukurimin gjatë shkuarjes në xhami për namaz të xhuma-së dhe tubime tjera. Në realitet, vetëdijesimi për çështjet e pastërtisë dhe ruajtja shëndetësore llogariten pjesë e pandarë nga synimet e pastërtisë, për të cilat ka kërkuar Muhamedi alejh'is-selam me fjalët dhe praktikat e tij. Interesimi i Muhamedit alejh'is-selam për pastërtinë ishte deri në atë masë sa që kur pa një oborr të një muslimani në gjendje jo të pastër, urdhëroi pastrimin e tij, duke ua tërhequr vërejtjen nga papastërtia dhe i ftoi të kujdesen edhe për oborret dhe mos t'i ngjajnë hebrenjve në papastërti. Me sa duket, një numër i madh i umetit është goditur sot me sprovën e hebrenjve, përfshirë sëmundjet psikologjike dhe shoqërore, që e kishin gjatë kohës së Muhamedit alejh'is-selam.¹⁶

Për shkak të deformimit metodologjik, njohuritë janë shndërruar në çështje tekstuale dhe parciale që bazohen në imitim dhe nxënie përmendësh, si dhe janë fundosur në komplikime, versione të zgjeruara dhe të shkurtuara. Njohuritë janë ndarë në pjesë. Është bërë një ndarje mes besimit dhe realitetit praktik në jetë. Shkenca e tevhidit ose siç njihet "ilmul-kelami" është kufizuar vetëm në çështjet e besimit, i cili në të shumtën e rasteve merret me polemika. Është ndarë "shkenca e fikhut" nga shkenca e besimit, për t'u marrë me çështjet praktike të jetës individuale, duke u bazuar në studimet dhe ixhtihadet e tij në metodologjinë që

¹⁶ Transmetohet në hadith: "Na ka treguar Muhamed ibn Beshari, na ka treguar Ebu Amir El-Ka'di, na ka treguar Halid ibn Ijasi nga Salih ibn Ebu Hassani, i cili ka thënë: Kam dëgjuar Seid ibn El-Musejibin duke thënë: "Allahu është i mirë dhe e do të mirën, i pastër dhe e do të pastërën, fisnik dhe e do fisnikërinë, bamirës dhe e do bamirësinë, andaj pastroni - më duket se tha - oborret tuaja dhe mos u ngjani hebrenjve. Tha: Këtë çështje ia tregova Muhaxhir ibn Mismarit dhe tha: Ngjashëm me te ma ka treguar Amir ibn Sead ibn Ebu Vekkasi, nga babai i tij, nga Muhamedi alejh'is-selam, vetëm se ai ka thënë: pastroni oborret tuaja". Shih transmetimin e hadithit në: Muhamed ibn Isa Tirmidhi, El-Xhami'us-Sahih "Sunen'ut-Tirmidhij", recension: Ahmed Muhamed Shakir, Bejrut: Daru ihja'ut-Turath'il-Arabijj, (pa datë botimi), vëll. 5, f. 111, hadithi nr. 2799.

për bazë merr analogjinë e pjesshme në raste të mëhershme, pa e marrë në konsideratë çështjen në tërësi. Kështu, dijeta-rët e mëvonshëm në të shumtën e rasteve mbështeten në konceptet gjuhësore të tekstit, duke harxhuar mund të madh në këtë çështje.

Kështu, njohuritë tekstuale në kohën e dobësisë, ngurtë-sisë dhe imitimit, janë bërë objektive në vete me qëllim që shenjtëria të mbulojë dobësinë e njohurive. Në të njëjtën kohë, e gjithë kjo të përdoret si material për të mbushur ko-kat e studentëve, pa pasur ndonjë përfitim të madh dhe pa marrë në konsideratë përshtatshmërinë e saj me studiuesin dhe rolin e tij në formimin intelektual dhe psikik.¹⁷ Çështja ka arritur deri në atë shkallë, sa që disa lavdërohen me vlerat e imamëve të tyre, ngase kanë kërkuar prej fëmijëve të tyre të mësojnë përmendësh dhjetëra mijëra tekste të gën-jyera, me qëllim që të mësojë hadithet e gënjyera. Ata nuk kanë kuptuar se të mësuarit e haditheve dhe teksteve të gën-jyera, do të kenë ndikim negativ në mendjen e studiuesit. Më mirë do të ishte sikur studentët të përpiqeshin të mësoj-në çështjet e sakta dhe se çdo gjë, veç saj, është jo e saktë, ngase çështjet e gënjyera dhe të pasakta nuk kanë fund. Për këtë çështje është e mjaftueshme perceptimi i qëllimeve, formave dhe mjeteve, duke sjellë disa shembuj, me qëllim të pengimit dhe kundërshtimit.

Gjithashtu sa i përket pakujdesisë ndaj pasojave psikolo-gjike të njohurive në mendimin e umetit, duke u thelluar në

¹⁷ Suneti i Pejgamberit alejh'is-selam është një burim i pasur dhe i rëndësishëm. Ishte një model i gjallë praktik në shoqërinë njerëzore në kohën e Muhamedit alejh'is selam. Zbatimi i tij në rrafshin praktik është i mundur, mirëpo jemi të obliguar ta kuptojmë atë, si dhe të kuptojmë rrethanat kohore dhe vendore të zbatimit të tij, me qëllim që të kuptojmë realitetin e domethëniesë të tij. Duhet të kujdesemi vetëm për sunetin sahih, duke përdorur të gjitha metodat shkencore për kritikën e senedit (transmetuesve) ose metnit (tekstit). Çështja më e rëndësishme është përshtatshmëria e sunetit me parimet, konceptet dhe synimet e Kur'anit. Sa i përket saktësisë së tekstit, por jo edhe të senedit, atëherë mund të llogariten si "athar" (gjurmë), duke përfitur nga kuptimet që përmbajnë, pa e konsideruar atë si të shenjtë, ngase pranimi në këtë rast është i mbështetur në kuptimet që ngërthejnë, gjë që është e mjaftueshme.

sasinë e njohurive e jo cilësinë, është edhe ajo që jemi duke e përjetuar sot në sferën e arsimit fetar, ngase mbushen mendjet e fëmijëve me informacione që nuk i përshtaten aftësive të tyre intelektuale e as formimit të tyre psikologjik. Dëmi i kësaj metodologjie nuk përkufizohet vetëm në mbushjen e kokës së fëmijës me gjëra të panevojshme, por kjo mbushje me këtë metodë e privon atë nga metodat e arsimit, të cilat kontribuojnë në formimin e tij psikologjik ne periudhat e zhvillimit të tij. Me anë të humbjes së këtij shansi pedagogjik emocional, duke qenë në moshën e fëmijërisë së hershme, do të humbet shansi i formimit të shëndoshë të tij psikologjik në pakthim.

Prej shembujve që flasin për mbushjen e mendjeve të fëmijës, e që janë pak të dobishme, është edhe çështja që e mësojnë përmendësh e që ndërliidhet me sasinë e zeqatit dhe përqindja në kafshë, përfshirë devetë, lopët, delet dhe të mbjellat. Shumica e këtyre fëmijëve nuk kanë parë kafshë e as nuk merren me blegtori dhe bujqësi! Nuk di se pse mbushen kokat e tyre me këto çështje të thata në mënyrë të hollësishme, që nuk ndërliidhen fare me realitetin e jetës së tyre. Nëse fëmijën e detyrojnë të mësojë përmendësh zeqatin e çështjeve për tregti, përfshirë këtu aksionet e shtëpive dhe fabrikave, sa prej tyre do të punojnë në fushën e grumbullimit të zeqatit?! Kjo çështje, a do t'i ndihmojë kur të rritet e të posedojë aksionet e ndryshme apo do të kërkojë mendimin e prerë të ekspertëve në këtë çështje?!

Dëmi nuk përkufizohet vetëm në mbushjen e mendjes së fëmijës më çështje jo shumë të nevojshme, por periudha më e keqe fëmijërisë, është periudhë e formimit psikologjik dhe emotiv. Në këtë kohë formohen konceptet, ndjenjat, emocionet e tjera, për këtë në këtë periudhë është më prioritare, kur bëhet fjalë për zeqatin, t'i mësohen atij kuptimet e zeqatit, përfshirë solidaritetin, mëshirën, sakrifikimin, dhënia

përparësi tjetrit, mbështetja e të dobëtimit dhe nevojtarit etj. E gjithë kjo nuk duhet t'iu mësohet vetëm në formë diktuese, por duke përdorur të gjitha mjetet tekstuale, audio dhe vizuale, dhe me metoda pedagogjike praktike dhe efektive. Prej këtyre metodave, p.sh. vizita e të varfërve, të pamundurave dhe me nevoja të veçanta, duke iu shërbyer atyre, me qëllim që të perceptojnë kuptimet e nevojës dhe vështirësive të tyre.

Humbja e shansit për formim psikologjik dhe zëvendësimi i tij me mbushjen e mendjes me njohuri që është bërë objekt në vete, pa vërejtur rolin e njohurive dhe pa vërejtuar ndikimin e tij negativ në formimin e mendjes së fëmijës dhe edukimin e tyre, është pakujdesje nga natyra e fëmijërisë dhe rolin e raportit së njohjes me aspektin psikologjik dhe emotiv në formimin dhe zhvillimin e personalitetit të njeriut. Kjo është një nga deformimet metodologjike të trashëguara që ka goditur mendimin islam dhe civilizimin islam në kohët e mëvonshme.

2.1.3. Deformimi i tretë: deformim i koncepteve

Deformimi i tretë që ka goditur mendimin islam dhe mendjen e muslimanit është deformimi i koncepteve. E gjithë kjo si rezultat i izolimit të dijetarëve, që si pasojë e saj lindi dobësia ideologjike, ngurtësia dhe instrumentalizimi i diskursit të frikës, me qëllim të shuarjes së shpirtit kritik, duke e detyruar masën e thjeshtë, për shkak të pamundësisë ideologjike, t'i dorëzohen imitimit dhe pranimit. Është kështu, ngase është e pamundur të shuhet shpirti i përndjekjes dhe të dorëzohet i tërë umeti para diktimeve, përpos nëse deformimi përfshinë shumë prej koncepteve bazike islame. E gjithë kjo me qëllim që të lehtëson çështjen, të përgatisë mendjet dhe shpirtat për nënshtrim, imitim dhe dorëzim.

2.1.3.1. Deformimi i konceptit të të qenët rob i Allahut (el-ubudije)

Koncepti i të qenët rob i Allahut (el-ubudije) llogaritet një ndër konceptet elementare islame. Deformimi i këtij koncepti ka shpjerë në deformimin e shumë koncepteve tjera islame, me qëllim që të bashkohen konceptet e deformuara dhe të jepet mundësia e dominimit psikologjik, nxjerrja nga përdorimi i mendjes kritike, izolimi i hulumtimit dhe meditimit dhe të mjaftuarit me kërkesa dhe ëndërrime pa kërkuar rezultate dhe pasoja.

Muslimani, sipas mësimëve islame është krenar, məkëm-bës dhe fisnik. Të qenët rob i Allahut për të është krenari dhe nderë, ngase me këtë shprehë vullnetin e tij të lirë për të njohur të vërtetën dhe për të pasuar rrugën e drejtë. Muslimanët besimtarë janë robërit e sinqertë të Allahut. Nuk është e rastit që Allahu t'i drejtohet njeriut në Kur'anin famëlartë me shprehjen (ibad) dhe (ubbad) që rrjedhin nga fjala (et-ta'bid), e jo me fjalën (abid) që rrjedh nga fjala (el-isti'bad).

Kjo është e ngjashme me përdorimin e fjalës “edh-dhullu الذلل” në Kur'an me kuptim nënshtrimi. Kështu, nënshtrimi i njeriut para prindërve është me kuptim respektim dhe lehtësim, e jo me kuptim poshtërimi dhe nënçmimi. Allahu thotë:

وَأَخْفِضْ لَهُمَا جَنَاحَ الذَّلِّ مِنَ الرَّحْمَةِ وَقُلْ رَبِّ ارْحَمْهُمَا كَمَا رَبَّيَانِي صَغِيرًا

“Dhe në shenjë mëshire shtrije pranë tyre krahun përulës e respektues dhe thua: “Zoti im! Mëshiroi ata të dy, sikurse më edukuan mua kur isha i vogël.”¹⁸

Përzierja e çështjeve mes formës se si i drejtohet Allahu jobesimtarit, mendjemadh, mohues dhe luftues kundër Tij,

¹⁸ El-Isra': 24

dhe formës se si i drejtohet besimtarit adhures dhe afrues drejt Tij, e në këtë mënyrë koncepti i të qenët rob i Allahut (el-ubudije) të rrjedh nga (el-isti'bad - robërim), është një përzierje e pabazë dhe e panevojshme. Kështu, ky kuptim i fundit denoncon të gjitha llojet e nënshtrimit, kërcënimit, mjet për poshtërim, zhveshje nga dinjiteti, mbyllje të trurit dhe pengesë mes Krijuesit dhe krijesës. Njeriu është krijesë e kufizuar, ndërsa Allahu është Krijues absolut dhe në këtë mënyrë nuk ka hapësirë për krahasim mes Krijuesit dhe krijesës. Nxitja e këtyre supozimeve dhe krahasimeve nuk ka fare kuptimi.

Deformimi i konceptit të të qenët rob i Allahut (el-ubudije) dhe reklamimi e këtyre krahasimeve ka mundësuar uljen e vlerës së mendjes. Kështu, çështjet që ndërlidhen me mendjen u vunë në shënjestër të akuzave për mohim dhe padëgjueshmëri. Ky deformim ka kontribuar në shtypjen e ndjenjës së muslimanit dhe konfiskimin e të drejtës së tij për të menduar dhe kritikuar.

Ka qëndrim nga ana e studentëve të shkencave fetare, të cilët ishin të varfër në shkencat humane dhe njohjen e formave për zbritjen e njohurive hyjnore në fushën praktike të njerëzve, shpiu në largimin e shumë mendimtarëve drejt filozofive të importuara dhe të trashëguara nga civilizimet dhe kulturat e popujve tjerë, të cilët kanë kaluar në islam, pa pasur këta mendimtarë metodologji udhëzuese. Nuk duhet harruar se shumica e këtyre filozofive, bazën e tyre e kanë në çështje të paqarta metafizike, të zhveshura tërësisht nga udhëzimet hyjnore. Kjo çështje ka sjellë një konflikt iluzor në mendimin islam mes mendjes dhe teksteve hyjnore (el-aklu ve'n-naklu). Kjo çështje edhe më shumë rriti dobësinë e mendimit të umetit, shpërndau përpjekjet dhe i gjithë ky konflikt përfundoi në deformimin e koncept-

teve islame për të mbuluar pamundësinë e mendimit, shtrembërimin e mendimit kritik dhe zhvlerësimin e tij.

Është shumë e rëndësishme perceptimi i raportit mes koncepteve bazike islame të përfshira në konceptin e tevhidit, vullnetit, të të qenët rob i Allahut (el-ubudije), mëkëmbjes (el-istihlaf), pastrimit etiko-moral (et-tezkije) dhe ndërtimit (el-umran).

Koncepti i tevhidit nuk është çështje që ndërlidhet vetëm me disa cilësi të Zotit dhe për të cilat kanë të drejtë të flasin vetëm disa grupe të njerëzve. Por, është parim fetar dhe koncept islam që ndërlidhet ngushtë me jetën e njerëzve, me kuptimin e jetës dhe kuptimin e qëllimeve të saj.

2.1.3.2. Qendërimi i konceptit të tevhidit dhe kuptimet e tij jetësore

Rëndësia e tevhidit në Islam fshihet në atë se formon kornizën për kuptimin e jetës dhe hapësirës, si dhe vë parimet dhe themelet e raporteve ndërnjerëzore. Çdo çrregullim në këtë parim ose koncept, do të ketë pasoja të rrezikshme në të kuptuarit, llojin dhe qëllimin e jetës islame.

Parim i tevhidit nënkupton njëshmërinë e Krijuesit. Ky realitet nënkupton unifikimin e hapësirës, unifikimin e jetës dhe njeriut dhe përplotësimin e krijesave dhe hapësirës e jo kundërshtimin. Po ashtu, parimi i tevhidit nënkupton synimin e hajrit mes krijesave, ku nuk jepet mundësia për dominim, padrejtësi dhe tirani mes njerëzve. Bazuar në këtë, parimi i tevhidit obligon parimet tjera, siç janë ajo e drejtësisë, konsultimit, barabarësisë në të drejta, në dinjitetin njerëzor, në lirinë e shprehjes dhe përgjegjësisë njerëzore.

Palca e konceptit të të qenët rob i Allahut (el-ubudije) është bamirësia, liria e shprehjes dhe përgjegjësia njerëzore, të përfshira në parimin e tevhidit dhe parimin e mëkëmbjes (el-istihlaf) mbi të cilën ngritët koncepti i pastrimit etiko-moral (et-tezkije) dhe koncepti ndërtimor ((el-í'mar). Nje-

riu, qoftë si individ apo grup obligohet të realizojë qëllimet e mira sipas ligjeve që Allahu i ka vendosur, qoftë në jetën njerëzore apo në ligjet natyrore përreth tij. E gjithë kjo duke u bazuar në udhëzimet hyjnore të shpalljes dhe ligjet e natyrshmërisë (el-fitreh), të cilat Allahu i ka vënë në krijesa.

Sipas këtij kuptimi të ndërlidhur mes sistemit të parimeve dhe koncepteve, nga njëra anë dhe vizionit të përgjithshëm islam, nga ana tjetër, koncepti i të qenët rob i Allahut (el-ubudije), ashtu siç potencohet në Kur'an, bëhet burim i krenarisë, fuqisë dhe vetëbesimit në ndërgjegjen e muslimanit dhe në formimin e tij psikologjik dhe emocional, e jo robërim para njeriut, e as burim i ndjenjave të poshtëritimit, nënçmimit, nënshtimit dhe negativitetit.

Me këtë rast është e dobishme të mbështetemi në disa citate kur'anore, të cilat lidhin lexuesin me burimin kryesor të parimeve dhe koncepteve islame, siç janë ajo e tevhidit, të qenët rob u Allahut (el-ubudije), pastrimi etiko-moral (et-tezkije), mëkëmbësia në tokë (el-istihlaf), reformimi (el-islam) dhe ndërtimi (el-umran). Këto koncepte do t'i sqarojmë me sa vijon:

Ajetet kur'anore që ndërlidhen me tevhidin, el-ubudije dhe et-tezkije:

Ajetet kur'anore, parimin e njëshmërisë së Allahut (et-tevhid) e llogarisin parim esencial për rregullimin e universit dhe bazë për përmirësimin dhe ruajtjen e tij. Allahu është Një, Krijues. Përndryshe, fundi i universit do të ishte shkatërrimi. Bazuar në këtë, Allahu është burimi i njohurive rreth gjendjes së universit. Ai udhëzon njeriun dhe krijesat se si të veprojnë mes tyre. Vetëm Ai ka të drejtë të orienton dhe Atij t'i nënshtrohet në çështjet e universit dhe në çështjet që rregullojnë atë. E gjithë kjo, e ngritur mbi besim ndaj Krijuesit dhe ndjenja e përgjegjësise gjatë veprimit që sjellin përmirësim, krenari dhe fund të mirë në të dy botët.

Për të vërtetuar parimin e Njëshmërisë (el-vahdanije), Allahu thotë:

لَوْ كَانَ فِيهِمَا ءِالِهَةٌ إِلَّا اللَّهُ لَفَسَدَتَا فَسُبْحَانَ اللَّهِ رَبِّ الْعَرْشِ عَمَّا يَصِفُونَ

“Sikur të kishte në to (në qiej e në tokë) zota pos Allahu, ato të dyja do të shkatërroheshin. Larg asaj që i përshkruajnë është Allahu, Zoti i Arshit.”¹⁹

Allahu i Lartëmadhëruar e konsideron bamirësinë dhe të qenët rob i Allahut shkak për përmirësimin e jetës. Në lidhje me këtë thotë:

فَمَنْ كَانَ يَرْجُوا لِقَاءَ رَبِّهِ فَلْيَعْمَلْ عَمَلًا صَالِحًا وَلَا يُشْرِكْ بِعِبَادَةِ رَبِّهِ ۚ أَحَدًا

“...e kush është që e shpreson takimin e Zotit të vet, le të bëjë veprë të mirë, e në adhurimin ndaj Zotit të tij të mos e përziejë askënd”.²⁰

Përmirësimi i gjendjes dhe veprat e mira janë rrugë drejt krenarisë në të dy botët. Në lidhje me këtë, Allahu thotë:

أَمْ نَجْعَلُ الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ كَالْمُفْسِدِينَ فِي الْأَرْضِ أَمْ نَجْعَلُ الْمُتَّقِينَ كَالْفُجَّارِ

“A mos do t’i barazojmë ata që besuan dhe bënë vepra të mira me ata që bënë shkatërrime në tokë, apo do t’i konsiderojmë njësoj si të ruajturit prej të këqijave, si ata që janë mëkatarë”.²¹

Ajetet kur’anore që ndërlidhen me mëkëmbësinë (el-istihlaf), përmirësimin dhe reformat (el-islam) dhe ndërtimin (el-i’mar):

Gjithashtu është e dobishme të cekim disa ajete të cilat sqarojnë rrugën e udhëzimit, reformave dhe përmirësimit,

¹⁹ El-Enbija: 22

²⁰ El-Kehf: 110

²¹ Sad: 28

si dhe përfundimin e mëkëmbësit besimtar, të devotshëm dhe të drejtë, i cili bën punë të mira. Po ashtu, Kur'ani sqaron edhe rrugën e mohimit dhe devijimit, si dhe përfundimin e mohuesit të devijuar. Në lidhje me këtë, Allahu thotë:

وَعَدَ اللَّهُ الَّذِينَ ءَامَنُوا مِنكُمْ وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَيَسْتَخْلِفَنَّهُمْ فِي الْأَرْضِ
كَمَا أَسْتَخْلَفَ الَّذِينَ مِن قَبْلِهِمْ وَلَيُمَكِّنَنَّ لَهُمْ دِينَهُمُ الَّذِي ارْتَضَى لَهُمْ
وَلَيُبَدِّلَنَّهُم مِّن بَعْدِ خَوْفِهِمْ أَمْنًا يَعْبُدُونَنِي لَا يُشْرِكُونَ بِي شَيْئًا وَمَن كَفَرَ
بَعْدَ ذَلِكَ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْفَاسِقُونَ

“Atyre nga mesi juaj të cilët besuan dhe bënë vepra të mira, Allahu u premtoi se do t’i bëjë zotërues në atë tokë ashtu si i pat bërë zotërues ata që ishin para tyre dhe fenë të cilën Ai e pëlqeu për ta, do ta forcojë, e në vend të frikës Ai do t’ju dhurojë siguri. Ata më adhurojnë Mua e nuk më shoqërojnë asgjë. E kush edhe pas kësaj mohon, të tillët janë ata më të prishurit.”²²

ثُمَّ جَعَلْنَاكُمْ خَلَائِفَ فِي الْأَرْضِ مِّن بَعْدِهِمْ لِنَنْظُرَ كَيْفَ تَعْمَلُونَ

“Pastaj juve ju bëmë zëvendësues pas tyre në Tokë për t’ju parë si do të veproni”²³

قَالَ يَقَوْمِ اعْبُدُوا اللَّهَ مَا لَكُم مِّنْ إِلَٰهٍ غَيْرُهُ ۗ هُوَ أَنشَأَكُم مِّنَ الْأَرْضِ
وَأَسْتَعْمَرَكُمْ فِيهَا فَاسْتَغْفِرُوهُ ثُمَّ تُوبُوا إِلَيْهِ إِنَّ رَبِّي قَرِيبٌ مُّجِيبٌ

“O populli im, adhurojeni Allahun, ju nuk keni ndonjë zot tjetër pos Tij, Ai së pari ju krijoi nga dheu dhe ju bëri banues të tij, andaj kërkoni falje prej Tij, dhe shprehni pendim te Ai. S’ka dyshim, Zoti im është afër (me mëshirë), Ai përgjigjet (lutjeve)”!²⁴

²² En-Nur: 55

²³ Junus: 14

²⁴ Hud: 61

قَالَ يَقَوْمُ اعْبُدُوا اللَّهَ مَا لَكُمْ مِنْ إِلَهٍ غَيْرُهُ ۗ قَدْ جَاءَتْكُمْ بَيِّنَةٌ مِنْ رَبِّكُمْ ۗ فَأَوْفُوا الْكَيْلَ وَالْمِيزَانَ وَلَا تَبْخَسُوا النَّاسَ أَشْيَاءَهُمْ وَلَا تُفْسِدُوا فِي الْأَرْضِ بَعْدَ إِصْلَاحِهَا ذَلِكُمْ خَيْرٌ لَكُمْ إِنْ كُنْتُمْ مُؤْمِنِينَ

*“O populli im, adhurojeni Allahun (Një), ju nuk keni zot tjetër pos Tij. Juve ju erdhi mrekullia nga Zoti juaj. Zbatoni drejt matjen dhe peshojën, e mos u bëni padrejtësi njerëzve në sendet e tyre, dhe mos bëni çrregullime në tokë pas përmirësimit të saj. Këto janë më të dobishme për ju, nëse jeni besimtarë”.*²⁵

وَأْتَبِعْ فِيمَا آتَاكَ اللَّهُ الدَّارَ الْآخِرَةَ ۗ وَلَا تَنْسَ نَصِيبَكَ مِنَ الدُّنْيَا ۗ وَأَحْسِنَ كَمَا أَحْسَنَ اللَّهُ إِلَيْكَ ۗ وَلَا تَبْغِ الْفُسَادَ فِي الْأَرْضِ ۗ إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ الْمُفْسِدِينَ

*“Dhe me atë që të ka dhënë Allahu, kërko (ta fitosh) botën tjetër, e mos lë mangu atë që të takon nga kjo botë, dhe bën mirë ashtu siç të ka bërë Allahu ty, e mos bën të këqija në tokë, se Allahu nuk i do çrregulluesit”.*²⁶

وَإِذَا تَوَلَّى سَعَى فِي الْأَرْضِ لِيُفْسِدَ فِيهَا وَيُهْلِكَ الْحَرْثَ وَالنَّسْلَ ۗ وَاللَّهُ لَا يُحِبُّ
الْفُسَادَ

*“E posa të kthehet ai në tokë, vepron të bëjë shkatërrim në të, të asgjësojë të korrat (mbjelljet) dhe gjallesat. E Allahu nuk e do çrregullimin (fesadin)”.*²⁷

وَمَا كُنَّا مُهْلِكِي الْقُرَىٰ إِلَّا وَأَهْلُهَا ظَالِمُونَ

*“Ne nuk shkatërruam vendbanime, pos vetëm kur bano-rët e tyre ishin zullumqarë”.*²⁸

²⁵ El-A'raf: 85

²⁶ El-Kasas: 77

²⁷ El-Bekare: 205.

²⁸ El-Kasas: 59

وَمَا كَانَ رَبُّكَ لِيُهْلِكَ الْقُرَىٰ بِظُلْمٍ وَأَهْلِهَا مُصْلِحُونَ

*“E Zoti yt nuk është që të shkatërrojë mizorisht vendet, nëse banorët e tyre janë punëmirë”.*²⁹

Në Kur’an ka edhe shumë ajete tjera. Po ashtu në sunetin e vërtetë - sahih, ka thesare të shumtë për udhëzim dhe orientim, që një pjesë e madhe e tyre presin përpjekjet shkencore për të përfitur prej tyre në lidhje me edukimin e rinisë, përmirësimin e metodologjisë së të menduarit, pas-trimin e kulturës së tyre dhe orientimin e drejtë.

2.1.4. Deformimi i katërt: deformimi i diskursit (komunikimit)

Deformimi i katërt i rrezikshëm i cili ka dëmtuar mendjen, ndjenjat dhe psikikën e muslimanit është deformimi i diskursit islam. Kjo ka ndodhur në periudhën e ndarjes mes elitës ideologjike islame dhe elitës politike. Kjo ndarje së bashku me izolimin kanë sjellë dobësi ideologjike që ka shndërruar mendimin e ixhtihadit, ripërtëritjes dhe kreativitetit në mendim tekstual dhe të mbyllur, i cili më vonë solli mbylljen e ixhtihadit. Ky mendim ngritët mbi imitimin dh përfundoi në atë gjendje, saqë sipas disave, teksti i dobët të jetë më prioritar se sa mendimi racional.

Deformimi i diskursit në ato rrethana, erdhi si rezultat i mendimit të izoluar dhe ndarjes mes prijatarëve të mendimit dhe prijatarëve politik. Në përgjithësi, kjo nuk ndër-lidhet me qëllimet, ngase diskursi i shndërruar nga diskurs i mendimit, hulumtimit, meditimit, bindjes dhe fuqisë për ixhtihad, ripërtëritje dhe kontrollim të ndryshimeve kohore dhe vendore, në diskurs të frikës, dominimit dhe shuarjes, i cili në shumë raste është mbështetur në mendime të disa personave të pandërgjegjshëm me interesa personale. Po

²⁹ Hud: 117.

ashtu, është mbështetur në komentimin e disa teksteve, të cilat në esencë iu janë drejtuar mohuesve, jobesimtarëve, mendjemëdhenjve dhe atyre që u shpallin luftë besimtarëve. Në këtë formë, diskursi fetar i frikës, edhe më shumë ndihmoi në shtrydhjen e shpirtit të masës së gjerë.

Nuk ishte e rastit thënia e Ebu Dherr Gifarit radijallahu anhu, i cili vinte nga shkolla e shpalljes, ndaj themeluesit të mbretërisë, atëherë kur Muavi ibn Ebu Sufjani u ngrit në minber për të ligjëruar rreth burimeve materiale të umetit dhe arkën shtetërore (bejtu mal'il-muslimin), të cilin e quajti "mal'ull-llah" (pasuri e Allahut). Në këtë rast ngritët Ebu Dhërri duke e kundërshtuar, përmirësuar dhe përkujtuar për të drejtën e umetit në burimet dhe pasuritë e tyre. Gjithashtu e përkujtoi për përgjegjësinë e pushtetarëve dhe punëtorëve rreth mënyrës më të mirë të grumbullimit dhe distribuimit mes meritoreve, duke i thënë: "bel mal'ul-muslimin" (në realitet është pasuri e muslimanëve).

Nuk është për t'u habitur që umeti të arrijë deri në këtë gjendje të përçarjes, negativitetit dhe prapambetjes nëse vizioni i muslimanit është i mbuluar me petkun e ndjenjave të dobësisë individuale dhe humbjen e sigurisë së solidaritetit kolektiv. Po ashtu, nëse vizioni i tij ndaj punës në jetë është negative dhe e zbratur nga dimensionimi civilizues, ndërtues dhe shpirtëror. Kur të deformohen konceptet e muslimanit, atëherë këto koncepte shndërrohen në mjete për zhvlerësim të mendjes dhe humbje të vetëbesimit në vete.

Nuk është për t'u habitur që umeti të arrijë deri në këtë gjendje të prapambetjes dhe negativitetit, përderisa ajo vuan nga terrori i elitës pushtetare, e cila nuk njeh forma tjera për t'u marrë me opozitarët përpos politikës së frikës, shuarjes, rrahjes dhe hapjen e dyerve të burgjeve për ta. Kjo është vetëm si rezultat i pamundësisë për kontrollimin e

çështjeve të reja dhe varfërisë për bazën ideologjike që i ndihmon për zhvillim, kontrollim, kryerje të punës në formën më të mirë dhe luftimin e korrupsionit.

Nëse terrorizmit politik i shtohet edhe terrorizmi i diskursit fetar, i cili në të shumtën e rasteve përfshin xhehenimin, vështirësitë e varrit dhe ditës së kijametit, në të cilën besimtarët do të dënohen për çdo veprim, qoftë i madh apo i vogël, do të kuptojmë disa nga shkaqet e shuarjes, dobësisë dhe negativitetet e shpirtit të umetit.

Prej shembujve të drejtpërdrejtë që lexuesit i bëhet më e qartë çështja e deformimit të diskursit fetar, është ajo që pash në një konferencë islame ndërkombëtare, ku tema e saj ishte: "Uniteti islam". Ligjërata ishte e përgjithshme, ndërsa salla ishte e stërmbushur me pjesëmarrës. Siç dukej, tema ishte e panjohur sa duhet për ligjëruesin dhe pjesëmarrësit filluan të luhaten në ndjekjen e ligjëratës. Ligjëruesi papritmas dhe pa ndonjë arsye të qartë orienton ligjëraten rreth vdekjes, ballafaqimi me te dhe se çka e pret keqbërësin! Kështu, para meje kisha një skenë të gjallë që shpreh keqpërdorimin e diskursit real dhe shndërrimit të tij në diskurs terrori dhe kërcënimi, me anë të së cilit ligjëruesi eliminon mendjen e dëgjuesit dhe përpiqet për të dominuar ndaj pjesëmarrësve në sallë dhe për të paralizuar fuqitë e tyre për mendim kritik ndaj asaj që e prezanton në ligjëraten e tij.

Prej shembujve më të freskët rreth metodës së shfrytëzimit të terrorizmit ideologjik dhe keqpërdorimit të simboleve të shenjta, është edhe ligjërata e një hatibi në ditën e xhuma rreth një çështje që ka të bëjë me pamjen e jashtme të njeriut. Tema ishte rreth lëshimit të mjekrës. Ligjëruesi nuk ishte aq i përgatitur për të sqaruar para xhematit urtësinë e lëshimit të mjekrës dhe filloi të shprehë mendimin e tij duke i frikësuar ata. Këtë e bëri duke e shndërruar çështjen e mjekrës si çështje anësore që ndërlihet me pamjen e jashtme

të njeriut, siç janë flokët dhe veshja, në çështje të besimit dhe mosbesimit. Sipas tij, ata që nuk lëshojnë mjekrën janë mohues të sunetit, ndërsa mohues i sunetit është mohues i fesë, dhe kështu mohuesi i fesë është qafir-jobesimtar.

Problematike këtu është mendimi dhe metodologjia, e cila vazhdon edhe sot e kësaj dite në ligjërime dhe arsimim, duke përdorur tekstet dhe duke i vënë në shërbim në formë të pakontrolluar, pa u vërtetuar shkencërisht dhe pa shfrytëzuar metodologjinë gjithëpërfshirëse të burimeve të njohjes. Po ashtu, pa arsimim të mirëfilltë që prodhon mendje të vetëdijshme që kuptojnë çështjet e paraqitura nga të gjitha anët në jetën reale të shoqërisë.

Pasi mësimi i akaidit, fesë dhe kulturës realizohej në këtë formë të ligjërit, ndikimi i mësimit fetar në të shumtën e rasteve ishte i dobët dhe negativ. Kjo mund të vërehet në pranimin e dobët të besimtarëve ndaj ligjëratave dhe këshillave, si dhe mund të vërehet në ndjenjat e fëmijës ndaj këtyre njohurive dhe metodave arsimore.

Në lidhje me këtë çështje mjafton të cekim se Muhamedi alejh'is-selam ishte babë, gjysh dhe edukator i suksesshëm. Ai nuk ka rrahë asnjëherë ndonjë fëmijë, ngase i donte fëmijët dhe të rinjtë.

Prej shembujve që sqarojnë sjelljen e mirë dhe të kuptuarit e Muhamedit alejh'is-selam me të rinjtë, është edhe ajo që kishte ndodhur mes vetë Muhamedit alejh'is-selam dhe një të riu, i cili kishte arritur moshën e pubertetit. Ky i ri shkoi te Muhamedi alejh'is-selam dhe kërkoi leje për amoralitet! Disa të pranishëm reagues ndaj sjelljes së tij me Muhamedin alejh'is-selam. Mirëpo, Muhamedi alejh'is-selam i qetësoi ata dhe urdhëroi që t'i japin hapësirë të ofrohet prej tij. Ajo që na intereson në këtë rast në aspektin pedagogjik është se Muhamedi alejh'is-selam u soll me butësi ndaj të riut dhe nuk iu drejtua atij me fjalë kërcë-

nuese, e as me çështje harami apo xhehenemi, ngase i riu nuk kishte ardhur për të mësuar dispozitën e veprimit, por kishte ardhur për të kërkuar rrugëdalje nga gjendja me të cilën ballafaqohej. Kështu, Muhamedi alejh'is-selam, duke kuptuar karakteret e njerëzve, kishte depërtuar në thellësinë e karakterit të të riut dhe kishte zgjuar ndërgjegjen e tij. Ai këtë e bëri duke nxitur tek ai dinjitetin dhe bujarinë e tij. E pyeti atë se a do të kishte pranuar që dikush të kryente amoralitet me nënën e tij, me motrën e tij, me hallën e tij, me tezën e tij?! Në çdo pyetje, krenaria e tij e bënte të refuzojë atë turp. Kështu, Muhamedi alejh'is-selam tërhoqi vëmendjen e tij drejt realitetit që nuk duhet të harrohet nga asnjë njeri i ndershëm. Ky realitet është se njeriu nuk duhet ta pëlqejë për tjerët atë që nuk e pëlqen për veten e tij. Këtë ia tha me dashurinë dhe respektin më të madh ndaj vuajtjeve të tij psikologjike, se ato të gjitha janë nëna, motra, halla dhe teze. Më pas u lut për të, gjë e cila i dha fuqi psikologjike, pengesë dhe mbrojtje.

Krahas metodologjisë gjithëpërfshirëse analitike dhe përplotësimit të burimeve të njohurisë në arsimimin dhe edukimin islam, është e domosdoshme edhe gjendja e një mekanizmi të zgjedhur dhe të përgatitur shkencërisht për të dalluar mendimet nga ixhtihadet. Ky mekanizëm, duke u bazuar në njohuritë rreth çështjeve konstante të fesë, intencave dhe gjendjes së njerëzve, do të zgjedh mendimin më të dobishëm për umetin, që përshtatet me gjendjen dhe karakterin e njerëzve dhe me rrethanat dhe çështjet e ndryshueshme dhe jokonstante. Në këtë mënyrë, diskursi merr karakter konsultativ, i cili me aftësitë fetare dhe politike përfiton bindjen e popujve, bashkon rreshtat, eksplodon energjinë dhe rregullon raportet mes anëtarëve të shoqërisë.

Ky lloj i programeve shkencore islame kur kompletohet me mekanizmi i konsultimit, atëherë do të sjell ambient, i

cili jep mundësi për ixhtihad dhe ripërtëritje, pa pasur pasoja negative që shndërrojnë ixhtihadin në mjet për përçarje të unitetit. Kështu sheriat, përfshirë anën e besimit dhe atë politik, bëhet udhërrëfyes i lëvizjes së umetit, i cili zhvillohet me zhvillimin e rrethanave, duke u bazuar në çështjet e udhëzimeve konstante të fesa, karaktereve të krijesave, nevojat dhe mundësitë e shoqërisë.

Frika që ka goditur diskursin islam, nuk është përkufizuar vetëm me të rriturit, por pasojat e saj kanë kapluar të gjitha shtresat, përfshirë edhe fëmijët dhe arsimimin e tyre. Kështu, diskursi ka marrë ngjyrën e diktimit, nxënies përmendësh, imitimit, dominimit material dhe shpirtëror dhe instrumentalizimin e simboleve të shenjta për ta ngulfatur shpirtin kritik dhe kontrollimin, si dhe nënshtrim të verbër ndaj proverbit: *“Kush ma mëson një shkronjë, i bëhem atij rob”*.

2.1.5. Deformimi i pestë: mendësi magjike dhe mitologjia

Është për t'u habitur përhapja e mentalitetit magjik dhe mitologjik në mesin e një umeti që ka për mbështetje Kur'anin, i cili fton për mendim, meditim, hulumtim, seriozitet, përpikëri, bamirësi, përpjekje dhe xhihad, ndjekje të ligjeve dhe marrja e të gjitha masave të duhura gjatë realizimit të punëve.

Realisht është për t'u habitur zhvillimi i mentalitetit magjik dhe mitologjik në mesin e umetit të një të Dërguari, për të cilin biografia dhe sunneti i tij në lidhje me menaxhimin e tij ndaj çështjeve të umetit, nuk lënë asnjë dyshim në seriozitetin e marrjes së të gjitha shkaqeve dhe menaxhimin e çështjeve, si dhe përpjekja në maksimum për të evituar çdo gjë që pengonte rrugën e tij.

Biografia e tij dhe zbatimi i mesazhit të tij ishte njerëzor, i ndërlidhur me marrjen në konsideratë të shkaqeve. Shprehja kur'anore në lidhje me natyrën e tij njerëzore ishte

mjaft e qartë. Ai fitonte ndaj armiqve, por edhe humbte, kishte shëndet, por edhe sëmurej, kishte uri, etje dhe në çështjet që nuk ndërlidheshin me mesazhin hyjnorë, e qëllonte dhe gabonte.

Muhamedi alejh'is-salam ishte i shkathët në drejtim, planifikim dhe menaxhimin në paqe dhe luftë. Allahu në lidhje me këtë çështje thotë:

قُلْ لَا أَمْلِكُ لِنَفْسِي نَفْعًا وَلَا ضَرًّا إِلَّا مَا شَاءَ اللَّهُ وَلَوْ كُنْتَ أَعْلَمَ الْغَيْبِ
لَاسْتَكْتَرْتُ مِنَ الْخَيْرِ وَمَا مَسَّنِيَ السُّوءُ إِنْ أَنَا إِلَّا نَذِيرٌ وَبَشِيرٌ لِّقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ

Thuaj: "Unë nuk kam në dorë për veten time as ndonjë dobi, as ndonjë dëm, pos çka do Allahu. Sikur ta dija të fshehtën, do t'i shumoja për vete të dobishmet, e nuk do të më prekte gjë e keqe. Unë nuk jam tjetër vetëm se qortues dhe përgëzues për njerëzit që besojnë".³⁰

قُلْ لَا أَقُولُ لَكُمْ عِنْدِي خَزَائِنُ اللَّهِ وَلَا أَعْلَمُ الْغَيْبِ وَلَا أَقُولُ لَكُمْ إِنِّي
مَلَكٌ إِنِّي أَتَّبِعُ إِلَّا مَا يُوحَىٰ إِلَيَّ قُلْ هَلْ يَسْتَوِي الْأَعْمَىٰ وَالْبَصِيرُ أَفَلَا
تَتَفَكَّرُونَ

Thuaj: "Unë nuk u them juve se i kam në kompetencë depot e Allahut (e t'ju sjell mrekuili), as nuk pretendoj se i di fshehtësitë (e t'ju tregoj se kur do t'ju vijë dënimi), as nuk u them se unë jam engjëll. Unë ndjek vetëm atë që më shpallet mua. Thuaj: "A janë baras i verbëti dhe ai që sheh?" A nuk mendoni?³¹

قُلْ إِنَّمَا أَنَا بَشَرٌ مِّثْلُكُمْ يُوحَىٰ إِلَيَّ أَنَّمَا إِلَهُكُمُ اللَّهُ وَاحِدٌ فَمَن كَانَ يَرْجُوا
لِقَاءَ رَبِّهِ فَلْيَعْمَلْ عَمَلًا صَالِحًا وَلَا يُشْرِكْ بِعِبَادَةِ رَبِّهِ ۚ أَحَدًا

³⁰ El-A'raf: 188

³¹ El-En'am: 50

*Thuaj: “Unë jam vetëm njeri, sikurse edhe ju, mua më shpallet se vetëm një Zot është Zoti juaj, e kush është që e shpreson takimin e Zotit të vet, le të bëjë vepër të mirë, e në adhurimin ndaj Zotit të tij të mos e përziejë askë”.*³²

وَمَا مُحَمَّدٌ إِلَّا رَسُولٌ قَدْ خَلَتْ مِنْ قَبْلِهِ الرُّسُلُ أَفَإِنْ مَاتَ أَوْ قُتِلَ انْقَلَبْتُمْ عَلَىٰ
 أَعْقَابِكُمْ وَمَنْ يَنْقَلِبْ عَلَىٰ عَقْبَيْهِ فَلَنْ يَصُرَ اللَّهُ شَيْئًا وَسَيَجْزِي اللَّهُ
 الشَّاكِرِينَ

*“Muhammedi nuk është tjetër vetëm se i dërguar. Edhe përpara tij pati të dërguar (që vdiqën ose u vranë). E nëse ai vdes ose mbytet, a do të ktheheshit ju prapa (nga feja ose lufta)? E kushdo që kthehet prapa, ai nuk i bën dëm Allahut aspak, kurse Allahu do t’i shpërblejë mirënjohësit”.*³³

Si është e mundur që bartësit e këtij mesazhi dhe ndjekësit e këtij të Dërguari, shumica e tyre të përfundojnë në mitologji dhe magjia të dominon mbi kokat dhe mendjet e tyre?!

2.1.5.1. Mbështetja reale në Allahun (et-tevekkul) dhe mbështetja e rrejshme (et-tevakul)

Mijëra ajete kur’anore i drejtohen zemrës dhe mendjes, vlerësojnë argumentin, ftojnë për punë, caktojnë përgjegjësi dhe urdhërojnë umetin e Muhamedit alejh’is-selam për aktivitet, përpjekje dhe marrje në konsideratë të shkaqeve. Kur beduini e pyeti Muhamedin alejh’is-selam në lidhje me devenë e tij se a ta lidhë apo të mbështetet në Allahun, ai i tha: “Lidhe, pastaj mbështetu në Allahun”.³⁴

³² El-Kehf: 110

³³ Alu Imran: 144

³⁴ Tirmidhiu, El-Xhami’us-Sahih, “Sunen’ut-Tirmidhi”, vëll. 4, fq. 668, hadithi nr. 2517.

Kur'ani vërteton se Allahu është Ai që: *الَّذِي خَلَقَ فَسَوَّىٰ وَالَّذِي قَدَّرَ فَهَدَىٰ* ³⁵ "I cili krijoi dhe përsosi, Dhe i cili përcaktoi e orientoi".³⁵ Allahu thotë: *ثُمَّ أَتَّبَعَ سَبَبًا* "Pastaj, ai iu rrek një aso mundësie (mori në konsideratë shkaqet)".³⁶ *وَأَنْ لَّيْسَ لِلْإِنْسَانِ إِلَّا مَا سَعَىٰ وَأَنَّ سَعْيَهُ سَوْفَ يُرَىٰ* ³⁶

ثُمَّ يُجْزَاهُ الْجَزَاءَ الْأَوْفَىٰ

*"Dhe se njeriut nuk i takon tjetër vetëm se ajo që ka punuar. Dhe se munda i tij më vonë (ditën e gjykimit) do të shihet. Pastaj ai shpërblehet me shpërblimin më të plotë".*³⁷

Me punë, me përpjekje në marrjen e shkaqeve, natyrshmerinë e karaktereve dhe duke kërkuar dhe hulumtuar ligjet hyjnore natyrore, realizohet aftësimi për arritjen e frutave. Në të gjitha këto çështje nuk ka vend për magji dhe mite ose asgjë që bie ndesh me mbështetjen e realitë në Allahun xh.sh. duke bërë përpjekje dhe duke ndjekur ligjet hyjnore natyrore në menaxhimin dhe drejtimin e çështjeve të jetës.

Realiteti i tevekkulit, lutjes dhe dobive të tyre vie pas kryerjes së punës dhe përpjekjes maksimale. Me tevekkul dhe lutje synohet kërkimi i ndihmës nga ana e Allahut në lidhje me çështjet universale të kozmosit të cilat nuk i njohim, e as nuk kemi dominim ndaj tyre, ngase vetëm Allahu është Ai që i njeh ato dhe ka në duart e Tij drejtimin e tyre.

Sa i përket dobësisë, përtacisë dhe heqjes dorë nga marrja në konsideratë të ligjeve dhe shkaqeve, duke u mbështetur vetëm në lutje, kjo është mbështetje e rrejshme (tevakul) dhe devijim nga rruga e islamit dhe rruga e ligjeve. Ky është i barabartë me ata të cilët merren me magji dhe troka-

³⁵ El-A'la: 2-3.

³⁶ El-Kehf: 89

³⁷ En-Nexhm: 39

sin dyert e fallxhorëve. E gjithë kjo shpie në devijim dhe rrëshqitje në drejtim të kufrit dhe shirkut.

Para se të zhytemi në çështjet që ndërlidhem me magjinë dhe mitet, është e rëndësishme të sjellim një shembull që sqaron lidhshmërinë islame mes seriozitetit në punë dhe kërkimit të shkaqeve nga njëra anë dhe lutjes drejtuar Allahut dhe mbështetjes tek Ai në arritjen e çështjeve nga ana tjetër. Shembull i përafërt me të është shembulli i studentit. Ai, krahas asaj që dëgjon ligjëratat, duhet të mëson, kupton, hulumton, përsëritë etj. Nëse e bën këtë, ai do të kalon. Përndryshe, sipas ligjeve shkak-pasojë, ai nuk do të mund të kalon. Këto janë ligjet e Allahut që i ka caktuar. Është e patjetërsueshme përpjekja dhe puna, si dhe marrja në konsideratë e shkaqeve për të arritur deri te frytet. Mirëpo, duhet kuptuar se për arritjen e suksesit, vetëm mësimi nuk është i mjaftueshëm, sepse sukcesi nuk ndërlidhet vetëm me shkaqet e drejtpërdrejta. Ai ndërlidhet me çështje më të gjera dhe më të përgjithshme. Është e mundur që student të ketë mësuar, mirëpo e ka penguar diçka që mos të shkoi në provim.

Është e mundur të ketë arritur në sallën e provimit, por pas dorëzimit të fletës së provimit, vëren se ka harruar përgjigjen e ndonjë pyetjeje. Është e mundur se është përgjigjur në të gjitha pyetjet, por më vonë vëren se është përgjigjur gabimisht, edhe pse e ka ditur përgjigjen e saktë. Për të gjitha këto çështje, njeriu nuk mund të parallogaritë. Në këto raste, njeriu nuk posedon mjet tjetër, krahas punës, përveç se të mbështetet në Allahun, në duart e të Cilit janë të gjitha çështjet dhe drejtimi i universit dhe lutjes drejtuar Allahut, duke kërkuar ndihmë dhe sukses. Ky është programi islam në jetë dhe kuptimi i vërtetë i tevekkulit dhe lutjes së sinqertë.

2.1.5.2. Terrorizmi, autokracia dhe prapambetja janë rezultat i miteve dhe magjisë

Këto deformime të cilat kapluan mendjen e myslimanit, krijuan parakushte të përshtatshme për mentalitet mitologjik dhe magjik. Kështu ndodhi atëherë kur popullata e thjeshtë ra viktimë e padrejtësive, autokracive, terrorizmit politik dhe frikës ideologjike. Popullata u bë servile, negative dhe hoqi dorë gradualisht nga hulumtimi, ndërtimi dhe kreativiteti. Kështu u fundos në varfëri, mitologji dhe injorancë. Në këtë gjendje, njeriu humb besimin në veten e tij, humb iniciativën në çështjet e jetës së tij dhe humb kontrollin në aftësitë e tij.

Në këtë gjendje të pamundësisë dhe dhembjes, është plotësisht normale të anon drejt miteve dhe magjisë, si dhe komenteve dhe rrëfimeve mitologjike. I dëgjon ato dhe kërkon ndihmën e tyre kundër sëmundjeve dhe rreziqeve, të cilave nuk ua din shkakun për shkak të injorancës, e as nuk mund t'i largon ato për shkak të pamundësisë. E gjithë kjo për arsye se kultura, formimi psikologjik dhe fuqia i tij janë shkatërruar. Është privuar nga fuqia mentale, psikika e kreativitetit dhe iniciativës dhe fuqia për hulumtim, që nuk ka asnjë popull në botë më prioritar për këtë çështje se sa populli dhe umeti islam që posedon Kur'anin.

2.1.5.3. Katastrofa në instrumentalizimin e fesë në shërbim të mitologjisë dhe magjisë

Kur sëmundja bëhet epidemi, infektim, kancer dhe kur sëmundja rritet deri në atë masë sa që vështirësohet shërimi para të gjitha sfidave dhe katastrofave që e godasin umetin, i cili përkundur diturisë, nuk ka kreativitet dhe as kryen punë me përpikëri, nuk arrin në rezultatin e duhur. E gjithë kjo është si rezultat i shenjtërimit të shumë prej miteve dhe

magjive dhe reklamimit të shumë prej mitologjive dhe israilizmave.

Kur u kompletua pjekuria e njerëzisë, programi i mendimit, udhërrëfyesi i jetës dhe u zbrit mesazhi i Kur'anit dhe drita e udhëzimit të tij në mendjen e tij, duke rregulluar raportin e tij me universin dhe duke u mbështetur në atë që Allahu ka pajisur njeriun me shkaqe dhe sekrete, atëherë ndryshoi edhe pozita e njeriut, ku me mendjen dhe diturinë e tij ishte ai që kontrollonte botën e tij. Askush tjetër në univers nuk kishte dominim ndaj tij e as nuk kishte mundësi të depërton e të kontrollojë atë. Për këtë në Kur'an thuhet:

وَأَنَا كُنَّا نَقْعُدُ مِنْهَا مَقْعِدَ لِلسَّمْعِ فَمَنْ يَسْتَمِعِ الْآنَ يَجِدْ لَهُ شَهَابًا رَصَدًا

*“Dhe ne më parë hulumtonim në vendvështrimin për të dëgjuar, e kush përpiqet të dëgjojë tash, ai has në pusinë e shkëndijës së zjarrtë”.*³⁸

Kur'ani ka sqaruar se magjistarët në të kaluarën kanë bërë mashtrimin e njerëzve me anë të magjisë. Këtë e vërteton ku thotë:

قَالَ الْقَوَّاءُ فَلَمَّا أَلْقَوْا سَحَرُوا أَعْيُنَ النَّاسِ وَاسْتَرْهَبُوهُمْ وَجَاءُوا بِسِحْرِ عَظِيمٍ

*“Ai (Musai) tha: “Hidhni ju!” E kur hodhën ata (shkopinj e litarë), magjepsën sytë e njerëzve, i frikësuan ata dhe sollën një magji të madhe”.*³⁹

قَالَ بَلْ أَلْقُوا فَإِذَا حِبالُهُمْ وَعَصِيْبُهُمْ يُخَيَّلُ إِلَيْهِ مِنْ سِحْرِهِمْ أَنَّهَا تَسْعَى

*“Ai (Musai) tha: “Jo, hidhni ju!” Kur ja, atij iu duk se nga ajo magji e tyre litarët dhe shkopinjët lëviznin (si gjarpërinj)”.*⁴⁰

³⁸ El-Xhinn: 9

³⁹ El-A'raf: 116

⁴⁰ Ta Ha: 66

إِنَّمَا صَنَعُوا كَيْدٌ سَجِرٌ وَلَا يُفْلِحُ السَّاجِرُ حَيْثُ أَتَى

“...sepse ajo që bënë ata nuk është asgjë tjetër pos mashtrim magjistari, e magjistari nuk do të ketë sukses kudo qoftë”.⁴¹

Po ashtu magjistarët nuk kanë fuqi për të sjellë dobi apo dëm, përpos me lejen e Allahut. Ndikimi i tyre i dëmshëm është për shkak të mashtrimeve dhe hileve që bëjnë edhe sot e kësaj dite.

Muhamedi alejh'is-salam ishte i dërguar për të gjitha botët, përfshirë edhe botën e xhinëve dhe botët tjera të fshehura në univers. Megjithatë, ai nuk kishte parë xhinët, e as nuk kishte kontaktuar me ta. Këtë të vërtetë Kur'ani e potencon, duke thënë:

قُلْ أَوْحَىٰ إِلَيَّ أَنَّهُ اسْتَمَعَ نَفَرٌ مِّنَ الْجِنِّ فَقَالُوا إِنَّا سَمِعْنَا قُرْءَانًا عَجَبًا

“Thuaj: “Mua më është shpallur se një grup i vogël nga xhinët i vuri veshin dhe dëgjoi (Kur'anin) dhe (kur u kthyen te të vetët) thanë: “Ne kemi dëgjuar një Kur'an që mahnit”.⁴²

Po ashtu iblisi, i cili, siç na njofton Allahu në Kur'an, ka mundësinë e vesveses dhe cytjeve te njeriu, megjithatë, ai nuk ka fuqi dominimi e as kontrollimi ndaj tij, përpos nëse njeriu me dëshirën e bën këtë. Në lidhje me këtë, Allahu thotë:

إِنَّ عِبَادِي لَيْسَ لَكَ عَلَيْهِمْ سُلْطَانٌ إِلَّا مَنِ اتَّبَعَكَ مِنَ الْغَاوِينَ

“Se ti ndaj robërve të Mi (të sinqertë) nuk ke kurrfarë force (as fizike as mendore), përveç atyre të humburve që vijnë pas teje”.⁴³

إِنَّهُ لَيْسَ لَهُ سُلْطَانٌ عَلَى الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَلَىٰ رَبِّهِمْ يَتَوَكَّلُونَ إِنَّمَا سُلْطَانُهُ عَلَى الَّذِينَ يَتَوَلَّوْنَهُ وَالَّذِينَ هُمْ بِهِ مُشْرِكُونَ

⁴¹ Ta Ha: 69

⁴² El-Xhinn: 1

⁴³ El-Hixhr: 42

“Vërtet, ai (shejtani) nuk ka kurrfarë fuqie kundër atyre që besuan dhe i janë mbështetur Zotit të tyre.⁴⁴ Mbizotërimi i tij është vetëm mbi ata që e përkrahin atë dhe mbi ata që për shkak të tij u bënë idhujtarë”.⁴⁵

Allahu, përmes librit të Tij të fundit, njeriut ia deshi të mirën e jo të keqen. E liroi atë nga dominimi i çdokujt përveç dominimit të Tij. Tërë botën e krijoi enkas për të dhe e vuri në shërbim të tij, ia dha mundësinë për ndërtimin dhe përparimin e tij vetëm me punë dhe përpjekje. Nuk ka asgjë e as fantazma që dominojnë ndaj tij. Po ashtu, nuk ka asnjë fuqi që paralizon ose mohon vullnetin e tij, shkatërron rolin, mohon përgjegjësinë, ose tallet me të duke e lënë të paaftë dhe pa vullnet. Vullneti është vullneti i tij, vepra është vepra e tij dhe përgjegjësia është përgjegjësia e tij. Allahu thotë:

فَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ خَيْرًا يَرَهُ ﴿٧﴾ وَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ شَرًّا يَرَهُ

“E kush punon ndonjë të mirë, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë. Dhe kush punon ndonjë të keqe, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë”.⁴⁶

⁴⁴Prej gabimeve që bëjnë disa studiues dhe depërtojnë përmes tij disa magjistarë, është edhe çështja e ndikimit të shejtanit që quhet “el-messu”. Kur’ani Famëlartë flet për “mess’ush-shejtan” (i prekuri nga djalli), e jo siç pretendojnë ata për preken e xhinëve në ajetin që flet për personat që veprojnë me kamatë ku thuhet: *“Ata që e hanë kamatën, ata nuk ngrihen ndryshe vetëm se si ngrihet ai çmenduri nga të prekurit e djallit. (Bëjnë) kështu ngase thanë: “Edhe shitblerja nuk është tjetër, por njësoj sikurse edhe kamata!”* El-Bekare: 275. Është e qartë se ky ajet në mënyrë alegorike përshkruan devijimin e personave që punojnë me kamatë se si ecin si të çmendur në devijimin e tyre nga rruga e drejtë. Kjo nuk ka lidhje fare me sëmundjet mentale dhe psikike. Kamataxhinjtë në këtë botë edhe pse janë të devijuar, ata janë të shëndoshë mentalisht dhe përgjegjës për veprimet e veta. Nuk ka lidhje devijimi i tyre në besim me sëmundje mentale, nervore dhe psikike. Kjo çështje është e qartë edhe në përngjasimin e frutave të xhehenemit në dëmin të pamjen e keqe të tyre me kokat e djajve. Ai që supozon se çdo sëmundje është “messun min’el-xhinni” (prekje nga xhinët) s’ka fjalë se është mashtrim dhe rrenë fallxhorësh, që nuk mbështetet në asnjë argument.

⁴⁵ En-Nahl: 99

⁴⁶ Ez-Zelzele: 7-8.

وَلَا تَكْسِبُ كُلُّ نَفْسٍ إِلَّا عَلَيْهَا وَلَا تَزِرُ وَازِرَةٌ وِزْرَ أُخْرَىٰ

“...dhe dëmi i secilit person është kundër vetes. Askush nuk do ta bartë barrën e tjetrit”.⁴⁷

وَاتَّقُوا يَوْمًا تُرْجَعُونَ فِيهِ إِلَى اللَّهِ ثُمَّ تُوَفَّىٰ كُلُّ نَفْسٍ مَّا كَسَبَتْ وَهُمْ لَا يُظْلَمُونَ

“Dhe ruajuni një ditë kur në të ktheheni te Allahu, dhe secilit njeri i plotësohet ajo që e ka fituar, dhe atyre nuk u bëhet e padrejtë”.⁴⁸

وَمَا أَصَابَكُمْ مِّنْ مُّصِيبَةٍ فَبِمَا كَسَبَتْ أَيْدِيكُمْ وَيَعْفُوا عَنْ كَثِيرٍ

“Çfarëdo e keqe që mund t’ju godasë, ajo është pasojë e veprave tuaja (të këqija), e për shumë të tjera Ai u falë”.⁴⁹

Mirëpo, ky vizion kur’anor, vizion i shkencës dhe mendimit, udhërrëfyes i punës dhe përpjekjes që peshon edhe grimcat e imëta, është luhatur pasi mendimi i imponimit, prapambetjes, imitimit dhe rënies turbulloi pastërtinë e tij. Kështu filluan që disa ajeteve kur’anore dhe disa haditheve të sakta të Pejgamberit alejh’is-selam, t’u japin komentim të gabuar, duke u bazuar në disa hadithe të dobëta dhe të shpikura. E gjithë kjo nga moskujdesi i “të sinqertëve” dhe shpikja e fallxhorëve, dallaverexhinjëve, interesaxhinjëve dhe transmetuesit e mitologjive dhe israilijateve, me qëllim që mendimit mitologjik dhe magjik t’i japin legjitimitet, të mbytë ndjenjën islame dhe në fund, umeti të dorëzohet në duart e fallxhorëve që t’u sjellin atyre edhe më shumë prapambeturi dhe injorancë.

⁴⁷ El-En’an: 164.

⁴⁸ El-Bekare: 281

⁴⁹ Esh-Shura: 30.

Ishte më prioritare për personat që merren me botën e fshehur metafizike, për të cilat nuk ka hapësirë për mendjen e as për shqisat e njeriut që ta kupton atë, të merren me analizimin e argumenteve për të dalluar të saktin nga jo i sakti, t'i përmbahen kufijve të kuptimeve kur'anore, intencave dhe qëllimeve, siç potencohen në kontekstin kur'anor, duke përfunduar me kaq. E gjithë kjo duke pasur parasysh intencat dhe duke zbatuar metodologjinë e saktë gjatë hulumtimit. Kjo metodologji mbështetet në rregullat e përgjithshme metodologjike, intencat dhe qëllimet e shariatit, rrethanat e kohës dhe vendit si dhe sfidat dhe problemet me të cilat ballafaqohet umeti.

Sipas meje, prej rregullave më të rëndësishme metodologjike që duhet të zbatohen në çështjet e gajbit (metafizike) është rregulli i përcjelljes së lajmit në mënyrë mutevatir.⁵⁰ Themi kështu sepse çështjet metafizike nuk i nënshtrohen mendjes, përvojës e as eksperimentit. Për këtë është patjetër marrja e lajmit nga burimet mutevatir. Sikur studiuesit të merrnin në konsideratë intencat dhe parimet në kuptimin dhe kritikën e teksteve, si dhe të ishin të përpiktë gjatë mbështetjes në tekst, duke kritikuar shkencërisht senedin (zinxhirin e transmetimit), do të rahatonin umetin nga një rrëshqitje vdekjeprurëse dhe nga dominimi i shenjtërisë së shumë çështjeve të rrejshme, të devijuara dhe të shtuara. Gjithashtu komentimet e gabuara kanë bërë që në rrethana të dobësisë, frikës dhe tiranisë, të orienton umetin në drejtim të mendimit mitologjik, duke hequr mendjen nga përdorimi. E gjithë kjo ia dorëzoi umetin lutjeve të mashtruesve dhe fallxhorëve, duke e radhitur atë në radhët e të prapambeturve dhe të dobëtëve.

⁵⁰ Mënyra "mutevatir" nënkupton përcjellja e një lajmi nga një grup i madh i njerëzve, gjeneratë pas gjeneratë, në atë mënyrë që është e pamundur depërtimi i gënjeshtërs.

2.1.5.4. Lutja dhe rukja lidhje emocionale, jo profesion

Prej gjërave që janë për keqardhje, është edhe ajo kur lutja dhe rukja përdoren nga disa njerëz për të hapur derën e miteve dhe për të bërë fallin si profesion. Lutja shndërrohet në profesion dhe mjet për përfitime materiale dhe për ngritje të pozitës. Kështu, disa njerëz veçojnë veten e tyre për këto pozita ose veçohen nga të tjerët praktikisht me dije ose pa dije, për të qenë ndërmjetësues mes tyre dhe Allahut në shërimin e njerëzve dhe plotësimin e nevojave të tyre. Njerëzit në këtë mënyrë sikur kanë gjykuar se ata janë të drejtë dhe të afër me Allahun, dhe se i kanë veçuar për orientim tek ata për plotësimin e nevojave. Këta njerëz, edhe pse thonë ndryshe, praktikisht kontrollojnë mëshirën e Allahut dhe e vënë në shërbim të tyre, duke e bërë atë profesion. Kurse në lidhje me këtë Allahu thotë:

وَإِذَا سَأَلَكَ عِبَادِي عَنِّي فَإِنِّي قَرِيبٌ ۖ أُجِيبُ دَعْوَةَ الدَّاعِ إِذَا دَعَانِ فَلْيَسْتَجِيبُوا لِي وَلْيُؤْمِنُوا بِي لَعَلَّهُمْ يَرْشُدُونَ

*“E kur robët e Mi të pyesin ty për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet, pra për të qenë ata drejt të udhëzuar, le të më përgjigjen ata Mua dhe le të më besojnë Mua”.*⁵¹

Nuk ka dyshim se Allahu subhanehu ve teala dëgjon lutjet e robërve të Tij. Ai di sekretet e tyre dhe me urtësinë e Tij i shpërblen ata sipas meritave. Të nevojshmit janë më meritoret për kthim tek Ai dhe lutje drejtuar Atij. Allahu thotë:

وَلَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ وَنَعَلْمَا تَوْسُوسًا بِهِ ۗ نَفْسُهُ وَنَحْنُ أَقْرَبُ إِلَيْهِ مِنْ حَبْلِ الْوَرِيدِ

⁵¹ El-Bekare: 186

*“Ne e kemi krijuar njeriun dhe dimë se ç’pëshpërit ai në vetvete dhe Ne jemi më afër tij se damari (që rrah) i qafës së tij”.*⁵²

وَقَالَ رَبُّكُمْ ادْعُونِي أَسْتَجِبْ لَكُمْ

*“Zoti juaj ka thënë: “Më thirrni Mua, Unë ju përgjigjem”.*⁵³

Sa i përket kërkimit të lutjes prej prindërve dhe prej njerëzve të drejtë dhe të sinqertë, ajo është çështje e preferuar, nëse e gjithë kjo është në mënyrë mekanike dhe me shpirt të bamirësisë dhe dashurisë, e jo me shpirt mashtrimi dhe supozimi se në duart e tij është mëshira e Allahut.

Është me rëndësi që kërkimi i lutjes prej njerëzve të drejtë dhe të sinqertë të mos jetë arsye për heqje dorë nga pendimi dhe nga vendosmëria për përmirësim të vetes së tij dhe afrimit tek Allahu. Kërkimi i lutjes nga i drejti duhet të shoqërohet me përpjekje për përmirësimin e vetes. Kështu, lutja e tij shndërrohet në mjet për afrim tek Allahu, e jo mjet për vetëkënaqësi dhe humbje të vetëdijes.

Kështu, kërkimi i lutjes nga ana e nevojtarëve drejtuar prindërve dhe njerëzve të drejtë dhe të sinqertë, nuk realizon qëllimin, përpos nëse kryhet në mënyrë mekanike dhe lidhshmëri emocionale. Në raste kur ndodhin fatkeqësi të mëdha zgjerohet për të përfshirë të gjithë njerëzit, ngase janë raste kur pranohen lutjet me lejen e Allahut, si dhe përforcon dashurinë, solidaritetin dhe ndihmën mes anëtarëve të shoqërisë. Allahu thotë:

ادْعُوا رَبَّكُمْ تَضَرُّعًا وَخُفْيَةً

*“Luteni Zotin tuaj të përulur e në heshtje”.*⁵⁴

⁵² Kaf: 16

⁵³ Gafir: 60.

⁵⁴ El-A'raf: 55.

2.1.5.5. Vazhdimi i përpjekjeve për përmirësimin dhe pastrimin e teksteve, koncepteve dhe komenteve

Mendimi dominues i umetit vuan nga pjesshmëria gjuhësore dhe tekstuale tradicionale, të mbështetura në mendime dhe rrethana historike që nuk ndërlidhen me ligjet, me realitetin në të cilin jemi duke jetuar, e as me sfidat dhe problemet me të cilat jemi duke u ballafaquar sot. Kjo e bën mendimin e umetit sikur një foto të komplikuar kur e copëton në copa të shumta, ose kur një fletë e pret me mjetin prerës. Kështu, për personin që nuk ka njohuri të mjaftueshme është shumë e vështirë që nga ato pjesë të vogla ta kthen fotografinë origjinale, siç ishte më parë. Kështu, injoranca e njerëzve përfundon duke marrë secili nga një pjesë e vogël, që ndryshon nga tjetra dhe në këtë mënyrë është vështirë që ndonjëri prej tyre të posedon pjesën e fotografisë që përfaqëson tërë fotografinë. Kjo është ekzakte me atë që po ndodhë sot. Në lidhje me çdo dispozitë apo çështje ngritën zëra të panumërta, me vizione dhe sende të ndryshme dhe kundra njëra tjetrës. Njerëzit nuk dinë se cila prej tyre është e saktë. Secili prej tyre posedon argument që mbështet mendimin e tij, në kohë që të tjerët mposhtin këtë mendim me mendim dhe argument tjetër.

Metodologjia e shëndoshë nuk lejon që ngjarjet, praktikat dhe rrethanat kohore dhe vendore të dominojnë ndaj qëllimeve dhe çështjeve të pandryshueshme dhe universale. Po ashtu, nuk lejon të ç'orientohen përpjekjet për përballimin e problemeve dhe sfidave. Kështu, komentet dhe konceptet e gabueshme, tekstet e falsifikuara dhe të trilluara, rrëfimet dhe mitologjitë nuk duhet të gjejnë hapësirë në mendimet e umetit, në çështjet e pandryshueshme dhe universale, si dhe në kulturën dhe praktikat e popullatës.

2.1.5.6. Reklamimi i mendimit dhe librave mitologjike dhe magjike konsiderohet krim fetar

Për umetin e Kur'anit dhe mëkëmbësinë e njeriut është krim në aspektin fetar, ideologjik dhe shoqëror, në këtë kohë dhe para sfidave me të cilat ballafaqohet umeti, të bëhet reklamim për çdo gjë që pengon shpirtin e shkencës, punës, përpjekjes, marrjen e masave dhe shkaqeve dhe bartjes së përgjegjësisë.

Është krim gjithashtu shpërndarja e librave të kohëve të mëhershme, të cilat veçohen për rrethana dhe sfida njohëse të mëhershme. Shumë prej tyre i takojnë mitologjive, prapambetjes dhe rënies, mirëpo, në mënyrë të rrejshme i mveshen fesë dhe trashëgimisë. Shpërndarja e këtyre librave, pa i kontrolluar dhe pastruar, si dhe reklamimi i tyre mes njerëzve dhe rinisë, në emër të fesë, llogaritet krim dhe sulm ndaj popullatës së këtij umeti.

Mendja e shëndoshë e muslimanit në raport me këto libra gjykon që ato duhet të studiohen nga ana e ekspertëve, duke u kuptuar rrethanat dhe motivet në të cilat janë shkruar, e assesi të jenë lëndë për reklamim mes masës së thjeshtë. Një reklamim i tillë llogaritet mashtrim dhe mitologji në emër të fesë dhe të trashëgimisë. Kjo vlen edhe për ato libra që për autorë figurojnë emrat e disa personave që i vlerësojmë dhe respektojmë, porse kanë gabuar në kuptimin e disa çështjeve.⁵⁵ Sa dukuri dhe fenomene kanë qenë të panjohura në të kaluarën, por falë hulumtimeve dhe arritjeve shkencore sot, janë bërë të njohura dhe të zgjidhura. Po ashtu, shumë prej këtyre supozimeve kanë dalë si të rrejshme dhe false.

⁵⁵ Ne e dimë se disa dijetarëve të mëhershëm iu referohen qindra libra, të cilat është e pamundur që ndonjëri prej tyre t'i ketë shkruar gjatë jetës së tij. Kjo le të kuptohet se disa njerëz, librat e tyre ua referojnë disa njerëzve me famë, me qëllim të reklamimit të mendimeve të tyre. Kjo na bën të refuzojmë supozimin e përkatësisë së ndonjë libri në emër të ndonjë dijetari, nëse në atë libër ka mendime që bien ndesh me mendimet dhe qëllimet e njohura të atij dijetari.

Kapja për mite, iluzione, rrëfime të trilluara, mrekulli të rrejshme dhe shpërndarja e tyre, si dhe përzierja mes të kaluarës së njeriut dhe rolit të miteve, nga njëra anë dhe gjendjes së tashme të njeriut i ngritur mbi udhëzimin hyjnor dhe programit shkencor dhe mendor, nga ana tjetër, e gjithë kjo nuk i shërben askujt, pos armiqve të umetit. Kjo nuk sjell asnjë rezultat, pos shkatërrimit të shpirtit shkencor dhe vazhdimin e dobësisë dhe pamundësisë së umetit.

Rinia dhe umeti në përgjithësi duhet të mbrohet nga këto mendime dhe lëndë të dëmshme, me besim të vërtetë dhe me shkollim të drejtë. Të gjitha këto çështje në sferën e edukimit, arsimimit dhe informatikës duhet të jenë larg syve dhe veshëve të rinisë dhe masës së thjeshtë. Këto lëndë helmuese dhe të dëmshme duhet të jenë në duart e ekspertëve për shqyrtim, larg duarve të fëmijëve dhe injorantëve.

2.1.5.7. Popujt përparojnë me shkencë e njohuri, jo me mitologji dhe magji

Popujt nuk kanë përparuar me veprat e magjistarëve dhe mitologëve, e as me bashkëpunëtorët e xhinëve dhe djajve. Por, përparimi është arritur falë asaj që Allahu ia ka dhuruar njeriut, përfshirë mendjen, njohuritë, fuqinë dhe përpjekjet, në përputhshmëri me karakteret dhe mundësitë e krijesave.

Duhet patjetër të kuptojmë natyrën e rrethanave dhe fazave pozitive dhe negative nëpër të cilat ka kaluar umeti. Po ashtu, duhet kuptuar natyrën e mentalitetit dhe mundësitë e diskursit në të kaluarën. Një sasi e madhe e ligjëritimit, qoftë edhe pozitive, i është përshtatur kohës, vendit, kulturës dhe mundësive të asaj periudhe. Për këtë, pranimi i saj dhe zbatimi në rrethanat dhe sfidat e sodit, duke lënë anash karakteristikat e kohës dhe duke e marrë atë si trashëgimi e së kaluarës, llogaritet lloji më i rëndë i injorancës dhe pakuj-

desisë. Ky lloj i diskursit sjell dëmin më të madh. Është gabim transmetimi i çdo gjëje që thuhet, ngase “çdo kuvend ka edhe fjalën e vet”. Një pjesë e asaj që është thënë dhe të cilën e kanë pranuar shumë prej paraardhësve tanë, është gabim transmetimi, përhapja, përdorimi dhe llogaritja si trashëgimi e shenjtë.

Mendimtarët dhe dijetarët e umetit duhet të mos bien në kurthet e metodologjive parciale dhe ... me qëllim që të kenë mundësi të kryejnë obligimin e tyre në shpëtimin e umetit. Po ashtu, ata, për përmirësimin e këtyre deformimeve, duhet të nisen duke marrë parasysh çështjet universale dhe qëllimet e shariatit, të pajisur me njohuri dhe hulumtime shkencore, historike, shoqërore, psikologjike dhe pedagogjike. E gjithë kjo, me një metodologji gjithëpërfshirëse, analitike dhe sistematike, përmes së cilave bëhet i qartë vizioni i shëndoshë islam dhe mënyrat e realizimit në botën islame. Po ashtu, nga perceptimi i ngjarjeve dhe teksteve në periudhën e shpalljes dhe më pas, do të kenë mundësi të perceptojnë dimensionin kohor dhe vendor, dhe rolin e tyre në të kuptuarit e ngjarjeve dhe teksteve të sakta, në atë mënyrë që duhet të jenë të kontrolluara dhe të dalluara me mjete më të sakta metodologjike. E gjithë kjo për të njohur veçoritë e atyre që u është drejtuar fjala, marrë parasysh faktorin kohë dhe vend, në kulturën, perceptimet, raportet dhe traditat e tyre shoqërore.

Shpesh ndodhë që kur shikohen ngjarjet dhe tekstet, të keqkuptohen çështjet. Kështu, bariu, mësuesi dhe udhëheqësi kur i drejtohen popullit të tyre, ata flasin sikur t'i drejtohen të gjithë njerëzisë, e jo një grupi apo individëve të caktuar, ku dallojnë aftësitë, perceptimet, kulturat dhe traditat e tyre. Marrë parasysh të gjitha këto çështje, duhet edhe mënyra e diskursit të dallon, bile edhe në vendin dhe kohën e njëjtë, nga një grup në tjetër dhe nga një formë në

tjetrën, varësisht nga gjendja e personit që i flet. Gjithashtu, për këtë çështje duhet të merren parasysh prioritetet, interesat, domosdoshmëritë dhe aftësitë që duhet t'i ketë në konsideratë personi që flet. Nëse çështja është kështu, atëherë çka duhet thënë për ato çështje që për disa shekuj janë larg rrethanat kohore dhe vendore?!

2.1.5.8. Vetëdija e prindërve është themel i ndërtimit

Është e dobishme këtu të sjellim një shembull për dallimin e diskursit për shkak të natyrës kulturore dhe natyrës së personit që i flet. Ky shembull sqaron rëndësinë e metodës së të kuptuarit të shumë prej veçorive të teksteve, të cilat nuk i kuptojnë ithtarët e metodologjive të pjesshme shkakun e mospranimit të njerëzve ndaj diskursit të tyre.

Nënat në Mekë, sipas meje, edhe në shumë vende tjera, në periudhën e fëmijërisë së brezit tonë dhe brezave të mëhershëm, përcillnin disa koncepte dhe metoda të trashëguara, të cilat shumë prej tyre janë zhdukur me kalimin e kohës. Prej këtyre çështjeve ishte edhe ajo që ua mësonin fëmijëve se çdo kokërr e shëgës është kokërr e xhenetit. Shega, siç dihet, është prej pemëve të dalluara në rajonin e Taifit dhe vendeve të Hixhazit. Frytet e kësaj peme lënë gjurmë të kuqe në rrobat e njeriut dhe është vështirë pastrimi i tyre. Po ashtu, pasi është vështirë të ruhen kokrrat e tij pa u derdh nga dora e personit që i hanë ato, ka lindur ideja se çdo kokërr e shëgës është kokërr xheneti. Kjo ide e shkëlqyer, bën fëmijën të kujdeset për çdo kokërr shege dhe lehtëson punën e nënës në ruajtjen e rrobave dhe orendive të shtëpisë nga përlyerja. Vetëm kur të kalojmë fazën e fëmijërisë, do të kuptojmë se “kokrra e xhenetit” ka qenë iluzion!

Duhet kuptuar se kujdesi i nënës për të mbrojtur fëmijët dhe përdorimi i iluzioneve, nga padituria, për realizimin e shpejtë të qëllimeve, mund të ketë ndikim shumë negativ!

Po ashtu, ngjashëm me këtë kemi edhe atë që e përdorin shumë prej nënave që nuk njohin psikikën e fëmijëve, duke i frikësuar ata nëse dalin jashtë shtëpive, sidomos gjatë natës ku mungon ndriçimi. Ata i kanë frikësuar duke ju thënë se natën dalin “vjedhësit”, “hajnat”, “shejtanët”, i frikësonin ata se është një “xhin” i njohur me emrin “du-xhejra”, i cili del natën me veshje të grave dhe se nuk mund të dallohet mes tij dhe një grua të rëndomtë, përpos se këmba e saj është në formën e këmbës së gomarit. Mund të paramendojmë se si do të jetë gjendja e një fëmije, i cili detyrohet të del nga shtëpia dhe takon një grua para tij në rrugë dhe në errësirë!

Këto mite frikësuese dhe ajo që mbillet në imagjinatën e fëmijës së vogël, është e mjaftueshme të ndalë fëmijën të kalojë pragun e derës në errësirën e natës. Jo vetëm kaq, por çështja kalon edhe në probleme psikologjike, të cilat mund të mos shlyhen. Ky lloj i edukimit përbën një faktor të rëndësishëm në formimin e cilësive të frikës dhe trishtimit në psikikën e fëmijës kur të rritet. Atëherë, duhet të presim të vjen një i huaj, që do të jetë më i ditur se ne dhe që do të shëtitet nëpër kodrat, luginat dhe shpellat tona, për të skicuar hartat dhe vendet e pasurisë.

Sa është për keqardhje se shumë prej ligjëruesve dhe shtëpive botuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, publikojnë tekste me përmbajtje negative, në veçanti tekste fetare, të cilat mund të jenë jo të sakta ose të falsifikuara, ose nuk janë kuptuar rrethanat, ose janë keqkuptuar apo interpretuar?!

2.1.5.9. Përpykje edhe më të mëdha në pastrimin e koncepteve elementare

Dijetari i njohur Muhamed Abduhu, i ndjekur nga disa dijetarë mendimtarë, pasi ishte ballafaquar me sfidat shken-

core evropiane, filloi në kohën e re pastrimin e trashëgimisë nga pasojat e miteve dhe fallit në kokën e muslimanit. Këtë e realizoi duke bërë rishikim ndaj të kuptuarit e teksteve dhe çështjeve të trashëguara. Këto problematika i rishikoi nga këndvështrimi i rrethanave, koncepteve, njohurive dhe sfidave të kohës. Ai ftoi në rishikimin e teksteve të trashëgimisë dhe metodat e kuptimit, kritikës dhe komentimit të këtyre teksteve, duke riformuluar diskursin islam, varësisht nga ndryshimet, nevojat dhe mundësitë e kohës së tij.

Krahas përpjekjeve të këtyre kolosëve, që shënuan një fillim të rëndësishëm, ende ka nevojë për përpjekje edhe më të mëdha, të cilat duhet të jenë metodologjike, me qëllim të vënies së bazamenteve dhe koncepteve të përgjithshme dhe të nevojshme për lirin e kokës së muslimanit nga mitet dhe falli, bazamente të cilat përshtaten me umetin e “lapsit” dhe “hekurit”. Në kohën e shkencës së ligjeve natyrore dhe duke marrë parasysh metodologjinë e shëndoshë shkencore, unifikohet vizioni dhe zgjerohen pikat e përbashkëta. Pa metodologji të shëndoshë shkencore, umetit i pamundësohet vizioni i vërtetë i përbashkët dhe zhduket fuqia për lirin e mendimeve, kulturës dhe qëndrimeve në formë objektive dhe efektive.

Për këtë, është jo efektive drejtimi i një dialogu rreth një çështje të rëndësishme dhe substanciale, siç është luftimi i mendimit mitologjik dhe zëvendësimi i tij me mentalitet shkencor, i bazuar në metodologji parciale dhe ..., sepse mungojnë kriteret metodologjike të dialogut dhe divergjencave në mendime. Në këso raste, dialogu patjetër përfundon në bisedime të pakuptimta rreth çështjeve parciale, që nuk sjell asgjë përpos rrëmujë ideologjike, rritje të divergjencave, ekstremizëm në qëndrime false, ikje nga hulumtimi shkencor në gjykim rreth qëllimeve, akuza të dyanshme dhe lindja e armiçësive që copëtojnë unitetin, dobësojnë

vendimet, shkatërrojnë ndërgjegjen kolektive, ngrenë barrierat e izolimit dhe shkujdesjen mes popullatës dhe elitës së kulturuar të umetit.

Unë ftoj dijetarët dhe mendimtarët të kujdesen për çështjen metodologjike, të veprojnë për pastrimin e kulturës nga deformimet dhe ndotjet që e kanë goditur, në veçanti mendimet mitologjike, magjike dhe mashtruese. Të kujdesen për studimin e teksteve dhe trashëgimisë në mënyrë metodologjike, duke përfshirë tekstin (el-metnu), zinxhirin (el-sened), formën dhe tematikën. E gjithë kjo duhet realizuar në baza të shëndosha, përfshirë qëllimet (el-mekasid), pikënisjet (el-muntalekat) dhe sfidat (el-tehaddijjat), në atë mënyrë që mos të lihet asnjë hapësirë që fjalët dhe tekstet të përdoren si hyrje për negativitet, tevakul dhe mashtrim.

Në fund të këtij kapitulli është e rëndësishme të ofroj kornizat e trajtimit të kërkuar, të përkujtoj shtyllat elementare, referencat e trajtimit dhe kriteret e matjes së rezultateve.

Këto shtylla duhet të gjykojnë çështjet universale të çdo hulumtimi në këtë sferë dhe të nxjerr rezultatet në bazë të kriterëve të caktuar. Ndaj këtyre shtyllave gjykon elementi substancial i Islamit dhe parimet elementare të tij, siç janë: parimet e tevhidit, mëkëmbësia në tokë (el-istihlaf), qëllimi i të qenët i dobishëm në jetën e njeriut, parimi i përgjegjësisë njerëzore i bazuar në punë dhe përpjekje në tokë sipas ligjeve kauzale në univers.

Shtyllat më të rëndësishme sipas Islamit dhe çështjet universale sipas teksteve kur'anore janë:

- Çështja në esencë nuk është çështje ekzistimi apo mosekzistimi të botëve tjera në univers. Ajo që na intereson është raporti i këtyre botëve - pa marrë parasysh natyrën e tyre - me botën njerëzore dhe ndikimi i tyre ndaj tij. Është e qartë se parimi i përgjegjësisë dhe parimi i marrjes së

shkaqeve në konsideratë, nuk japin hapësirë që botët tjera të kontrollojnë njeriun. Po ashtu, duhet bërë dallimin mes botëve të ndryshme metafizike dhe të fshehta. Për disa prej tyre nuk dimë asgjë. Disa prej tyre janë krijesa të vogla që nuk mund t'i sheh me sy njeriu, të cilat njeriut i kanë shkaktuar shumë sëmundje dhe katastrofa. Disa prej tyre janë të dobishme për njeriun, sekretet e të cilave i ka zbuluar shkenca sot.

- Shejtani dhe pasardhësit e tij - duke përfshirë edhe xhinët - i takojnë botës metafizike (el-gajb). Ata nuk kanë asnjë kontroll ndaj njeriut.

- Çështjet e magjisë dhe fallit janë mashtrime dhe iluzione

- Me fillimin e shpalljes botërore, respektivisht Kur'an-it, njerëzia ka kaluar në një fazë të re të pjekurisë dhe performansës. Njeriu është shndërruar në krijesë me vizion të plotë dhe në pozicion të përgjegjësisë. Ai është transferuar nga bota e fëmijërisë njerëzore, bota e injorancës dhe iluzioneve, në botën e librit, mendjes, diturisë, njohurisë, punës dhe marrjes në konsideratë të shkaqeve. Me anë të mendjes dhe shkencës janë zbuluar dhe vazhdojnë të zbulohen sekretet e botës së fshehtë në krijesat e imëta. Me këtë ai largoi shumë prej shkaqeve të dobësisë, frikës dhe trishtimit. Po ashtu, shkenca me anë zbulimeve shkencore, anuloi shumë prej mjeteve të mashtruesve, fallxhorëve dhe magjistarëve. Kjo është realizuar duke zbuluar shumë prej ligjeve fizike dhe karakteristikat e lëndëve, si dhe shumë prej sekreteve të psikikës njerëzore, sëmundjet dhe gjërat që ndikojnë tek ai.

- Sikur fallxhorët, mashtruesit dhe magjistarët të ishin realitet, do të ndihmonin veten e tyre. Mirëpo, ata e bëjnë të gjithë këtë me qëllim për të përfituar pasurinë e të humburve dhe për t'i dëmtuar ata materialisht dhe moralisht.

- Parimet që flasin se njeriu është i nderuar (tekrim), mëkëmbës (istihlaf), e tërë bota në shërbim (tes'hir) dhe përgjegjës (mes'ulije), lënë të kuptojmë se njeriu kontrollon botën e tij dhe bartë përgjegjësinë e veprave të tij në orientimin e botës që e rrethon, e jo kontrolli i botës së fshehtë ndaj tij.

- Rezultati përfundimtar që mund të përfundon çdo hulumtim, kuptim dhe komentim, patjetër të shpie në një të vërtetë të padiskutueshme se ajo që veprojnë fallxhorët, mashtruesit dhe magjistarët nuk sjell asgjë përpos dëm për njeriun. Veprimi me ta dhe rënia në rrjetin e tyre është hutim dhe devijim, dhe se marrja me këtë aktivitet është sherr dhe kufër.

2.1.6. Deformimi i gjashtë:

racizmi "hiqni dorë prej tij se është i qelbur"

Jam rritur në Mekë. Në ambientet e saj kam parë të gjitha llojet e njerëzve, me ngjyra dhe lloje të ndryshme. Në shtëpi, mëhallë, në hapësirat e Haremit dhe përreth tij. Ata janë pjesë e imja dhe unë pjesë e tyre, në njerëzi, fe dhe atdhedashuri. Nuk ka dallim mes tyre, përpos cilësive dhe karakteristikave individuale.

Ky fëmijë ka lexuar librin e Allahut në shtëpi, në shkollë, në Qabe. Ka studiuar një sërë librash që përmbajnë hadithe nga sunneti i Muhamedit alejh'is-selam. Ka menduar me zemrën dhe mendjen e tij ajetet kur'anore që flasin për unitetin e njeriut, vëllazërinë e muslimanëve dhe respektimin e të afërmve. Allahu thotë:

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَخَلَقَ مِنْهَا زَوْجَهَا وَبَثَّ مِنْهُمَا رِجَالًا كَثِيرًا وَنِسَاءً ۚ وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي تَسَاءَلُونَ بِهِ ۚ وَالْأَرْحَامَ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلَيْكُمْ رَقِيبًا

“O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqën) e saj, e prej atyre dyve u shtuan burrra shumë e gra. Dhe kini frikë Allahun që me emrin e Tij përбетoheni, ruajeni farefisn (akraballëkun), se Allahu është mbikëqyrës mbi ju.”⁵⁶

يٰۤاَيُّهَا النَّاسُ اِنَّا خَلَقْنٰكُمْ مِّنْ ذَكَرٍ وَّاُنْثٰى وَجَعَلْنٰكُمْ شُعُوْبًا وَّقَبَاۤىِٕلٍ
لِّتَعَارَفُوْۤا اِنَّ اَكْرَمَكُمْ عِنْدَ اللّٰهِ اَتْقٰىكُمْ اِنَّ اللّٰهَ عَلِيْمٌ خَبِيْرٌ

“O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s’ka dyshim se te Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijat), e Allahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë.”⁵⁷

وَمِنْ ءَايٰتِيْهِۦ خَلَقَ السَّمٰوٰتِ وَالْاَرْضِ وَاَخْتَلَفَ اَلْسِنٰتِكُمْ وَاَلْوٰنِكُمْ اِنَّ فِىْ
ذٰلِكَ لَآيٰتٍ لِّلْعٰلَمِيْنَ

“Nga argumentet e Tij është krijim i qiejve e i tokës, ndryshimi i gjuhëve tuaja dhe i ngjyrave tuaja. Edhe në këtë ka argumente për njerëz”.⁵⁸

يٰۤاَيُّهَا الَّذِيْنَ ءَامَنُوْا كُوْنُوْا قَوّٰمِيْنَ بِالْقِسْطِ شُهَدَآءَ لِلّٰهِ وَلَوْ عَلٰى اَنْفُسِكُمْ اَوْ
اَلْوَالِدِيْنَ وَاَلْاَقْرَبِيْنَ

“O ju që besuat, vazhdimisht të jeni dëshmues të drejtë për hirë të Allahut edhe nëse është kundër (interesit) vetvetes suaj, kundër prindërve ose kundër të afërmeve”.⁵⁹

⁵⁶ En-Nisa': 1

⁵⁷ El-Huxhurat: 13

⁵⁸ Err-Rrum: 22

⁵⁹ En-Nisa': 135

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا كُونُوا قَوَّامِينَ لِلَّهِ شُهَدَاءَ بِالْقِسْطِ وَلَا يَجْرِمَنَّكُمْ شَنَاٰنُ قَوْمٍ عَلَىٰ ءَلَّا تَعْدِلُوا ءَعْدِلُوا هُوَ أَقْرَبُ لِلتَّقْوَىٰ وَاتَّقُوا اللَّهَ إِنَّ اللَّهَ خَبِيرٌ بِمَا تَعْمَلُونَ

*“O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të Allahut, duke dëshmuar të drejtën, dhe të mos u shtyjë urrejtja ndaj një populli e t’i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë. Kini dro Allahun se Allahu di hollësisht për atë që veproni”.*⁶⁰

Po ashtu Muhamedi alejh’is-selam ka thënë:

“Të gjithë jeni nga Ademi, ndërsa Ademi është krijuar nga dheu. Nuk ka më shumë vlerë arabi ndaj joarabit, e as joarabi ndaj arabit përpos me devotshmëri”;

“Mos të vijnë njerëzit ditën e Kiametit me veprat e tyre, e ju të vini me afërsinë familijare”;

“Oj Fatime, e bija e Muhamedit, nuk do të mund të ndihmoj asgjë para Allahut”;

“Sikur Fatimja, e bija e Muhamedit, të vidhte, do t’ia preja dorën”;

“Besimtari është vëlla i besimtarit. Nuk i bën padrejtësi, e as nuk e dorëzon atë. Allahu është në ndihmën e njeriut, derisa njeriu të jetë në ndihmën e vëllait të tij”;

„Muslimani për muslimanin është sikur fortifikata, përforcon njëra-tjetrën”;

„Shembulli i besimtarëve në dashuri dhe mëshirë, është sikur shembulli i një trupi të vetëm. Nëse një organ është i sëmurë, i tërë trupi do të përjeton dhembjen dhe temperaturën”.

Fëmija lexon dhe mendon i hutuar rreth historisë së umetit, përfshirë konfliktet dhe konfliktet e fiseve, nacionaliteve dhe racave, ashtu siç ka ndodhur në Andaluzi. Ai

⁶⁰ El-Maide: 8

me imagjinatën e tij nuk kupton të gjitha këto konflikte fisnore dhe racore. Kur rritet dhe tejkalon periudhën e fëmijërisë, ai del nga vendi ku është rritur. Shëtitet në vende të ndryshme, përfshirë botën arabe dhe jashtë botës arabe, në lindje dhe perëndim. Atëherë ai vëren se njerëzit ndahen në etni, fise, popuj, raca, gjuhë etj. Vetëm atëherë, ai kupton krizën e thellë të umetit islam.

Islami është fe ndërkombëtare që kërkon unifikimin e njeriut. Kjo është ajo që e bën atë një tërësi të kompletuar që fillon nga pozitiviteti i substancës së tij, përfshirë shpirtin, vlerat, drejtësinë, solidaritetin dhe mëshirën. E gjithë kjo e përfshirë në atë që quhet sheriat. Të gjitha këto vlera shiheshin në praktikë në shoqërinë gjatë shpalljes, shoqëri e cila dallohej me besim të paluhatur në njëshmërinë e Allahut, në vëllazëri, drejtësi dhe mëshirë. Kjo shoqëri ishte e pastër nga “qelbësira” e racizmit, nacionalizmit dhe përkatësisë fisnore. Të gjithë ishin vëllazër. Kjo ishte shtylla në të cilën stabilizohet njeriu shpirtërisht. Nuk ka dallim mes një njeriut dhe tjetrit përpos me devotshmëri, bartje të përgjegjësisë dhe kryerje të obligimeve.

Në mesazhin islam, përfshirë vlerat dhe kulturën e tij, takohen të gjitha përkatësitë njerëzore, që nga krijimi i parë nga një person, afërsia farefisnore, feja dhe njerëzia, e gjithë kjo me shpirtin e drejtësisë dhe bamirësisë, duke përfshirë të gjithë llojin njerëzor. Nuk është për t’u habitur se bijtë e mesazhit islam dhe gjenerata e parë e sahabëve janë cilësuar me cilësitë më të larta të dashurisë dhe respektit. Allahu në lidhje me ta thotë:

وَالَّذِينَ تَبَوَّءُوا الدَّارَ وَالْإِيْمَانَ مِنْ قَبْلِهِمْ يُحِبُّونَ مَنْ هَاجَرَ إِلَيْهِمْ وَلَا يَجِدُونَ فِي صُدُورِهِمْ حَاجَةً مِمَّا أُوتُوا وَيُؤْتُونَ عَلَى أَنْفُسِهِمْ وَلَوْ كَانَ بِهِمْ خَصَاصَةٌ وَمَنْ يُوقِ شَحْنَفْسِهِ فَاُولَئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ

*“Edhe ata që përgatitën vendin (Medinën) dhe besimin para tyre, i duan ata që shpërnguleshin tek ata dhe nuk ndiejnë në gjokset e tyre ndonjë nevojë (për zili a tjetër) nga ajo që u jepej atyre (muhaxhirëve), madje edhe sikur të kishin vetë nevojë për te, ata u jepnin përparësi atyre para vetvetes. Kush është i ruajtur prej lakmisë së vet, të tillët janë të shpëtuar”.*⁶¹

2.1.6.1. Racizmi është ndotje e rrezikshme akaidore, kulturore dhe shoqërore

Është e rëndësishme të bëjmë dallimin mes racizmave të xhahiljetit, nga njëra anë dhe lidhjes farefisnore islame, nga ana tjetër. Racizmat janë cilësi të kafshëve, diskriminim dhe padrejtësi. Ndërsa, lidhja farefisnore islame është mëshirë, lidhje dhe bamirësi, në të cilin, i forti e ndihmon të dobëtin dhe i madhi të voglin.

Për këtë shohim se Islami aq sa ndalon nga racizmi dhe etnicizmi, duke kërkuar drejtësi dhe vëllazëri njerëzore “qoftë edhe kundër juve” “edhe nëse është i afërt”, ai po në të njëjtën masë porositë për lidhje farefisnore, fton për bamirësi ndaj të afërmeve. E gjithë kjo vetëm e vetëm për t’i afruar njerëzit mes tyre dhe për të përhapur shpirtin e dashurisë, solidaritetit dhe afrimit në shoqëri. Islami zgjerohet në këtë afrim, duke përfshirë vëllazërit nga gjiu dhe të drejtat e fqinjit të afërt. Të gjitha këto lidhje janë lidhje vëllazërore dhe mëshire, duke mos i bërë askujt padrejtësi e as armiqësi ndaj të drejtës së askujt, e as duke mohuar aftësitë e askujt.

Nuk është e rastit që njëri nga pesë kushtet e Islamit, respektivisht haxhi, në esencë është simbol i unitetit dhe vëllazërisë islame. Kjo shihet qartë kur muslimanët zhvishen nga çdo gjë që mund të sjell dallime mes tyre. Të gjithë ditën e Arafatit qëndrojnë kokëzbuluar, të mbuluar vetëm

⁶¹ El-Hashr: 9

me ihrame, ku nuk ka dallim mes të madhit dhe voglit, të pasurit dhe të varfrit, pa dallim gjuhe dhe ngjyre. Të gjithë janë vëllezër. Të gjithë prej Ademit. Fundi i fundit, të gjithë janë njerëz.

Nëse dëshirojmë të rikthejmë shpirtin islam, unitetin e umetit dhe lartësinë e mesazhit, patjetër duhet të punojmë në pastrimin e besimit, vlerave dhe kulturës së bijve të umetit nga “qelbësira”, padrejtësitë dhe ndyrësitat e racizmit dhe etnicizmit. Allahu thotë:

يَتَّيِّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لَا يَسْخَرُ قَوْمٌ مِّن قَوْمٍ عَسَىٰ أَن يَكُونُوا خَيْرًا مِّنْهُمْ وَلَا نِسَاءٌ مِّن نِّسَاءٍ عَسَىٰ أَن يَكُنَّ خَيْرًا مِّنْهُنَّ وَلَا تَلْمِزُوا أَنفُسَكُمْ وَلَا تَنَابَرُوا بِاللِّقَابِ بِنَسِ الْأَسْمِ الْفُسُوقِ بَعْدَ الْإِيمَانِ وَمَن لَّمْ يَتُبْ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الظَّالِمُونَ

*“O ju që besuat, nuk bën të tallet një popull me një popull tjetër, meqë të përqeshurit mund të jenë më të mirë nga ata të cilët përqeshin dikë tjetër, e as gratë me gratë e tjera, sepse mund të ndodhë që gratë e tjera të jenë më të mira se ato që përqeshin (duke e nënçmuar njëri-tjetrin) dhe mos etiketoni njëri-tjetrin me llagape. Pas besimit është keq të përhapet llagapi i keq. E ata që nuk pendohen, janë mizorë”.*⁶²

Është patjetër të rishikohet dhe rilexohet gjendja jonë aktuale, duke u bazuar në konceptet dhe praktikat e periudhës së shpalljes. E gjithë kjo për ta pastruar nga kuptimet dhe komentimet e gabuara, nga kurthet e njerëzve që kanë qëllime të caktuara dhe nga gabimet e njerëzve të sëmurë.

Racizmi dhe etnicizmi janë mënyrë e shëmtuar për ta deformuar vizionin islam dhe vlerat e tij në sheriatin e dritës dhe shpirtërores, në të cilin gjendet uniteti, vëllazëria,

⁶² El-Huxhurat: 11

bashkëpunimi, solidariteti etj. Aty gjendet “fuqia për të drejtën” për të përballuar ligjin e xhunglës ku “e drejta i takon fuqisë”, ngase aty ka dallime, diskriminime, ashpërsi dhe egërsi, i cili bazohet në politikat shkatërruese dhe interesat nacionale.

2.1.6.2. Bota e së drejtës dhe dritës dhe bota e xhunglës dhe errësirës

Fuqia nuk është sferë për të bërë dallimin mes botës së të drejtës dhe dritës dhe botës së xhunglës dhe errësirës, por dallimi mes tyre fshihet në atë se për çfarë qëllimi e përdorin fuqinë? Për të mbrojtur të drejtën apo të padrejtën? Të mirën apo të keqen? Drejtësinë apo padrejtësinë? Për mëshirim apo nënçmim? Për vëllazërim apo diskriminim? Për të bërë krijesat rob të Krijuesit apo robërimin e krijesave dhe poshtërimin e tyre para krijesave si ta?

Nëse çdo pemë ka fryte, atëherë frytet e tevhidit janë vëllazërimi, drejtësia dhe solidariteti. Nëse çdo gjë posedon të kundërtën e saj, atëherë e kundërta e tevhidit është dallimi racor. Nuk ka mirësi, drejtësi e as paqe në gjithë tokën në përgjithësi, e në vendet islame në veçanti, përpos se me vëllazërim dhe mëshirë njerëzore. Për shkak të dobësimin të vëllazërisë dhe mëshirës, të mos themi të humbjes në tërësi, është ndotur shoqëria dhe civilizimi me qelbësirën e dallimeve racore, etnike dhe fanatizma. Allahu thotë:

إِنَّ هَذِهِ أُمَّتُكُمْ أُمَّةً وَاحِدَةً وَأَنَا رَبُّكُمْ فَاعْبُدُونِ

“Kjo fë është e juaja dhe është e vetmja fë (e shpallur), kurse Unë jam Zoti juaj, pra më adhuroni vetëm Mua”.⁶³

إِنَّمَا الْمُؤْمِنُونَ إِخْوَةٌ فَأَصْلِحُوا بَيْنَ أَخَوِيكُمْ وَاتَّقُوا اللَّهَ لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ

⁶³ El-Enbija: 92

“S’ka dyshim se besimtarët janë vëllezër, pra bëni pajtim ndër-
mjet vëllezërve tuaj dhe kini frikë Allahun, që të jeni të mëshiruar
(nga Zoti)”.⁶⁴

وَأَعْتَصِمُوا بِحَبْلِ اللَّهِ جَمِيعًا وَلَا تَفَرَّقُوا وَاذْكُرُوا نِعْمَتَ اللَّهِ عَلَيْكُمْ إِذْ كُنْتُمْ
أَعْدَاءً فَأَلَّفَ بَيْنَ قُلُوبِكُمْ فَأَصْبَحْتُمْ بِنِعْمَتِهِ إِخْوَانًا

“Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin (fenë dhe Kur’anin) e
Allahut, e mos u përçani! Përkujtojeni nimetin e Allahut ndaj
jush, kur ju (para se ta pranoni fenë islame) ishit të armiqësuar, e
Ai i bashkoi zemrat tuaja dhe ashtu me dhuntinë e Tij aguat të
jeni vëllezër”.⁶⁵

Po ashtu, Muhamedi alejh’is-selam ka thënë: “Nuk është
prej nesh ai që thërret në fanatizëm, nuk është prej nesh ai që
lufton në emër të fanatizmit dhe nuk është prej nesh ai që vdes me
fanatizëm”.⁶⁶

Nëse realisht dëshirojmë të rikthejmë ndjenjën dhe
konceptin e umetit, nëse dëshirojmë të zhdukim shkaqet e
përçarjes dhe konflikteve, nëse dëshirojmë realisht që
besimi, tevhidi, drejtësia dhe bashkëpunimi të jenë themel i
ndërtimit tonë dhe burim i ndërgjegjes sonë, atëherë është e
patjetërsueshme të fillojmë me pastrimin e edukatës dhe
kulturës nga helmimet e diskriminimit, dallimet racore dhe
etnike. E gjithë kjo me qëllim që umeti të kthehet i unifiku-
ar, i fortë dhe i lidhur mes veti me parimet afërsisë, mëshi-
rës, solidaritetit dhe ndihmës, qoftë kur “bën padrejtësi”
ose kur “i bëhet padrejtësi”,⁶⁷ duke filluar nga individit dhe

⁶⁴ El-Huxhurat: 10

⁶⁵ Alu Imran: 103

⁶⁶ Sulejman ibn El-Esh’ath Es-Sixhistani, *Sunenu Ebi Davud*, Recenzent: Muhamed Muhjiddin Abdulhamid, Bejrut: Darul Fikr (p.d.), vëll. 2, fq. 753, hadithi nr. 5121.

⁶⁷ Transmeton Buhariu se Muhamedi alejh’is-selam ka thënë: “Ndhimo vëllain tënd kur bën padrejtësi dhe kur i bëhet padrejtësi” Thanë: O i Dërguari i Allahut, do ta ndihmojë kur i bëhet padrejtësi, por si ta ndihmojë kur bën padrejtësi? Tha: e kapë për dorë”. Hadithi është në: El-Buhari, Sahih’ul-Buhari, vepër e cituar, vëll. 2, fq. 863, hadithi nr. 2312.

familja e ngushtë, duke vazhduar me familjen e gjerë, të afërmit, fiset dhe popujt, dhe duke përfunduar me formimin e umetit islam dhe mbarë njerëzisë.

2.2. Rezultatet e hidhura dhe pasojat e devijimeve ideologjike në formimin psikologjik të umetit

Pasojat e konfliktit mes elitës intelektuale dhe elitës politike nuk përfunduan vetëm me largimin e tyre nga zbatimi praktik dhe fundosja në formalitete teorike në çështjet që ndërlidhen me politikën e shoqërisë dhe rregullimin shoqëror, e as në përkufizimin e kujdesit të tyre për çështjet individuale të bijve të umetit, por e gjithë kjo solli ndryshime rrënjësore në mendimet e elitës intelektuale, në natyrën e vizionit ndaj shoqërisë dhe krijimin e një raporti armiqësor mes elitës politike dhe elitës intelektuale, role të kundërta dhe konflikt ndaj asaj se kush po ushtron pushtet më shumë ndaj masës së thjeshtë të umetit. E gjithë kjo i ka dhënë diskursit ideologjik dhe fetar një dimension të vazhdueshëm politik dhe konfliktuoz, që bën umetin dhe ndërgjegjen e tij të nënshtruar, duke ia humbur besimin - për shkaqe të ndryshme - në udhëheqjen politike dhe sistemet e ngritura mbi bazën e racizmit, padrejtësisë dhe diktaturës.

Ndikimi i këtyre fryteve ndaj mendimit islam dhe interesimit të dijetarëve ishte humbja e dimensionit të vërtetë pedagogjik dhe mjeteve kulturore dhe metodologjike, qofshin teorike apo praktike, prapambetja e institucioneve edukativo-arsimore, gjë e cila shpui në praktika njohëse dhe pedagogjike, të cilat në masë të madhe ndikuan në shkatërrimin e bazamenteve dhe themeleve psikologjike, mbi të cilat ngritët formimi shoqëror, ndërtimor dhe civilizues i umetit islam.

Diskursi terrorist dhe politika terroriste ishin fryti i mallkuar që goditi elitat islame, qofshin intelektuale apo politike. Ngase dhuna - e përfshirë në këtë diskurs - është mjetë i atij që është i dobët ndaj kontrollit në situata për të kuptuar rregullat e daljes nga to. Kështu, masa e thjeshtë e umetit është bërë viktimë e konflikteve politike mes elitës intelektuale dhe asaj politike.

Themeli i dilemës mbi të cilën devijoi ecuria e shoqërisë islame ishte dobësia e faktorit pedagogjik islam në formimin dhe përgatitjen e beduinëve, në rekrutimin e tyre në ushtrinë çlirimtare. Përgatitja, edukimi dhe këshillimi i dobët - në fund të fundit - ishte mjeti i keq që nxiti mosmarrëveshjet dhe rrëzoi shtetin e hilafetit. Në anën tjetër, mendimi racor dhe fisnor mundësoi ngritjen e mbretërisë, përfshirë këtu gjithë atë që barti mendimi fisnor - më pas edhe ai nacional - prej ndikimeve në besim dhe ndryshimeve politike, shoqërore dhe ekonomike.

Për shembull, të gjitha dokumentet që flasin rreth dhënies së tokës në periudhën e shpalljes dhe të halifëve të drejtë, tregojnë se ato toka jepeshin për shfrytëzim e jo për pronësim. Mirëpo, më pas ato u shndërruan në prona absolute për individë, lider dhe familje,⁶⁸ gjë e cila tregon se sa ishin të thella ndryshimet dhe devijimet, si dhe sa ishin larg politikave që zbatoheshin në periudhën e shpalljes dhe të halifëve të drejtë.

Kur'ani sqaron gjendjen e shumicës së beduinëve, duke treguar se ishin jo aq të civilizuar dhe dobët të formuar në aspektin akaidor dhe pedagogjik, gjë që obligoi angazhimin për riedukim dhe riformim psikologjik, shoqëror dhe civilizues për të hyrë në shoqërinë islame. Allahu thotë:

⁶⁸ Habib'ul-Sayed. "Al-Iqta: A historical Survey of Land Tenure and Land Revenue Administration in Some Muslims Countries, with Special Reference to Persia", in the *Contemporary Aspects of Economic and Social Thinking in Islam*, Plainfield, ind: the Muslim Students Association of USA and Canada, 1970.

قَالَتِ الْأَعْرَابُ ءَأَمَّنَّا قُلْ لَمْ نُؤْمِنُوا وَلَكِن قُولُوا أَسْلَمْنَا وَلَمَّا يَدْخُلِ الْإِيمَانُ فِي قُلُوبِكُمْ

*„Beduinët thanë: “Ne kemi besuar!” Thuaj: “Ju nuk keni besuar ende, por thuani: Ne jemi dorëzuar, e ende nuk po u hyn besimi në zemrat tuaja“.*⁶⁹

الْأَعْرَابُ أَشَدُّ كُفْرًا وَنِفَاقًا وَأَجْدَرُ أَلَّا يَعْلَمُوا حُدُودَ مَا أَنْزَلَ اللَّهُ عَلَى رَسُولِهِ ۗ وَاللَّهُ عَلِيمٌ حَكِيمٌ

*“Beduinët janë të pajisur me mohim e hipokrizi më të fortë, dhe janë më të përshtatshëm për të mos i njohur dispozitat që ia zbriti të dërguarit të Tij Allahu. Allahu i di çështjet, Ai është i urtë”.*⁷⁰

Për këtë, Islami ka filluar menjëherë me edukimin dhe arsimimin e tyre. Ka dërguar te vendet dhe shtëpitë e tyre grupe mësuesish për edukim dhe arsimim. Megjithatë, të gjitha këto përpjekje dhe politika i kanë penguar sfidat e mëdha ushtarake të persianëve dhe romakëve, të cilat rrethonin shtetin islam në lindje dhe perëndim, shtypnin muslimanët, pengonin njerëzit nga e drejta e tyre për të pranuar Islamin, përgatiteshin për shkatërrimin e shtetit islam dhe shoqërisë islame dhe përpiqeshin për t’i rikthyer arabët në injorancën e tyre dhe nënshtrimin ndaj udhëheqësve të tyre.

Kështu, konflikti politik, i jashtëm dhe i brendshëm, çoi në moskujdesin e shteteve islame ndaj aspektit pedagogjik, moskujdesin e dimensionit njohës dhe shoqëror në studimin e karaktereve, ngjarjeve dhe ndryshimeve në kohë dhe vend. Si rezultat i gjithë kësaj ishte mosnjohja e rëndësisë së

⁶⁹ El-Huxhurat: 14

⁷⁰ Et-Tevbe: 97

fëmijës dhe edukimit të tij si bazament për ndryshim në rrugë të drejtë.

Për këtë, nuk është dhënë shansi për mendjen e muslimanit, i cili ka vuajtur nga diktatura dhe terrorizmi, duke u marrë me çështje parciale dhe teorike, për t'u përballuar me deformimet që kanë kapluar personalitetin e njeriut musliman dhe devijimet shoqërore në praktikat e tij dhe për t'u kujdesur shkencërisht për zhvillimin e shkencave shoqërore, kuptimin e fëmijërisë, kujdesi për fëmijën dhe shkencat që ndërliken me edukimin e tij, studimin e psikologjisë fëmijërore dhe mjetet e zhvillimit të personalitetit dhe aftësive intelektuale, shpirtërore, fizike e tjera, duke i llogaritur si çështje qendrore shkencore, që meritojnë mund rreth hulumtimit, studimit dhe vrojtimit për të njohur karakteret, ligjet, çelësat e sekretit, energjinë e fshehur, metodat dhe qëllimet e zhvilluara dhe të përshtatshme për të plotësuar nevojat dhe për t'u përballuar sfidave.

Kjo mangësi llogaritet prej shkaqeve reale që zbardhin shkakun e prapambetjes së muslimanëve dhe pamundësinë për përmirësim dhe ngritje deri më sot. Në të njëjtën kohë sqaron suksesin e përpjekjeve bashkëkohore evropiane, të cilat kanë konsideruar çështjen pedagogjike të ngritur mbi baza shkencore eksperimentale, si themel të renesancës dhe përparimit, si dhe gurëthemel për zhvillimin e energjive.

KAPITULLI I TRETË

Fëmija: Bazamenti i nisjes

Duke ndjekur devijimet dhe deformimet e lartshënuara në historinë dhe ecurinë e umetit islam, duhet të mos harrojmë se mirësia dhe bereqeti i Islamit për mbarë njerëzinë ka vazhduar gjatë tërë kohës dhe në të gjitha rrethanat. Në pjesën dërmuese të muslimanëve - me disa dallime nga një kohë në tjetrën dhe nga një vend në tjetrin - Islami ka qenë i pranishëm me shpirtin, besimin, vlerat dhe parimet elementare.

Kjo pjesë e mbetur e shpirtit islam është ajo që komenton mbetjen e fuqisë, energjisë, vlerave dhe qëllimeve të larta në identitetin e umetit. Nëse krahasohet - për disa shekuj - me popujt e injorancës dhe idhujtarisë përreth tij, vërejmë se civilizimi islam edhe krahas deformimeve dhe devijimeve që e kanë goditur në mentalitetin, psikikën dhe sistemin e tij, prapëseprapë mbetet civilizimi më i ngritur për disa shekuj. Gjatë këtyre shekujve, dijetarët, mendimtarët dhe filozofët e tij kanë ofruar horizonte të reja për përparim dhe kreativitet shkencor, kështu që civilizimi njerëzor, nuk do të kishte mundësi të vazhdonte ecurinë që e ka realizuar sot, e as të arrinte atje ku ka arritur, pa u pas në atë trashëgimi të madhe shkencore dhe civilizuese.

Mirëpo, kjo nuk duhet të na largon nga qëndrimi kritik për të huluntuar shkaqet që çuan në dobësimin e shpirtit motivues islam dhe lejuan prapambetjen e umetit, në kohë kur popujt tjerë përparuan duke e sfiduar umetin islam dhe duke kontrolluar ata në këtë gjendje të vështirë të cilën po e shohim sot.

3.1. Lëvizjet reformuese islame dhe nevoja për vlerësim

Nëse mendojmë hollësisht në historinë e umetit, do të vërejmë se ka pasur disa përpjekje për reformim. Këto përpjekje kanë qenë të udhëhequr nga dijetarë, mendimtarë, prijës dhe sulltanë, të bazuar në qëllime fetare, politike dhe qytetare. Prej përpjekjeve më të rëndësishme ishte ajo e Ebu Hamid Gazaliut (vd. 505 h./ 1111), i cili gjithë potencialin e tij e orientoi në përmirësimin e ecuresë së mendimit islam dhe pastrimin e tij nga mbeturinat e mendimit filozofik metafizik grek, i cili ka devijuar mendimin islam dhe harxhoi energjinë e tij në çështje të padobishme sipas vizionit islam.

Përderisa libri i Gazaliut "Tehafut'ul-felasife" ka zbardhur këtë dimension, libri "Ihjau ulum'id-din" nxiti për punë me qëllim që umeti të kthen energjinë shpirtërore, duke e kthyer raportin pozitiv dhe shkrirjen mes njohurive shariatike dhe ndjenjave islame. Ai synonte pastrimin e mentalitetit njohës shariatik nga deformimet dhe devijimet e filozofisë metafizike greke, si dhe zbatimin e çështjeve shariatike islame, të mbështetura - sipas vizionit të tij - me zuhdin (asketizmin) islam, i liruar tërësisht nga devijimet e tesavufit filozofik (el-hululi), të cilin e kishin trashëguar muslimanët nga filozofia metafizike greke.

Fatkeqësisht, përpjekjet e Gazaliut nuk patën sukses, ngase nuk ishin përpjekje reformuese metodologjike dhe rrënjësore për pikënisjet e njohurisë islame. Përpjekjet e tij reformuese mbetën vetëm në rrethin e meditimeve ideologjike teorike, të cilat nuk realizuan nevojat e ndryshimit rrënjësor, ideologjik dhe shoqëror islam.

Pas Gazaliut erdhën shumë mendimtarë dhe reformist. Prej tyre veçojmë: Shejh'ul-islam Tekijudin Ahmed ibn Tejmije, Imam Ali ibn Ahmed ibn Hazm dhe dijetari i madh Abdurrahman ibn Haldun. Në mesin e këtyre përpjekjeve

janë edhe përpjekjet politike, administrative dhe ushtarake të prijësve të Alu Zenkiut dhe Salahudin Ejubiut, të cilët arritën të ripërtërijnë dukshëm energjinë shpirtërore dhe materiale të umetit, gjë e cila u mundësoi fitore ndaj kryqëzatave, çlirimin e tokës dhe rikthimin e vendeve të shenjta.

Me kalimin në islam të fiseve të fuqishme turkmene dhe me formimin e Shtetit Osman me sistem të fuqishëm administrativ dhe ushtarak, u ngrit flamuri islam në Evropën Lindore, në kohë kur vendet arabe dhe islame vazhdonin në dobësinë dhe gjumin e tyre. Në anën tjetër, shteti islam në Spanjë vazhdonte të përçahej, duke luftuar mes vete fiset dhe prijësit e tyre, deri sa u shkatërruan nga ana e spanjollëve. Më në fund, që nga shekulli XVIII, bota islame u fundos në prapambeturi, rënie dhe dobësi përballë fuqisë së zhvilluar evropiane.

Më pas filluan të lëvizin ndjenjat e rezistencës dhe dëshirës për reforma dhe ndryshim në mesin e umetit islam. Kështu lindi përpjekja e Shejh Muhamed ibn Abdulvehab (1703-1792) për të ringjallë mendimin e Ibn Tejmijes. Lëvizja e Muhamed ibn Ali Senusit në Libi (1787-1859). Lëvizja e Imam Muhamed Mehdiut në Sudan (1843-1885). Lëvizja islame reformuese e Abdulhamid ibn Badisit në Algjeri (1889-1940), e cila ishte themeluar për çlirimin e Algjerisë dhe pavarësisë së saj më 1962. Reformat civile dhe ushtarake që sollën sulltanët osmanë, duke filluar nga sulltan Selimi III (1761-1808) dhe duke përfunduar me sulltan Abdulhamidin II (1842-1918). Reformat civile që i solli Valiu i Egjiptit Muhamed Ali Pasha (1769-1849) sipas modelit evropian në fushën ekonomike, bujqësore, industriale, arsimore dhe ushtarake. Lëvizja reformuese ideologjike dhe politike e Xhemaludin Afaganiut (1838-1897). Shkolla reformiste fetare dhe kulturore e Shejh Muhamed Abduhu (1849-1905). Procedurat laike të gjeneralit Qemal Ataturk

(1881-1937) për modernizimin e Turqisë sipas modelit evropian, pasi hoqi hilafetin osman islam dhe shpalli formimin e Republikës turke në vitin 1923, duke e vënë në zbatim ligjin zviceran në vend të sheriatit islam. Lëvizja reformiste, islame, politike dhe shoqërore e Imam Hasan Benës (1906-1949), e cila u përhap në Egjipt dhe vendet tjera arabe. Lëvizja reformiste, islame, politike dhe shoqërore e Shejh Ebu'l-A'la Mevdudi (vd. 1979) në Gadishullin indian. Të gjithë këto krahas një numri të madh të mendimtarëve dhe reformistëve, siç janë: Shah Velijullah Dehlevi (vd. 1763), dijetari i madh Muhamed Ikbal (vd. 1938), Hajrudin Tunisi (vd. 1890), Abdurrahman Kevakibi (vd. 1902), Reshid Rida (vd. 1935), Sejid Kutub (vd. 1966), Malik ibn Nebi (vd. 1973) etj.

Edhe pse pjesa dërrmuese e këtyre përpjekjeve, për nga pikënisjet ishin të sakta, ngase ishin të llojllojshme dhe mbulonin të gjitha orientimet islame dhe civile në fushat e besimit, politike, shoqërore dhe ekonomike, megjithatë shihet qartë se ato nuk kishin diagnostifikuar mirë bazën e sëmundjes dhe burimin e telasheve, e as nuk patën mundësi realizimin e qëllimeve për të vënë në lëvizje energjinë e umetit në mënyrë efektive. Po ashtu, nuk arritën të reformojnë formimin ideologjik dhe psikologjik, si dhe të ndalin dallimin e madh mes tyre dhe popujve të përparuar në performansë, fuqi dhe civilizim.⁷¹

Para kësaj gjendje në të cilën ishte umeti, hulumtuesi dhe mendimtari ndjehet i detyruar të vazhdon hulumtimet dhe përpjekjet e tij deri sa të udhëzohet në gjetjen e shkakut apo shkaqeve drejt detyrës së madhe dhe ndikuese. Kështu, ai do të angazhohet për marrjen në konsideratë të shkaqeve për trajtimin e problemit derisa të shërohet umeti, të dallo-

⁷¹ Për të kuptuar dimensionet e kësaj çështje ideologjike, lexo: Ebu Sulejman, Abdulhamid, *Ezmet'ul-akl'il-muslim*, Hernden & Rijad: El-Ma'had el-alemi li'l-fikr'il-islami & Ed-Dar'ul-alemijeti li'l-kitab'il-islami, 1994.

hen performansat e tij, t'iu kundërvihet me sukses sfidave, dhe në fund të jetë në gjendje që mbarë njerëzisë t'ia ofron prodhimin e saj, të rikthen shëndetin, të drejtat, dinjitetin dhe të kontribuon në ngritjen e civilizimit.

3.1.1. Fëmija: ushtari i panjohur

Gjatë hulumtimit tonë vërejmë se mendimi reformist dhe lëvizjet reformiste islame nuk kanë lënë shumë çështje pa i trajtuar në mënyrë serioze deri më tash. Megjithatë, dimension më i rëndësishëm që duhet marrë në konsideratë dhe duhet trajtuar, është çështja e fëmijës, si mjet elementar për të sjellë reformat dhe ndryshimet e kërkuara. Themi kështu, sepse fëmija ka fuqi për krijimin e rrethanave që plotësojnë kushtet e reformave dhe ndryshimit që kërkojnë lëvizjet reformuese. Fëmija shpie në riaftësimin e individit musliman dhe përmes tij edhe të shoqërisë islame, gjë që i mundëson që përsëri të posedon fuqi për përballimin e sfidave.

Sikur mendimi islam të mendonte hollësisht në procesin e ndryshimit, rritjes dhe zhvillimit, në aspektin fizik dhe psikologjik të fëmijës, do të kuptonte dimensionin e ndryshimit tek njeriu, si dhe kuptimin e gjendjes dhe nevojave të tij. Kjo do të ishte hyrja më e mirë për të sjellë reformat metodologjike të njohjes islame, si dhe riformimin e personalitetit islam me dimensionet e tij individuale dhe kolektive.

3.1.2. Kultura e njerëzve të përgjithshëm dhe kultura e njerëzve të veçantë: sëmundje që vazhdon të dëmtojë formimin

Vërehet se ajo pjesë e paktë që i është kushtuar edukimit dhe arsimimit të fëmijës nga ana e umetit në kohët e mëherëshme, ishte e ndarë në dy pjesë të dalluara mes veti:

Pjesa e parë: pjesa e drejtuar për fëmijët e veçantë. Kjo formë e edukimit ishte në formë të këshillave dhe udhëzimeve që iu ofroheshin edukatorëve të fëmijëve të veçantë,

të cilët i arsimonin dhe edukonin në shtëpitë e tyre. Këtu përfshiheshin vlerat e butësisë, dinjitetit, fisnikërisë dhe komunikimit të mirë. Me këso vlerash edukoheshin fëmijët e prijësve dhe elitës. E gjithë kjo me qëllim që të përgatiten për qendrat e udhëheqjes dhe pushtetit në shoqëri. Të këtij lloji janë porositë e Muavi ibn Ebi Sufjanit, Abdulmelik ibn Mervanit, Haxhaxh Thekafiut, Harun Rreshidit e tjerë, të cilat i gjejmë në librat e historisë. Për edukimin dhe arsimimin e këtyre fëmijëve kanë punuar mësimdhënës dhe edukator që ua kanë mësuar shkencat fetare, letërsi, kulturë dhe udhëheqje.

Pjesa e dytë: pjesa e drejtuar për fëmijët e masës së gjerë. Arsimimi i tyre kryhej në “mektebe”. Aty mësonin diç nga Kur’ani, parimet e matematikës që ishin të domosdoshme për menaxhimin e nevojave individuale ditore. Siç tregon historia, gjendja e mektebeve, aftësia e mësimdhënësve dhe mjetet mësimore në to ishin jo në nivelin e duhur. Aty mësohej përmendësh dhe shpesh përdorej edhe ndëshkimi fizik. Arsimimi i këtyre fëmijëve realizohej me financim të prindërve të tyre, të cilët ishin në gjendje të rëndë ekonomike. Për gjendjen e vështirë të këtyre mektebeve nuk kujdesej askush, përpos një numrit të vogël të dijetarëve dhe mendimtarëve, në mesin e të cilëve imam Ebu Hamid Gazaliu dhe dijetari i famshëm, Ibn Halduni. Këta mendimtarë kishin kritikuar gjendjen, mjetet dhe nivelin e ulët të mualimëve, derisa disa këshillonin prindërit që mualimët e fëmijëve të tyre të mos u mësojnë asgjë nga çështjet e besimit për shkak të nivelit të ulët të njohurive që posedonin këta mualimë.

Rezultat i gjithë kësaj ishte arsimim i dobët për fëmijët e masës së thjeshtë dhe rënie e nivelit kulturor. Është e qartë se ekzistimi i dy llojeve të kulturës dhe arsimimit ka ndihmuar dukshëm në këtë gjendje.

Këtyre dy llojeve iu bashkëngjitet edhe lloji i tretë për përgatitjen e punëtorëve. Kjo realizohej në një numër të kufizuar të shkollave dhe trajnimeve mësimore, të cilat financoheshin nga ana e vakëfit. Në këto shkolla shkonin një numër i vogël i të rinjve të zgjedhur me qëllim të formimit të elitës shkencore fetare, të cilët do të kryejnë detyrën e shkrimit, shërbimit në administratë, fetvave dhe gjykimit. Në këto shkolla merrnin mësimet fetare, letrare dhe gjuhësore, sidomos mësimet e fikhut dhe usuli-fikhut për shkak të nevojës së madhe për përgatitjen e myftinjve dhe gjykatësve.

Kështu ishte gjendja e arsimit të fëmijëve të umetit në të kaluarën. Kjo gjendje në masë të madhe vazhdon edhe sot e kësaj dite dhe në shumicën e vendeve islame, të mos themi në të gjitha. Vërejmë se fëmijët e elitës së dalluar mësojnë me financim të prindërve të tyre në shkolla të veçanta. Këto shkolla janë mirë të përgatitura për nga pajisja me mjete mësimore, teknike dhe teknologji, si dhe përdorim të metodave të avancuara mësimore, gjëra të cilat nuk gjenden në shkollat publike. Në të njëjtën kohë këto shkolla kontribuojnë për shpëlarjen e trurit, gjë e cila dobëson fuqishëm lidhshmërinë e shumë prej nxënësve me popullin, fenë dhe kulturën e tyre. Po ashtu dobëson perceptimin e tyre ndaj realitetit të ndjenjave të popullit të tyre dhe sekretet e energjisë tek ata. Këto shkolla në të shumtën e rasteve i përgatisin për të qenë udhëheqës dhe liderë diktatorë ndaj popujve të tyre. Këta personalitete - duke u bazuar në pajisjet mbizotëruese dhe mbështetjen e të huajve - arrijnë të ushtrojnë pushtetin absolut në vendet e tyre dhe të shuajnë çdo lëvizje që synon fuqinë, kreativitetin dhe iniciativën. Kështu gjendja e popujve përfundon në një gjendje që mbizotëron dobësia, varfëria, injoranca, prapambetja dhe fuqia e të huajve që synojnë pasurinë dhe vendet e shenjta të tyre.

Për shkak të mungesës në kulturën islame, fëmija është bërë hallka e zbrazur rreth së cilës sillet pamundësia e ume-tit për të ndryshuar gjendjen dhe për të ripërtërirë energjinë e tij. Moskujdesi ndaj çështjeve të edukimit të fëmijës musliman, pamundësia e mendimit islam në këtë sferë, mos-perceptimi i rëndësisë së zhvillimit pedagogjik të fëmijës në vendet islame dhe mungesa e madhe në plotësimin e kërkesave të këtij zhvillimi, është një ndër shkaqet më të rëndësishme për pamundësinë e sjelljes së reformave dhe ndryshimeve të synuara për riformimin e mentalitetit dhe ndërgjegjes të fëmijës musliman.

3.1.3. Zhvillimi i vetëdijes pedagogjike dhe përmirësimi i arsimit është bazament i reformave

Prej gabimeve më të mëdha që i bëjmë, është edhe ajo se ne lodhemi gjatë diskutit dhe këshillimit drejtuar të rriturve, në kohë kur anashkalojmë zhvillimin e tyre derisa janë të vegjël dhe nuk përpiqemi për të bërë ndryshimin e kërkuar në formimin psikologjik dhe emocional të tyre në moshën kur shumë lehtë edukohen, arsimohen dhe ndikohen. Kështu vazhdon devijimi. Degë e njomë lihet anash duke u zhvilluar i shtrembët dhe degë e thatë dhe e shtrembët, për të cilën nuk sjell dobi asgjë.

Perceptimi mendor të të rriturit nuk mjafton – detyrimisht - për të lëvizur ndjenjat e tyre. As nuk shpie në reagim dhe bashkëveprim. Sa ka prej frikacakëve që nuk dinë gjë për trimërinë, përpos disa poezive që flasin rreth trimërisë, e të cilat nuk i dinë shumica e trimave. Sa ka prej mjekëve duhanpirës që i dinë dëmet e duhanit, njohuri të cilat u mungojnë shumicës së atyre që kurrë në gojën e tyre nuk kanë vërë cigare. Sa ndjehet i shqetësuar njeriu kur sheh se si shumë prej muslimanëve - qofshin nga elita apo masa e thjeshtë - përcjellin lajmet nga kanale të ndryshme,

lexojnë gazeta dhe analiza, të cilëve nuk u mungon perceptimi mendor për mangësitë dhe nevojat e umetit, por e gjithë kjo nuk ndikon në veprat, kontributin dhe sjelljet e tyre, sikur muslimani të jetë radio apo televizor që nuk ndalet nga fjalët e kota dhe thashethemet, por nuk ka vend për të për veprim dhe kontribut.

Prej shkaqeve më të rëndësishme të kësaj gjendje të sëmurë është se dimensionet e përgjithshme të formimit të personalitetit të muslimanit janë lënë pas dore në periudhat e hershme të formimit. Nuk sjell dobi asgjë nëse rreth tyre u flet të rriturve. Çdo gjë që mund të bën këshilla dhe sqarimi tek i rrituri është perceptimi mendor, gjë e cila nuk lidhet fare me reagimin emocional, nëse praktikisht nuk është mbjellë gjatë periudhës fëmijërore. Shembull për këtë është gjuha e parë dhe gjuha e dytë dhe ndikimi i tyre ndaj njeriut dhe reaksioneve të tij.

Reaksioni dhe kreativiteti, zakonisht ndodhë vetëm me gjuhën e parë. Për këtë është shumë e rëndësishme pasurimi i gjuhës së parë me çdo gjë të re për çdo popull. Ndërsa gjuha e dytë, e cila mbështetet në përkthime, nuk mund të lëvizë lehtë ndjenjat dhe reaksionet. Në gjuhën e parë, fjala nuk ndahet nga tematika e tij, e as nuk mund të paramendohet tematika pa fjalën. Lidhshmëria mes fjalës si simbol dhe tematikës si përmbajtje është sekret i reaksionit dhe bashkëveprimit në gjuhë.

3.1.4. Mësimi i Musait dhe ndryshimi shoqëror

Është e rëndësishme këtu të përkujtojmë mësimin që ofron rrëfimi kur'anor ndaj përvojës islame të Musait alejh'is-salam gjatë përmirësimit të gjendjes së Beni Israilëve. Ata u shtypën dhe i robëruan me pa të drejtë në Egjiptin faraonik. Allahu deshi t'ju ndihmojë dhe të përmirësojë atë që e kishte shkatërruar padrejtësia, tirania dhe robërimi.

Kur i nxori Musa alejh'is-selam në shkretëtirën Sina gjatë rrugës drejt tokës së premtuar, kërkoi prej tyre të shkojnë për ta marrë tokën, për ta formuar shtetin, për të rikthyer lirinë dhe për të bartur përgjegjësitë.

Pasi populli ishte rritur si rob dhe nuk ishte në mundësinë e tyre për të marrë përsipër përgjegjësitë, sakrificat dhe iniciativat e formimit, ishte patjetër t'i përgjigjeshin Musait alejh'is-selam, ashtu siç përgjigjen robërit të frikësuar dhe pa ndonjë iniciativë. Kjo shihet qartë kur Musai alejh'is-selam ju tha:

يَقَوْمُ ادْخُلُوا الْاَرْضَ الْمُقَدَّسَةَ الَّتِي كَتَبَ اللهُ لَكُمْ وَلَا تَرْتَدُّوا عَلٰى اَدْبَارِكُمْ فَتَنْقَلِبُوا خٰسِرِيْنَ
 قَالُوا يَمُوْسٰى اِنْ فِيْهَا قَوْمًا جَبّٰرِيْنَ وَاِنَّا لَنْ نَدْخُلَهَا حَتّٰى
 يَخْرُجُوْا مِنْهَا اِنْ يَخْرُجُوْا مِنْهَا فَاِنَّا دٰخِلُوْنَ

“O popull imi, hyni në tokën e shenjtë, të cilën Allahu ua premtoi, dhe mos u ktheni mbrapa, pse atëherë ktheheni të dëshpëruar.

*Ata (populli i Musait) thanë: “O Musa, aty është një popull i fuqishëm (dhunues), prandaj ne nuk do të hyjmë aty kurrë derisa ata të mos dalin nga ajo (të na e lirojnë pa luftë), nëse dalin ata nga ajo, ne do të hyjmë”.*⁷²

Ata shprehën mohim dhe mosmarrje të iniciativës, duke mos marrë përgjegjësi dhe duke e lënë barrën mbi supet e tjetrit, i cili në këtë rast ishte Musa alejh'is-selam, ndërsa me gjuhën e popujve sot përshtatet me fjalët: “qeveri” ose “kombet e bashkuara” ose “bashkësia ndërkombëtare”. Është kështu, sepse robi - si rezultat i gjendjes dhe formimit të tij psikologjik- bëhet negative, nuk ka interes e as nuk ka të drejtë në iniciativë. Në të gjithë atë që mundet është nënshtrimi ndaj urdhrave, ngase ai është rob i urdhëruar.

⁷² El-Maide: 21-22

Kështu ishte pjesa e dytë e përgjigjes se Benu Israilëve ndaj Musës alejh'is-selam. Përgjigje e të dobëtit që heq dorë nga përgjegjësia dhe hedhja e saj mbi supet e tjetrit:

قَالُوا يَمُوسَىٰ إِنَّا لَن نَّدْخُلَهَا أَبَدًا مَّا دَامُوا فِيهَا فَاذْهَبْ أَنْتَ وَرَبُّكَ فَقَتِيلًا إِنَّا هَاهُنَا قَاعِدُونَ

“Ata thanë: “O Musa, ne kurrë nuk hyjmë në të derisa ata janë aty, shko pra ti dhe Zoti yt e luftoni, ne po rrimë këtu!”⁷³

Pasi Musa alejh'is-selam e dinte se thirrja dhe këshilla nuk do të ndryshonte asgjë nga karakteri i këtyre të rriturve “robërve”, e as nuk do t'i furnizonte me energji të nevojshme, me fuqi dhe trimëri që e kërkon ngritja dhe përparimi, atëherë ishte e udhës që përpjekjet e tij t'i drejton drejt fëmijëve dhe adoleshentëve, më qëllim të përgatitjes së tyre, duke i mbjellë tek ata cilësitë e kërkuara për ngritjen e civilizimit, formimin e shoqërisë dhe përballimin e sfidave.

Është e rëndësishme të bëjmë dallimin mes orientimit të ndjenjave dhe energjisë psikologjike nga njëra në dhe natyrës së tyre nga ana tjetër. Ndjenjat dhe energjia psikologjike mund të orientohen dhe riorientohen varësisht prej bindjeve, të cilat mund të ndryshojnë për shkak të perceptimeve dhe përvojave. Kështu mund të beson jobsimtari, të heq dorë i padrejti nga padrejtësia e tij dhe të udhëzohet i devijuari. Ndërsa natyra e ndjenjës dhe formimit psikologjik nuk pranojnë ndryshim. Kështu, trimi nuk mund të bëhet frikacak, koprraci nuk bëhet dorëdhënës dhe fisniku nuk bëhet i poshtër.

Shembull për këtë kemi ushtarin e një ushtrie të mirë dhe anëtarin e një grupi kriminel. Që të dy posedojnë dy cilësi elementare, prej cilësive të formimit psikologjik:

⁷³ El-Maide: 24

trimëria dhe besnikëria. Mirëpo, ata dallojnë në orientim. Ushtari i mirë është njeri i mirë dhe human që mbron umetin dhe vatanin, ndërsa anëtari i grupit kriminel është njeri i keq që vë veten e tij në shërbim të krimit dhe dëmit. Mund të udhëzohet krimineli i devijuar dhe të heq dorë nga krimi dhe armiqësia e tij. Po ashtu, mund të devijon ushtari dhe polici e të bën dëm dhe çrregullim. Omer ibn Hatab Faruku dhe Ebu Xhehl Amr ibn Hishami, që të dy ishin trima dhe udhëheqës. Por, i pari ishte trim i hidajetit dhe Islamit, ndërsa i dyti trim i kufrit dhe injorancës.

Për këtë, shohim se Musa alejh'is-salam me orientim hyjnor - pasi Allahu dinte karakteret dhe gjendjen e formimit psikologjik të popullit - vendosi të drejtohet drejt punës rrënjësore për të realizuar reformat dhe ndryshimin në zemër dhe ndjenja, pa shpejtuar me vjeljen e frutave. Këtë e bëri duke punuar për riedukimin e popullit, duke i orientuar përpjekjet e tij drejt fëmijëve dhe adoleshentëve për t'i formuar ata mbi baza të shëndosha në aspektin kulturor, intelektual dhe emocional.

Kështu Musa alejh'is-salam - me urdhër hyjnor - detyroi gjeneratën e “robërve” nga Beni Israilët të qëndrojnë në shkretëtirën Sina dyzet vjet, krahas vështirësive të mëdha. E gjithë kjo u bë, me qëllim të formimit të një gjenerate të re e liruar nga deformimet intelektuale dhe psikologjike të dala nga periudha e robërimit. Në lidhje me këtë, Allahu thotë:

قَالَ فَإِنَّهَا مُحَرَّمَةٌ عَلَيْهِمْ أَرْبَعِينَ سَنَةً يَتِيهُونَ فِي الْأَرْضِ فَلَا تَأْسَ عَلَى الْقَوْمِ
الْفَاسِقِينَ

*“(Allahu) Tha: “Ajo (tokë) është e ndaluar (haram) për ta katërdhjetë vjet. Do të sillen nëpër tokë (të hutuar). Ti mos u keqëso për popullin e shfrenuar”.*⁷⁴

⁷⁴ El-Maide: 26.

Rezultat i gjithë kësaj ishte formimi i gjeneratës së njerëzve të lirë. Allahu thotë:

قَالَ الَّذِينَ يُظُنُّونَ أَنَّهُمْ مُلْقُوا اللَّهَ كَمَ مِنْ فِئَةٍ قَلِيلَةٍ غَلَبَتْ فِئَةً كَثِيرَةً بِإِذْنِ اللَّهِ وَاللَّهُ مَعَ الصَّالِحِينَ وَلَمَّا بَرَزُوا لِجَالُوتَ وَجُنُودِهِ قَالُوا رَبَّنَا أَفْرِغْ عَلَيْنَا صَبْرًا وَثَبِّتْ أَقْدَامَنَا وَانصُرْنَا عَلَى الْقَوْمِ الْكَافِرِينَ فَهَزَمُوهُمْ بِإِذْنِ اللَّهِ وَقَتَلَ دَاوُدُ جَالُوتَ وَعَاتَهُ اللَّهُ الْمُلْكَ وَالْحِكْمَةَ وَعَلَّمَهُ مَا يَشَاءُ وَلَوْلَا دَفْعُ اللَّهِ النَّاسَ بَعْضَهُمْ بِبَعْضٍ لَفَسَدَتِ الْأَرْضُ وَلَٰكِنَّ اللَّهَ ذُو فَضْلٍ عَلَى الْعَالَمِينَ

“Po ata që ishin të bindur se do ta takonin Allahun thanë: “Sa e sa grupe të vogla me dëshirën e Allahut kanë triumfuar ndaj grupeve të mëdha”! Allahu është me durimtarët. E kur i dualën përballë Xhalutit dhe ushtrisë së tij, thanë: “Zoti ynë! Na dhuro durim! Na i përforco këmbët tona dhe na ndihmo kundër pabesimtarëve! Me ndihmën e Allahut i thyen ata, e Davudi e mbyti Xhalutin dhe Allahu i dha atij (Davudit) sundimin, pejgamberllëkun dhe e mësoi atë për çdo gjë që deshi. Dhe sikur Allahu të mos i mbronte njerëzit me disa prej disa të tjerëve, do të shkatërrohej toka, po Allahu është bamirës i madh ndaj njerëzimit”.⁷⁵

Në këtë rrëfim hyjnor ka mësim për secilin që kupton karakteret dhe ka njohuri nga shkenca e psikologjisë, pedagogjisë dhe sociologjisë.

Për të gjithë këtë, lënia e fëmijës anash në projektin e umetit dhe moskonsiderimi i tij epiqendër e rëndësishme pedagogjike dhe shkencore, duke u marrë vetëm me të rriturit, ishte përshpejtim për vjeljen e frutave para kohe. Kjo shpreh krizën e mendimit të umetit dhe pakujdesin në rolin e njohurisë, hulumtimit, krahasimit dhe eksperimentit në shkencat e karaktereve dhe përplotësimin e tij me shpalljen (vahjin).

⁷⁵ El-Bekare: 249-251

3.2. Pozita e mendimit në raport me problemet e mëdha të umetit

Nuk ka dyshim se problemet dhe krizat me të cilat ballafaqohet umeti sot janë të shumta. Gjithashtu shkaqet të cilat i sjellin ato dhe i ushqejnë janë të shumta. Mirëpo, në të shumtën e rasteve, ka probleme më të mëdha, të cilat llogariten si bazë për probleme tjera. Gjithashtu ka shkaqe që shkaktojnë dhe ushqejnë këto probleme. Është e rëndësishme që përballë këtyre problemeve të grumbulluara dhe shkaqeve të ndërlydhura, të jemi të kujdesshëm ndaj shkaqeve kryesore dhe elementare, pa të cilat nuk mundet trajtimi i problemeve në mënyrë efektive, përpos nëse i kundërvihemi këtyre shkaqeve. Arritja e këtij rezultati do të ishte një pikënisje për trajtim të suksesshëm dhe dominim ndaj shkaqeve tjera.

Është e qartë se bota islame përfshinë një sipërfaqe shumë të madhe. Është shumë e pasur me resurse njerëzore dhe materiale. Ka rrënjë të thella historike dhe civilizuese. Është përplot i mbushur me ambicie, vlera dhe parime. Megjithëkëtë është botë e prapambetur. Në një gjendje të mjerueshme. Të përçarë dhe në armiqësi mes vete, gjë që u ka mundësuar shumë fuqive tjera, të cilat janë më të vogla se ajo, të dominojnë ndaj saj, të vjedhin të drejtat dhe të kontrollojnë pasuritë e saj.

Ndoshta disa ngjarje popullore flasin për realitetin e botës islame që janë me efektive se njëmijë artikuj. Prej këtyre ngjarjeve është edhe ajo që transmetohet se një beduin u pyet për një njeri se a e do? Ai u përgjigj: "Po... Ai nuk është as fqinj e as i afërt"! Gjendja e umetit në përçarje dhe konflikte rrjedh në të kundërtën e asaj që duhet të jetë. Pra, në vend të raporteve të mira dhe lidhjeve që forcojnë

solidaritetit dhe dashurinë mes tyre, ata janë të përçarë dhe në gjendje konfliktuoze.

Nëse çështja në esencë është se “muslimani është vëlla i muslimanit, nuk i bën padrejtësi e as nuk ia dorëzon armikut”, “kështu ia plotëson nevojën vëllait të tij, Allahu ia plotëson atij nevojat”,⁷⁶ “Muslimani për muslimanin është sikur tullat e ndërtesës, përforcojnë njëri tjetrin”,⁷⁷ “Shembulli i besimtarëve në dashuri dhe mëshirë mes veti është sikur shembulli i një trupi. Nëse një organ është i sëmurë, i tërë trupi ndien dhembjen”.⁷⁸ Si mund të komentojmë këtë gjendje të vështirë, që është në të kundërtën e asaj që duhet të jetë?! Me çfarë feje dhe besim, me çfarë mendje dhe logjikë, me çfarë dobie dhe interes mund të kuptojmë dhe të arsyetojmë këtë gjendje?!

Pikëpamjet për të kuptuar këtë dukuri janë të shumta, sikur që janë të shumta edhe shprehja e keqardhjeve. Mirëpo, të gjitha zgjidhjet që janë ngritur mbi këto pikëpamje dhe keqardhje kanë dështuar. Andaj, për të kuptuar këtë dukuri, ku do të përfshihet njohja e shkaqeve substanciale dhe të thella, është patjetër të kemi një vizion më të përgjithshëm dhe më të thellë.

3.2.1. Islami është burim i mirësisë së mbetur në mesin e këtij umeti

Është për keqardhje dhe pengesë për rilindjen e umetit se pjesa dërrmuese e elitës pushtetare bashkëkohore, në lidhje me mendimet, pikëpamjet ndaj umetit, identitetin dhe historinë, janë të frymëzuar nga qëndrimet perëndimore. Dihet se qëndrimet perëndimore janë uzurpuese dhe kolonizuese. Kultura e tyre historike është e lidhur me kry-

⁷⁶ El-Kushejri, Muslim ibn El-Haxhaxh, *Sahih'ul-Muslim*, recensent: Muhamed Fuad Abdulbaki, Beirut: Daru Ihja'it-turath'il-arabiji, (p.v.b.), vëll. 4, fq. 1996, nr. i hadithit 2580.

⁷⁷ El-Buhari, *Sahih'ul-Buhari*, vepër e cituar, vëll. 1, fq. 182, hadithi nr. 467; El-Kushejri, *Sahih'ul-Muslim*, vepër e cituar, vëll. 4, fq. 1999, hadithi nr. 2585.

⁷⁸ El-Kushejri, *Sahih'ul-Muslim*, vepër e cituar, vëll. 4, fq. 1999, hadithi nr. 2586.

qëzatat ndaj botës islame dhe me shtetin Osman. Ndërsa, vështirësitë e tyre historike janë të lidhura me kishën e mesjetës dhe mendimin teologjik mitologjik, i cili çështjet e shenjta i ka vënë në shërbim të monopolit të pushtetit, pasurisë, diktaturës, korrupsionit dhe mbyjtjes së mendjendriturve, shkencëtarëve dhe kreatorëve në shoqëri. E gjithë kjo ka ndikuar që elita pushtuese e botës islame të mos e percepton natyrën e sistemit civilizues dhe tërë energjinë civilizuese, ndërtuese, humanitare dhe pozitive, të cilën e ka deformuar politika e trashëguar fisnore dhe kombëtare. Kanë vepruar kështu me qëllim që të shfrytëzojnë çështjet e shenjta për të shërbyer në monopolin e pushtetit dhe pasurisë, diktaturës dhe korrupsionit dhe mbyjtjes së mendjendriturve, shkencëtarëve, kreatorëve dhe konceptet e tevhidit, mëkëmbësisë në tokë, përgjegjësisë, lirisë, konsultimit dhe vlerat e solidaritetit. Kështu, ata përshpejtojnë, kur për çdo problem apo fatkeqësi që ndodhë në botën islame, akuzojnë Islamin, sado që Islami nga këto akuzat të jetë i pastër, kontributi i tij të jetë pozitiv dhe regjistri historik të jetë i ndritur. Këtë akuzë e bëjnë gabimisht ose nga injoranca, pa e studiuar çështjen në mënyrë të detajuar dhe kritike!

E vërteta e qartë që na intereson këtu në sferën e unitetit dhe solidaritetit është se të gjitha kontributet pozitive në historinë e muslimanëve mbështesin dhe ftojnë në unitetin e tyre. Të gjitha meritat për këtë çështje i takojnë Islamit dhe vlerave të tij. Ai ka unifikuar fiset dhe popujt, ka realizuar vëllazërimin mes tyre, ka shndërruar të gjitha negativitetet e racizmit në pozitivitete që ftojnë në barabarësi, vëllazëri dhe solidaritet. Të gjithë njerëzit janë nga një baba dhe një nënë. Dallimet e tyre në popuj dhe fise duhet të jenë shkak për njohje, bashkëveprim dhe solidarizim. Dallimet në gjuhë dhe racë janë dukuri që tregojnë madhësinë e Allahut në krijesat e tij. Këto dallime nuk duhet përdorur si

mjete për dominim, konflikte dhe armiqësi. Njerëzit më fisnik te Allahu janë “më të devotshmit” dhe më të dashurit tek Ai janë “më të dobishmit” ndaj krijesave të Tij!

Jehona e Kur’anit dhe sunnetit pejgamberik, historia e periudhës së parë islame në formimin e umetit, politikat e tij në drejtësi, solidaritet, zbutjen e zemrave, shtrirjen e themeleve të paqes së përgjithshme dhe sigurisë kolektive, do të vazhdojnë të nxisin në shpirtat e muslimanëve keqardhje, dhembje, pikëllim dhe ambicie të mëdha për unitetin në të cilin fton Islami.

Nëse Islami me vlerat dhe vizionin e tij universal nuk janë shkak për përçarje dhe konflikt mes muslimanëve, atëherë a mund të fshihet shkaku në ndarjen e tyre në etnitete, raca, gjuhë dhe tradita të ndryshme? Kolonializmi, komplotet, kurthet dhe armiqësitë e huaja, a mund të jenë shkaqe tjera për përçarje, urrejtje, armiqësi dhe konflikte mes shteteve dhe popujve të botës islame?

3.2.2. Kolonializmi është dobësim dhe sëmundje

Ne e dimë se kolonializmi me të gjitha politikat, kurthet dhe armiqësitë e tij ka qenë dhe vazhdon të jetë një prej shkaqeve më të rëndësishme që ka kontribuar dhe kontribon për këtë gjendje zhgënjyese të botës islame. Megjithatë, në të njëjtën kohë besojmë fuqishëm se kolonializmi dhe suksesi i politikave të tij tirane dhe armiqësore janë një sëmundje kalimtare, që e kanë mundur njerëz me sëmundje më të rrezikshme dhe më të thella nga brendia e umetit. Ky grup ka shkatërruar mburojën e saj dhe ka mundur depërtimin e politikave kolonizuese. Kështu, nuk arrihet çlirimi nga politikat kolonizuese që nxisin përçarje, lufta dhe konflikte mes shteteve dhe popujve të umetit, përpos nëse çrënjosen shkaqet e fshehura në brendi të umetit, res-

pektivisht çrrënjosjen e këtij grupi që mundësojnë dobësimin e mburojës dhe zbatimin e politikave kolonizuese.

Për të kuptuar sipërfaqësimin dhe sekondarizimin e këtyre shkaqeve, është patjetër njohja më e thellë dhe më e përgjithshme e këtyre dukurive të sëmura në brendinë e umetit. Për të sqaruar këtë çështje, është e dobishme të marrim si shembull disa modele nga historia njerëzore që janë të ngjashme me cilësitë e umetit tonë. Të shohim katastrofat e tyre dhe çështjen e diktaturës dhe kolonializmit në mesin e tyre. Si janë luftuar këto dukuri nga këta popuj? Të shohim pasojat në krahasim me veprat e tyre në mesin tonë! Të analizojmë nëse të njëjtat shkaqe janë të mjaftueshme për të komentuar dukuritë e sëmura dhe pasojat e tyre në mesin tonë?! Do të zgjedhim tre shembuj, ku mes tyre dhe mes gjendjes së umetit tonë ka ngjashmëri të shumta. Këto janë: Kina, India dhe Evropa.

3.2.3. Krahasime në çështjen e unitetit islam: Kina, India dhe Evropa

Kina

Fillojmë me Kinën, ngase në shumë çështje, përfshirë numrin, gjendjen, hapësirën, llojllojshmërinë dhe historinë është e ngjashme me Botën Islame.

Kina - ashtu sikur edhe Bota Islame - përfshinë 1/5 e banorëve të tokës. Është një vend me sipërfaqe të madhe, përfshirë vende të ftohta, shkretëtira dhe male të mëdha. Në brendinë e tij përfshinë popuj dhe fise të shumta, me tradita dhe etnitete të ndryshme. Aty përdoren shumë gjuhë. Komunikimi gjuhësor mes popujve arrihet duke mësuar kuptimin e mijëra fjalëve të ndërlikuara në formë të fotografive. Gjuha kineze i ngjanë gjuhës hieroglifike faraonike të vjetër dhe të zhdukur. Kështu, mund të takohen dy persona kinez dhe të mos kuptohen mes vete për shkak të

dallimeve gjuhësore. Për shkak të gjuhës së shkruar dhe në formë fotografike, të gjithë nxënësit e Kinës mund ta përdorin si mjet për komunikim të përbashkët mes tyre.

Kina ka një histori të bujshme dhe të gjatë. Ka pasur perandorë dhe feudalë të shumta. Mes tyre kanë ndodhur luftëra dhe konflikte të shumta. Popujt e saj kanë përjetuar shumë fatkeqësi dhe padrejtësi. Ka qenë i kolonizuar dhe i nënshtruar ndaj padrejtësive dhe pangopësive të kolonizatorit. Ngjashëm, siç ka ndodhur me Botën Islame, kur ishte dhe vazhdon të jetë i sunduar nga sulltanë, udhëheqës, feudalë dhe kolonizatorë.

Kina, falë kulturës dhe ndjenjave kolektive ka mbetur një shoqëri dhe shtet unik. Ajo që po ndodhë sot mes Kinës dhe Tajvanit, qëllimi i tij në realitet nuk është ndarja dhe copëtimi i unitetit të Kinës, por është konflikt mes grupeve dhe interesave nën ombrellën e legjitimitetit. Ajo që e bën që ky konflikt të vazhdon dhe Tajvani të ndahet nga shteti i Kinës janë interesat e huaja dhe fuqia e tyre.

India

Rasti i dytë është shteti i Indisë. Edhe në këtë shtet ka një numër të madh të banorëve, përafërsisht 1/5 e banorëve të tokës, respektivisht më shumë se një miliard banorë. Përfshijnë një hapësirë të madhe, nga Malet e Himalajeve deri afër Ekuatorit. Përfshin në brendinë e tij popuj të shumtë që dallojnë në etnitete, raca, gjuhë dhe besime. Edhe Indinë gjatë historisë e ka kapluar diktatura e perandorëve dhe feudalistëve, padrejtësia e kolonializmit, bile edhe ndoshta edhe më keq se sa kishte kapluar Kinën dhe Botën Islame.

Tokat e shtetit të Pakistanit musliman, ishin pjesë e vendeve të Indisë. Problemet etnike, gjuhësore, fetare, shoqërore dhe ekonomike, me të cilat ballafaqohet India janë shumë më shumë se ato të Pakistanit. Megjithatë, India, pas

ndarjes së Pakistanit, ka mbetur shtet unik, ndërsa festa kombëtare e Bangladeshit musliman është dita e ndarjes nga shteti i Pakistanit, e cila ishte ngritur në emër të Islamit. Konfliktet që ndodhin mes krahinave të ndryshme të Pakistanit janë shqetësuese për të ardhmen unifikuese të këtij vendi islam.

Vlen të theksohet këtu se disa analistë si shkak për luftën hinduso-pakistaneze e shohin refuzimin e hindusëve ndarjen e çfarëdo pjese të tokës së Gadishullin Indian nga toka e Indisë së madhe.

Evropa

Rasti i tretë është Kontinenti Evropian dhe unionet e saj të suksesshme ekonomike, ushtarake dhe politike. Të gjithë e dimë historinë e Evropës dhe luftërat e saj kolonizuese dhe kombëtare gjatë shekujve, si dhe si konfliktet mes tyre nxitën luftëra botërore që morën jetën e miliona njerëzve.

Ky kontinent, me historinë e tij konfliktuoze, me llojllojshmërinë e tij kulturore, etnike, gjuhësore dhe tradicionale, interesat e tij i shndërroi nga gjendje konflikti dhe përballimi mes vete, në unitet, solidaritet dhe bashkëpunim për ndërtim dhe zhvillim. Arriti sukses në formimin e blloqeve ekonomike dhe politike të mëdha botërore, që sjellin përfitime dhe kontrollojnë tregje dhe resurse. Për të realizuar interesat e saj, ka arritur praktikisht që formon Evropën e unifikuar në institucione, blloqe dhe valutën e unifikuar, që ka për qëllim ndarjen e përfitimeve me dollarin, ngase është valutë ndërkombëtare dhe synon përmes tij të përfiton pasuritë e popujve të vegjël dhe të varfër. Në krye të këtyre shteteve janë shtetet e Botës Islame.

Pse arritën armiqtë e ditës së djeshme të popujve evropianë të bashkohen për interesa dhe të shërojnë plagët mes tyre? Si arritën që interesat mes tyre të zhdukin armiqësitë

dhe të fshijnë hakmarrjet mes tyre? Nuk mund të gjejmë koment tjetër përpos ndjenjës dhe kulturës kolektive në mesin e këtyre popujve. Ata arritën të bëjnë solidarizimin për interesat e veta edhe krahas tërë asaj që ishte mes tyre.

Me Unionin Evropian u kompletua linja e frikshme mes unioneve të mëdha botërore, të cilët rrethojnë Botën e dobët dhe të përcarë islame dhe afrikane. Këto unione janë: unio- ni kinez, indian, rus, evropian dhe amerikan. Bota islame dhe afrikane, ndoshta edhe Amerika jugore, konsiderohen si vende konfliktesh dhe gjah përreth së cilave mbledhen hienat.

Kjo gjendje e mjerueshme dhe e përgjakshme e Botës islame dhe afrikane - krahas asaj që është gjendje fatkeqësie për banorët e saj - ajo është edhe vend konkurrence dhe konflikti mes fuqive të mëdha. Është e rëndësishme për njerëzinë plotësimin e zbrazëtirës dhe ngritjen e unioneve botërore islame dhe afrikane që mund të llogariten si ortak me fuqitë botërore. Kështu, bota do të eviton rreziqet e luftërave shkatërruese që nuk mund të parashikohen pasojat për njeriun dhe civilizimin njerëzor.⁷⁹

Shihet qartë nga shembujt që sollëm më lartë se shkaqet që i atribuojmë si shkaqe për përçarje dhe konflikt të Botës islame, nuk janë të vetmet që komentojnë gjendjen tonë. Edhe pse të njëjtat shkaqe gjendeshin edhe te të tjerët, por megjithatë ata nuk përfunduan në gjendjen që përfunduan ne, gjendje konfliktesh, përçarje dhe dobësie.

Ndoshta prej çështjeve të çuditshme dhe ironike janë edhe ato se shumë prej marrëveshjeve ekonomike dhe politike që bashkuan dhe unifikuan Evropën, marrëveshje të ngjashme kanë ndodhur edhe mes shteteve arabe. Marrë-

⁷⁹ Vlen të theksohet se autori këtë libër e ka shkruar diku ka fundi i shekullit të kaluar. Andaj të gjithë e dimë se çfarë luftëra kanë ndodhur në Botën Islame në shek. XXI, respektivisht nga viti 2001 e deri më sot. Lufta e Irakut, Sirisë, Jemenit, Libisë, Sudanit dhe vende tjera të botës Islame, ku kanë marrë jetën e miliona njerëzve muslimanë të pafajshëm. (v. p.)

veshje për tregje të përbashkëta, uljen e tatimeve doganore, mbështetjen e tregtisë dhe këmbim tregtarë mes vendeve arabe, marrëveshje për mbrojtje të përbashkët etj. Mirëpo, në rrafshin praktik asgjë nuk është realizuar prej këtyre marrëveshjeve. Pengesat dhe barrierat mes vendeve dhe popujve arabë vazhdojnë akoma. Konfliktet rriten edhe më shumë. E gjithë kjo le të kuptohet se çdo marrëveshje mes arabëve është e hidhur dhe nuk do të sheh dritën, e as nuk do të realizohet në realitet mes palëve arabe!

3.2.4. Feja, racioja dhe interesi që të gjitha na urdhërojnë për unitet dhe solidarizim

Feja nuk na urdhëron për përçarje dhe konflikte, përkundrazi na nxitë për unitet dhe vëllazërim. Nëse racioja dhe interesi nuk na urdhërojnë për përçarje, por na nxisin për unitet, solidarizim dhe ndihmë, atëherë për çka gjendja jonë është e kundërta e asaj që e kërkon feja, racioja dhe interesi?

Përçarja dhe konflikti janë prej sëmundjeve shoqërore, të cilat ndërlidhen me anën kolektive në personalitetin e njeriut. Kjo anë duhet të jetë temë hulumtimi dhe njohje e shkaqeve, të cilat kanë çuar drejt deformimeve në personalitetin e njeriut musliman.

Të gjithë e dimë se uniteti, solidariteti dhe bashkëpunimi janë prej komponentëve më të rëndësishme të anës kolektive dhe të përgjithshme në personalitetin njerëzor. Formimi i drejtë i anëve të ndryshme të personalitetit njerëzor - qoftë individual apo kolektiv - është i domosdoshëm për drejtimin dhe baraspeshën e personalitetit njerëzor, dhe më pas edhe drejtimin dhe baraspeshën e shoqërisë. Njeriu në natyrën e tij është individ, sjellja e të cilit lidhet me vullnetin dhe bartjen e përgjegjësive së ekzistimit, kryerja e obligimeve të këtij ekzistimi, në aspektin shpirtëror dhe material. Kjo çështje, shpirtërisht dhe materialisht nuk realizohet,

përpos përmes anës kolektive në formimin e njeriut dhe më pas formimin e shoqërisë që është i domosdoshëm për ekzistimin e njeriut dhe vazhdimin material të tij, duke filluar nga familja, babai dhe nëna dhe duke përfunduar me shoqërinë, i cili është mjet për individin dhe hapësirë e jetesës dhe qëndrimit.

Përmes shoqërisë dhe performansave njerëzore në te, anëtarët e shoqërisë realizojnë ekzistimin material, si dhe ngritjen shpirtërore dhe morale. Qenia njerëzore nuk gjendet, e as nuk mundet të zhvillohet, e as të mbijeton si individ, për shkak të fuqive të tij dhe nevojave, dhe për shkak të fëmijërisë së tij të gjatë. Është patjetër të ketë një shoqëri, në mbrojtjen dhe përkujdesin e të cilit zhvillohet. Ai përmes raporteve shoqërore shpreh vullnetin e tij dhe në atë shoqëri realizon ndjenjat, vlerat dhe qëllimet. Me anë të këtij bashkëveprimi pastron dëlirësinë e tij dhe me bashkëveprim të dalluar në shoqëri, realizon qëllimin e ekzistimit të tij.

3.2.5. Çrregullimi kolektiv në kulturën e umetit: (gjëja që të mungon, nuk mund t'ia japësh dikujt)

Çdo çrregullim gjatë përkujdesjes së anës kolektive në formimin e personalitetit të individit, patjetër të ketë pasoja negative gjatë performancave të individit dhe llojit të jetës dhe ekzistimit të tij, në aspektin shpirtëror dhe material. Me këtë do të unifikohet natyra e anës kolektive në personalitetin e individit me natyrën e shoqërisë, qoftë për të mirë ose për të keq. Do të ndikon edhe lloji i raporteve me shoqërinë dhe institucionet e tij, si dhe në baraspeshën, stabilitetin dhe fuqinë e tij për të kryer detyrat në përkujdesjen e jetës njerëzore për bijtë e umetit.

Nëse vëren çrregullim në performansën kolektive të individëve dhe mungesë në përkujdesje të raporteve, institucioneve dhe pjesëmarrje pozitive aktive në nevojat dhe

kërkesat e tij, atëherë duhet të hulumtojmë rreth mendimit, kulturës dhe programeve edukativo-arsimore të kësaj shoqërie. Fëmija përfiton kuptimin e vetes, raporteve dhe roleve të tij individuale dhe kolektive prej dy burimeve. Burimi i parë është natyral që buron nga ndjenja e tij për nevojat dhe perceptimet mendore. Ndërsa burimi i dytë buron nga konceptet e përgjithshme të kulturës së shoqërisë së tij. Nga ajo se sa janë të shëndosha dhe të baraspeshuara këto koncepte të përgjithshme dhe kultura me lëvizjen e realitetit, nevojat, mundësitë dhe sfidat e shoqërisë, varet edhe baraspesha e individit në aspektin individual dhe kolektiv, performansa e drejtë, fuqia e tij për sukses në përballimin e sfidave dhe në fund, fuqia e tij për të pasuruar veten dhe shoqërinë në aspektin shpirtëror dhe material.

Ne periudhën e fëmijërisë, aspekti psikologjik, emocional dhe shpirtëror për nga natyra e rolit të tij elementar për formimin e personalitetit është më e përgjithshme dhe më e rëndësishme se aspekti njohës. Bile, aspekti njohës në këtë periudhë është mjet për formimin e aspektit psikologjik dhe emocional. Për këtë, këtij aspekti, në sistemin kulturor dhe pedagogjik të cilit do popull, duhet dhënë kujdesin dhe rëndësinë më të madhe, si dhe duhet vërtetuar se aspektet kulturore dhe njohëse që i ofrohen fëmijës, ato në rend të parë janë mjete për formimin psikologjik, emocional dhe shpirtëror. Gjithashtu, ndihmojnë në formimin intelektual, krahas rolit njohës, i cili kompletohet me aspektin emocional në formimin e aftësive të fëmijës.

3.2.6. Aspekti kolektiv në mendimin islam

Nëse hulumtojmë në mënyrë të hollësishme rreth historisë së mendimit të umetit islam, në veçanti aspektin kolektiv të formimit të personalitetit të muslimanit, në baraspeshën e formimit dhe saktësinë e performansave civilizuese,

do të vërejmë një përputhshmëri marramendëse mes anëve pozitive dhe atyre negative të shoqërisë.

Në periudhën e shpalljes, shpirti kolektiv ishte në gjendjen më të mirë dhe nivelet më të larta. Po ashtu ndjenja e individëve - në cilësinë e anëtarit në trupin e umetit - marrë në konsideratë përkatësinë, përgjegjësinë dhe solidaritetin ishte në piedestalin më të lartë. Allahu thotë:

وَالَّذِينَ تَبَوَّءُوا الدَّارَ وَالْإِيْمَانَ مِنْ قَبْلِهِمْ يُحِبُّونَ مَنْ هَاجَرَ إِلَيْهِمْ وَلَا يَجِدُونَ فِي صُدُورِهِمْ حَاجَةً مِمَّا أُوتُوا وَيُؤْثِرُونَ عَلَىٰ أَنْفُسِهِمْ وَلَوْ كَانَ بِهِمْ خَصَاصَةٌ وَمَنْ يُوقِ شَحْنَفْسِهِ فَاُولَٰئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ

*“Edhe ata që përgatitën vendin (Medinen) dhe besimin para tyre, i duan ata që shpërnguleshin tek ata dhe nuk ndiejnë në gjoksat e tyre ndonjë nevojë (për zili a tjetër) nga ajo që u jepej atyre (muhaahirëve), madje edhe sikur të kishin vetë nevojë për te, ata u jepnin përparësi atyre para vetvetes. Kush është i ruajtur prej lakmisë së vet, të tillët janë të shpëtuar”.*⁸⁰

Ky shpirt kolektiv, i fortë dhe efektiv, nuk ka ardhur nga asgjë. Por, ka ardhur nga esenca e zhvillimit arab fisnor, të lirë dhe të thjeshtë, të cilën nuk e kanë shkatërruar sistemet e padrejtësisë dhe diktaturës. Këtë çështje e formoi dhe e efektizoi shpirti i besimit islam dhe sistemi i tij i ngritur mbi parimin e drejtësisë dhe solidaritetit.

Muhamedi alejh'is-selam, kryesues i qeverisë së shoqërisë islame vendosi shtyllat e sistemit të drejtë, që kujdeset për anëtarët e shoqërisë, mbron dinjitetin e tyre njerëzor, ruan të drejtat e tyre, qofshin musliman apo jo. Çështja arriti deri në atë pike saqë shteti mori garancinë e borxheve, në shenjë përkujdesi dhe nxitje për bashkëpunim me anëtarët e shoqërisë. Nëse vdes borxhliu dhe nuk lë pas vete pasuri të

⁸⁰ El-Hashr: 9

mjaftueshme për larjen e tij, atëherë shteti merr përsipër borxhin e tij. Muhamedi alejh'is-selam ka thënë: “Kush vdes dhe lë pasuri, ajo i takon trashëguesve të tij. Kush vdes dhe lë borxh, unë mbuloj atë”. Për këtë, nuk është për t'u habitur se muslimanët flijuan, shpenzuan dhe bënë çdo gjë për formimin dhe ruajtjen e umetit. Kur Muhamedi alejh'is-selam në një gjendje të vështirë kërkoi prej tyre të shpenzojnë, ata ofruan pasuri të shumta. Në krye të dhuru- esve ishte mendjemprehti Ebu Bekri radijallahu anhu.⁸¹

Sikur që dhanë sadakë muslimanët, dha edhe Ebu Bekri radijallahu anhu. Mirëpo, ai nuk dha vetëm kur kishte nevojë dhe në momente të vështira, e as nuk dha pjesën e tepruar të pasurisë së tij, por kishte dhënë sadakë tërë pasu- rinë e tij, pa lënë asgjë për fëmijët e tij! Muhamedi alejh'is- selam, siç transmeton imam Ahmedi, e kishte pyetur: „Çka latë për fëmijët tuaj”? Ebu Bekri u përgjigj me dy fjalë, me të cilat shkurtimisht tregon natyrën e sistemit shoqëror, di- mensionin e tij kolektiv dhe metodën e kryerjes, duke thë- në: “Ua lash atyre Allahun dhe të Dërguarin e Tij”.

⁸¹ Është e dobishme që të themi diçka rreth personalitetit dhe urtësisë së Ebu Bekrit që të kuptojmë qëlli- met e veprave të tij në të kuptuarit e shpirtit të shoqërisë në periudhën e shpalljes. Ebu Bekri për shkak të urtësisë dhe mendjprehtësisë së tij ishte ai që shoqëroi Muhamedin alejh'is-selam në udhëtime të vështira dhe të rrezikshme. Ai me mendjen e tij të pastër besoi pa fije dyshimi ngjarjen e Israsë dhe Mí'raxhit. Ai, siç transmeton Ebu Davudi dhe Ahmedi, me zemrën e tij trime dhe besimin e fortë, qëndroi i paluhatur në momentin e pikëllimit, respektivisht vdekjen e Muhamedit alejh'is-selam edhe pse Muhamedi alejh'is- selam për të ishte njeriu më i afërt dhe më i dashur se çdo kush tjetër. Ai tha: “Kush e adhuron Allahun, Ai është i gjallë dhe nuk vdes, ndërsa kush e adhuronte Muhamedin, ai ka vdekur”. Ai citoi ajetin kur'anor:

وَمَا مُحَمَّدٌ إِلَّا رَسُولٌ قَدْ خَلَتْ مِنْ قَبْلِهِ الرُّسُلُ أَفَإِنْ مَاتَ أَوْ قُبِلَ انْقَلَبْتُمْ عَلَى أَعْقَابِكُمْ وَمَنْ يَنْقَلِبْ عَلَى عَقْبَيْهِ فَلَنْ يَصُرَ اللَّهُ شَيْئًا وَسَيَجْزِي اللَّهُ الشَّاكِرِينَ

“Muhamedi nuk është tjetër vetëm se i dërguar. Edhe përpara tij pati të dërguar (që vdiqën ose u vranë). E nëse ai vdes ose mbytet, a do të ktheheshit ju prapa (nga feja ose lufta)? E kushdo që kthehet prapa, ai nuk i bën dëm All-llahut aspak, kurse All-llahu do t'i shpërblejë mirënjohësit”. Alu Imran: 144. Në këtë rast, siç transmeton Ibn Maxhe, Omeri dhe muslimanët thanë: “Sikur të mos e kishim lexuar këtë ajet asnjëherë më parë”. Ebu Bekri është njeriu i cili udhëhoqë me urtësi dhe sukses shtetin islam pas vdekjes së Muha- medit alejhis selam. Beduinët bënë një kryengritje politike kundër shtetit, por ai i mposhti ata dhe i ktheu në shoqërinë njerëzore civilizuese.

Ata që nuk kuptojnë rëndësinë e dimensionit kolektiv mendojnë se përgjigja e Ebu Bekrit radijallahu anhu shpreh vetëm besimin e tij të thellë. Nuk ka dyshim se ishte ashtu. Si ai në çështjen e besimit kishte edhe shumë prej sahabëve të dalluar. Mirëpo, krahas kësaj ajo shprehte edhe perceptimin e tij ndaj sistemit shoqëror të cilit i takonte, shoqëri e bashkuar dhe solidar mes vete. Në të nuk humb as i varfëri e as i dobëti. Një për të gjithë dhe gjithë për një. Të gjithë janë solidarë, në vëllazërim, shpenzim dhe përkujdesje.

Prej këtu bëhen të qarta dallimet e rëndësishme mes shoqërisë në periudhën e shpalljes, përfshirë konceptet dhe performansat nga njëra anë dhe koncepteve të periudhës së tiranisë dhe izolimit, në të cilën u dobësua dimensionin kolektiv në sistemin shoqëror. E gjithë kjo reflektoi pakujdesin e elitës mendore nga kuptimi i këtij dimensionin dhe kuptimet që nxirren nga tekstet, ngase “nuk është ai që sheh, sikur ai që dëgjon” dhe se nuk ka argument më të qartë se eksperiencia dhe përvoja. Shoqërie e tiranisë dhe diktaturës, që nuk ka pare e as nuk ka përjetuar shoqërinë e drejtësisë, dinjitetit dhe solidaritetit, nuk mund të percepton kuptimet dhe domethëniet që gjenden në tekstet e shenjta, ngase “çdo enë jep atë që ka në brendinë e saj”.

Për këtë, mendimtarët e izolimit kuptuan përgjigjen e Ebu Bekrit radijallahu anhu, se ishte vetëm shprehje e imanit dhe mbështetjes në Allahun. Ata nuk kuptuan se vendimin që mori nuk ishte i rastit, e as shpërthim emocional, pas të cilës do të pendohej, por ishte vendim i shëndoshë dhe mirë i studiuar. Me siguri se imani dhe mbështetja e tij absolute në Allahun kishte ndikim të madh, por ndikim të madh kishte edhe besimi i tij në qeverinë islame dhe sistemin e tij që kujdeset për nevojtarët: “*Ua lash atyre Allahun dhe të Dërguarin e Tij*”.

Pa e kuptuar këtë sistem dhe natyrën e tij, është e pamundur të kuptohet dialogu i shkurtër dhe kuptimplotë mes Muhamedit alejh'is-selam dhe Ebu Bekrit radijallahu anhu, në përjashtim të sociologëve, ekspertëve dhe atyre që e kanë jetuar atë sistem dhe kanë kuptuar natyrën e funksionimit.

Kur dimensionin kolektiv pësoi rënie dhe u shndërrua në konfiskim të pasurisë, humbje të të drejtave, padrejtësia ndaj të varfërve dhe nevojtarëve arriti në atë nivel sa që anëtarët e shoqërisë nuk kishin besim në sistemin shoqëror. Në këso raste çdo individ është garanci vetëm për veten dhe fëmijët e tij. Njeriu nuk kujdeset pos për veten e tij. Ai nuk pret gjë nga shoqëria, e as shoqëria nuk pret gjë prej tij. Nuk është për t'u habitur kur shumica e anëtarëve të shoqërisë sot, ikin - me qëllim - nga kryerja e çdo detyre të përgjithshme, bëhen koprrac - edhe krahas mundësisë materiale - për të plotësuar një nevojë të përgjithshme, shkatërrohet para syve të tyre institucionet dhe braktisen nevojat dhe gjërat e rëndësishme. Në të gjitha këto raste, ata vetëm luajnë rolin e spektatorit, të cilit nuk i intereson asgjë. Sa janë të dhembshme dallimet mes tyre dhe popujve të cilët interesohen për edukimin e ndjenjës kolektive, në të cilët zhvillohet ndjenja e shpenzimit dhe solidaritetit.

3.2.7. Pasojat e rrezikshme të dobësisë së dimensionit kolektiv në kulturë dhe pedagogji

Me dobësimin e dimensionit kolektiv në personalitetin e muslimanit, nuk është për t'u habitur rënia e institucioneve të përgjithshme të umetit. Me këtë vështirësohet zbatimi i të drejtave të përgjithshme, pagesa e tatimeve dhe përhapet koprracia dhe mosflijimi. Në kohë kur individi vrapon pas plotësimit të nevojave të tij dhe të fëmijëve të tij, ai aspak nuk kujdeset për nevojat e umetit e as për nevojat e të var-

fërve dhe nevojtarëve, ngase ai e di se nëse atë e godet ndonjë nevojë, vetëm ai është garanci për veten dhe familjen e tij, dhe se askush nuk e ndihmon atë në plotësimin e nevojave të tij. Kështu vetë gjendja e tij flet duke thënë: „*Kush nuk mëshirohet, nuk mëshiron*“.

Në këtë gjendje të lënies pas dore të edukimit të dimensionit kolektiv në formimin e personalitetit të anëtarëve të popujve islam në kohën e dekadencës, nuk është për t'u habitur nga përhapja e dukurisë së lypjes. Sikur shoqëria dhe sistemi i tij të garantonte për nevojtarët minimumin e nevojave të tyre për të mbrojtur dinjitetin njerëzor, nuk do të dilnin për të përjetuar nënçmimin e lypjes, e as fëmijët e tyre nuk do të formonin një mundësi të mirë për krime dhe amoralitet. Përhapja e këtyre dukurive dhe përhapja e hesh-tjes nga to, janë argumente të qarta për syrin, të dëmshme për ndërgjegjen dhe dëshmitare për dobësimin e dimensionit kolektiv në mesin e umetit, si dhe mosfunksionim i shëndoshë i sistemit shoqëror.

Me dobësimin e dimensionit kolektiv në formimin e personalitetit të muslimanit, nuk është për t'u habitur nga përhapja e korrupsionit shoqëror, nga përhapja e varfërisë dhe injorancës, nga ulja e nivelit të shërbimeve, ikja nga kryerja e të drejtave dhe obligimeve të përgjithshme dhe llogaritje e pasurisë publike si e lejuar për të gjithë ata që dëshirojnë të marrin! Këtyre sëmundjeve shoqërore u bashkëngjiten edhe sëmundja e prapambetjes nga ruajtja e interesave të umetit dhe sinqeriteti ndaj kryerjes së detyrave. Mund që sëmundja të rritet dhe të kalon në tradhti ndaj shtetit, përçarje të organeve dhe konflikt për grabitje të pasurisë së tij.

Me rënien e periudhës së halifëve të drejtë dhe me dominimin e shpirtit injorant dhe fisnor në arenën politike, larg parimeve të drejtësisë dhe përmirësimit, u dobësua fuqia e nxitjes shpirtërore islame, u përhapën konfliktet dhe

rrodhën gjakrat. Kështu u dobësua shpirti islam dhe së bashku me të u dobësua edhe dimensionin kolektiv. Fuqia e umetit u shpërnda në etnitete, fise, popuj dhe grupime. Humbën dhe u zhdukën besnikët e umetit, të izoluar larg politikave të umetit dhe gjërat që e goditën përfshirë korrupsionin, dhunën dhe gjakderdhjen, duke qenë të kënaqur me mësimet dhe dhikr në xhami, shkolla dhe teqe.

Humbja e umetit para racizmit nuk u ndal vetëm në xhiron e parë mes besnikëve të periudhës së shpalljes dhe nxënësve të medresesë së Medinës, por kaloi edhe më larg për të dobësuar rezistencën dhe për të shkatërruar fuqinë për riformimin e projektit të reformave, sipas udhëzimeve të politikave në kohën e shpalljes.

Fatkeqësisht, dështimi i përpjekjeve të burrave që dolën nga medreseja e Medinës dhe trashëguesit e periudhës së shpalljes gjatë disa shekujve pas periudhës së halifëve të drejtë, përfundoi në izolim, i cili - me përjashtime të vogla - ishte afër dorëzimit. Ky dorëzim çoi drejt mbjelljes së negativitetit shoqëror në mendimin dhe ndërgjegjen e umetit, anashkalimin e dimensionit kolektiv në formimin e njeriut, shkatërrimin e bazamenteve dhe themeleve, në atë mënyrë që institucionet politike dhe organet shtetërore të vijjnë në pozitë të dyshimtë, duke humbur kështu edhe legjitimitetin në mesin e popullatës.

Në vend që të kuptojnë burrat e medresesë së Medinës gabimin e metodës së dhunës, me qëllim të reformave dhe ndryshimit gjatë përballimit, në vend që të hulumtojnë metoda më efektive, duke njohur natyrën e çrregullimit dhe metodat efektive për riformimin e personalitetit islam dhe në vend se të përforcojnë faktorët e aspektit kolektiv në te, ata vazhduan në izolimin e tyre dhe përballimin me forma të ndryshme, pa e kuptuar dijetarët dhe mendimtarët rolin e fëmijërisë në riformulimin e personalitetit të umetit, men-

talitetin dhe formimin psikologjik në mënyrë natyrale dhe paqësore. Çështje e edukimit të fëmijëve mbeti e kufizuar në aspektin arsimor, mekanik dhe fetare me ngjyrim të kufizuar të personalitetit.

Kështu, i tërë mudi u harxhua për shkak të vazhdimit të konfliktit, mirëpo në mënyrë negative. Vazhdoi çdo grup në hapjen e gropave, grumbullimin e mjeteve dhe përgatitjen e ndihmësve për të mbrojtur sa të jetë e mundur këto qëndrime. Kështu, edhe fuqitë e umetit vazhdonin të dobësohen dhe të humben.

Pushteti, politika, çështjet publike dhe pasuritë janë të veçanta për elitën politike, fisnore, raciste dhe ushtarake. Sa i përket çështjeve të veçanta të individëve dhe bashkëveprimet individuale, aty mund të përzihet edhe elita ideologjike dhe fetare. Kështu, ndihmëtarët, ushtarët dhe pasuritë janë mjete të elitës politike dhe pushtetarëve, ndërsa xhamitë, teqetë, derset për këshilla dhe feta, janë mjete të elitës ideologjike dhe fetare. Sa i përket popullatës, ajo në mesin e elitave është gjahu i padrejtësisë, nënçmimit, injorancës dhe varfërisë. Kështu, shoqëria islame është arenë për mitologji dhe magji, si dhe dorëzim në dërvishizëm të pakuptimtë.

3.2.8. Domosdoshmëria e formimit të dimensionit kolektiv në kulturë dhe pedagogji

Katastrofa u arrit kur në duart e elitës ideologjike dhe pa vetëdije, u mboll kjo gjendje e sëmurë. Vizioni i përgjithshëm islam u formulua në atë mënyrë që të reflekton këtë realitet, në të cilin fshihet dimensionin kolektiv në mendimin e umetit, qoftë si kulturë, edukatë apo arsimim. Kështu, anashkalohet çështja dhe izolimi bëhet cilësi e jetës shoqërore. Sipas konceptit të fikhut, qëllimi i tij është „ibade-adhurimi“, ndërsa njeriu musliman, pas zhveshjes së tij nga dimensionin shpirtëror, bëhet negativ në jetë. Kështu, Islami

mbetet vetëm disa të drejta mes njerëzve dhe disa kritere ligjore për kontrata, e assesi përpikëri, ndërtimtari dhe besnikëri ndaj përgjegjësive të mëkëmbësisë në tokë.

Libri i fikhut islam është bërë hallka lidhëse mes kulturës ideologjike të njerëzve të veçantë dhe kulturës së popullatës. Në realitet, ai është udhërrëfyesi për formimin intelektual të muslimanit dhe bazament i formimit të tij psikologjik. Kjo pozitë qendrore e librit të fikhut rreth kulturës së muslimanit, në kohët e fundit na bënë të kuptojmë dëmin e madh dhe të vazhdueshëm që e ka goditur formimin intelektual dhe psikologjik të muslimanit. Kështu, libri i fikhut ka anashkaluar dimensionin kolektiv nga plani i udhëzimeve dhe ka kufizuar çështjet e dhikrit dhe obligimeve fetare se vetëm ato janë „ibadete-adhurime“, a në realitet janë „dimensioni shpirtëror“ në jetën e njerëzve. Kështu, jeta dhe mëkëmbësia në tokë është reduktuar vetëm në „muamelat-kontratat mes njerëzve“.

Derisa të reformohen librat e fikhut, kulturës dhe pedagogjisë islame, që të jenë udhërrëfyese për kuptim, kulturë dhe edukatë të përgjithshme dhe të shëndosha për të qenë bazament i vetëdijes civilizuese, pozitive, të përgjithshme dhe të kompletuar, që prodhojnë mendim që kujdeset për formimin e mendjes, psikikës dhe personalitetit të muslimanit në aspektin individual dhe kolektiv, duke i zhvilluar ato në mënyrë pedagogjike që nga lindja, përfshirë dhe periudhat e fëmijërisë. Nuk ka hapësirë e as shpresë në formimin e një personaliteti që posedon fuqi, solidaritet, iniciativ dhe kreativitet, që do të jetë në gjendje ta vë umetin në vijat e para të popujve të përparuar.⁸²

⁸² Nëse shfletojmë librat e dijetarëve rreth çështjeve të pushtetit dhe politikës, do të vërejmë se pjesa dërrmuese e tyre janë teorike ose ndërlidhen me rregullimin administrativ. Ato cilësohen me shpirtin e këshillimit ndaj sunduesit, të cilat shpeshherë i dhurohen atij. Nuk ka shkrime që i drejtohen umetit nga fakti se ai është çështja bazë, si dhe gjërat që ndërlidhen me çështjen e konsultimit (shura'), çështjet që ndërlidhen me të drejtat dhe obligimet e qytetarëve dhe interesave të tyre politike. Imam El-Maverdi,

3.3. Ndryshimi shoqëror dhe diskursi (komunikimi) pedagogjik

Nëse pranojmë se umeti në këtë periudhë është i dobët, i lodhur, i përçarë dhe i nënçmuar, ndërsa në të njëjtën kohë pranojmë se është i pasur me resurset materiale dhe me parimet dhe vlerat e larta morale dhe shpirtërore. Nëse përfundojmë se prapambetja e umetit në esencë është për shkak të dobësisë që ndodhi si rezultat i konfliktit mes elitës politike dhe intelektuale në kohët e mëhershme, gjë e cila solli deformime të llojllojshme në pikëpamjet e umetit, e cila u reflektua në plan-programet, shkencat dhe njohuritë njerëzore që shprehin njëanshmëri, sipërfaqësi, ngurtësi dhe parcializëm. Nëse kuptojmë se si gjatë shekujve kanë dështuar të gjitha përpjekjet për reformim dhe rilindje në realizimin e qëllimeve për të ripërtërirë energjinë e umetit dhe përmirësimin e ecurisë, atëherë është koha për të parashtruar këtu pyetjet: Cila është rrugëdalja nga kjo gjendje? Si mund të ripërtërihet energjia, përmirësimi i ecurisë dhe sjellja e ndryshimit? Cila është metoda e rëndësishme reformuese, të cilën nuk e ka përdorur - në mënyre efektive - projekti reformues islam deri më sot?

Duhet të fillojmë nga fillimi. Cili është realiteti i problemit, realiteti i çështjeve të kërkuara dhe realiteti i sfidave me të cilat ballafaqohet umeti? Nëse esenca e problemit është fuqia për ndryshim, negativiteti, mungesa e iniciati-

gjykatësi suprem në periudhën e abasitëve në librin e tij: “El-Ahkam’us-Sultaniyeh” ka vendosur se pranimi i udhëheqësit (el-bej’atu) arrihet edhe vetën nëse dy persona e bëjnë këtë, krahasim me aktin e kurorëzimit! Këtë e ka bërë i nënshtuar ndaj praktikave të prijësve turk të cilët kishin uzurpuar pushtetin dhe në shenjë kujdesi ndaj asaj që kishte mbetur nga hilafeti dhe zbatimi i sheriatit.

Për të përfituar më shumë, lexo librin: “El-Unfu ve idaret’us-sira’is-sijasijji fi’l-fikr’il-islamijji bejne’l-mebdei ve’l-hijari: ru’jetun islamijjeh” të autorit të këtij libri. Ai sqaron rëndësinë e zbatimit të parimit të konsultimit (shurasë) në administrimin e politikës së shoqërisë, zbatimi i mjeteve civile dhe paqësore në përmirësimin e ecurisë politike në shoqëri. E gjithë kjo ruan shoqërinë nga përçarja, i mbështet lëvizjet reformuese dhe në fund realizon stabilizimin politik për shoqërinë.

vës dhe kreativitetit, dobësia e energjisë emocionale, guximit letrar dhe dobësia e dinjitetit njerëzor, mungesa e mentalitetit shkencor kreativ dhe shpirtit iniciues. Nëse problematika në fund të fundit është humbja e dinjitetit të njeriut, guximit, shpenzimit, ndihmës dhe fuqisë së tij, si dhe dobësimi në fushën e shkencës dhe njohurisë, atëherë përgjigjja është se ajo që kërkohet, është domosdoshmëria e ndryshimit në natyrën e formimit psikologjik dhe emocional të këtij njeriu. Është i domosdoshëm angazhimi për formimin e mentalitetit shkencor, kreativ, pozitiv dhe efektiv të muslimanit, me të gjitha parimet, vlerat, konceptet dhe pikëpamjet e larta të këtij mentaliteti.

Është i pamundur ndryshimi i realët dhe dështojnë përpjekjet reformiste në realizimin e qëllimeve, sepse diskursi i drejtuar vetëm të rriturve, nuk ndryshon formimin e tyre dhe se vetë përkufizimi jonë me diskurs vetëm ndaj të rriturve nuk mund të sjell ndryshimin e domosdoshëm pedagogjik të fëmijët dhe adoleshentët.

3.3.1. Si ta kuptojmë diskursin pedagogjik islam?

Diskursi islam në periudhën e shpalljes ka qenë i llojllojshëm, varësisht prej nevojës, atyre që u është drejtuar me ligjërime, gjendjes, dimensioneve dhe qëllimeve. Për këtë edhe diskursi ishte efektiv dhe ndikues. Prej shkaqeve më të rëndësishme të dobësimit të diskursit në kohët e mëvonshme, ishte mungesa e eksperiencës për ligjërime, mungesa e perceptimit të dimensioneve, të gjendjes dhe nevojave të atyre që u drejtohet me ligjërime. Kjo gjendje bëri që të gabojnë të kuptuarit e diskursit të tyre, të kuptuarit e realitetit dhe qëllimeve. E gjithë kjo solli deformime, dobësoi ndikimin e tij dhe e shndërroi atë në diskurs teorik, që shpesh here rezultatet e tij janë të kundërta me atë që ka për qëllim!

3.3.2. Dobësimi i studimeve humane rezultoi përzierjen e dimensioneve dhe sferave

Dobësimi i studimeve humane në periudhat e mëvonshme rezultoi dobësimin e mendimit islam dhe përzierjen e dimensioneve dhe sferave të ndryshme. Në shumë çështje kam vërejtur pasojat e përzierjes së dimensioneve, sferave dhe gjendjeve. Çështja e fundit është studimi që kam bërë rreth çështjes së dhunës dhe menaxhimit të konfliktit politik në këndvështrimin islam, i botuar në libër nga ana e Institutit Botëror të Mendimit Islam. Kam sqaruar në libër se prej shkaqeve më të rëndësishme që pengojnë ecurinë e reformimit islam, është çështja e përzierjes mes dimensionit të menaxhimit të konfliktit politik brenda shoqërisë dhe konfliktit politik që ndodhë mes shoqërive. Thënë ndryshe, përzierja mes koncepteve të brendshme politike dhe koncepteve të jashtme politike. Muslimanët me këtë përzierje ishin sikur ai që vë shpatën jo në vendin e saj dhe ai që shpenzon pasurinë në drejtim jo të duhur.

Më parë këtë problematikë metodologjike në mendimin islam e kisha sqaruar në një studim të botuar në Kajro rreth „Teorisë ekonomike islame“, në të cilin kam përfshirë çështjen e ekonomisë islame dhe parimet elementare të tij, politikave që i praktikoi Muhamedi alejh'is-selam gjatë zbatimit të këtyre parimeve në rrethanat dhe mundësitë e kohës së tij dhe mënyrën se si mund të përfitojmë në planifikimin e politikave që përshtaten me rrethanat dhe mundësitë e kohës sonë. Në këtë studim kam sqaruar se prej shkaqeve më të rëndësishme që sjellin gabime në kuptimin e qëllimeve të ekonomisë islame dhe shkaqeve të devijimit në praktikën e mëvonshme, është përzierja mes rregullave dhe kritereve të brendshme ekonomike dhe rregullave dhe kritereve të jashtme ekonomike. Për këtë nuk është për t'u habitur kur një mendjendritur islam, siç ishte Ibn Hazm

Endelusi të jep fetva se hadithi rreth kontratës së Muhamedit alejh'is-salam me hebrenjtë e Hajberit që ata të punojnë tokat e tyre, ndërsa frutat të ndahen në gjysmë mes tyre ka deroguar hadithet që ndalojnë një gjë të tillë në Medine, për të cilat Muhamedi alejh'is-salam kishte thënë se janë kama-të. Sipas Ibn Hazmit, shkaku i derogimit ishte se kjo ishte çështja e fundit që kishte bërë Muhamedi alejh'is-selem me hebrenjtë në Hajber në lidhje me këtë çështje. Mirëpo, Ibn Hazmi nuk i kishte kuptuar mirë përzierjen mes dimensionit të brendshëm dhe atij të jashtëm në ekonomi.

Rregullat që merren në konsideratë në ekonominë e jashtme ndryshojnë rregullat të cilat merren në konsideratë në ekonominë e brendshme. Përzierja metodologjike mes tyre shpie në mendim të gabuar.⁸³

3.3.3. Llojllojshmëria e diskursit sipas Llojllojshmërisë së atyre që ju flet

Nëse mendojmë hollësisht, do të vërejmë se mënyrat e paraqitjes së shpalljes ishin sipas dimensioneve të ekzistimit dhe llojllojshmërisë së nevojave. Kemi diskurs të përgjithshëm, diskurs sipas kohës dhe vendit, diskurs drejtuar mendjes, diskurs drejtuar psikologjisë emocionale të besimtarit, diskurs vërejtës dhe kërcënues ndaj mendjemadhit kokëfortë, diskurs për ftesë, këshillim dhe përgëzues për besimtarin punëtor, diskursi pedagogjik, i kujdesshëm dhe i dashur drejtuar fëmijëve dhe adoleshentëve, diskurs në gjendje pasurie, diskurs në gjendje vështirësie dhe nevoje, diskurs që ndërlidhet me politikën dhe sundimin, diskurs për njerëzit e thjeshtë, diskurs drejtuar udhëheqësve dhe të

⁸³ Abdulhamid Ahmad Ebu Sulejman, "El Unfu ve idaret'us-sira'is-sijasijji fi'l'fikris-sijasijji'il-islamijji bejne'l-mebdei ve'l-hijar: ru'jetun islamijetun; Abdulhamid Ebu Sulejman, *Nadharijet'ul-islam'il-iktisadijeh: el-felsefetu ve'l-vesail'ul-muasire*, Kajro: Mektebet'ul-Hanxi, 1960; Abdulhamid Ahmad Ebu Sulejman, "The Theory of the Economics of Islam". *Journal of Economics and Management*, 6 no. 1&2, Kuala Lumpur: International Islamic University IIUM, 1998.

urtëve, diskurs për mbarë njerëzinë dhe diskurs vetëm për pejgamberët alejhim'us-selam.

Çdo diskurs ka natyrën dhe qëllimet e veta, të cilat duhet të merren në konsideratë për të kuptuar rrethanat, efektet dhe komentimin e tyre. Për këtë, të shihet çështja e llojllojshmërisë së diskursit për shkak të llojllojshmërisë së atyre që u flet si çështje besimi ose gënjeshtre apo derogues dhe e deroguar, tregon qartë për sipërfaqësim dhe dobësi mendimi.

Për këtë arsye, prej çështjeve më të rrezikshme që bie si preh e saj, mendimi është edhe sipërfaqësimi i diskursit për akumulimin e mendimit dhe formimin e shoqërisë. Më parë folëm rreth një lloj të ligjërimit, në të cilin përzihen dimensionet e ligjërimit, por pa energji formimi dhe ndikimi. E gjithë kjo për shkak se në këtë lloj diskursi ka terrorizëm psikologjik fetar, me të cilin është cilësuar mendimi islam në periudhën e izolimit dhe ndarjes, krahas terrorizmit materialist politik, me të cilin është cilësuar politika. E gjithë kjo për shkak të dobësisë së mendimit dhe pushtetit dhe për shkak të ndarjes mes mendimit dhe politikës.

Në rrethanat e izolimit dhe ndarjes ishte patjetër që mendimi islam të bie në një përzierje mes diskursit kohor dhe vendor të periudhës së shpalljes, nga njëra anë dhe diskursit të pafillim, fetar dhe hyjnor, nga ana tjetër. Kjo nënkupton përzierjen e çështjeve konstante me ato të ndryshueshme. Kështu ishte patjetër - për shkak të dobësisë mendore - përzierja mes diskursit të frikës dhe kërcënimit me diskursin e këshillimit dhe orientimit, përzierjen e diskursit drejtuar jobesimtarëve me diskursin drejtuar besimtarëve, përzierjen e diskursit drejtuar udhëheqësve dhe pushtetarëve me diskursin drejtuar masës së thjeshtë, diskursin drejtuar në gjendje të mirë me diskursin drejtuar në gjendje të vështirë dhe në fund përzierjen mes diskursit

drejtuar kujdesit ndaj fëmijës me diskursin rreth përgjegjë-sive të të rriturve dhe kontrollimi i sjelljes.

Kjo përzierje ishte një mjet i domosdoshëm, të cilin e ka imponuar dobësia ideologjike, ngurtësimi i vizionit shkencor, parcializimi metodologjik, tekstual dhe gjuhësor i ndarë nga studimi i përgjithshëm shoqëror, me qëllim që elita ideologjike të ruan pozicionin e saj, krahas dobësisë së saj dhe të luan rolin e saj qoftë edhe në minimum, me qëllim të mbrojtjes së shoqërisë nga anarkia totale dhe rrënimi i plotë.

3.3.4. Pasojat shkatërruese të keqpërdorimit të shenjtërimit të ligjërimit: mentalitet robërisht

Me anë të përzierjes së diskursit dhe keqpërdorimit të shenjtërimit, është mundësuar dominimi i diskursit të terrorizmit ideologjik për të imponuar nënshtrimin ideologjik, mbylljen e gojëve, imponimin e ngurtësisë dhe përgatitja e njerëzve për të pranuar këtë lloj të mendimit, kulturës dhe elitës që bartë atë. Pushteti politik autokrat dhe i dobët ka përfituar nga ky lloj ligjërimi, nga pasojat e tij psikologjike dhe shkatërruese, me qëllim që masa e thjeshtë të dorëzohet para padrejtësive dhe korrupsionit të tyre. Kështu u formua në mesin e masës së thjeshtë “lloji i robërve” të dorëzuar para padrejtësive të pushtetarëve. Çështja kishte arritur deri në atë masë sa që - pas largimit të pushtuesit anglez dhe përhapjes së anarkisë - kishte të tillë që shprehnin keqardhje për largimin e “zotërisë” anglez.

Diskursi i terrorizmit psikologjik, ngurtësimi i mendjeve, shuarja e mendimit dhe imponimi i mendimit dhe bindjes, për nga pamja e jashtme duken si mëshirë, ndërsa brendia e saj në fund të fundit është mbyllje e mendjes, mohim i njohurisë, robërim i ndërgjegjes, ngurtësimi i shpirtit dhe rrugë për prapambeturi.

Diskursi tradicional islam i mbushur me terrorizëm psikologjik synon pengimin e rrënimit dhe anarkisë, por kjo

është me qëllim të dominimit të elitës ndaj masës së thjeshtë të umetit dhe nënshtrimi i tyre. Ky diskurs ka synuar të rriturit e umetit, duke anashkaluar dhe injoruar fëmijët. Në të gjitha rastet ka përdorur gjuhën e kërcënimit dhe frikës. Prej mjeteve më të rëndësishme ishin përzierja e diskursit ndaj besimtarit dhe jobesimtarit, çështjeve konstante dhe atyre të ndryshuara, përdorimi i shenjtërisë së tekstit për të detyruar mendjen e besimtarit të tejkalon gjendjen reale dhe zbulimin e ligjeve natyrore. E gjithë kjo, me qëllim që shpirtrat dhe mendjet muslimane të pranojnë çështjet kontradiktore dhe muslimanët të dorëzohen para çështjeve mitologjike “që u sjellin dëm e jo dobi”. Kështu ka humbur kujdesi për diskursin e stilit peygamberik, i dashur, emocional, psikologjik dhe pedagogjik për fëmijën. Po ashtu ka humbur të kuptuarit e tij, perceptimi i mjeteve dhe qëllimeve të cilat nxisin për besim, trimëri, xhihad dhe iniciativë. Kështu, qëllimet e sirës (jetëshkrimit) peygamberike⁸⁴ janë kufizuar në çështje të veçanta, përkujtim dhe përshkrim të luftërave.

3.3.5. Diskursi pedagogjik dhe diskursi legjislativ: sistemi penal si model

Do të zgjedhim sistemin penal islam si model për baraspeshën e diskursit islam, llojlojshmërinë e dimensioneve dhe pozitivizmin e qëllimeve për të ndihmuar njeriun mus-

⁸⁴ Duhet rishikuar librat e sires së Muhamedit alejh'is-selam për qëllime të arsimit të fëmijëve dhe adoleshentëve, duke u koncentruar në qëllimet dhe metodologjitë në dritën e realitetit, mundësitë dhe nevojat e shoqërisë islame, duke potencuar edhe sfidat. E gjithë kjo me qëllim që para fëmijëve dhe adoleshentëve të vendoset një model i gjallë. Kështu, periudha mekase do të jetë periudhë e vënies së rregullave, koncepteve dhe përgatitjes së liderëve. Ndërsa periudha medinase të jetë periudhë e formimit të shoqërisë, umetit dhe institucioneve. Në këtë periudhë kanë ndodhur vështirësitë, luftërat dhe konfliktet. Andaj, sireja nuk duhet të jetë vetëm përshkrim serik i ngjarjeve dhe luftërave me qëllim që orientalistët të mos argumentojnë me te se islami është përhapur vetëm me luftëra dhe shpatë. Kështu shpallja do të mbetet anësore, ndërsa luftërat dhe konfliktet esencë, e jo anësore të cilat i kanë imponuar rrethanat e kohës.

liman për të kaluar jetën e tij, qoftë si individ apo kolektiv në siguri dhe qetësi, dhe për ta ndihmuar atë brenda kufijve të natyrës njerëzore për zhvillim, kryerje të përgjegjësive dhe synim të të mirës dhe dinjitetit.

Ngase ky lloj i diskursit më shumë se çdo lloj tjetër, në veçanti në kohët e mëvonshme, ka shpie në përzierje të shumta, keqkuptime dhe lënie pas dore të kuptimeve të teksteve, të bazuara në kuptimin e natyrës njerëzore dhe qëllimet e shariatit dhe bashkëveprim mes tyre. E gjithë kjo me qëllim të realizimit të jetës humane dhe efektive.

Medituesi i natyrës njerëzore dhe hulumtuesi i sekreteve të tij, po ashtu medituesi i diskursit penal në Islam, percepton realisht kuptimin, llojllojshmërinë dhe qëllimin e diskursit islam, përfshirë edhe diskursin penal. Kështu, diskursin islam e gjen diskurs sigurie dhe qetësie, e jo diskurs frike, të cilin e përdor pushteti për të frikësuar masën e thjeshtë dhe e përdorë si mjet për të ushtruar mbi ta pushtetin dhe për të formuar njerëz me psikologji të robërve. Nuk është i kotë përkujdesi i Islamit në diskurs për të siguruar drejtësinë dhe qetësinë në shpirtrat e njerëzve.

Nuk është e kotë atë që e kushtëzon ky sistem rreth dëshmime në veprën penale për amoralitet dhe dënimi i dështimit në vërtetimin e amoralitetit. Ngase dënimi në krimin e amoralitetit, në realitet është dënim për publikimin e krimit më shumë se sa për vetë krimin. Çështja e saj është si të gjitha çështjet tjera të ngjashme me te. Kjo çështje në fund kthehet te edukata dhe ndërjegjja, në të kundërtën me krimet e vrasjeve dhe mallrave, të cilat synojnë veprimin dhe pengimin e tij, ndjekjen e kriminelëve, me qëllim të mbrojtjes së njerëzve nga armiqësitë dhe krimet e tyre.⁸⁵

⁸⁵ Abdulhamid Ebu Sulejman, "El-Emnu ve's-selam'ul-ixhtimaijju hedefu nidham'il-ukubat'il-islamiji: teemlulat fi netaixhi dirasetin ixhtimaijjetin liseken'it-tullab'il-xhamijine", mexhel-letu islamijjet'ur-

Mungesa e të menduarit dhe hulumtimit shkencor të kontrolluar në ligjet natyrore, gjendjen reale dhe ndodhitë, ka shpjer në përzierjen e ligjërit. Po ashtu ka shpjer në moskujdesin e diskursit drejtuar fëmijërisë dhe mosperceptimin e dimensioneve pedagogjike. Kjo nënkupton tejkalimin e periudhës fëmijërore, moskuptimin e saj dhe natyrës së saj, zhvillimin e periudhave dhe njohjen e rolit të saj në përgatitje dhe ndryshim. Nga kjo lind edhe moskuptimi i metodologjisë pejgamberike dhe diskursin e tij në përkujdesje ndaj të drejtave të fëmijës, metodologjinë e edukimit, llojin e diskursit dhe domethëniet e këtij ligjërimi.

Diskursi i frikës psikologjike, i cili dominoi në mendimin e umetit, arriti deri në atë nivel saqë pothuaj nuk la gjë në mendjen e umetit pos diskursit të dënimit dhe frikësimit të fëmijës. Gjithë këtë qëndrim e arsyeton përmes një teksti, i cili edhe nëse është i saktë, mund të përdoret vetëm për ndonjë rast të jashtëzakonshëm. Prej këtyre argumenteve kemi rastin kur përgjegjësi i fëmijës dhjetëvjeçar, mund të detyrohet që këtë fëmijë, në rast se ai këmbëngulë - edhe krahas përpjekjeve të familjes duke e nxitur - të mos e falë namazin, bazuar në hadithin e Muhamedit alejh'is-selam, në të cilin thotë: "Mësoni fëmijët tuaj të falin namazin në moshën shtatëvjeçare dhe rrihni ato nëse nuk falen në moshën dhjetëvjeçare".⁸⁶ Në realitet, hadithi sqaron se ndalohet ndëshkimi i tij fizikisht, sado që çështja të jetë e rëndësishme, para se të dallon çështjet dhe të kupton dimensionet e përgjegjësisë, respektivisht të arrijë moshën dhjetëvjeçare. Natyrisht se kjo rrahje vjen pas harxhimit të të gjitha mjeteve të mundshme pedagogjike dhe është rrahje që nuk dëmton, me qëllim frikësimi dhe për të kuptuar se çështja është serioze dhe e rëndësishme. Me siguri se nëse përdoren të

ma'rifë, nr. 14, 1998, fq. 167.; Abdulhamid Ebu Sulejman, *El-Islah'ul-islam'il-muasir*, Kajro: Dar'us-selami, 1427 h./2006.

⁸⁶ Tirmidhi, El-Xhami'us-Sahih "*Sunen'ut-Tirmidhi*", vepër e cituar, vëll. 2, fq. 259, hadithi nr. 407.

gjitha mjetet pedagogjike me metoda të shëndosha, rrallë herë mund të ndjehet nevoja për të përdorur rrahjen.

Nën hijen e këtij teksti të veçantë - në rast të pranimit si të saktë - dhe në këtë gjendje të veçantë dhe në frymën e diskursit frikësues, koncepti i dënimit është shfrytëzuar si mjet bazik dhe i përgjithshëm për edukim, mjet që dominon në konceptin e umetit ndaj fëmijërisë, minimizimin dhe anashkalimin e kësaj çështje dhe frikësimi i fëmijëve të njomë, duke i frikësuar me dënime, me qëllim që të bëhet një hyrje e përgjithshme ndaj një koncepti steril të njohurisë. Gjithashtu, përmes këtij teksti është anashkaluar një e vërtetë e madhe nga periudha e shpalljes. Kjo e vërtetë është se Muhamedi alejh'is-selam, i cili ishte babë, gjysh dhe edukator i suksesshëm, asnjëherë nuk ka rrahur asnjë fëmijë në jetën e tij. Ai ishte i dashur, i mëshirshëm dhe i durueshëm gjatë bashkëveprimit me fëmijët. Kujdesej për gjendjen e tyre, interesohej për nevojat e tyre, kuptonte natyrën dhe aftësitë e tyre, si dhe kuptonte periudhat përmes së cilave kalonin dhe u fliste sipas përgatitjes së tyre psiko-fizike.⁸⁷

⁸⁷ Transmeton Buhariu nga Enesi radjallahu anhu se ka thënë: Muhamedi alejh'is-selam ishte njeriu më i moralshëm. Kisha një vëlla që quhej Ebu Umejr. Kur vinte te ne Muhamedi alejh'is-selam i thoshte: O Ebu Umejr, ç'bëri Nugejri. (Nugejri lodër me të cilin luante fëmija). Ndodhte që Muhamedi alejh'is-selam të ishte me ne dhe vinte koha e namazit. Urdhëronte pastrimin e shtrojës që kishim dhe më pas ngriheshim dhe faleshim bashkë. Shih: El-Buhari, *Sahih'ul-Buhari*, vepër e cituar, vëll. 5, fq. 2291, hadithi nr. 5850.

Transmeton Ahmedi në Musnedin e tij nga Abdullah ibn El-Harith i cili ka thënë: Muhamedi alejh'is-selam përshkruante Abdullahun, Ubejdullahun dhe shumë prej Beni Abasëve, mandej thoshte: Kush arrin i pari tek unë do t'i jap këtë dhe këtë. Tha: Ata garonin mes vete dhe binin ne shpinën dhe gjoksin a tij. I puthte ata dhe i përkëdhelte. Shih: Esh-Shejbani, Ahmed ibn Hanbel, *Musned'ul-imam Ahmed ibn Hanbel*, Recensim: Shuajb El-Arnaut, Bejrut: Mueseset'ur-Risale, botim 20, 1420 h./ 1999, vëll. 3, fq. 335, hadithi nr. 1836.

Transmeton Ahmedi në Musnedin e tij se Rafi ibn Amr El-Gifari ka thënë: Isha i vogël dhe gjuaja hurmat e ensarëve me gurë. Erdhi Muhamedi alejh'is-selam dhe i thani se këtu është një fëmijë që i ruan hurmat. Më çuan te Muhamedi alejh'is-selam dhe tha: O djalosh, për çka po i gjuan hurmat? I thashë: Për të zotngrenë. Tha: mos i gjuan hurmat dhe ha nga ajo që bie në tokë. Më pas ledhatoi kokën time dhe tha: O Zot ngre barkun e tij". Shih: Esh-Shejbani, Ahmed ibn Hanbel, *Musned'ul-imam Ahmed ibn Hanbel*, Recensim: Shuajb El-Arnaut, Bejrut: Mueseset'ur-Risale, botim 20, 1420 h./ 1999, vëll. 33, fq. 452, hadithi nr. 20343.

Transmeton Tirmidhiu në Sunenin e tij nga Enesi se ka thënë: Kam shërbyer Muhamedin alejh'is-selam dhjetë vite. Asnjëherë nuk më ka thënë of, e as për ndonjë gjë që e kam bërë, nuk ka thënë pse e ke bërë, e as për ndonjë gjë që e kam lënë, pse nuk e ke bërë. Muhamedi alejh'is-selam ishte njeriu më i moral-

Islami nuk ka synuar frikësimin e njerëzve dhe formimin e “njerëzve të robëruar”. Po ashtu, me anë të dënimeve nuk synohet frikësimi i njerëzve dhe çrrënjësia e gabimeve të tyre, por dënimet janë faktor i rëndësishëm për të mbështetur ndjenjën e popullatës se janë të sigurt, përkujdesi për ta dhe mbrojtja e të drejtave të tyre, mbështetja e fuqive pozitive të ta dhe largimi nga e keqja dhe krimi. Në esencë, zbatimi i dënimit nuk realizohet nëse çështja është e dyshimtë, sepse qëllimi i dënimit është luftimi i krimit, e jo vetë dënimi. Për këtë në islam ka nxitje për falje nga hakmarrja, përderisa falja kryhet me vetëdëshirë dhe nuk ka frikë nga hakmarrja. Në historinë e gjyqit gjatë periudhës së shpalljes dhe halifëve të drejtë ka argument dhe dëshmi për këtë çështje. Po ashtu pranohet pendimi i vjedhësit nëse heq dorë nga vjedhja. Në rast të çrregullimeve në tokë (el ifsad) mund që në vend të syrgjynosjes, të dënohet me burg dhe kështu mbetet i burgosur deri sa të sigurohen nga shërr i tij.

3.3.6. Diskursi peygamberik pedagogjik si model

Le të shohim se si ka vepruar Muhamedi alejh’is-selam me nipin e tij, Husejn ibn Aliun radijallahu anhuma, deri sa ishte në këmbë duke falur namazin në xhami me xhematë. Fëmija kishte hipur mbi shpinën e gjyshit të tij, Muhamedit alejh’is-selam, derisa ishte në sexhde. Muhamedi alejh’is-selam, e la për disa çaste dhe më pas e zbriti para se të ngrihej nga sexhdeja. Kur e pyetën sahabët se pse e kishte zgjatur sexhden? Ai ishte përgjigjur në një mënyrë pedagogjike dhe me fjalë shumë të shkurtra, duke thënë: “Djali im kishte hipur mbi shpinën time dhe desha të mos e largoj deri sa

shëm. Shih: Tirmidhij, El-Xhami’us-Sahih “Sunen’ut-Tirmidhij”, vepër e cituar, vëll. 4, fq. 368, hadithi nr. 2015; Esh-Shejbani, Ahmed ibn Hanbel, *Musned’ul-Imam Ahmed ibn Hanbel*, Recensim: Shuajb El-Arnaut, Beirut: Muesseset’ur-Risale, botim 20, 1420 h./ 1999, vëll. 21, fq. 521, hadithi nr. 13675.

të plotëson nevojën e tij”.⁸⁸ Ndërsa grupi i izolimit dhe anashkalimit të fëmijërisë nga kjo ngjarje kuptojnë vetëm anën sipërfaqësore, e cila kufizohet në dashurinë e Muhamedit alejh’is-selam ndaj fëmijëve, ngase ndjenjat e dashurisë së Muhamedit alejh’is-selam ndaj nipit të tij nuk e arsyetojnë zgjatjen e sexhdes, pa marrë parasysh në konsideratë njerëzit që kishte prapa.

Gjithë atë që e mbanë mend fëmija nga kjo ngjarje, është momenti kur gjyshi i tij i dashur është ulur në tokë, Ai ka shfrytëzua këtë rast dhe ka hipur mbi shpinën e tij për argëtim dhe lojë. Këtu shihet urtësia e Muhamedit alejh’is-selam në perceptimin e botës fëmijërore dhe metodat e bashkëveprimit me te. Është një rast praktik ku Muhamedi alejis selam i mësoi shokët e tij. Ai nuk shpejtoi për ta zbritur fëmijën nga shpina në tokë, ngase fëmija në këtë rast do të kuptonte vetëm momentin kur gjyshi i tij e ka përzënë, sidomos kur është në gjendje që nuk mund të flasë.

Kur sahabiu El Ekreu ibn Habis pa Muhamedin alejh’is-selam duke e puthur nipin e tij Hasanin radijallahu ahu i tha: Unë nuk kam puthur asnjë nga dhjetë fëmijët e mi! Atëherë, Muhamedi alejh’is-selam i tha: “Kush nuk mëshiron, nuk mëshirohet”.⁸⁹ Mund të kuptohet këtu se për qëllim është vetëm mëshira e Allahut. Mirëpo, në aspektin psikologjik-pedagogjik mund të kuptohet se vrazhdësia ndaj fëmijës në fëmijërinë e tij do të kthehet me vrazhdësi kur ai të plakët. Po ashtu duhet kuptuar se sëmundjet psikologjike trashëgohen nëpër gjenerata për shkak të injorancës dhe vrazhdësisë.

Le të dëgjojmë me vëmendje se si Muhamedi alejh’is-selam iu drejtua djalit të axhës së tij, Abdullah ibn Abbasit,

⁸⁸ En-Nesaiu, Ahmed ibn Shuajb, *El-Muxhteba mine’s-sunen*, Recenzent: Abdulfettah Ebu Guddeh, Alep: Mekteb’ul-metbuat’il-islamijeh, 1406 h./1986, vëll. 2, fq. 229, hadithi nr. 1141.

⁸⁹ El-Buhari, *Sahih’ul-Buhari*, vepër e cituar, vëll. 5, fq. 2235, hadithi nr. 5651.

duke i thënë: “O djalosh! Unë do të mësoj disa fjalë: Ruaje Allahun, Allahu do të ruan ty; ruaje Allahun, do ta gjesh Atë përballë; kur të kërkosh, kërko prej Allahut; kur të kërkosh ndihmë, kërko prej Allahut. Dije se po që se e tërë njerëzia të bashkohen për të të sjellë ndonjë dobi, nuk do të mundnin ta bënin atë, përpos nëse Allahu e ka shkruar. Dije se po që se e tërë njerëzia të bashkoheshin për të bërë ndonjë dëm, nuk do të mundnin ta bënin, përpos nëse Allahu e ka shkruar. Janë ngritur lapsat dhe janë tharë fletushkat”.⁹⁰

Çka gjejmë në këtë formë të komunikimit? Aty gjejmë dy çështje elementare pedagogjike, të cilat llogariten tulla të edukimit të shëndoshë për njeriun e lirë, besimtar, i përgatitur për hajr dhe mirësi. Këto dy çështje janë: e para, ngritja e raportit të dashurisë dhe mbështetjes psikologjike mes djaloshit dhe Zotit të tij, i Cili e ushqen atë, e ruan dhe kujdeset për të. E dyta, zhvillimi i shpirtit të trimërisë dhe guximit, bazuar në ndjenjën e zemrës, bindjen e mendjes, përgjegjësinë e ndërgjegjes dhe iniciativën e mëkëmbësisë (el-istihlaf) “edhe nëse të japin fetva për te njerëzit”.⁹¹

Diskursi pejgamberik është diskurs pedagogjik për fëmijën. Aty vërehet dashuria dhe respekti ndaj të vegjëlve. Për këtë, Muhamedi alejh’is-selam, sa herë që kalonte pranë të vegjëlve, i përshëndeste ata me selam.⁹² Të rriturit e pjekur prej meshkujve dhe femrave janë ata të njëjtit, të cilët në vegjëli kanë gëzuar respekt, vlerësim dhe vetëbesim. Nëse dëshiron të shohësh të rritur fisnik, atëherë eduko të voglin

⁹⁰ Tirmidhij, El-Xhami’us-Sahih “Sunen’ut- Tirmidhij”, vepër e cituar, vëll. 4, fq. 667, hadithi nr. 2516.

⁹¹ Transmeton Imam Ahmed i me sende nga Vabise ibn Ma’bed sahabij i Muhamedit alejh’is-selam se ka thënë: Erdha te Muhamedi alejh’is-selam për ta pyetur për të mirën (el-birru) dhe të keqen (el-ithmu). Më tha: Ke ardhur të pyesësh për të mirën dhe të keqen? Thash: Pasha Atë që të ka dërguar me besim të drejtë, nuk kam ardhur për të pyetur për diçka tjetër! Tha: E mira (el-birru) është ajo për të cilën qetësohet gjoksi yt, ndërsa e keqja (el-ithmu) është ajo e cila të ngacmon në gjoks, edhe nëse të japin fetva për te njerëzit”. Shih: Esh-Shejbbani, Ahmed ibn Hanbel, *Musned’ul-Imam Ahmed ibn Hanbel*, vepër e cituar, vëll. 29, fq. 523, hadithi nr. 17999.

⁹² El-Kushajri, *Sahihu Muslim*, vepër e cituar, vëll. 4, fq. 1929, hadithi nr. 2482.

të rritet me cilësitë e dinjitetit, respektit, vlerësimit dhe vetëbesimit.

Kjo është natyra e diskursit dhe komunikimit pejgamberik dhe pedagogjik lidhur me fëmijët. Aty ftohet për shfaqjen e kujdesit, dashurisë dhe mëshirës me të vegjlit. Bile kujdesi i Muhamedit alejh'is-selam me çështjet e fëmijës fillon para se të lindë ai. Kjo realizohet duke bërë përzgjedhjen e prindërve të tij që do të merren me edukimin e tij. "Martoni të mirët (salihin) prej meshkujve dhe femrave."⁹³ "Zgjidhni për fëmijët tuaj dhe martoni ekuivalentet ...".⁹⁴ "Martohuni me femra të dashura dhe që lindin".⁹⁵

Muslimanët kanë humbur këtë formë të diskursit dhe komunikimit pejgamberik dhe pedagogjik në raport me fëmijën. Në vend të tij përdorën formën e nënçmimit, imponimit dhe frikës. Nuk kanë studiuar periudhën fëmijërore dhe zhvillimin e fëmijës për të parë rritjen e fuqive dhe energjive psikologjike dhe fizike tek ai. Nuk i kanë shfrytëzuar këto fuqi për të realizuar ndryshimin dhe rikthimin e energjisë. Kështu u poshtëruan popujt, u fikën energjitë e fshehura dhe sollën fiset, të huajt dhe armiqtë për t'i mbrojtur ata dhe shtetet e tyre. Shtypën popujt e vetë dhe bënë veten dhe të tjerët - në fund të fundit - viktimë të armës së ushtrive dhe të poshtëruar para armiqve.

⁹³ Ed-Daremi, Abdullah ibn Abdurrahman, *Sunen'ud-Darimi*, Recenzent: Fevaz Zemreli & Halid Es-Sebe', Bejrut: Dar'ul-Kitab'il-Arabi, bot. 10, 1407 h., hadithi nr. 2086.

⁹⁴ El-Kazvini, Muhamed ibn Jezid, *Sunenu ibni Maxheh*, Recenzent: Muhamed Fuad Abdulbaki, Bejrut: Dar'ul-Fikr, (pa vit botimi) vëll. 1, fq. 633, hadithi nr. 1968.

⁹⁵ Es-Sexhestani, *Sunenu Ebi Davud*, vepra e cituar, vëll. 1, fq. 625, hadithi nr. 2050.

KAPITULLI I KATËRT

Zgjidhja bazike: Formimi i fëmijërisë

Më parë theksuam se për çështje madhore është patjetër të ketë më shumë faktorë efektiv dhe për probleme të mëdha është patjetër që përpjekjet të jenë të llojllojshme. Në të gjitha rrethanat, duhet kuptuar se pesha dhe prioriteti i çdo faktori dhe çdo përpjekje, varet nga natyra e rastit, nga rrethanat e problemit, sfida dhe çështjet që ndërlidhen me te. Për këtë, ajo që ofron ky hulumtim, përfshirë vizionin dhe zgjidhjen për aktivizimin e projektit reformues islam, nuk zhvlerëson rëndësinë e faktorëve tjerë të shumtë dhe ndikues në krizën e umetit dhe mangësinë e performan-save, as nuk zhvlerëson rëndësinë e përpjekjeve për punë dhe reformim në fronte të ndryshme, përfshirë ato politike, ekonomike, shoqërore, thirrëse dhe mbrojtëse. Me këtë hulumtim synohet përplotësimi i mjeteve njohëse, intelektuale, kulturore dhe pedagogjike, derisa të mbrapsen sulmet. Në të njëjtën kohë, me gjithë energjinë dhe guximin e mundshëm, sado që çështja të jetë e rëndë dhe e hidhur, të bashkëveprohet me të gjithë faktorët që ndikojnë në rastin konkret, të bashkohen të gjitha përpjekjet e nevojshme për realizimin e suksesit në zgjidhjen e krizës, rikthimin e energjisë së umetit dhe rolin e tij prioritar. Faktorin të cilin e synon ky hulumtim dhe me një rëndësi të veçantë është fëmijëria, e cila ka qenë dhe akoma mbetet dimensionin i humbur në mendimin islam, i cili ka penguar aktivizimin e projektit reformues të umetit dhe lëvizjen e energjisë së ndryshimit në te.

Ndarja mes elitës intelektuale dhe politike ka rezultuar mbizotërimin e mendimit tekstual dhe teorik, i cili nga ana e tij ka rezultuar sofizëm shkollor në “kulturën e veçantë”,

përfaqësim mitologjik në “kulturën e masës së thjeshtë”, tekstualitet dhe nxënie përmendësh në “programet mësimore”, autoritet dhe pushtet mbizotërues në “metodologjinë e edukimit”, autokraci, shkapërderdhje dhe fuqi në “marrjen e pushtetit”, përçarje dhe konflikte në “raportet shoqërore”, rënie në “performancat e individit dhe shoqërisë” dhe shkatërrim në civilizim dhe ndërtimtari.

4.1. Rruga e reformave dhe përballimi i sfidave

Edhe pse kriza e umetit në esencë ishte krizë politike dhe shoqërore, e lindur nga konfliktet ideologjike dhe fraksioniste, megjithatë është shndërruar në krizë ideologjike, kulturore dhe civilizuese që ka deformuar vizionin dhe kulturën dhe ka fikur mendimin. Më pas, kjo ka kaluar në katastrofë kur është shndërruar në krizë psikologjike dhe pedagogjike që sa vjen e thellohej dhe trashëgohej. E gjithë kjo, e bënte umetin të pamundshëm për reforma dhe ripërtëritje, si dhe rikthimin e iniciativës dhe fuqisë për përballimin e sfidave.

Nëse dëshirojmë zgjidhjen e krizës, realizimin e reformave dhe aftësinë e umetit për të tejkaluar pengesat dhe për të përballuar sfidat, atëherë është e domosdoshme të studiojmë dhe të hulumtojmë. Të zbërthejmë dhe analizojmë, me qëllim që të mësojmë esencën e sfidave. Të mësojmë mangësitë e performansave me të cilat ballafaqohet umeti, me qëllim që të mësojmë format e ndryshimit dhe reformave të nevojshme. E gjithë kjo, me qëllim që umeti të jetë në gjendje të përballon sfidat, të rikthen fuqinë për përpikëri në performansa, të mundëson që feja e tevhidit, mëkëmbjes, drejtësisë, punës, solidaritetit, sigurisë dhe paqes të luajnë rolin e tyre në vlerësim e civilizimit njerëzor.

4.1.1. Sfidat

Me qëllim që përpjekjet të jenë efektive dhe reformat prodhuese, që në fillim duhet të dimë realitetin e sfidave të mëdha, me të cilat ballafaqohet mendja e muslimanit dhe umeti islam në përgjithësi. E gjithë kjo me qëllim që të jetë një udhërrëfyes dhe orientues për ndryshim dhe reformim, dhe rezultatet të jenë reale dhe praktike.

Sfida më e madhe me të cilën ballafaqohet Bota Islame sot dhe të cilën duhet luftuar dhe neutralizuar, është sfida e “fuqisë shkencore teknologjike”. Kjo sfidë ka nënshtruar popujt e Botës Islame. Luftimi i kësaj sfide është kusht për sukses në çdo çështje tjetër. Me siguri se mjetet e “globalizimit”⁹⁶ kanë shumëfishuar fuqinë e të huajve - falë mundësive shkencore dhe teknologjike - për të realizuar kontrollin dhe për të shfrytëzuar pasurinë e umetit, për të anashkaluar rolin dhe kulturën e tij, si dhe për të përçarë unitetin e tij.

Posedimi i “fuqisë shkencore teknologjike” nuk realizohet me importimin e mjeteve dhe pajisjeve, e as me grumbullimin e të rinjve në dhomat e mësimin, por ajo realizohet me zhvillimin e mendjes shkencore dhe zhvillimin e fuqisë psikologjike dhe kreative. Kemi importuar të gjitha mjetet dhe pajisjet, por rezultati ishte vetëm rritja e konsumimit tek umeti, harxhime të tepërta, rritja e teknikëve nëpër zyra etj. E gjithë kjo për arsye se problematika në esencë është ideologjike, kulturore dhe pedagogjike, para se të jetë çështje materiale sasiore.

Çdo popull, i cili dëshiron të posedon fuqi shkencore dhe teknologjike, patjetër që paraprakisht duhet të posedon

⁹⁶ Duhet bërë dallimin mes ndërkombëtarizmit (el-alemije) dhe globalizmit (el-avlemeh). Ndërkombëtarizmi sipas mendimit tonë dhe për nga struktura gjuhësore nënkupton mundësitë dhe mjetet shkencore të cilët i mundësojnë njeriut komunikim, njohje, shkëmbim dhe bashkëpunim. Ndërsa, globalizmi është term që synohet ajo që po ndodhë sot, d.m.th. shfrytëzimi i mundësive dhe mjeteve shkencore nga ana e fuqive të mëdha dhe kolonizuese ndaj popujve të dobët, me qëllim të nënçmimit dhe sundimit ndaj pasurive të tyre.

mendime njerëzore, shoqërore të gjalla dhe shkenca shoqërore humane të gjalla. Krahas kësaj, duhet të posedon metodologji shkencore sipas ligjeve natyrore që ngrihet mbi përpjekjet njerëzore dhe mbështetet në udhëzimin e çështjeve konstante të imanit, mbi bazën etike të tevhidit, vlerat e drejtësisë, solidaritetit dhe paqes, e jo vetëm të ketë dertin e rritjes së sasisë së armatimit shkatërrues. Që të mundet umeti të përballon sfidën e “shkencës dhe teknikës”, nevojitet patjetër përballimi i problematikave kulturore dhe pedagogjike, me qëllim që të mund të plotëson kushtet e nevojshme metodologjike dhe pedagogjike për të pasur sukses në posedimin e fuqisë shkencore dhe teknike.

4.2. Problematika kulturore: Përfundimi i konflikteve iluzore dhe përmirësimi i koncepteve

4.2.1. Islami është fe e mendjes, bindjes dhe shkencës

Problemi i parë në këtë çështje është problemi kulturor. Është patjetër pengimi i deformimeve dhe mënyrave të dobësimit që depërtojnë në brendinë e mentalitetit shkencor, ngatërrojnë programet e ligjeve natyrore dhe dobësojnë energjinë mendore.

Shpallja hyjnore iu ka drejtuar mendjes, ndërgjegjes dhe emocioneve, duke përdorur metodën e bindjes shkencore. Ka luftuar rrugën e paditurisë, injorancës dhe imitimit të verbër. Komunikimi sipas shpalljes, është çështje që në te ka parashtrim të pyetjeve dhe polemizim. Sahabët kanë besuar në te pasi e kanë kuptuar dhe janë dorëzuar pas bindjes. Jo besim i shkaktuar nga frika, e as dorëzim nga trishtimi. Ata ishin të udhëzuar punëtor dhe luftëtarë të fuqishëm.

Respektimi i mendjes së njeriut dhe respektimi i bindjes së ndërgjegjes së tij ishin bazamenti i fortë mbi të cilën u

ngrit periudha e shpalljes. Ndërsa, lirimi i njeriut dhe ndërgjegjes së tij ishin synim i Islamit dhe çlirimeve islame. Allahu thotë:

وَقُلِ الْحَقُّ مِنْ رَبِّكُمْ فَمَنْ شَاءَ فَلْيُؤْمِنْ وَمَنْ شَاءَ فَلْيُكْفُرْ

*“E ti thuaaj: “E vërteta është nga Zoti juaj, e kush të dojë, le të besojë, e kush të dojë, le të mohojë”.*⁹⁷

وَمَا لَكُمْ لَا تُقَاتِلُونَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَالْمُسْتَضْعَفِينَ مِنَ الرِّجَالِ وَالنِّسَاءِ
وَالْوِلْدَانِ الَّذِينَ يَقُولُونَ رَبَّنَا أَخْرِجْنَا مِنْ هَذِهِ الْقَرْيَةِ الظَّالِمِ أَهْلُهَا وَاجْعَل لَنَا
مِنْ لَدُنكَ وَلِيًّا وَاجْعَل لَنَا مِنْ لَدُنكَ نَصِيرًا

*“Ç’keni që nuk luftoni për Zotin dhe për (t’i shpëtuar) të paaf-
tit: nga burrat, nga gratë e nga fëmijët, të cilët luten: “Zoti ynë!
nxirrna nga ky fshat (Meka), banorët e të cilit janë mizorë. Jepna
nga ana Jote shpëtim e ndihmë!”*⁹⁸

وَقَاتِلُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ الَّذِينَ يُقْتَلُونَكُمْ وَلَا تَعْتَدُوا إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ الْمُعْتَدِينَ

*“Dhe luftoni në rrugën e Allahut kundër atyre që ju sulmojnë
e mos e teproni se Allahu nuk i do ata që e teprojnë (e fillojnë
luftën)”.*⁹⁹

فَمَنْ أَعْتَدَىٰ عَلَيْكُمْ فَأَعْتَدُوا عَلَيْهِ بِمِثْلِ مَا أَعْتَدَىٰ عَلَيْكُمْ وَأَتَّقُوا اللَّهَ
وَأَعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ مَعَ الْمُتَّقِينَ

*“Pra, kush ju sulmon juve, kthenia sulmin atij edhe ju po në
atë masë dhe kini frikë nga Allahu e ta dini se Allahu është me të
devotshmit”.*¹⁰⁰

⁹⁷ El-Kehf: 29

⁹⁸ En-Nisa: 75

⁹⁹ El-Bekare: 190

¹⁰⁰ El-Bekare: 194

4.2.2. Dënimi i renegatit nuk ndërlihet as me besimin dhe as me bindjen

Në kohën e Muhamedi alejh'is-selam, askush nuk është frikësuar nga kërcënimi me vdekje për atë që bëhet renegat. Ishte kështu ngase ata kishin bindje se besimi nuk vjen, përpos nga bindja dhe se një besim i tillë është një nga bazamentet, intencat dhe pikënisjet e fesë. Jehudët që kishin bërë komplot me hyrjen e tyre sipërfaqësisht në islam dhe daljen nga ai, e kishin bërë me qëllim fitneje. Pra, çështja është çështje komploti dhe mashtrimi, e jo çështje besimi dhe bindje. Allahu thotë:

وَقَالَتْ طَّائِفَةٌ مِّنْ أَهْلِ الْكَتَابِ ءَامِنُوا بِالَّذِي أُنزِلَ عَلَى الَّذِينَ ءَامَنُوا وَجْهَ النَّهَارِ وَآكُفِّرُوا ءَاخِرَهُ لَعَلَّهُمْ يَرْجِعُونَ

*“Një grup nga ithtarët e librit thanë (të vetëve): “Besoni paradite në atë që u është shpallur atyre që besuan (muslimanëve), e pasdite mos e besoni, e ndoshta edhe ata (muslimanët), do të zbrapsen (nga besimi i tyre)”.*¹⁰¹

Kështu, ata kërcënimin e komplotistëve nuk e konsideronin si anulim të të drejtës së njeriut në bindje dhe besim. As nuk kanë detyruar as imponuar asnjërin nga ithtarët e librit dhe civilizimeve në besim dhe sistemin e jetës së tij. Këtë nuk e bënin vetëm nga ajo se e dinin se ai që beson me bindje nuk mund që në vend të fesë së tevhidit, mëkëmbësisë, përgjegjësisë dhe synimit të hajrit, të pranon përrallat e politeizmit dhe idhujtarisë, si dhe injorancën e ateizmit dhe mohimit, por nga bindje se ky mentalitet ka besuar në njeriun dhe të drejtën e tij për vetëvendosje.

Kjo që u tha më lartë, as në aspektin human, e as civilizues nuk vlen për gjendjen e fiseve idhujtare arabe, të cilët

¹⁰¹ Alu Imran: 72

kishin një sistem shoqëror primitiv.¹⁰² Veprimi me fiset arabe sipas parimit: “ose luftë, ose pranim të Islamit” duhet kuptuar si përpjekje me qëllim të nxjerrjes së tyre nga idhujtaria në shoqërinë e civilizimit, pjekurisë shoqërore dhe dinjitetit njerëzore, e jo mohim i të drejtës së njeriut në besim.

4.2.3. E vjetra dhe e reja në programin fetar dhe civil

Ky shembull na çon drejt problematikës së parcialitetit dhe sipërfaqësimit tekstual, dobësisë së kriterëve metodologjik në çështjet e prioriteteve, parimeve dhe pikënisjeve të ngjarjeve në kulturën e umetit, si dhe rolin e saj në deformimin e mentalitetit shkencor. Nëse kësaj problematike nuk u kundërvihet në mënyrë të plotë shkencore, dialogu intelektual do të mbetet steril dhe i pafrytshëm, do të ketë kundërshtime dhe mosmarrëveshje mes palës së kulturuar dhe mendimtarëve, tradicionalistëve dhe bashkëkohorëve, fetarëve dhe laikëve. Kështu umeti do të mbetet në komë dhe fundosje.

Shumë prej kuadrove fetare janë të ndikuar nga ndjenja e frikës nga rreziku për shkak të sulmit kulturor të huaj dhe të pamundësisë për ta përballuar atë. Për këtë, forma dominuese e komunikimit dhe diskursit është “frikësimi” dhe kundërsulm ndaj laicizmit, duke i cilësuar kundërshtarët si të dalë nga feja. Nga ana tjetër, mosbindja e laikëve me fjalët e fetarëve, me metodat e të menduarit dhe mënyrën e komunikimit të tyre, ka nxitur frikësimin dhe armiqësimin e komunikimit dhe diskursit laik, duke i cilësuar fetarët si njerëz injorant dhe të prapambetur, ngase nuk pranojnë orientimin e tyre në imitim të verbër ndaj të tjerëve.

¹⁰² Abdulhamid Ebu Sulejman, *En-Nadharijet'ul-islamijetu li'l-alakat'id-Devlijeti: ittixhahatun xhedidetun li'l-fikri ve'l-menhexhijet'il-islamijeti*, Rijad: Metabiu Firezdek et-Tixharijetu, fq. 202-211.

Kjo ndeshje mes tyre ka çuar në polarizim shkatërrues. E ka larguar laikun injorant nga njohja e fesë, identitetit dhe civilizimit, për të marrë qëndrim ndaj fesë dhe historisë mes armiqësisë dhe mosinteresit. Po ashtu, në të njëjtën kohë, ka larguar njeriun fetar nga arritja e civilizimit njerëzor në fushat e njohurisë, duke pasur frikë për fenë, trashëgiminë dhe historinë nga humbja dhe dorëzimi para shkençave dhe mendimeve të importuara nga jashtë. Kështu, umeti është paralizuar dhe është ndarë mes shkollës fetare sipërfaqësore tradicionale dhe përballë saj shkolla laike sipërfaqësore e huaj. Esenca e kundërshtimit mes tyre - në shumë aspekte - është ngritur mbi çështjen e frikës, pamundësisë dhe injorancës.

Është patjetër tërheqja e fitilit të frikës ideologjike gjatë komunikimit dhe diskursit nga mendimtarët dhe njohësit e të gjitha palëve. Po ashtu është patjetër largimi i injorancës nga palët kundërshtuese. Kjo është rruga për hapjen e dialogut rreth çështjeve dhe sfidave të umetit. Kështu, në vend të konfliktit do të vije bashkëpunimi për formimin e projektit civilizues islam për umetin. Projekt i cili ngritët mbi bazamentin e tevhidit, mëkëmbësisë, drejtësisë, solidaritetit dhe paqes, duke përdorur shkencën dhe mendjen, si dhe duke kryer punën me përpikëri dhe bamirësi. Të gjitha këto çështje janë vlera dhe parime madhore, kërkesa të çdo njeriu të sinqertë dhe synim më i lartë se çdo gjë tjetër.

Kërkesa e kuadrove laike, parimisht është arritja e fuqisë shkencore dhe ligjeve natyrore. Qëndrimi i kuadrit fetar islam, në realitet nuk kundërshtohet me këtë kërkesë. Në anën tjetër, kërkesa e kuadrit fetar islam, parimisht është udhëzimi në vlerat e larta islame. Qëndrimi i kuadrit laik nuk kundërshtohet me këto synime dhe qëllime të larta. Problemi vjen, kur të dy palët fillojnë dialogun pa baza metodologjike, nga pikënisje dhe perceptime ideologjike të

deformuara që nuk formojnë bazë të shëndoshë për kuptim të përbashkët dhe dialog efektiv.

Fillimisht duhet përgatitur kushtet për dialog. Më pas marrëveshja për çështjet konstante dhe të padiskutueshme, për qëllimet dhe synimet. Prezantimi i problemeve elementare të secilit grup, që lejon këmbim mendimesh dhe këmbim të informacioneve rreth çështjeve diskutabile. Gjetja e zgjidhjeve të përshtatshme për trajtimin e problemeve. E gjithë kjo mundëson krijimin e kushteve dhe qëllimeve të përbashkëta të cilat ngrihen mbi çështjet konstante dhe qëllimet e përbashkëta, duke pranuar me zemërgjerësi mendimin e tjetrit, vazhdimin e dialogut frytdhënës, në frymë bashkëpunimi dhe uniteti civilizues njerëzor.

Islamistët dhe laikët e kulturuar janë në pajtim rreth besimit në Allahun, i vetmi Krijues, në udhëzimin e shpalljes (vahjit), në intencat e tij rreth vlerave të drejtësisë, mirësisë, dinjitetit njerëzor, përgjegjësisë në punë. Po ashtu janë në pajtim rreth marrjes në konsideratë të ligjeve natyrore, obligueshmërisë së veprimit, përpikëria në punë dhe përgjegjësia e veprimit.

Janë të pajtimit se duhet poseduar fuqinë shkencore dhe teknologjike, shkaqet e fuqisë materiale dhe shpirtërore, domosdoshmëria e reformave dhe përmirësimit, nxitja e energjisë së fshehur të umetit dhe zbatimi i virtyteve morale.

Mirëpo, nëse palët nuk kanë përgatitur veten për dialog dhe komunikim mes vete, të bazuar në shkencë dhe njohuri që posedon secila palë, qoftë në fushën e fesë, trashëgimisë dhe historisë islame, apo në fushën e trashëgimisë njerëzore në shkencat shoqërore dhe metodat e hulumtimit shkencor, kjo marrëveshje do të mbetet vetëm ëndërr dhe shpresë.

Në realitet, umeti islam vuan nga një laicizëm i çuditshëm, në të cilën janë të barabartë laiku dhe fetari. Kjo vije

si rezultat i asaj se secila palë këmbëngulë në injorimin e tjetrit, arritjet, mendimet dhe fuqitë e tjetrit, gjë që shpie në dështimin e dialogut, thellimin e mosmarrëveshjeve mes tyre dhe mbyllja e derës së takimit. Kështu vdes ndërgjegjja e umetit dhe shuhet fuqia.

Le të fillojmë me përgatitjen e një gjenerate të re të dijetarëve dhe të kulturuarve, të cilët kanë njohuri rreth shpalljes dhe fesë, perceptojnë intencat dhe vlerat e fesë, mësojnë nga thesari i trashëgimisë, kanë njohuri rreth shkencave humane dhe shoqërore dhe njohin metodologjinë eksperimentale. Le të fillojnë dijetarët dhe të kulturuarit me përgatitjen e programeve për zgjerimin e rrethit të njohurive, posedimin e aftësive për dialog dhe bashkëpunim të frytshëm. Universitetet dhe qendrat për hulumtim shkencor le të paraqesin programe, të tregojnë burimet dhe të zhvillojnë lëndët e nevojshme për kulturën e muslimanit, përfshirë anët njohëse fetare dhe shkencat shoqërore. Në këtë sferë ka pasur përpjekje serioze, që ka bërë islamizimin e diturive dhe reformimin e programeve, çështje të vëna në tryezë, në skenën shkencore dhe kulturore të Botës Islame. Bazuar në këto çështje, kristalizohen çështjet e unifikimit të kulturës, synimeve, programeve dhe metodave për edukim të umetit. Këto përpjekje duhet mbështetur dhe zhvilluar.

Prej grupeve me mendime ndryshe, kërkohet që të ulen bashkë, të pajisur me njohuri rreth intencave dhe vlerave të fesë, si dhe energjisë shoqërore dhe natyrore. Duhet evituar shkaqet që pengojnë përpikërinë në veprim dhe fuqinë e shkencës dhe teknikës. Duhet mësuar se si të pastrohet kultura e umetit nga mitet, magjia dhe çështjet e pavërteta. Në fund, duhet mësuar se si duhet të pengohet përhapja e negativiteteve dhe dobësimi i dimensionit të përgjithshëm në formimin e personalitetit të bijve të umetit.

4.2.4. Interesat e laikëve dhe vërejtjet e tyre metodologjike

Prej çështjeve më të rëndësishme rreth së cilave kanë mendime të ndryshme islamistët tradicionalistë dhe laikët properëndimorë, pa ndonjë bazë të shëndoshë, janë çështjet si p.sh.: zbatimi i metodologjisë shkencore në shkencat natyrore nga ana e laikëve, a do të thotë detyrimisht mohim i çështjeve metafizike (el-gajb) dhe kujdesit të Allahut ndaj çështjeve të universit sipas urtësisë së Tij, në atë mënyrë që nuk mund ta kupton logjika dhe perceptimet e njeriut? Mbështetja në mendje dhe në çështjen shkak-pasojë, a nënkupton mohim të metafizikës (el-gajb) dhe gjërave që ndër lidhem me të si caktimi i Allahut në kontrollimin e çështjeve të universit? Kjo paqartësi gjendet tek të dyja palët:

a. Kur flasim islamistët rreth lutjes, mbështetjes në Allahun, dorëzimin tek Allahu, urtësinë e fshehtë të caktimit të Allahut në kontrollimin e çështjeve të krijesave, zakonisht sjellin argumente dhe tekste, të cilat i paraqesin në formë këshillash. Ato i prezantojnë të shkëputura nga tërësia dhe të ndara nga korniza njohëse dhe dimensionet kohore dhe vendore, pa u kujdesur fare për ligjet natyrore në krijesa. Mendimi i tyre në të shumtën e rasteve nuk ndërlidhet me fuqinë e veprimeve në shoqëri. Ky mendim për laikët është humbje e vetëdijes dhe ikje nga realiteti. Islamistët kur i drejtohen popullit dhe i nxisin për çështjet që duhet vepruar për të ndryshuar gjendjen e tyre dhe për t'i përballuar sfidat, kjo vije vetëm si shpërthim i frustrimeve, pa njohur fare realitetin e gjendjes së tyre dhe mundësinë e energjive të tyre. E gjithë kjo, edhe më shumë do të shton vështirësitë e tyre, do të shpartallon dhe do të humb përpjekjet e formimit dhe reformimit.

b. Kundërshtimet e laikëve properëndimor bien në veshët e islamistëve sikur të jetë mohim i shenjtërisë së fesë, mohim i teksteve fetare, mohim i metafizikës (alem'ul-gajb)

dhe fuqisë së Allahut dhe kujdesit të Tij në kontrollimin e çështjeve të krijesave.

Nëse palët në përgjithësi - nga këndvështrime të ndryshme - në realitet kanë pajtime në parime dhe pikënisje, të cilat besojnë në Allahun dhe ligjet e Tij dhe ftojnë për meditim dhe punë, siç thotë Muhamedi alejh'is-selam: „Të jesh i kujdesshëm në gjërat e dobishme, kërko ndihmën e Allahut dhe mos u bë i dobët“.¹⁰³ Si mund të ndodhë kjo përzierje edhe krahas ekzistimit të një sasive të përbashkët të çështjeve mes bijve të umetit, duke u nisur nga çështja se njëra palë nuk është në vetëdije, ndërsa pala tjetër ateiste dhe mohuese?!

Arsyeja e kësaj përzierje është se kuptimet e shumë prej çështjeve të qarta ne fe dhe ndodhive të përfituara nga periudha e shpalljes dhe periudha e halifëve të drejtë, kanë humbur në komentime sipërfaqësore. Transmetimet e ngjarjeve mbështeten në mënyrë të vazhdueshme në një numër të madh të transmetuesve. Kuptimi i tyre nga ana e tjerëve ishte në nivele të ndryshme gjatë dy shekujve. Dallimet në rajone, cilësi, si dhe luftërat dhe konfliktet e njëpasnjëshme dhe ndarjet e tyre në grupime, interesa dhe orientime, e gjithë kjo, çështjen e shënimeve, publikimeve dhe recensioneve e ka bërë prej çështjeve më të rënda.

Është e rëndësishme për dijetarët dhe të interesuarit me studimin e saktësisë dhe kredibilitetit të teksteve, të kuptojnë se çështja e hulumtimit të teksteve, sidomos teksteve të sunnetit, nuk është e kufizuar vetëm me specialistët në shkencën e transmetuesve (ilm'ul-rivaje), fikhut dhe ligjit. Këtyre u janë shtuar edhe dy grupe të njerëzve:

1. Masa e gjerë e umetit, e cila falë përhapjes së kulturess dhe vetëdijes për rrjedhat e jetës, lexojnë dhe kujdesen për shumë tekste dhe në forma të ndryshme.

¹⁰³ El-Kushejri, *Sahihu Muslim*, vepër e cituar, vëll. 4, fq. 2052, hadithi nr. 2664.

2. Grupi i profesionistëve në shkencë të ndryshme si ato materiale, humane dhe shoqërore, të cilët tekstet i trajtojnë të ndërlidhura me përvojat dhe aftësitë e tyre në ligjet natyrore. Kështu, kontrollimi i tekstit nga ana e tyre realizohet, duke u bazuar në bazamente shkencore dhe ligje natyrore, e jo vetëm në format e transmetimit të zinxhirit. Ata marrin parasysh përmbajtjen e tekstit (el-metnu), kuptimet e tij, lidhshmërinë e tij me çështjet bazë, rrethanat dhe zbulimin e çështjeve të fshehta të rrethanave, shkaqeve dhe çështjet e mundshme.

Interesimet e masës për çështjet e jetës dhe gjërat që ndikojnë në të si dhe interesi i dijetarëve të ligjeve natyrore për pastrimin e mendimit, duhet detyrimisht të respektohet dhe zhvillohet, e assesi të refuzohet, duke argumentuar se kanë specializim të ngushtë. Është kështu për arsye se fusha e hulumtimit shkencor dhe mjeteve të tij është zgjeruar dhe ka ndryshuar, si dhe shumë prej studiuesve fetarë nuk kanë njohuri të mjaftueshme rreth tij dhe mjeteve të tij.

4.2.5. Mundësitë bashkohore dhe metodologjike të përgjithshme në çështjet e kritikës ndaj tekstit (el-metnu) dhe zinxhirit (es-senedu)

Hadithet e transmetuara janë diku afër njëqindmijë. Shumë prej haditheve kanë transmetime të ndryshme, duke shtuar, hequr ose ndryshuar në fjalët e hadithit. Transmetimet mund të jenë kundërthënëse dhe nuk janë që të gjitha në të njëjtin nivel të besueshmërisë. Ka hadithe Sahih (të sakta) dhe Daif (të dobta), ndërsa disa të tjera Mevdu' (apokrifë). Ndodhë shpesh që kërkuesit e hadithit japin mendime të ndryshme rreth vlerësimit të një teksti dhe të një transmetimi, deri në atë shkallë, sa që shkakton habi dhe pikëpyetje rreth objektivitetit të metodologjisë, nevojës për rishikim në të dhe përfitimin nga mundësitë bashkëkohore shkencore në zhvillimin e tij.

Krahas kësaj, ka qindra mijëra hadithe të trilluara, të cilat janë refuzuar dhe nuk janë transmetuar. Derisa Imam Ahmedi në duart e tij ka pasur diku pesëqindmijë hadithe, që prej tyre nuk pranohen e as nuk transmetohen, përpos diku pesëdhjetëmijë hadithe. Shumë prej tyre llogariten si të dobëta. Kjo është një çështje e rëndësishme dhe e dhimbshme, e cila sqaron numrin e madh të transmetimeve të rrejshme, të cilat nuk merren në konsideratë.

Njohja e këtij realiteti, edhe pse nxjerr në dritë mundin të cilin e kanë përjetuar dhe vështirësitë me të cilat janë ballafaquar dijetarët e hadithit, në të njëjtën kohë sqaron gjendjen psikike dhe intelektuale, si dhe ashpërsinë e konflikteve dhe rrymave që kishin depërtuar në brendinë e umetit. Ata, përmes shprehjeve dhe shenjtërimit të teksteve, kishin gjetur mjetin reklamues për të mbështetur mendimet dhe qëndrimet e tyre, gjë që kishte lejuar falsifikimin, përdorimin e israilizmave dhe gënjeshtreve për qëllime akaidore dhe politike. Këto qëllime kishin shkaktuar transmetimin e këtij numri të madh të haditheve të rrejshme.

Po ashtu, është me rëndësi të dihet se pjesa dërmuese e haditheve të përcjella, përpos dhjetëra haditheve praktike, të cilat i kanë ndjekur umeti, nuk arrijnë shkallën e haditheve mutevatir që janë të sigurt dhe të saktë, dhe pamundësohet depërtimi i gabimit dhe gënjeshtres në to. Shumë prej haditheve nuk kuptohet lehtë se pse janë transmetuar në mënyrë "Ahad", edhe pse supozohet të jenë "Mutevatir", ngase flasin për çështje të përgjithshme, janë të rëndësishme dhe përfshijnë sfera të gjera. Disa prej haditheve janë kundërtënëse në shprehje dhe formë - edhe për të njëjtin transmetues - gjë që në shumë raste nuk e pranon mendja.

Ngurrimi i dijetarëve në periudhën e shpalljes nga transmetimi i hadithit dhe kujdesi për mospërhapjen e tij, ishte

për shkak se ata kishin kuptuar rrezikun e keqkuptimit të hadithit për shkak të mosnjohjes së njerëzve ndaj rrethanave kohore dhe vendore që ka shoqëruar ngjarjet, pa të cilat do të ishte vështirë njohja e qëllimit dhe kuptimit, në veçanti sqarimet e pakta të rrethanave kohore dhe vendore që ka shoqëruar transmetimin.

Ajo që ka shpjerë në shtimin a transmetimit të haditheve “Ahad” nga dijetarët e mëvonshëm, të saktë ose të dobët, krahas qëllimeve politike dhe akaidore gjithashtu është mendim i dobët dhe izolues. E gjithë kjo me qëllim që të mbulohet paaftësia e umetit me shenjtërimin e tekstit. Kjo dukuri është rritur në proporcion me pamundësinë e mendimit dhe hulumtimit, si dhe përvojën dhe eksperiencën e paktë. Sa më shumë të rritet pamundësia mendore dhe paaftësia për ixhtihad në përcjelljen e gjërave të ndryshueshme, rritet interesi për tekstin, gjë që jep hapësirë për imitim sipërfaqësor, derisa disa preferojnë të veprojnë me tekst “Daif” (të dobët) para veprimit me mendim dhe logjikë të shëndoshë.

Divergjencat që kanë lindur rreth shkrimit të hadithit - duke ndaluar ose lejuar - flasin për divergjenca në mendime rreth asaj se sa është i drejtë transmetimi i shumtë pa kuptuar mirë, për shkak të mosnjohjes së rrethanave vendore dhe kohore. A janë këto hadithe që ndërliidhen me komunikimin e shpalljes:

وَأَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ وَأَحْذَرُوا فَيَنْ تَوَلَّيْتُمْ فَأَعْلَمُوا أَنَّمَا عَلَى رَسُولِنَا
الْبَلَّغُ الْمُبِينُ

*“Bindjuni Allahut dhe bindjuni të dërguarit e kini kujdes (mos kundërshtoni). E nëse refuzoni, atëherë pra, dijeni se obligim i të dërguarit Tonë është vetëm komunikimi i qartë”.*¹⁰⁴

¹⁰⁴ El-Maide: 92.

Apo ndoshta këto hadithe dhe udhëzime ndërliidhen me rolin e Muhamedit alejh'is-selam në udhëheqje, menaxhimin e shtetit, arsimimit rreth çështjeve që ndërliidhen me shoqërinë, për të cilat bën ixhtihad, duke u bazuar në dritën e udhëzimeve të sheriatit:

يَتَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا أَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ وَأُولَى الْأَمْرِ مِنْكُمْ فَإِن تَنَزَعْتُمْ فِي شَيْءٍ فَرُدُّوهُ إِلَى اللَّهِ وَالرَّسُولِ إِن كُنتُمْ تُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ
ذَلِكَ خَيْرٌ وَأَحْسَنُ تَأْوِيلًا

*“O ju që besuat, bindjuni Allahut, respektoni të dërguarin dhe përgjegjësit nga ju. Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashtrojeni atë te Allahu (te libri i Tij) dhe te i dërguari, po qe se i besoni Allahut dhe ditës së fundit. Kjo është më e dobishmja dhe përfundimi më i mirë”.*¹⁰⁵

Apo nënshtirim ndaj ndonjë çështje të caktuar, të cilën nuk e ka treguar Kur’ani gjerësisht, por e ka sqaruar Muhamedi alejh'is-selam në mënyrë praktike, siç është rasti me namazin dhe zeqatin?

وَأَقِيمُوا الصَّلَاةَ وَءَاتُوا الزَّكَاةَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ

*“Falni rregullisht namazin, jepni zeqatin dhe respektoni të dërguarin në mënyrë që të mëshiroheni”.*¹⁰⁶

Namazi dhe zeqati janë dy kondita më të rëndësishme të fesë, të cilat Kur’ani nuk i ka sqaruar gjerësisht, në të kundërtën e agjërimit dhe haxhit të cilat Kur’ani në tekstin e tij i ka përfshirë gjerësisht. Për këtë, suneti pejgamberik, e në veçanti ai praktik, është burim kryesor rreth mënyrës së faljes së namazit dhe dhënies së zeqatit. Ndërsa sa i përket fjalëve dhe veprave të Muhamedit alejh'is-selam që ndërli-

¹⁰⁵ En-Nisa': 59.

¹⁰⁶ En-Nur: 56.

dhen me çështjet dhe kërkesat e jetës,¹⁰⁷ ato i sqaron ajeti: (إِنَّمَا أَنَا بَشَرٌ) “Vërtet unë nuk jam gjë tjetër pos njeri”.¹⁰⁸

Po ashtu, duhet të merret parasysh qëndrimi i halifëve të drejtë, sahabëve të mëdhenj dhe burrave të rreshtit të parë në lidhje me ata që kanë marrë guximin për transmetimin e fjalëve dhe udhëzimeve të Muhamedit alejh’is-selam, të cilat kanë përfshirë ngjarje në rrethana të caktuara, kujdesi për mbetjen e tyre në Medinë, me qëllim që t’u flasin vetëm atyre që kanë përjetuar këtë periudhë dhe kanë kuptuar rrethanat e transmetimit.

Po ashtu, duhet kuptuar edhe çështjet e përgjithshme që janë transmetuar nga vetë Muhamedi alejh’is-selam, në lidhje me ndalimin ose lejimin e shkrimit të hadithit dhe qëllimet që mund të përfitohen nga kjo çështje, për përbalimin e të metave dhe sfidave që kanë goditur umetin. Po ashtu keqpërdorimin e shumë njerëzve ndaj haditheve, për t’i shfrytëzuar si keqardhje ndaj trillimeve, miteve, epsheve dhe armiqësive; mjete për të shtypur ndërgjegjen e umetit, për të mbyllur mendjen e tij dhe për ta frikësuar ndërgjegjen; mjete për luftëra dhe konflikte, si dhe ndihmesë në duart e armikut.

Problemeve të transmetimit i shtohet edhe dobësia e kritikës ndaj tekstit (el-metnu), sepse kritika konstruktive buron nga aftësia shkencore dhe eksperiencia e kritikuesit me natyrën e përmbajtjes, gjë e cila u mungon shumë prej studiuesve në sferën e transmetimit. Studimet e tyre zakonisht përkufizohen rreth fjalëve, formave dhe rregullave të

¹⁰⁷ Transmeton Imam Muslimi me sened nga Rafi’ ibn Hadixh se ka thënë: Erdhi Muhamedi alejh’is-selam në Medinë në kohë kur medinasit shartonin hurmat. Ai tha: Ç’po bëni? Thanë: E bënim më parë. Tha: Ndoshta nëse nuk e bëni, do të jetë më mirë. Ata e lanë. Mirëpo, prodhimi u zvogëlu. Këtë ia treguan atij. Ai tha: Vërtet unë nuk jam gjë tjetër pos njeri. Nëse ju urdhëroj diçka nga feja, zbatoheni atë, po nëse ju urdhëroj diçka nga mendimi im, atëherë unë jam vetëm njeri”. El-Kushejri, *Sahih’ul-Muslim*, vepër e cituar, vëll. 4, fq. 1835, hadithi nr. 2362.

¹⁰⁸ Fussilet: 6.

mësuara përmendësh, deri në atë shkallë - për shkak të dobësisë në njohje dhe kritikë - saqë shohim se si nga një transmetues kemi dy transmetime kontradiktore, gjë e cila në shumë raste nuk përputhet me shpirtin e sheriatit, parimet e mendjes dhe vizionin e shëndoshë shkencor.

Dobësia e aftësisë në kritikë ka arritur deri në atë shkallë, saqë është lënë pas dore krahasimi i vërtetësisë së hadithit me Kur'anin, libër i shenjtë, përmbledhës dhe i transmetuar në mënyrë mutevatir. Allahu në lidhje me Kur'anin thotë:

مَا فَرَطْنَا فِي الْكِتَابِ مِنْ شَيْءٍ

*“Asgjë nuk kemi lënë pas dore nga evidence”.*¹⁰⁹

كِتَابٌ أَحْكَمْتُ آيَاتُهُ ثُمَّ فُصِّلَتْ مِنْ لَدُنْ حَكِيمٍ خَبِيرٍ

*“Libër, ajetet e të cilit janë radhitur (në mënyrë të përsosur, njëkohësisht) edhe shkoqitur nga i Dijshmi i të gjitha çështjeve në hollësi”.*¹¹⁰

وَلَقَدْ جِئْتَهُمْ بِكِتَابٍ فَصَّلْنَاهُ عَلَىٰ عِلْمٍ هُدًى وَرَحْمَةً لِّقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ

*“Ne u sollëm atyre (mekasve) një libër (Kur'anin) që ua shkoqitëm në baza të diturisë, e që është udhërrëfyes e mëshirë për ata që besojnë”.*¹¹¹

Kështu, në periudhën e përhapjes së mendimit të izoluar, u zbeh pozita e Kur'anit, i cili cilësohet me këshillime të përgjithshme që të jetë burim i të kuptuarit, këshillimit dhe udhëzimit, duke marrë parasysh ndryshimin e rrethanave, rasteve dhe kohëve. Në vend të saj janë përdorur shumë hadithe “ahad”, me dimensione të caktuara kohore dhe vendore, me qëllim të qetësisë së mendjes nga lodhja e

¹⁰⁹ El-Ena'm: 38.

¹¹⁰ Hud: 1.

¹¹¹ El-A'raf: 52.

hulumtimit dhe ixhtihadit dhe përballimit të çështjeve të ndryshueshme. Kjo shihet qartë, kur të krahasojmë numrin e vogël të haditheve, me të cilat kanë argumentuar imamët muxhtehidë, në krye të të cilëve ishte Ebu Hanife dhe numri i madh i haditheve, me të cilat flasin kërkuesit e vegjël të diturisë pa dituri, njohuri dhe kontrollim.

Shumë prej këtyre haditheve ishin prej çështjeve që vështirë mund të kontrollohen dhe të njihet realiteti i transmetuesve, të cilët nuk i kanë parë, e as nuk kanë jetuar në kohën e tyre kodifikuesit e hadithit. E gjithë që kanë transmetuar ata, është vetëm ajo që kanë dëgjuar në një kohë kur janë përhapur fraksionet, konfliktet dhe çrregullimet.

4.2.6. Shembuj nga kritika ndaj tekstit (el-metnu): metafizika (ilm'ul-gajbi) dhe ndotja e kulturës

Është e rëndësishme në këtë sferë të sjellim një shembull që tregon problematikat me të cilat ballafaqohet mendimi islam dhe kultura islame. Ne e dimë se muslimani vepron i mbështetur në Allahun. Është i fortë në besimin e tij dhe duke fituar me punën e tij. Nuk ka vend për magji, fall dhe asnjë formë prej formave të përfitimit pa mund. Megjithatë, vërejmë në Sahihu Muslim ku transmeton se Muavi ibn Hakem ka thënë: Thash: O i Dërguari i Allahut, ka pak kohë që kam braktisur xhahilijetin (inJORANCËN), në kohë që Allahu ka sjellë Islamin. Nga mesi jonë ka njerëz që shkojnë te fallxhorët. Tha: Mos shko tek ata. Thash: nga mesi jonë ka njerëz që parashikojnë çështjet e këqija. Tha: Kjo është një çështje që e gjejnë në gjokset e tyre dhe nuk i ndalon. Thash: Nga mesi jonë ka burra që shkruajnë vija në rërë. Tha: kishte një Pejgamber që shkruante vija në rërë".¹¹² Sipas këtij teksti,

¹¹² Salih, Menhelul aridin Sherhu Rijadis Salihin, Stamboll, (pa vit botimi), f. 914. Këtu gjendet kuptimi i fjalës "shkruante në rërë" duke thënë: shkrimi në rërë është i lejuar nëse është shkencë që përputhet me atë që është transmetuar në mënyrë të saktë nga pejgamberët, në veçanti Idrisi alejh'is-salam. Mirëpo,

sikur Muhamedi alejh'is-selam lejon “shkrimin në rërë” dhe çështjet që ndërlidhen me te se kinse zbulon të fshehtën (gajbin), gjë e cila bie ndesh me ajetet e qarta nga Kur’ani.

Nëse kjo është e saktë, atëherë çështja shkakton habi. Si është e mundur që Muhamedi alejh'is-selam, të cilit i zbret shpallja, mos t’ua mëson njerëzve formën e saktë të shkrimit në rërë me qëllim që të fitojnë. Sipas këtij hadithi, kuptohet se Muhamedi alejh'is-selam, me anë të kësaj forme të çuditshme që shpie në njohjen e të fshehtës (gajbit) duhet t’u sqaron të mos bien viktimë e keqpërdorimit të fallxhorëve dhe magjistarëve. Një hadith i tillë dhe me një kuptim të tillë nga një dijetar i shariatit dhe me pozitë të konsiderueshme fetare, ofron një mbështetje dhe hap një shteg për personat që kanë qëllime të caktuara.

Kur’ani famëlartë këtë çështje në mënyrë të qartë e ka sqaruar, duke thënë:

قُلْ لَا أَمْلِكُ لِنَفْسِي نَفْعًا وَلَا ضَرًّا إِلَّا مَا شَاءَ اللَّهُ وَلَوْ كُنْتُ أَعْلَمُ الْغَيْبِ لَاسْتَكْتَرْتُ مِنَ الْخَيْرِ وَمَا مَسْنِيَ السُّوءُ إِنْ أَنَا إِلَّا نَذِيرٌ وَبَشِيرٌ لِّقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ

“Thuaj: “Unë nuk kam në dorë për veten time as ndonjë dobi, as ndonjë dëm, pos çka do Allahu. Sikur ta dija të fshehtën, do t’i shumoja për vete të dobishmet, e nuk do të më prekte gjë e keqe. Unë nuk jam tjetër vetëm se qortues dhe përgëzues për njerëzit që besojnë”.¹¹³

عَلِمُ الْغَيْبِ فَلَا يُظْهِرُ عَلَىٰ غَيْبِهِ أَحَدًا إِلَّا مَنِ ارْتَضَىٰ مِنْ رَسُولٍ فَإِنَّهُ يَسْلُكُ مِنْ بَيْنِ يَدَيْهِ وَمِنْ خَلْفِهِ رَصَدًا

nëse është lloj falli, atëherë është e refuzuar. Mënyra e shkrimit në rërë është kështu: personi vendon në rërë tri vija, më pas hedhë në to ndonjë bërthamë dhe thotë kështu e kështu. Është e qartë se Muhamedi alejh'is-selam ndalon nga të gjitha format e fallit, mirëpo tolerimi me vënien e vijave në rërë ndërlidhet me veprimin e disa pejgamberëve si Idrisi alejh'is-selam.

¹¹³ EI-A’raf: 188

*“Ai është që e di të fshehtë, por fshehtësinë e vet nuk ia zbulon askujt. Me përjashtim të ndonjë të dërguari që Ai do. Atëbotë Ai vë roje para edhe prapa tij (kur i shpall fshehtësinë)”.*¹¹⁴

وَمَا كَانَ اللَّهُ لِيُظِلَّعَكُمْ عَلَى الْغَيْبِ وَلَكِنَّ اللَّهَ يَجْتَبِي مِنْ رُسُلِهِ مَنْ يَشَاءُ
فَقَامِنُوا بِاللَّهِ وَرُسُلِهِ وَإِنْ تُؤْمِنُوا وَتَتَّقُوا فَلَكُمْ أَجْرٌ عَظِيمٌ

*“Allahu nuk ju zbulon juve të fshehtat (e të dini se ç’mbajnë në zemrat e tyre). Por Allahu është Ai që nga të dërguarit e vet zgjedh atë që do (e i zbulon ndonjë të fshehtë). Prandaj, besoni Allahut dhe të dërguarit të Tij, e në i besofshit dhe nëse ruheni, atëherë ju keni një shpërblim të madh”.*¹¹⁵

Nuk dallon kjo shumë nga ajo që e ka transmetuar Buhariu dhe Muslimi nga Aisheja radijallahu anha, e cila ka thënë: pyetën disa njerëz Muhamedin alejh’is-selam rreth fallxhorëve. Ai tha: Nuk ka gjë prej tyre. Thanë: O i Dërguari i Allahut, ata ndonjë herë flasin dhe fjala e tyre del e drejtë. Tha: “Atë fjalë të drejtë që e thonë, e përvjedh xhini dhe e vë në veshin e bashkëpunëtorëve të tyre, të cilët më pas e përziejnë me njëqind gënjeshtër”. Në transmetimin e Buhariut nga Aisheja radijallahu anha se ka dëgjuar Muhamedin alejh’is-selam duke thënë: “Melaiket zbresin në re. Përmendin një çështje që është vendosur në qiell. Shejtani përvjedh atë dhe e dëgjon. Më pas ua tregon fallxhorëve, të cilët krahas asaj i shtojnë edhe njëqind gënjeshtër nga ana e tyre”.

Sipas këtij hadithi, fallxhorët dinë diçka nga e fshehta (gajbi), të cilën e dëgjojnë xhinët dhe shejtanët dhe më pas ua kumtojnë atyre. Ata më pas, krahas asaj që e dinë nga e fshehta, shtojnë sa të donë prej gënjeshtërave. Në ndërkohë, Kur’ani potencon në mënyrë të prerë se të fshehtë e di

¹¹⁴ El-Xhinn: 26-27

¹¹⁵ Alu Imran: 179.

vetëm Allahu. Ai tregon se gjendja ka ndryshuar, ngase përvjedhja e dëgjimit nga ana e xhinëve ka përfunduar me ardhjen e shpalljes së fundit dhe me arritjen e njeriut periudhën e pjekurisë dhe përgjegjësisë, përmes së cilës bartë emanetin e mëkëmbjes dhe menaxhimin e çështjeve të tij. Andaj nuk di të fshehtëm (gajbin) askush pos Allahut. Allahu thotë:

قُلْ أَوْحَىٰ إِلَيَّ أَنَّهُ اسْتَمَعَ نَفَرٌ مِّنَ الْجِنِّ فَقَالُوا إِنَّا سَمِعْنَا قُرْءَانًا عَجَبًا

*“Thuaj: “Mua më është shpallur se një grup i vogël nga xhinët i vuri veshin dhe dëgjoi (Kur’anin) dhe (kur u kthyen te të vetët) thanë: “Ne kemi dëgjuar një Kur’an që mahnit”.*¹¹⁶

وَأَنَّا كُنَّا نَقْعُدُ مِنْهَا مَقْعِدًا لِّلسَّمْعِ فَمَن يَسْمِعُ الْآنَ يَجِدْ لَهُ شِهَابًا رَّصَدًا وَأَنَّا لَا نَدْرِي أَشَرٌّ أُرِيدَ بِمَن فِي الْأَرْضِ أَمْ أَرَادَ بِهِمْ رَبُّهُمْ رَشَدًا

*“Dhe ne më parë hulumtonim në vendvështrimin për të dëgjuar, e kush përpiqet të dëgjojë tash, ai has në pusinë e shkëndijës së zjarrtë. Ne nuk e dimë se me këtë (përgatitje të qiellit) është për qëllim ndonjë e keqe për ata që janë në tokë, apo Zoti i tyre dëshiron që ata t’i udhëzojë”.*¹¹⁷

Nëse Kur’ani Famëlartë sqaron në mënyrë të qartë se në kohën pas shpalljes së “Librit-Kur’anit” njeriu ka arritur periudhën e pjekurisë. Ai është në gjendje të bartë përgjegjësinë e vendimeve dhe dëshirave të tij. Andaj, në periudhën e librit dhe të shkencës, vetë ai, e askush tjetër, është që menaxhon jetën e tij dhe është përgjegjës për te. Pas periudhës së “Librit”, nuk ka asnjë hapësirë për asnjë fuqi prej botëve tjera të ndërhyjë në caktimin e Allahut dhe ligjet e tij në rrjedhat e jetës së njeriut. Askush nuk mundet të dijë të fshehtat e botës së njeriut për të kontrolluar rrjedhën e

¹¹⁶ El-Xhinn: 1

¹¹⁷ El-Xhinn: 9-10

jetës së tyre. Mbrojtja e pejgamberëve dhe shpallja që u zbret atyre është e përpiktë. Ai që merr guximin për të përvjedhur dëgjimin, është i gjykuar me vdekje nga ana e një sistemi të përpiktë të meteorëve djegëse që nuk gabojnë. Allahu me këtë deshi të mirën për njeriun, duke e liruar atë nga ndikimi i botëve tjera ndaj botës së tij, respektivisht pengimin e bartjes së përgjegjësive. Nuk është e rastit se forma e ajeteve në suren El Xhin është në formën e kohës së kaluar (ishim). Ndërsa (tash), çështja ka ndryshuar. Në realitet, informimi i Muhamedit alejh'is-salam për xhinët dhe botën e tyre ishte me transmetim e jo me vrojtim. *قُلْ* (أُوحِيَ إِلَيَّ) "Thuaj: "Mua më është shpallur".¹¹⁸

Nëse këto hadithe janë të sakta, atëherë, a mund të jenë prej teksteve që mund të komentohen (te'vil) se janë raste për njerëz të veçantë dhe mentalitete të veçanta, për të cilat deshi Muhamedi alejh'is-salam të eviton dëmin, por me një metodë që përshtatet me mentalitetin dhe aftësitë e tyre psikike dhe mendore? Në këtë mënyrë, këto hadithe do të jenë të një natyre të veçantë që e imponon nevoja e komunikimit me njerëz, dhe me këtë zbatohet dëmi më i vogël mes dy dëmeve!

Transmeton Buhariu nga Aliu radijallahu anhu se ka thënë: "Flitjuni njerëzve aq sa kuptojnë. A dëshironi të përgënjeshtrohet Allahu dhe i Dërguari i Tij"?! Transmeton Muslimi nga Ibn Mes'udi radijallahu anhu se ka thënë: "Çdo fjalim që mban para një populli, të cilin nuk mund ta kuptojnë, do të jetë fitne për disa prej tyre". Ne duhet të kontrollojmë jo vetëm të kritikuarit e zinxhirit (senedit), por edhe kritikën ndaj tekstit (metnit). Të kontrollojmë komentimin dhe metodologjinë e tij, në atë mënyrë që Kur'ani Famëllartë, përfshirë intencat dhe konceptet e tij të jenë gjykatës për pranimin e çdo gjëje tjetër jashtë Kur'anit, siç

¹¹⁸ El-Xhinn: 1

janë hadithet, mendimet dhe komentimet e dijetarëve. Në këtë mënyrë do të mbyllim çdo derë nga e cila mund të vjen deformimi dhe do të luftohet miti, magjia dhe ndotja intelektuale dhe kulturore.

Suneti i saktë (sahih) pejgamberik është një thesar i pasur dhe nuk kemi nevojë për më shumë prej haditheve të pasakta. Sa i përket haditheve që për nga kuptimi janë të sakta, por për nga zinxhiri jo, atëherë e pranojmë çështje të urta dhe gjurmë, për shkak se kuptimi i tyre përputhet me shpirtin e shariatit.

4.2.7. Bota para shpalljes së Kur'anit dhe bota pas saj

Nga kuptimi i përgjithshëm i shpalljes dhe nga realiteti i periudhës njerëzore në të cilën jemi duke kaluar, kuptojmë se bota para shpalljes së Kur'anit dallon nga bota pas shpalljes së saj. Bota para shpalljes cilësohej si botë e mrekullive dhe miteve, ndërsa bota pas saj cilësohet si botë e librit, shkencës dhe ligjeve natyrore.

Është e dobishme këtu të diskutojmë rreth kuptimit ndaj asaj që është potencuar në Kur'an në lidhje me nënshtrimin e shejtanëve ndaj Pejgamberit të Allahut, Sulejmanit alejh'is-selam dhe rreth "dy melekeve"¹¹⁹ në Babilion Haru-

¹¹⁹ Muhamed ibn Jusuf i njohur me Ebu Hajan Endelusi Garnati (645-754h.) në librin e tij "*El-Bahr'ul-Muhit*", sipas leximit "el-melekejn" thotë: "Shumica e dijetarëve e lexojnë me "e", pra "el-melekejn". Sipas kësaj, kuptimi është se janë dy melek. Thuhet se ata janë Xhebraili dhe Mekaili. Ka mendim se janë dy melek të tjerë: Haruti dhe Maruti".

Ibn Abasi, Haseni, Ebul-Esved Dueli, Dahhaki dhe Ibn Ebza e kanë lexuar me "i", pra "el-melikejn". Ibn Abasi ka thënë: Ata ishin dy burra magjistarë në Babiloni, ngase melaiiket nuk ua mësojnë njerëzve magjinë. Haseni ka thënë: Ata ishin dy burra të ashpër në Babiloni të Irakut. Ebul-Esved Dueli ka thënë: Ata ishin Haruti dhe Maruti, që përputhet me mendimin e Hasenit. Ibn Ebza ka thënë: Ata dy janë Davudi dhe Sulejmani alejhim'es-selam. Thuhet se ata janë dy shejtanë. Sipas mendimit të Ibn Ebza fjala "ma" është mohuese, ndërsa sipas mendimit të gjithë të tjerëve ajo është përemër lidhor.

Kuptimi i zbritjes në këtë ajet është hedhje në zemër. Komentatorët sipas leximit "el-melekejn" kanë treguar rrëfime të çuditshme dhe jologjike që ndërliiden me dashurinë, fiskin dhe kufrin. Ata dy në Babiloni janë duke u ndëshkuar që përshtatet me ato periudha historike duke pranuar shumë mite dhe çudira për shkak të përhapjes së miteve dhe pamundësisë mendore. Sido qoftë, Ebu Hajjani ka përfunduar

tit dhe Marutit, të cilët disa njerëz i kanë marrë si mbështetje për të arsyetuar një sasi të madhe të mendimeve mitologjike, duke mashtruar masën e thjeshtë për të rënë viktimë në rrjetin e fallxhorëve dhe magjistarëve. Allahu thotë:

وَاتَّبَعُوا مَا تَتْلُوا الشَّيَاطِينُ عَلَىٰ مُلْكٍ سُلَيْمَنَ ۗ وَمَا كَفَرَ سُلَيْمَنُ وَلَكِنَّ الشَّيَاطِينَ كَفَرُوا يُعَلِّمُونَ النَّاسَ السِّحْرَ وَمَا أُنزِلَ عَلَى الْمَلَكَيْنِ بِبَابِلَ هَارُوتَ وَمَرْوَتَ ۗ وَمَا يُعَلِّمَانِ مِنْ أَحَدٍ حَتَّىٰ يَقُولَا إِنَّمَا نَحْنُ فِتْنَةٌ فَلَا تَكْفُرْ ۗ فَيَتَعَلَّمُونَ مِنْهُمَا مَا يُفَرِّقُونَ بِهِ بَيْنَ الْمَرْءِ وَزَوْجِهِ ۗ وَمَا هُم بِضَارِينَ بِهِ مِنْ أَحَدٍ إِلَّا بِإِذْنِ اللَّهِ ۗ وَيَتَعَلَّمُونَ مَا يَضُرُّهُمْ وَلَا يَنْفَعُهُمْ ۗ وَلَقَدْ عَلِمُوا لَمَنِ اشْتَرَاهُ مَا لَهُ فِي الْآخِرَةِ مِنْ خَلْقٍ وَلَبِئْسَ مَا شَرَوْا بِهِ ۖ أَنفُسَهُمْ لَوْ كَانُوا يَعْلَمُونَ

*“E ndoqën atë që e thonin djajt në kohën e sundimit të Sulejmanit. Po Sulejmani nuk ishte i pafé, djajt ishin të pafé, sepse u mësonin njerëzve magjinë. (ndoqën) Edhe çka u zbriti në Babil dy engjëjve, Harutit dhe Marutit. E ata të dy nuk i mësonin askujt (magjinë) para se t’i thonin: “Ne jemi vetëm sprovë, pra mos u bën i pa fé!” E, mësonin (njerëzit) prej atyre dyve atë (magji) me çka ndanin burrin prej gruas së vet, por pa lejën e Allahut me atë askujt nuk mund t’i bënin dëm dhe ashtu mësonin çka u sillte dëm e nuk u sillte dobi atyre. E ata (jehuditë) e kanë ditur se ai që (hodhi librin) e zgjodhi atë (magjinë), ai në botën tjetër nuk ka ndonjë të drejtë (në mëshirën e Zotit). Po ta dinin, ata se për ç’ka e shitën vetveten, ajo është shumë e keqe”.*¹²⁰

Sikur të thellohemi në kuptimin e ajetit paraprak, do të vërejmë se ajo flet për çështje, ngjarje dhe rrethana që kanë ndodhur para shpalljes së Kur’anit të Muhamedi alejh’is-salam. Njerëzia para shpalljes së Kur’anit ishte primitive, e

në atë që përputhet me mendimin e Ibn Abasit radjallahu anhu ku ka thënë: “E gjithë kjo është jo e saktë. Melaiket janë të mbrojtura nga gabimi”.

- Ebu Hajjan, Muhamed ibn Jusuf, El-Behr’ul-Muhit, Bejrut: Dar’ul-Fikr, 1992, vëll. 1, fq. 528.

¹²⁰ El-Bekare: 102

shpërndarë në disa popuj të izoluar dhe të kufizuar në shkencë dhe njohuri. Këtyre popujve rishtazi u kanë ardhur mesazhe hyjnore dhe këshillime, me qëllim të ngritjes së tyre njerëzore. Këto mesazhe kanë përfunduar me shpalljen e Kur'anit, libër i njohurisë, shkencës dhe për mbarë njerëzinë. Për këtë shohim se mrekullitë ishin kërkesa të periudhës primitive dhe mjete të peygamberëve për të udhëzuar jetën e njerëzve dhe për të depërtuar në zemrat dhe mendjet e tyre, me qëllim të arritjes deri te bindja e kufizuar drejt peygamberit dhe mesazhit të tij. Këtë gjë e sqaron surja El-Xhinn.

Ajeti 102 i sures El Bekare, i cituar më lartë sqaron se ajo që iu nënshtrua Sulejmanit nga veprat e djajve, nga fuqitë natyrore dhe çdo gjë që potencohet në ajete tjera kur'anore, i takon fushës së ndihmës hyjnore nga ana e Allahut dhe mrekullive peygamberike, pa prekur fare besimin e Sulejmanit dhe pa bërë asnjë përpjekje jolegjitime nga ana e tij për komunikim me botët tjera, në veçanti me botën e djajve. E gjithë kjo, ngase ata që cilësohen si djaj "shejâtîn" qofshin prej njerëzve ose xhinëve, është patjetër të jeni jobesimtarë, mendjemëdhenj dhe mëkatarë ndaj Zotit, gjë e cila ka bërë të meritojnë këtë epitete.

Sa i përket çështjes se "në Babiloni dy engjëjve, Harutit dhe Marutit", po ashtu i takon periudhës para zbritjes së Kur'anit. Periudhë e mrekullive dhe raportit të njeriut primitive me botët tjera dhe ngjitjes së tij në mënyrë graduale drejt kompletimit njerëzor, pavarësisë dhe bartjes së përgjegjësisë për veprimet e tij, brenda kornizave të luftës mes të vërtetës dhe të pavërtetës, dritës dhe errësirës. Për këtë është e papërshtatshme të kuptohet teksti kur'anor - qoftë edhe për atë periudhë - se melaikët ua mësojnë njerëzve të keqen dhe kufrin, gjë e cila nuk përputhet me natyrën e tyre, e as nuk e pranon ndërgjegjja e pastër dhe e shëndoshë islame.

Burimet tregojnë se forma e leximit “el-melekejn” që është dyjësi i emrit melek, që do të thotë “dy melekët” është i saktë. Po ashtu forma e leximit “el-melikejn” që është dyjësi i emrit melik, që do të thotë “dy mbretërit” është i saktë. Sipas meje, forma “el-melikejn” “dy mbretërit” është më prioritar. Sipas kësaj forme të leximit, merr kuptimin se ata ishin në formë të priftërinjve që gjendeshin në faltoret e civilizimeve të hershme, të cilat dominonin para civilizimit grek. Ata paraqitnin veten si njohës të shkencave dhe njohurive, me anë të të cilave njiheshin si të fortë para masës së thjeshtë. Kjo është e ngjashme me atë që paraqitet në rrëfimn e Musait alejh’is-selam me magjistarët e Faraonit, të cilët me magjitë e tyre mashtronin masën e thjeshtë.

Mund të paramendohet se këta mbretër priftërinj dhe adhurues të drejtë, kur ua kanë mësuar njerëzve njohuritë të cilët i kanë mësuar nga të tjerët dhe nga ajo që Allahu i ka frymëzuar, ua kanë tërhequr vërejtjen nxënësve nga këto njohuri të trashëguara, të cilat nëse keqpërdoren do të jenë fitne (sprovë) dhe në këtë mënyrë do të shkaktojnë dëme dhe do të devijojnë njerëzit nga rruga e drejtë. Ky kuptim është kuptim i pranuar që përshtatet me natyrën dhe pozitën e melaikeve.

Ndoshta është e nevojshme të përkujtojmë lexuesit rreth mashtrimeve në lëvizje, zë, dritë dhe forma tjera që bëjnë aktorët në lojërat e cirkut. Po ashtu në shfaqjet kinematografike, për të cilat sikur të mos kishim bindje të paluhatur se paraqiten në atë mënyrë që mashtrojnë syrin, do të bindeshim se janë lëvizje të gjalla dhe reale.

Ky është një shembull rreth çështjeve kur ka mendime të ndryshme, programe të kundërta, probleme, rreziqe dhe pasoja të dëmshme për mentalitetin e umetit. Rreth këtyre çështjeve rrallë herë ulen profesionistët dhe specialistët e fushave përkatëse për të zbardhur çështjet dhe për të vënë rregullat e bashkëveprimit pozitiv dhe të shëndoshë, në

aspektin ideologjik dhe pedagogjik. E gjithë kjo, me qëllim që në fund të mos prishet besimi, mendja dhe vendosmëria, si dhe të mos largohen nga udhëzimet e Kur'anit dhe përgjegjësitë e mëkëmbësisë në tokë.

4.2.8. Domosdoshmëria e përmirësimit metodologjik dhe pastrimit kulturor

Për shkak të mangësive në metodologjitë tona, shumë prej haditheve, të cilat mund të jenë jo të sakta për ndonjë arsye, qoftë në zinxhirin apo tekstin e hadithit, i njëjtë mund të jetë i saktë në sferën e të kritikuarit të tekstit (el-metnu) dhe në sferën e studimit të transmetuesve, studim krahasues në dritën e të kritikuarit të tekstit (et-metnu). Disa hadithe mund të jenë të sakta, mirëpo në rrethana të veçanta që lexuesi i sotëm nuk e di se për çka është thënë në atë kohë. Kështu, ai gabon në të kuptuarit e tij dhe ndotë kulturën dhe mentalitetin e umetit, duke hapur derën e miteve dhe falleve, me anë të të cilave shkatërrohet përgjegjësia intelektuale, shkencore dhe mëkëmbëse, si dhe energjia psikologjike e bijve të umetit.

Qëllimi, nga ajo që u tha më lartë, nuk është që ne të këmbëngulim për ndonjë mendim të prerë, por qëllimi është hapja e derës për një dialog shkencor, metodologjik dhe të fortë mes dijetarëve dhe mendimtarëve, të cilët kanë përgatitje të kompletuar metodologjike, shkencore dhe kulturore, me anë të të cilave përcaktohen qëllimet dhe intencat. Përveç kësaj, trajtohen çështjet në dritën e shpirtit të shariatit dhe intencave të tij, realitetit, gjendjes dhe problemeve të umetit, përcaktohen çështje konstante dhe të pandryshueshme, përfshihen çështjet e ndryshueshme dhe përballen sfidat. Në këtë mënyrë veprojmë me seriozitetin më të madh për pastrimin dhe reformimin e metodologjive të mendimeve tona dhe për përfitimin nga mjetet dhe mun-

dësitë e reja. Kështu pastrojmë kulturën tonë dhe mbyllim rrugën për njerëzit e papjekur, të sëmuret shpirtërisht dhe personat me interesa.

4.3. Problemi pedagogjik: metoda dhe pikënisja

Nëse dëshirojmë veprim serioz për të realizuar fuqinë e umetit për reforma, ndryshim dhe veprim, si dhe për të mundësuar projektin e reformave islame për të realizuar qëllimet e larta, është i domosdoshëm aktiviteti për trajtimin e problemit pedagogjik.

Nga mesi i umetit ka lindur një numër i madh i mendimtarëve dhe reformatorëve, të cilët kanë shkruar, janë përpjekur dhe kanë tërhequr vërejtjen ndaj shumë të metave nga të cilat vuan umeti. Megjithatë, deri më sot, umeti nuk ka pasur sukses për të sjellë ndryshimin e shpresuar dhe për t'u liruar nga të metat dhe sëmundjet, nga të cilët vuajmë edhe sot e kësaj dite. Jemi të mendimit se këta mendjendritur nuk kanë qenë të vetëdijshëm në masë të mjaftueshme rreth dimensionit pedagogjik të periudhës së fëmijërisë, e cila është bazament i ndryshimit. Kështu, fëmija dhe dimensionin pedagogjik -në masë të madhe- janë anashkaluar nga mendimi i umetit dhe nga politika e aktiviteti i saj ideologjik dhe shoqëror.

Me rënien e mendimit pedagogjik -si pjesë e rënies së mendimit shoqëror dhe human- pa qëllim është deformuar edhe vizioni i përgjithshëm shoqëror. Kështu, kanë depërtuar negativitetet dhe çrregullimet shoqërore për shkak të grumbullimit të sëmundjes së autokracisë dhe shtypjes në politikë, mendim dhe pedagogji, ngase nuk ka konsultim, as drejtësi, e as fuqi pa kulturë dhe ideologji, si dhe nuk ka zhvillim pa edukim dhe arsimim.

Shoqëria e shtypur, e frikësuar dhe e nënshtruar është shoqëri autoritare, ku mohohet roli dhe pjesëmarrja e tjetrit.

Çdo person ngulfat dhe robëron atë që është në pozitë më të ultë se ai. Çdo person posedon psikikë të robit dhe është i goditur me sëmundjen e robërimit ndaj atij që është më i fortë se ai. Në të njëjtën kohë, ky person, për shkak të nënçmimit që ka përjetuar, në rast se i jepet mundësia të ushtrojë ndonjë post, ai do të bëhet një gjakpirës dhe tiran ndaj të tjerëve që janë më poshtë dhe më të dobët se ai. Mes bijve të një shoqërie robërish, nuk ka solidarizim e as bashkëveprim, por janë egoistë që vrapojnë pas interesave. Japin tërë mundësinë për të qenë pasues dhe të nënshtuar, gjë e cila vazhdon zinxhirë gjersa përfundon te bos i madh dhe tirani më i lartë, i cili adhuron veten e tij, ndërsa ky bos i nënshtrohet zotëriut të huaj që vjen nga jashtë.

Në një shoqëri që ka psikikë të robërve dhe mendim autoritar, është plotësisht e natyrshme që kujdesi për fëmijën të jetë në fund të prioriteteve, me vlerë dhe dinjitet të anashkaluar e në asnjë mënyrë kapital i ardhmërisë, bërthamë e zhvillimit dhe shpresë e umetit. Kjo qenie, pra fëmija, gjithnjë duhet të pranon kërkesat dhe të nënshtrohet. Ai nuk ka të drejtë as të pyes e as të pyetet, as të diskuton e as të diskutohet. Nuk merren në konsideratë nevojat e tij fëmijërore, ndërsa ai është i obliguar pa të drejtë kundërshtimi, të mëso përmendë dhe të imiton. Në shoqërinë e robërve, kështu janë programet dhe konceptet pedagogjike. Sa i përket frikësimit dhe ndëshkimit, ato janë dy mjetet elementare, qofshin të shfaqura apo jo.

4.3.1. Domosdoshmëria e kujdesit në raportet mes çështjeve njohëse dhe atyre emocionale-pedagogjike

Me këtë lloj të programeve dhe mjeteve në procesin njohës dhe edukativo-arsimor nuk ka hapësirë për diskutimin dhe komunikimin pejgamberik ndaj fëmijës, i cili është i ngritur mbi parimet e butësisë, dashurisë, kujdesit, respektit dhe motivimit. Po ashtu, nuk ka vend për studim shken-

cor, shoqëror dhe pedagogjik ndaj fëmijërisë, si dhe ndaj energjive, mundësive dhe rolit të fëmijërisë në reformim dhe ndryshim shoqëror dhe civilizues.

Për këtë, reformat ideologjike, duke marrë në konsideratë tërë potencialin, përfshirë mjetet kulturore dhe pedagogjike, duhet të fillojnë me investim të madh dhe të drejt-përdrejtë në fushën e pedagogjisë, përmes së cilës mund të realizohet riformulimi dhe lirimi i personalitetit musliman, formimi i individit të drejtë dhe të shëndoshë, që mund të jetë anëtar efektiv në një shoqëri të fortë, të drejtë, stabile dhe solidare në aspektin shoqëror, që ngërthen në vete mendje që logjikon dhe mediton në aspektin njohës dhe psikikës besimtare, të lirë, pozitive dhe fisnike që cilësohet me trimëri dhe iniciativë.

Për të pasur mundësi të rikthejmë formimin psikologjik dhe intelektual të fëmijës musliman, si dhe ndryshimin pozitiv që përfaqëson shpirtin e besimit në Një Zot mbi baza të shëndosha shkencore, duhet patjetër të kuptojmë çështjet konstante dhe të ndryshueshme në programin edukativ të fëmijës musliman, të zhvillojmë dhe të thellojmë hulumtimin shkencor pedagogjik në dritën e çështjeve konstante islame. E gjithë kjo në atë mënyrë që përshtaten programet, mjetet, përpjekjet dhe përkujdesjet pedagogjike me zhvillimin e njohurive dhe eksperiencave, me natyrën e gjërave të ndryshueshme dhe sfidave, si dhe me gjitha mundësitë e fëmijës, përfshirë mjetet, aftësitë, energjitë për zhvillimin e cilësive dhe aftësive të patjetërsueshme për sukses dhe përparim në fushën e arritjeve dhe kontributit.

4.3.2. Rënia e mendimit pedagogjik është pasojë e rënies në njohjen e ligjeve natyrore

Për shkak të mungesës së shkencave shoqërore dhe mungesës së vetëdijes me natyrën e programit pejgamberik, nuk është për t'u habitur mungesa e shkencave, hulumti-

meve dhe studimeve pedagogjike në historinë e mendimit islam. Shembull i saktë që përshkruan gjendjen, fuqinë dhe energjinë e umetit, është gjendja e mektebeve ku mësonin fëmijët e masës së thjeshtë, ku në to, financimin e bartnin njerëzit e thjeshtë dhe të varfrit, me kushte mizore sikur në klasa, gjendja e mualimëve dhe programeve mësimore.

Prapambetjen tonë dhe përparimin e tjerëve në disa aspekte e sqaron edhe ajo se gjithë atë që e kanë mësuar fëmijët e masës së thjeshtë nga interesimet dhe përkujdesjet e mendimtarëve dhe hulumtimeve të tyre ishte vetëm pak nga meditimet e tyre, vrojtimit kritikuese ndaj programeve mësimore, gjendjet e mektebeve, metodat mësimore, mjetet mësimore, kultura e mësimdhënësve dhe aftësitë e tyre.

Është gabim të jepet një pasqyrë e saktë rreth realitetit të punës edukativo-arsimore në mesin e umetit përmes disa këshillave të njerëzve të veçantë, udhëheqësve dhe prijësve që ia kanë drejtuar edukatorëve të fëmijëve të tyre në shtëpi, ose disa mendime pedagogjike të disa mendimtarëve dhe shkencëtarëve. E gjithë kjo nuk ka lidhje me realitetin e punës edukativo-arsimore në historinë e umetit. Përhapja e këtyre devijimeve politike dhe ideologjike gjatë praktikave të prijësve të umetit ndihmon për të kuptuar përhapjen e dukurisë së arsimimit të veçantë dhe të huaj të fëmijëve. Si rezultat i gjithë kësaj është rënia kulturore e masës së thjeshtë të umetit dhe rënia e fuqisë në vendet e Botës Islame.¹²¹

¹²¹ Mentaliteti i dominimit mes një grupi të vogël që posedon të gjitha veçoritë me të cilat izolohehen nga umeti dhe masa e thjeshtë e nënshtruar, që nuk njuh përpos nënçmim, poshtërim dhe pakujdesje. Kjo gjë e bën Botën Islame dhe keqtrajtimin e të drejtave të njeriut prej formave më të rëndësishme të prapambetjes së tij, si dhe lehtëson dominimin dhe kontrollimin ndaj saj.

Përhapja e dukurisë "shërbëtorët e shtëpive" dhe mënyra e bashkëpunimit me ta që është përhapur në Botën Islame është edhe një pamje tjetër e keqe e këtij mentaliteti. Ngase këtyre shërbëtorëve, pothuaj u mohohen të gjitha të drejtat e njeriut në dinjitet, pagë, qetësim. E gjithë kjo është ngase gjërat i shikojnë nga një këndvështrim i një grupi dominues ndaj qenieve të poshtëruara, deri sa disa mendojnë se ata janë një "lloj i tjetër" që nuk meritojnë përpos ashpërsisë dhe nënçmimit. Është e pajustificueshme as e

4.4. Mes të kaluarës dhe të tashmes: bazamentet dhe pikënisjet pedagogjike

4.4.1. Modeli: programi pejgamberik gjatë edukimit

Për të kuptuar gjendjen e tashme të umetit është patjetër të hulumtojmë në mënyrë objektive dhe metodologjike për të kuptuar gjendjen e tij në fillim. Në këtë mënyrë do të kuptojmë realitetin e gabimeve që kemi bërë, shkakët që kanë ndikuar në prapambetjen tonë, si dhe në fund për të marrë mësim dhe këshilla. Nëse diskursi kur'anor është bazament i mendimit tonë dhe program i jetës tonë, atëherë diskursi dhe programi pejgamberik në edukim duhet të jenë bazament i fillimit të veprimit, të cilat i nxjerrim nga sunneti praktik, jetëshkrimi i Muhamedit alejh'is-selam, këshillat e tij, vetitë e personalitetit dhe metodat e bashkëveprimit me njerëzit përreth tij. Kuptimin tonë ndaj tyre e bëjmë në bazë të kriterëve në kuptimin, qëllimet, vlerat dhe parimet e ajeteve kur'anore. Po ashtu e gjejmë në vetitë e Muhamedit alejh'is-selam që ndërlidhen me personalitetin, moralin dhe të qenët e tij Pejgamber.

Kur'ani ka kufizuar vetitë e personalitetit të Muhamedit alejh'is-selam me mëshirë, dashuri, kontroll ndaj vetes dhe moral të mirë. Allahu thotë:

papranueshme që të përdoret poshtërimi dhe vrazhdësia gjatë bashkëpunimit me këta njerëz vetëm e vetëm se janë të nevojshëm edhe për gjëra të pavlershme për të mbetur të gjallë.

Është patjetër të merret në konsideratë çështja e këtyre mentaliteteve, praktikave, deformimeve dhe devijimeve nga parimet dhe konceptet islame në vëllazërinë njerëzore dhe vëllazërinë islame, parimet e drejtësisë, shpenzimit dhe altruizmit, në veten, kulturën dhe shoqëritë tona. Obligohemi t'u kundërviemi me gjithë fuqinë gjatë formimit të fëmijëve tanë në aspektin e besimit dhe emocional. E gjithë kjo me qëllim që të bëhemi një umet i fortë që ç'rrenjosë përçarjen, pashkollimin, poshtërimin dhe dobësimin e pjesës dërrmuese të umetit, ku si rezultat i saj do të jetë dobësimi i tërë umetit dhe dominimi i armiqtve ndaj tij.

Seleksionimi i leximit ndaj historisë se periudhave të prapambetjes së umetit nuk do të na ndihmon që në mënyrë objektive dhe pa fije frike të perceptojmë sëmundjet tona dhe njohjen e shkaqeve të dobësimin dhe devijimit që kanë depërtuar në brendinë e umetit.

وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا رَحْمَةً لِّلْعَالَمِينَ

“E Ne të dërguam ty (Muhammed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat”.¹²²

وَإِنَّكَ لَعَالَىٰ خُلُقٍ عَظِيمٍ

“Vërtet, ti je në një shkallë të lartë të moralit”!¹²³

فَبِمَا رَحْمَةٍ مِّنَ اللَّهِ لِنْتَ لَهُمْ وَلَوْ كُنْتَ فَظًّا غَلِيظَ الْقَلْبِ لَانفَضُّوا مِنْ حَوْلِكَ فَاعْفُ عَنْهُمْ وَاسْتَغْفِرْ لَهُمْ وَشَاوِرْهُمْ فِي الْأَمْرِ فَإِذَا عَزَمْتَ فَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُتَوَكِّلِينَ

“Ti ishe i butë ndaj atyre, ngase Allahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do shkapërderdheshin prej teje, andaj ti falju atyre dhe kërko ndjesë për ta, e konsultohu me ta në të gjitha çështjet, e kur të vendosësh, atëherë mbështetu në Allahun, se Allahu i do ata që mbështeten”.¹²⁴

Transmeton Muslimi nga Ibn Sa'di nga nëna e besimtarëve Aisheja radijallahu anha të ketë thënë: “Muhamedi alejh'is-selam nuk ka rrahur me dorën e tij asnjë grua, asnjë shërbëtorë e asgjë tjetër, përpos luftës që ka bërë në rrugë të Allahut...”. Autorët e dy sahiheve kanë transmetuar nga Enesi radijallahu anhu se ka thënë: “Kam shërbyer Muhamedin alejh'is-selam dhjetë vite. Asnjëherë nuk më ka thënë “uff”, e as për një punë që kam bërë, pse e ke bërë, e as për një punë që e kam lënë, pse e ke lënë”. Sipas një transmetimi tjetër, ka thënë: “Nuk më ka sharë asnjëherë, as nuk më ka mëshuar asnjëherë, as nuk më ka përzënë, as nuk është mërrolur në fytyrën time, as nuk më ka dënuar për ndonjë

¹²² El-Enbija': 107

¹²³ El-Kalem: 4.

¹²⁴ Alu Imran: 159.

punë që më ka urdhëruar dhe jam vonuar. Po nëse dikush nga familja e tij më ka qortuar ka thënë: lëre atë, nëse diçka është e caktuar do të bëhet”.

Tirmidhiu transmeton nga Ebu Hurejre radijallahu anhu të ketë thënë: Muhamedi alejh’is-selam ka thënë: “Besimtarë me besim më të plotë është ai që është me moral më të mirë. Më të mirët në mesin tuaj janë ata që janë më të mirë për gratë e tyre”. Ibn Maxheh dhe Hakimi transmeton nga Muhamedi alejh’is-selam të ketë thënë: “Më i miri në mesin tuaj është ai që është më i mirë për familjen e tij. Unë jam më i miri nga ju për familjen time”. Në transmetimin e Buhariut dhe Muslimit nga Aisheja radijallahu anha ka thënë: “Sa herë që i është dhënë Muhamedit alejh’is-selam e drejta e zgjedhjes mes dy çështjeve, gjithmonë ka zgjedhur më të lehtë, përderisa nuk ishte mëkat. Po nëse ishte mëkat, ai ishte njeriu më larg prej tij. Muhamedi alejh’is-selam nuk është hakmarrë për veten e tij asnjëherë, përpos nëse janë zhvlerësuar çështjet e urdhëruara nga Allahu, atëherë është hakmarrë për Allahun”.

Buhariu dhe Muslimi transmeton nga Aisheja radijallahu anha të ketë thënë: “Allahu është i butë dhe e do butësinë në gjitha çështjet”. Tirmidhiu transmeton nga Ebu Dherri radijallahu anhu se një njeri Muhamedit alejh’is-selam i tha: Më këshillo? Ai i tha: “Të kesh frikë respekt ndaj Allahut kudo që gjendesh”. Tha: Shto më shumë? Tha: “Punën e keqe e ndjek me të mirë, sepse ajo do ta shlyen”. Tha: Shto më shumë? Tha: “Sillu me njerëzit me moral të mirë”. Ebu Davudi dhe Tirmidhiu transmetojnë se Muhamedi alejh’is-selam ka thënë: “Mëshiruesit i mëshiron Rrahmani (i Gjithëmëshirshmi). Mëshironi ata që janë në tokë, do t’ju mëshiron Ai që është në qiell”. Transmeton Imam Ahmedi nga Ebu Derdai të ketë thënë: “Nuk kam parë as nuk kam dëgjuar Muhamedin alejh’is-selam të flet, përpos

buzëqeshur". Transmeton Imam Ahmed, Hakimi dhe Bejhekiu nga Ebu Hurejreja radijallahu anhu se Muhamedi alejh'is-selam ka thënë: "Jam dërguar për t'i plotësuar virtetet morale".

Atëherë, cilat janë shenjat e këtij programi dhe këtij diskursi dhe komunikimi peygamberik pedagogjik të Pejgamberit të mëshirës dhe moralit? Cilat janë çështjet konstante të këtij program dhe këtij komunikimi? Cilat janë pikënisjet e tij?

4.4.2. Dashuria, bindja dhe guximi janë pikënisjet e diskursit dhe komunikimit peygamberik pedagogjik

Dashuria, përkëdhelja, butësia, mëshira dhe respekti i ndjenjave ishin bazament i programit, diskursit dhe komunikimit peygamberik pedagogjik për zhvillimin e fëmijëve dhe formimin e tyre psikologjik dhe emotiv. Pa perceptuar këtë dimension gjatë formimit psikologjik dhe emotiv të fëmijës, nuk do të mund të perceptojmë mangësinë në projektin e reformave të umetit, as të kuptojmë shkaqet e pamundësisë në realizimin e pjesës dërrmuese të qëllimeve të mëdha dhe formimin e gjeneratave të fuqishme, për të bartur vështirësitë e sfidave me të cilat ballafaqohet umeti.

Mësuam më parë se si Muhamedi alejh'is-selam iu drejtua vogëlushit Ibn Abas radijallahu anhu dhe se si vëri mes tij dhe Allahut raportin e dashurisë dhe përkujdesjes? Si mbjelli në brendinë e tij guximin dhe besimin në vete? Si gjatë faljes së namazit u kujdes për nipin e vogël, i cili kish-te hipur në shpinën e tij dhe e la të luan pa tentuar largimin e tij?

Muhamedi alejh'is-selam ishte shumë i kujdesur në respektimin e fëmijës dhe ndjenjave të tij. Ai kur kalonte pranë fëmijëve, i përshëndeste sikur që i përshëndet të rriturit. Interesohej për fëmijët siç interesohej për të rriturit.

Sillej me butësi ndaj tyre dhe kujdesej për ndjenjat e tyre. Nuk injoronte ekzistimin e tyre në tubime. Bënte shaka me ta dhe porosiste nderimin e tyre, si dhe nxiste për drejtësi mes tyre.¹²⁵

Gabon shumë ai që mendon se dhuna dhe imponimi me gojë apo me dorë është mjet i shëndoshë në edukim. Në realitet, ato janë argument i dobësisë dhe mungesës së performansës pedagogjike të prindërve, si dhe shkatërrim i personalitetit, respektit, krenarisë, dinjitetit të fëmijës dhe besimit në vetveten e tij. Sa është rëndë kur shohim vetitë e ligjit të xhunglës në shumë prej traditave dhe trashëgimisë së popujve tanë. Shohim dobësimin e shpirtit dhe moralit islam. Kjo shihet me përhapjen e dukurisë së dominimit fizik të të fortëve, jo vetëm me të vegjlit, por shihet si e drejtë e çdo autoriteti që u jep të drejtë rrahjen edhe të rriturve dhe shkeljen e dinjitetit të tyre njerëzor. E gjithë kjo shndërrohet në simbol të shkatërrimit në besim, civilizim dhe

¹²⁵ Sehl ibn Said Saidi radijallahu anhu transmetohet se Muhamedi alejh'is-selam i sollën pije nga i cili piu. Në të djathtën e tij ishte vogëlushi ibn Abasi, ndërsa në të majtën pleqtë. Muhamedi alejh'is-selam vogëlushit i tha: A më lejon që t'ju jap me pi atyre? Vogëlushi tha: Jo v'Allahi, asnjërit nuk i jap përparësi në hisen time.

El Kushejri, *Sahihu Muslim*, vepër e cituar, vëll. 3, fq. 1604, hadithi nr. 2030.

Ebu Hurejre radijallahu anhu transmeton se Muhamedi alejh'is-selam ka thënë: "Kush i thotë një fëmijës se eja të jap diçka dhe nuk i jep, ajo do t'i shkruhet atij një gënjeshtër".

Esh-Shejbanî, *Musned'ul-Imam Ahmed ibn Hanbel*, vepër e cituar, vëll. 15, fq. 520, hadithi nr. 9836.

Prej gjërave që kanë tërhequr vërejtjen time dhe më kanë pëlqyer është ajo që e kam parë prej shumë nënave amerikane gjatë bashkëveprimit me fëmijët e tyre të cilët i shoqëronin në vende publike, në rrugë, kopshte, stadione, tregje etj. nëna kur dëshironte t'i drejtohet fëmijës së saj me ndonjë këshillë, sqarim apo qortim për ndonjë sjellje të palakmueshme, nuk e bënte atë e ngritur në këmbë mbi kokën e fëmijës, por ulej në atë mënyrë që fytyra e saj ishte përballë fytyrës së fëmijës dhe më pas i drejtohej me fjalim.

Nuk harroj një ngjarje kur një grua kishte mbushur karrocën e saj me gjërat që kishte blerë. Pasi kishte bërë pagesën dhe kishte arritur te dera e marketit për të shkuar te makina e saj ku duhej të kalonte rrugën për të arritur deri te parkingu. Ajo me një dorë mbante karrocën, ndërsa me dorën tjetër mbante fëmijën e saj. Ajo iu drejtua fëmijës duke e pyetur se nëse dëshiron të hipë në karrocë apo të ecë deri te parkingu. Ai zgjodhi ecjen. Kështu me një dorë shtynte karrocën, ndërsa me tjetrën mbante fëmijën e saj për dore edhe krahas vështirësisë që përjetonte. Kjo sjellje pedagogjike me siguri se do të bën fëmijën të respekton veten e tij kur të rritet, të kujdeset për veten e tij, të zhvillohet i pajisur me guxim, të mbron të drejtat e tij dhe të mos lejon në asnjë mënyrë injorimin e tyre.

edukatë që ka goditur umetin. Pejgamberi alejh'is-selam hidhërohej kur zotëriu ngriste dorë mbi robin e tij. Ky hidhërim nuk shuhej e as veprimi i tij nuk falej, përpos nëse ai lironte robin e tij.¹²⁶ Bile ai mallkon atë që dëmton kafshën pa nevojë.¹²⁷ Atëherë çka mendon për atë që përdorë dhunën në edukim?!

4.4.3. Dashuria është fuqi dhe motiv: raportet ndikuese dhe frytdhënëse

Dashuria sjell besim në vete, qetësim dhe guxim. Bile si rezultat i raporteve të ngritura mbi dashurinë është se ajo kultivon frikë pozitive, përmes së cilës fëmija kujdeset për kënaqësinë e atij që do, qoftë Zot, fe, Pejgamber, prind, mësuës dhe nuk posedon ndjenja negative të lindura nga frika negative, e cila vjen si rezultat i dhunës dhe imponimit, si dhe humbjes së ndjenjave të dashurisë, respektit, besimit në vete, drejtësisë dhe bashkëveprimit të mirë.

¹²⁶ Muslimi transmeton nga Ebu Ali Suvejd ibn Mukrin radijallahu anhu të ketë thënë: “Kisha shtatë vëllezër. Kishim një shërbëtores të cilës vëllai më i vogël ia mëshoi një shuplakë. Muhamedi alejh'is-selam na urdhëroi ta lirojmë atë”. Shih: El-Kushejri, *Sahih'ul-Muslim*, vepër e cituar, vëll. 3, f. 1279, hadithi nr. 1658. Transmeton Muslimi nga Ibn Mesud El Bedri radijallahu anhu se ka thënë: Rrahja një robin tim me kamxhikë. Dëgjova një zë pas meje duke më thënë: “Dije Ebu Mesud”. Prej hidhërimit nuk dallova zërin. Kur u ofrua ai ishte i Dërguari i Allahut alejh'is-selam. Ai thoshte: “Dije Ebu Mes'ud, dije Ebu Mes'ud”. Unë hodha kamxhikun nga dora. Ai tha: “Dije Ebu Mes'ud se Allahu është më i fuqishëm ndaj teje se sa ti ndaj robin”. Thashë: O i Dërguari i Allahut, ai është i lirë për hir të Allahut. Ai tha: “Sikur mos ta bëje do të mbulonte apo do të prekte zjarri (i xhehenemit)”. Shih: El-Kushejri, *Sahih'ul-Muslim*, vepër e cituar, vëll. 3, f. 1280, hadithi nr. 1659.

¹²⁷ Buhari dhe Muslimi transmeton nga Ibn Omeri radijallahu anhuma se Muhamedi alejh'is-selam ka thënë: “Një grua do të dënohet dhe do të hy në zjarr për shkak se ka mbyllur një mace derisa ka ngordhur. As nuk e ka ushqyer, as nuk i ka dhënë për të ngrënë ngase e ka mbyllur, e as nuk e ka lënë të lirë të hanë prej ushqimeve të tokës”. Shih: Buhari, *Sahih'ul-Buhari*, vepër e cituar, vëll. 2, fq. 834, hadithi nr. 2236. Kushejri, *Sahih'ul-Muslim*, vepër e cituar, vëll. 4, fq. 1760, hadithi nr. 2242.

Buhari dhe Muslimi transmeton nga Ibn Omeri radijallahu anhuma se Muhamedi alejh'is-selam “ka mallkuar të gjithë ata që vënë në shënjestër për gjuajtje diçka të gjallë”. Shih: Kushejri, *Sahih'ul-Muslim*, vepër e cituar, vëll. 3, fq. 1549, hadithi nr. 1958.

Muslimi transmeton nga Ibn Abasi radijallahu anhuma se Muhamedi alejh'is-selam kaloi pranë një gomari i plagosur në fytyrë dhe tha: “Allahu e mallkoftë atë që e ka plagosur”. Shih: Kushejri, *Sahih'ul-Muslim*, vepër e cituar, vëll. 3, fq. 1673, hadithi nr. 2117.

Për shkak të kujdesit të vogël nga pjesa dërrmuese e umetit për lexim dhe interesim pedagogjik nga njëra anë, si dhe sasisë së vogël të literaturës shkencore, pedagogjike dhe shoqërore në këndvështrimin islam nga ana tjetër, vërejmë se prindërit dhe edukatorët shpesh herë bëjnë përzjerje mes koncepteve të dashurisë, lirisë dhe sistemit. Këto koncepte atyre u duken si të kundërta mes vete, por në realitet janë të ndërlidhura dhe përplotësuese.

Dashuria nuk nënkupton lazdrim të pamasë, as plotësim i të gjitha dëshirave dhe kërkesave të fëmijës, as mbyllje të syve nga gjitha gabimet dhe lëshimet e tij, por dashuri e vërtetë është palca e raportit e cila ngritët mes fëmijës dhe edukatorit si shprehje e ndjenjave të respektit, interesit dhe kujdesit të sinqertë pozitiv, i cili synon interesin e të voglit dhe ofrim i metodave të ndryshme për rahatënë, zhvillimin e aftësive dhe formimin psikologjik të tij mbi baza pozitive dhe të shëndosha islame. E gjithë kjo nënkupton përpjekje dhe durim për të kuptuar psikikën e fëmijë dhe periudhën nëpër të cilën është duke kaluar, njohjen e metodave pedagogjike të cilat duhet përdorur gjatë edukimit të tij, me qëllim që fëmija vetvetiu të orientohet drejt sjelljes së shëndoshë.

4.4.4. Liria është fuqi: kufijtë dhe kriteret e saj

Për shkak të injorancës së shumë prindërve rreth koncepteve pedagogjike dhe mangësisë së shumë prej mendimtarëve dhe pedagogëve në kryerjen e rolit të tyre shkencor, edukativ dhe orientues, mund të ndodhë që koncepti i lirisë sipas tyre të nënkupton lirinë absolute, që nënkuptim veprimi i çdo gjëje që i teket njeriut. Ky kuptim është i gabueshëm dhe iluzor. Me siguri se në fund do të sjell anarki, korrupsion, çrregullim dhe shkatërrim.

Liria njerëzore posedon kufij, rregulla dhe kritere që lindin nga natyra e njeriut dhe shoqërisë në të cilën jeton ai. Andaj, është patjetër të kuptohet ajo dhe të merren parasysh kufijtë e saj. Njeriu së bashku me shoqërinë është një sistem i kombinuar, për të cilët ekzistojnë rregulla, kritere dhe kufij të cilat duhet të kihen parasysh dhe të mos tejkalohen, përndryshe do të shkatërrohet i tërë sistemi, ku do të jenë të barabartë sistemi i shoqërisë njerëzore me sistemet e atomit, qelizës dhe galaktikës. Mirëpo, nga kjo mund të kuptohet gjithashtu se ka hapësirë për liri dhe zgjedhje brenda kufijve të natyrës së sistemit shoqëror njerëzor.

Nuk ka të drejtë njeriu ta privojë tjetrin nga e drejta e zgjedhjes dhe përgjegjësia e tij. Mirëpo, obligim i shoqërisë është që anëtarët e saj t'i vë para obligimeve dhe përgjegjësive, të kujdeset për arsimimin dhe vetëdijesimin e tyre, ta hapë rrugën para tyre për të përdorur lirinë legjitime në kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësive dhe t'i detyron të respektojnë të drejtat e shoqërisë dhe kufijtë, kriteret dhe rregullat e sistemit sipas ligjit dhe legjislaturës shoqërore në përputhshmëri me parimet e konsultimit. E gjithë kjo, sepse esenca e lirisë është fuqia e kryerjes së obligimeve, bartja e përgjegjësive dhe aftësimi i njeriut për të pranuar të vërtetën dhe kryerja e përgjegjësive të mëkëmbësisë dhe ndërimit sipas parimeve të drejtësisë dhe bamirësisë.

Për këtë nuk është e kotë liria e fesë, besimit dhe mendimit në sheriatin islam. Gjithashtu nuk është e kotë se sheriatin me kufijtë e tij nuk ndjek njerëzit në çështjet e fshehta dhe të veçanta me sjelljet e tyre e që ndërliken me karakteret e tyre. E gjithë kjo është lënë në ndërgjegjen dhe edukatën e tyre. Kështu, nuk japin llogari përpos për gjërat që i bëjnë haptas, duke i dëmtuar të tjerët dhe duke publikuar gjërat e këqija. Përkundrazi, sheriatin dënon ata që ndjekin dhe

përcjellin lëshimet e njerëzve, zbulojnë të metat e tyre dhe frikësojnë ata.

Islami përputhet me mendimet gjithë njerëzve të mençur në botë se me fjalën “liri” është për qëllim dhënia e mundësisë çdo njeriut të realizon interesat e tij sipas bindjes që posedon, pa dëmtuar të tjerët. Nga kjo nënkuptohet se qëllimi nga zbatimi i lirisë njerëzore është qëllim pozitiv brenda kufijve të interesave të përbashkëta shoqërore, të ngritura mbi ligje që janë në përputhshmëri me bindjen e popullatës dhe vizionin kolektiv të ngritura mbi bazën e konsultimit islam.

Ajo që e dallon Islamit nga shoqëritë tjera në botën bashkëkohore është se Islami është feja e vetme, e cila posedon libër të ruajtur hyjnor. Ky libër - bazuar në diturinë hyjnore dhe absolute - cakton çështjet konstante të së mirës dhe reformimit të shoqërisë njerëzore dhe çështjeve universale në rrjetin e raporteve njerëzore, në kohën e tashme dhe të mëvonshme. E gjithë kjo nuk mund të vjen përpos nga Krijuesi i universit dhe të Gjithëdijshmit absolut rreth asaj që ka krijuar. Për vërtetësinë e saj dëshmojnë mrekullitë e pejgamberisë dhe validiteti i librit në gjitha kohët dhe vendet.¹²⁸ Allahu thotë:

سُرِّيهِمْ ءَايَاتِنَا فِي الْأَفَاقِ وَفِي أَنْفُسِهِمْ حَتَّىٰ يَتَبَيَّنَ لَهُمْ أَنَّهُ الْحَقُّ ۗ أَوَلَمْ يَكْفِ بِرَبِّكَ أَنَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ شَهِيدٌ

*“Ne do t’ua bëjmë atyre të mundshme që t’i shohin argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre deri që t’u bëhet e qartë se ai (Kur’ani) është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?”.*¹²⁹

¹²⁸ Abdulhamid Ebu Sulejman, “Teemulaturun fi dhahirijjeti ibn Hazmin ve l’xhaz’ir-Risalet-il-muhamedijjeh”, Mexhel-let’ut-texhdidi, Malezia: El-Xhamiat’ul-islamijjet’ul-alemijjeh, viti 2, nr. 3, 1998.

¹²⁹ Fussilet: 53.

Për këtë popujt e tjerë që posedojnë libra të falsifikuar nuk kishin rrugëdalje tjetër përpos përzierjes, destabilizimit dhe pafuqisë në njohjen e kufijve të lirisë në sistemin e shoqërive njerëzore, ngase atyre u mungojnë çështjet konstante. Kështu, gjitha përpjekjet për njohjen e këtyre kufijve dhe çështjeve konstante kanë dështuar. Evropa është e pamundur për të zëvendësuar gjërat e humbura nga trashëgimia e mëhershme e ndikuar nga krishterimi dhe Islami. Zot i çdo individ i është epshi i tij. Është përhapur çrregullimi dhe harxhimet e tepërta. Është shkatërruar familja. Çdo kush ka lirinë e plotë në ngopjen e epsheve. Çdo njeri vendos se çka duhet të merr e çka të len, pa pasur nevojë për njohuri ose argument dhe pa pasur fuqi për njohje të besueshme për pasojat. Derisa edhe të aftët e tyre çdo ditë pa fije orientimi japin mendime të çoroditura.

Perëndimorët kanë bërë përpjekje të zbulojnë nocionin e ligjit natyror, mirëpo kanë dështuar. Ngase ajo është çështje universale që nuk mund ta përfshinë atë mendimi parcial. Për këtë vërejmë se si ata për çdo ditë nxjerrin teori, çdo ditë tregojnë për gabimet e teorive të mëparshme dhe çdo ditë lind shkollë e re filozofike. Vetëm gjërat konkrete dhe të prekshme janë pasoja e ç'orientimit në dhunë dhe krim nga njohja e çështjeve konstante të shoqërisë njerëzore, kufijve të lirisë së njeriut dhe obligimit e anëtarëve të shoqërisë për ruajtjen e sistemit shoqëror nga shpërbërja dhe rënia të cilën nuk mund ta largon zëri i makinave, mjetet e shumta e as shkatërrimi i armëve dhe municionit. Allahu thotë:

أَوَلَمْ يَسِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَيَنْظُرُوا كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الَّذِينَ مِن قَبْلِهِمْ كَانُوا أَشَدَّ مِنْهُمْ قُوَّةً وَأَثَارُوا الْأَرْضِ وَعَمَرُوهَا أَكْثَرَ مِمَّا عَمَرُوهَا وَجَاءَتْهُمْ رُسُلُهُم بِالْبَيِّنَاتِ فَمَا كَانَ اللَّهُ لِيَظْلِمَهُمْ وَلَكِن كَانُوا أَنفُسَهُمْ يَظْلِمُونَ

“A nuk udhëtuan ata nëpër tokë e të shohin se si qe përfundimi i atyre që ishin para tyre!? Ata ishin edhe më të fortë se këta, ata e lëruan tokën dhe e rindërtuan atë më shumë se sa këta, e rindërtuan, atyre u patën ardhur të dërguarit e vet me fakte të qarta. Pra, Allahu nuk ishte që t’ju bëjë të padrejtë atyre, por ata vetvetes i bënë të padrejtë”.¹³⁰

Perëndimi sot - duke marr parasysh gjendjen shoqërore dhe morale të tij - është më se i nevojshëm për mesazh hyjnor të pafalsifikuar, respektivisht për islam që do ta ndihmonte për të kuptuar kufijtë e lirisë në shoqëri.

Sa i përket umetit islam, i cili akoma është i lidhur me shpalljen hyjnore dhe çështjet universale të tij, ngurtësia ideologjike dhe pasojat që kanë dalë nga ajo si robërimi, autokracia dhe ngurtësia kanë shkatërruar konceptin e konsultimit dhe lirisë në shoqëritë e tyre. Tek ata dominon mendimi i protektoratit dhe psikika e robërve, gjë e cila që në fillim i bën ata të nevojshëm për lirim ideologjikisht dhe pedagogjikisht nga ky mendim i trashëguar diktatorial, me qëllim të rikthimit të ndjenjës së lirisë së shëndoshë, guximit motivues dhe ngritjen e shoqërisë konsultative dhe institucioneve të saj. Nga kjo nënkuptohet se shoqëritë islame kanë nevojë për liri të kontrolluar, përballë nevojës së Perëndimit për kontrollimin e lirisë.

4.4.5. Esenca e sistemit dhe disiplinës: kalitja dhe ndjenja e dinjitetit dhe përgjegjësive

Sistemi dhe disiplina në aspektin pedagogjik nuk nënkuptojnë imponim, nënçmim, terrorizim, imitim dhe nënshtrim të verbër. Përkundrazi, ato në rend të parë janë kalitje dhe edukim për njeriun për kryerjen e obligimeve, bartjen e përgjegjësive, kontrollimi i vullnetit njerëzor dhe motivimi i tij në drejtim që përputhet me dinjitetin njerëzor.

¹³⁰ Err-Rrum, 9.

Në raste çrregullimi, të cilat kërkojnë ndëshkimin e fëmijës fizikisht, e gjithë ajo duhet të kryhet brenda një program kurues pedagogjik që merr në konsideratë shkaqet e rastit, siç janë ambienti në të cilin jeton fëmija, faktorët që kanë shkaktuar këtë gjendje dhe metodat e mëhershme që janë përdorur me të nga edukatorët e tij. Në rast nevojë për ndëshkim fizik është patjetër të mos e realizon atë përpos përgjegjësit të tij. Mirëpo, ndëshkimi fizik nuk duhet të vije në shprehje përpos nëse harxhohen gjitha metodat pozitive, duke marrë parasysh edhe parimin e gradualitetit në edukim. Këto metoda duhet të jenë sipas kësaj radhitje: shprehja e pakënaqësisë dhe largimi, sjellja jo e butë me të, tërheqja e vërejtjes, qortim dhe ndalimi nga privilegjet dhe gjërat e dashura për të. E gjithë kjo nëse realisht jemi të kujdesshëm për shëndetin psikologjik të fëmijës dhe për dinjitetin e tij njerëzor.

Çështja e ndëshkimit të fëmijës fizikisht është më e rrezikshme se ndëshkimi i të rriturit. Andaj nuk është e dinjitetshme minimizimi i çështjes së fëmijës, përbuzja e dinjitetit të tij dhe ndëshkimi i tij fizikisht për çdo gabim që bën, qoftë i madh apo i vogël. Me siguri se këto ndëshkime në periudhën e formimit do të shkaktojnë deformime dhe pasoja negative në psikikën dhe personalitetin e fëmijës.

Me siguri se dominimi i përkujdesit për mbushjen e kokave të të rinjve me informacione në llogari të përkujdesit për anën psikologjike dhe emocionale është e ngjashme, me atë i cili hedh ujë në rezervuarin e karburantit. Kështu do të ndalet lëvizja, shkatërrohet energjia e as nuk ngopet i eturi.

Dashuria është metoda pedagogjike përmes së cilës zhvillohen raportet e frytshme. Me dashuri rritet besimi dhe afrimi mes edukatorit dhe fëmijës. Aq sa më shumë të kujdeset edukatori për dobinë e fëmijës, kontaktin me të, afrimin tek ai, motivimin e tij dhe vlerësimin e përpjekjeve të

tij, aq më shumë fëmija do të lidhet me te, do të ketë besim tek ai dhe do të kujdeset për kënaqësinë e tij dhe përfitimin e besimit të tij. Fëmija është një qenie e përshtatshme ku mund të mbillen vlerat. Gjë që ia lehtëson edukatorit punën e tij, duke e kapur atë për dore drejt ngritjeve të tij në përpjekje për të arritur më të mirën dhe më të lartën.

4.4.6. Fazat elementare të zhvillimit të fëmijërisë dhe pikënisjet e bashkëveprimit me to

Edukatori i suksesshëm, para se gjithash, përkujdeset për të njohur cilësitë dhe aftësitë intelektuale, psikologjike, emocionale dhe fizike të fëmijës. Duhet bërë këtë me qëllim që ta orienton atë drejt zhvillimit të aftësive në këtë fazë të jetës së tij, përfshirë formimin intelektual, psikologjik, emocional dhe fizik. E gjithë kjo, me qëllim të mbjelljes së vlerave më të larta dhe shpërthimit të energjive më të mëdha, brenda kufijve të veçorive fëmijërore dhe aftësive të tij mendore, psikologjike dhe fizike, duke mos e ngarkuar me diç përtej mundësive të tij, e as duke lënë anash atë që është e mundur për ta arritur.

Është e natyrshme për fëmijën në **moshën parashkollore**, d.m.th. deri në moshën shtatëvjeçare që ai t'i përgjigjet harmonizimit dhe kalitjes. Kjo periudhë dallohet me nevojën e fëmijës për formimin e aftësive të thjeshta. Po ashtu dallohet me paaftësinë e fëmijës për përqendrim, përcjellje dhe mbamendje. Për këtë, në këtë periudhë, diskutimi, loja, durimi dhe përsëritja janë bazament i edukimit. Është e rëndësishme që fëmija të ndjehet i afërt me edukatorin. Ta dojë dhe të përfitojë besimin e tij. Po ashtu edukatori duhet të ketë plan, të dijë se çka kërkohet prej fëmijës, me qëllim që fëmija të ndjej sigurinë dhe t'i jepet shansi i kalitjes. Kjo mund të realizohet kur këshillat e edukatorit nuk janë kontradiktore dhe kalitja është e vazhdueshme në atë mënyrë

që fëmija të ndjehet i rehatshëm dhe të dijë se çka kërkohet prej tij.

Më pas vjen periudha e fëmijërisë së **vonshme** (et temjiz), diku pas moshës shtatëvjeçare. Kjo fazë kërkon krijimin e një ambienti të dashurisë, besimit reciprok dhe besnikërisë, duke e shprehur atë në forma të ndryshme. Në këtë fazë, edukatori vazhdon me durim përcjelljen e tij, kalitjen ndaj traditave, shprehive, metodave të shëndosha dhe sjelljes së mirë gjatë bashkëveprimit me njerëzit që e rrethojnë, qofshin të rritur apo të vegjël. Po ashtu duke e këshilluar për butësi, bashkëpunim, respektim të të drejtave të tjerëve, bashkëveprim me të tjerët, përpjekja për realizimin e obligimeve, si dhe lidhjen e ndjenjave dhe sukseseve pozitive me atë se sa janë realizuar këto qëllime në sjelljen dhe raportet e tij me të tjerët.

Me arritjen e fëmijës në moshën dhjetëvjeçare fillon periudha e pjekurisë fizike dhe psikologjike. Në këtë fazë, edukatori duhet të fillojë me kalitjen e tij për të bartur përgjegjësitë, nxitjen pozitive për garim dhe dallim pozitiv, hapjen e horizonteve të njohurive para tij për lexim, hulumtim dhe arritjen e sukseseve dhe kreativitetit. E gjithë kjo duke e motivuar që ai të jetë i dalluar dhe duke bartur rreziqet. Për realizimin e gjitha këtyre qëllimeve duhet të ketë në dispozicion gjitha mjetet e studiuara mirë dhe në të njëjtën kohë duhet kujdesur që fëmija të mos bie pre e rreziqeve dhe dështimeve të pallogaritura.

Kështu, dashuria në të gjitha fazat e fëmijërisë është shtylla e edukimit të shëndoshë dhe të suksesshëm, duke u bazuar edhe në kalitjen dhe kontrollimin e programit edukativ.

Sa i përket periudhës së *pubertetit*, në këtë fazë të fëmija lind dashuria ndaj njohjes, kërkimi i bindjes, dashuria për pavarësi dhe gjetja e rrugës për hulumtim dhe lartësim. E

gjithë kjo në kohë kur fëmija i nënshtrohet ndryshimeve fizike, psikologjike dhe emocionale, për të cilat nuk ka përvojë e as njohuri se si të vepron me to. Kjo gjë te fëmija shkakton destabilizim në veten e tij dhe bashkëveprimet me të tjerët. Ai përjeton ndjenja të cilat e nxisin që të jetë i mbyllur ose të dominon tek ai ndjenjat e turpfit, ose e kundërta duke e bërë të rebelohet dhe të del kontrollit.

Duke përdorur komunikimin, zemërgjerësinë para ndjenjave të pavarësisë, suksesit, hulumtimit dhe kërkimit të njohurisë, normal nën hijen e përkujdesit dhe sigurimin e një klime të pastër, përcjellje të qetë, këshillimi të përshtatshëm dhe projekteve të shëndosha, mund të realizohen rezultate pozitive. Në këtë mënyrë mund të arrihet kontrolli ndaj energjive dhe fuqive të shpërthyer në brendinë e të vegjëleve.

Me kalimin e pjekurisë dhe arritjen e moshës, në të cilën shtohen energjitë, interesimet dhe guximi për t'u zhytur në rreziqet e jetës, vetëbesimi, motivimi dhe hedhja e përgjegjësive mbi supet e të rinjve janë gjërat që i duhet të riut, me qëllim të formon përvojat dhe të hap rrugën e tij në jetë, si anëtar i fuqishëm, i dobishëm, kreativ dhe i dalluar në marrjen e iniciativave, fuqinë për bartjen e përgjegjësive në mënyrë të fuqishme dhe të ndërgjegjshme që i takon një muslimani të denjë.

Me siguri se elementet si ajo e bindjes, motivimit, respektimit, dhënies hapësirë iniciativës, kreativitetit dhe bartja e përgjegjësive janë bazament i anës kolektive në formimin e personalitetit pozitiv. Nëse edukatorët marrin në konsideratë interesimin dhe përkujdesjen ndaj fëmijëve dhe të rinjve në këto faza të zhvillimit të tyre, do të arrijnë sukses në formimin e fuqisë dhe besnikërisë, dhe kështu do të krijojnë kushte për përgatitjen e kuadrove për përmirësim dhe reformim. Përndryshe, pa këtë, nuk ka hapësirë

për nxjerrjen e një gjenerate të re që do të bartë misionin e Islamit, e as nuk ka vend për formimin e shoqërisë së forte, solidare, konsultuese dhe me dinjitet.

4.4.7. Vetitë e edukatorit të suksesshëm

Edukatori nëse dëshiron të jetë i suksesshëm në punën e tij duhet të cilësohet me njohuri, dashuri, dinjitet, respekt, drejtësi dhe durim. Këto janë bazamentet e patjetërsueshme për edukimin e mendjeve dhe shpirttrave, si dhe përgatitjen e tyre për bartjen e përgjegjësive. Këto veti formojnë kuadro të dalluar në çdo popull dhe çdo vend. Muhamedi alejh'issalam ka thënë: *“Njerëzit janë sikur xehet. Të dalluarit në periudhën e xhahilijetit (injurancës) janë të dalluar edhe në Islam, nëse bëhen të kuptueshëm (mësojnë).”*¹³¹

Edukimi i shëndoshë, ambienti i përshtatshëm dhe formimi i drejtë psikologjik bashkëveprojnë me karakterin dhe natyrshmërinë e njeriut, pa marrë parasysh se ky njeri është në xhahilijet apo islam. Islami në përgjithësi dhe fikhu, me qëllimet e tij të larta, orienton këtë energji drejt të mirës dhe suksesit. Po nëse mungon formimi psikologjik dhe energjia emocionale, atëherë shkenca dhe fikhu do të nxisin drejt punës dhe flijimit në një nivel tepër të ulët.

Dituria dhe njohuria janë të patjetërsueshme për suksesin e edukatorit dhe edukatës në përgjithësi. Pa dituri dhe njohuri rreth psikologjisë së fëmijës dhe fazave të zhvillimit të tij, nuk do të sjell dobi fare dashuria, bile ndoshta janë shkak për humbjen e fëmijës dhe edukim joadekuat. Kështu do të rritet i dobët, i lazduar, egoist ku nuk mund të krijon raporte të mira me të tjerët. Në një proverb thuhet: *“armiku i ditur është më i mirë se miku i paditur”*.

¹³¹ El-Buhari, *Sahih'ul-Buhari*, vepër e cituar, vëll. 3, fq. 1288, hadithi nr. 3304. Shih po ashtu: Esh-Shejbani, *Musned'ul-imam Ahmed ibn Hanbel*, vepër e cituar, vëll. 16, fq. 461, hadithi nr. 10791.

Drejtësia është bazamenti i fortë mbi të cilën stabilizohet dashuria, fisnikëria, respekti dhe efekti i këshillimit mes fëmijës dhe edukatorit, ngase drejtësia është pika e besueshmërisë së edukatorit ndaj fëmijës. Fëmija nuk do të dëgjon shprehjet e dashurisë e as shfaqjen e respektit nëse gjithë këtë nuk e shoqëron ndjenja për drejtësinë e edukatorit, duke mos bërë dallim mes fëmijëve ose grupeve.

Durimi dhe edukata janë dy cilësi që nuk ndahen nga njëra-tjetra, sepse paaftësia, mangësia, gabimi, dashuria për të njohur dhe eksperimenti janë cilësi të fëmijërisë, me të cilat, edukatori është patjetër të bashkëvepron me to me shpirt pozitiv. Ky është çmimi të cilin duhet ta paguan edukatori me qëllim që fëmija të zhvillohet drejtë. Duhet përsëritur çështjet, të mësohet prej gabimeve, të zbulon energjitë dhe ambientin përreth. Pa butësi dhe durim nuk do të sjell dobi dashuria, as nuk do të sjell dobi këshilla, as nuk do të përfitohet shprehia, as nuk do të përmirësohet sjellja, as nuk do të zhvillohet fuqia.

Pa mund dhe interes për përkujdesje ndaj fëmijës dhe plotësimin e nevojave të tij nuk ka dashuri, as fisnikëri e as drejtësi. Me dashuri, mund dhe durim xheneti është nën këmbët e nënave¹³² dhe prindërit arrijnë pozitën e mirësisë dhe shoqërimit të mirë.¹³³

Zgjedhja e mësimdhënësve, respektimi dhe nderimi i tyre është prej obligimeve më të rëndësishme të prindërve

¹³² Nga Muavi ibn Xhahime transmetohet se kishte shkuar te Muhamedi alejh'is-salam dhe kishte thënë: O i Dërguari i Allahut, dëshiroj të shkoj në luftë dhe erdha të të konsultoj? Ai i tha: A ke nënë? Tha: po. Tha: "Qëndro pranë saj sepse xheneti është nën këmbët e saj". Shih: En-Nisai, *El-Muxhteba mine's-Sunen*, vepër e cituar, vëll. 6, fq. 11, hadithi nr. 3104. Po ashtu: Hakimi në *El-Mustedrek*. Dhehebiu e ka saktësuar dhe mbështetur dhe e ka pranuar Mundhiriu.

¹³³ Buhariu dhe Muslimi transmetojnë se një njëri erdhi te Muhamedi alejh'is-salam dhe tha: O i Dërguari i Allahut: kush është më meritor për bamirësinë time? Tha: nëna jote. Tha: Pastaj kush? Tha: Nëna jote. Tha: Pastaj kush? Tha: Nëna jote. Tha: Pastaj kush? Tha: Babai yt. Shih: El-Buhari, *Sahih'ul-Buhari*, vepër e cituar, vëll. 5, fq. 2227, hadithi nr. 5626.

El-Kushejri, *Sahih'ul-Muslim*, vepër e cituar, vëll. 4, fq. 1974, hadithi nr. 2548.

dhe shoqërisë. Popujt të cilat merren me edukim të mirëfilltë të femrës, duke respektuar pozitën e tyre dhe respektojnë mësimdhënësit, aty do të lindin breza të dala. Ndërsa popujt që nënvlerësojnë pozitën e gruas dhe bie niveli i edukimit të tyre, si dhe nënvlerësohen mësimdhënësit dhe pozita e tyre, aty do të bie edhe kultura, morali dhe aftësitë e bijve të tyre. Prindërit dhe popujt nuk kanë investuar në diç më të rëndësishme dhe më madhështore se sa investimi në sferën e edukimit dhe arsimimit.

Muhamedi alejh'is-salam ishte model dhe shembull në shtëpi dhe xhami, gjatë këshillave, ligjëratave dhe shoqërimit me të. Është e rëndësishme që muslimanët të kuptojnë mësimet e programit dhe diskursit pejgamberik pedagogjik rreth çështjeve të gruas dhe fëmijëve. E gjithë kjo me qëllim të rikthimit të formimit të gjeneratave myslimane, të ngritura mbi besim dhe vepra të mira.

KAPITULLI I PESTË

Familja muslimane është burim i ndjenjave

5.1. Sekretet e shariatit në formimin e familjes: themelet dhe metodat

Nëse qëllimet e larta të pedagogjisë islame janë: formimi i “besimtarit të sinqertë”, „mëkëmbësit kujdestar“ dhe „të fortit besnik“, me siguri se këto qëllime nuk mund të arrihen, pos me energjinë e bindjes së besimit, ndjenjën e përgjegjësisë së mëkëmbësisë, trimërinë e zemrës, pjekurinë e sinqeritetit dhe amanetit dhe kryerja e mirë dhe përpikëria në punë. Këto vlera formohen në fëmijëri dhe formulohen mbi bazamentin e formimit të ndjenjave të njeriut. Për këtë, familja dhe marrëdhëniet e mira familjare janë bazamenti më i rëndësishëm i programit pejgamberik pedagogjik për fëmijën. Është kështu për arsye se familja është çerdhe e parë dhe më e rëndësishme e fëmijës. Ai lind i paaftë për të siguruar nevojat dhe për të mbrojtur veten e tij pa përkujdesjen familjare që i siguron atij nevojat materiale dhe shpirtërore, si dhe kujdeset për fëmijërinë e tij. Për gjithë këtë, formimi i familjes dhe lloji i raportit mes anëtarëve të saj llogaritet prej dimensioneve më të rëndësishme pedagogjike, nga të cilat varet edhe lloji i formimit të personalitetit njerëzor.

Islami, Kur’ani dhe Muhamedi alejh’is-selam i kanë kushtuar familjes dhe marrëdhënieve brenda saj kujdesin më të madh. Familjen e kanë llogaritur bërthama elementare e formimit të individit dhe shoqërisë. Për këtë është e rëndësishme të njihemi me vizionin islam në formimin e familjes dhe raportet mes anëtarëve të saj, me qëllim që të

kemi mundësi të ngremë shtyllat e saj mbi bazamente të shëndosha, të cilat ofrojnë mbështetjen pedagogjike të shëndoshë në formimin e fëmijës musliman, duke mënjanuar disa devijime të cilat i kanë imponuar traditat, rrethanat dhe ngurtësimi i mendimit, në veçanti në këtë periudhë, në të cilën është duke kaluar umeti dhe sfidat me të cilat është duke u ballafaquar sot.

Allahu i Lartëmadhëruar thotë:

وَمِنْ آيَاتِهِ أَنْ خَلَقَ لَكُمْ مِنْ أَنْفُسِكُمْ أَزْوَاجًا لِتَسْكُنُوا إِلَيْهَا وَجَعَلَ بَيْنَكُمْ مَوَدَّةً وَرَحْمَةً إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ

*“Dhe nga faktet (e madhërisë së) e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë”.*¹³⁴

وَالَّذِينَ يَقُولُونَ رَبَّنَا هَبْ لَنَا مِنْ أَزْوَاجِنَا وَذُرِّيَّاتِنَا قُرَّةَ أَعْيُنٍ وَاجْعَلْنَا لِلْمُتَّقِينَ إِمَامًا

“Edhe ata që thonë: “Zoti ynë, na bën që të jemi të gëzuar me (punën) e grave tona dhe pasardhësve tanë, e neve na bën shembull për të devotshmit”.¹³⁵

وَإِذْ قَالَ لُقْمَنُ لَابْنِهِ وَهُوَ يَعِظُهُ يَا بُنَيَّ لَا تُشْرِكْ بِاللَّهِ إِنَّ الشِّرْكَ لَظُلْمٌ عَظِيمٌ وَوَصَّيْنَا الْإِنْسَانَ بِوَالِدَيْهِ حَمَلَتْهُ أُمُّهُ وَهْنًا عَلَى وَهْنٍ وَفِضْلُهُ فِي عَافِيٍّ أَنْ أَشْكُرَ لِي وَلِوَالِدَيْكَ إِلَى الْمَصِيرِ وَإِنْ جَاهَدَاكَ عَلَى أَنْ تُشْرِكَ بِي مَا لَيْسَ لَكَ بِهِ عِلْمٌ فَلَا تُطِعْهُمَا وَصَاحِبَهُمَا فِي الدُّنْيَا مَعْرُوفًا وَاتَّبِعْ سَبِيلَ مَنْ أَنَابَ إِلَيَّ ثُمَّ إِلَيَّ مَرْجِعُكُمْ فَأُنَبِّئُكُمْ بِمَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ

¹³⁴ Err-Rrum: 21.

¹³⁵ El-Furkan: 74

“(Përkujujtoji popullit tënd) Kur Llukmani duke e këshilluar, birit të vet i tha: “O djali im, mos i përshkruaj Allahut shok, sepse idhujtaria është padrejtësi më e madhe!” Ne njeriun e kemi urdhëruar për (sjellje të mira ndaj) prindit të vet, sepse nëna e vet atë e barti me mund pas mundi dhe pas dy viteve ia ndau gjinin. (E porositëm) Të jeshë mirënjohës ndaj Meje dhe ndaj dy prindërve tu, pse vetëm tek Unë është kthimi juaj. E nëse ata të dy tentojnë që ti të më përshkruash Mua shok, për çka ti nuk ke kurrfarë fakti, atëherë mos i respekto ata, po në çështjet e jetës së kësaj bote të keshë mirëkuptim ndaj tyre, e ti ndiqe rrugën e atij që është i kthyer kah Unë, mandej kthimi juaj është tek Unë, e Unë do t’ju njoftoj për atë që keni punuar”.¹³⁶

وَوَصَّيْنَا الْإِنْسَانَ بِوَالِدَيْهِ إِحْسَانًا حَمَلَتْهُ أُمُّهُ كُرْهًا وَوَضَعَتْهُ كُرْهًا وَحَمَلُهُ
 وَفِصْلُهُ ثَلَاثُونَ شَهْرًا حَتَّىٰ إِذَا بَلَغَ أَشُدَّهُ وَبَلَغَ أَرْبَعِينَ سَنَةً قَالَ رَبِّ أَوْزِعْنِي
 أَنْ أَشْكُرَ نِعْمَتَكَ الَّتِي أَنْعَمْتَ عَلَيَّ وَعَلَىٰ وَالِدَيَّ وَأَنْ أَعْمَلَ صَالِحًا تَرْضَاهُ
 وَأَصْلِحْ لِي فِي ذُرِّيَّتِي ۗ إِنِّي تُبْتُ إِلَيْكَ وَإِنِّي مِنَ الْمُسْلِمِينَ

“Ne e urdhëruam njeriun t’u bëjë mirë prindërve të vet, ngase nëna e vet me mundim e barti dhe me vështirësi e lindi, e bartja e tij dhe gjidhënia e tij zgjat tridhjetë muaj (e ai vazhdon të jetojë) derisa ta arrijë pjekurinë e vet dhe kur t’i mbush dyzet vjet ai thotë: “Zoti im, më inspiro mua që të falënderoj për të mirën Tënde që ma dhurove mua dhe prindërve të mij, që të bëj vepra të mira që i pëlqen Ti dhe m’i bën të mirë pasardhësit e mij, unë pendohem te Ti dhe unë jam me muslimanët”.¹³⁷

وَقَضَىٰ رَبُّكَ أَلَّا تَعْبُدُوا إِلَّا إِيَّاهُ وَبِالْوَالِدَيْنِ إِحْسَانًا ۗ إِمَّا يَبُلُغَنَّ عِنْدَكَ الْكِبَرَ
 أَحَدُهُمَا أَوْ كِلَاهُمَا فَلَا تَقُلْ لَهُمَا أَقْبٌ وَلَا تُنْهَرُهُمَا وَقُلْ لَهُمَا قَوْلًا كَرِيمًا ﴿٣٧﴾
 وَأَخْفِضْ لَهُمَا جَنَاحَ الذَّلِيلِ مِنَ الرَّحْمَةِ وَقُلْ رَبِّ أَرْحَمُهُمَا كَمَا رَبَّيَانِي صَغِيرًا

¹³⁶ Lukman: 13-15

¹³⁷ El-Ahkaf: 15.

“Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuronit tjetër pos Tij, që të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve. Nëse njërin prej tyre, ose që të dy, i ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u thuaj atyre as “of - oh”, as mos u bë i vrazhdë ndaj tyre, po atyre thuaju fjalë të mira (të buta, respektuese). Dhe në shenjë mëshire shtrije pranë tyre krahun përulës e respektues dhe thuaj: “Zoti im! Mëshiroi ata të dy, sikurse më edukuan mua kur isha i vogël”.¹³⁸

Muhamedi alejh’is-selam ka thënë: “Njeriu me besim më të kompletuar është ai që ka moral më të mirë dhe është i butë me familjen e tij”.¹³⁹

Po ashtu ka thënë: “Më i mire në mesin tuaj është ai që është më i mirë për familjen e tij, ndërsa unë jam më i miri nga jush për familjen time”.¹⁴⁰

Muslimi nga Ebu Hurejreja radijallahu anhu nga Muhamedi alejh’is-selam se ka thënë: “Gruaja ka transmetuar martohet për katër çështje: për pasurinë, prejardhjen familjare, bukurinë dhe fenë e saj. Përfito fetaren, përndryshe do të mbetesh duarzbrazur”.¹⁴¹

Said ibn Mensur transmeton nga Muhamedi alejh’is-selam se ka thënë: “Nëse vjen dikush kërkon martesë të të cilit ia pëlqeni fenë dhe moralin e tij, martojeni atë. Nëse nuk e bëni do të ndodhin në tokë çrregullime të mëdha”.¹⁴²

¹³⁸ El-Isra’: 23-24.

¹³⁹ Ahmedi transmeton në Musnedin e tij. Shih:

Esh-Shejbanî, *Musned’ul-imam Ahmed ibn Hanbel*, vepër e cituar, vëll. 40, fq. 242, hadithi nr. 24204.

¹⁴⁰ Transmeton Ibn Maxheh në Sunenin e tij dhe Tirmidhiu në Xhamiun e tij. Shih:

El-Kazvini, *Sunenu Ibn Maxheh*, vepër e cituar, vëll. 1, fq. 636, hadithi nr. 1977.

Et-Tirmidhi, *El-Xhami’us-Sahih*, vepër e cituar, vëll. 5, fq. 709, hadithi nr. 3895.

¹⁴¹ Transmeton Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejreja radijallahu anhu. Shih:

El-Buhari, *Sahih’ul-Buhari*, vepër e cituar, vëll. 5, fq. 1958, hadithi nr. 4802.

El-Kushejri, *Sahihu Muslim*, vepër e cituar, vëll. 2, fq. 1086, hadithi nr. 1466.

¹⁴² Transmeton Said ibn Mensur në Sunenin e tij nga Ibn Hurmuz San’ani radijallahu anhu. Shih:

El-Bezar, Said ibn Mensur, Sunenu Said ibn Mensur, recension: Habiburrahma El-E’dhamij, Bejrut: Darul-Kutub’il-ilmijeti, bot. 1, 1985, vëll. 1, fq. 83, hadithi nr. 590.

Transmeton Ahmedi, Ebu Davudi, Nesaiu dhe Hakimi se Muhamedi alejh'is-selam ka thënë: *“Martohuni me gratë të dashura dhe që lindin, sepse unë do të mburrem me ju para popujve të tjerë ditën e Kijametit”*.¹⁴³

Buhariu dhe Muslimi transmeton nga Ibn Omeri radijallahu anhu të ketë thënë: *Kam dëgjuar Muhamedin alejh'is-selam, duke thënë: Të gjithë jeni barinj dhe secili prej jush është përgjegjës për kopenë e vet. Imami (kryetari) është bari dhe është përgjegjës për kopenë e vet. Njeriu është bari në familjen e tij dhe përgjegjës për kopenë e vet. Gruaja është bareshë në shtëpinë e burrit të saj dhe përgjegjëse për kopenë e saj. Shërbëtori është bari në pasurinë e zotërisë së tij dhe është përgjegjës për kopenë e tij”. Ka thënë: Gjithë këto i kam dëgjuar nga Muhamedi alejh'is-selam. Mendoj se ai ka thënë dhe këtë: “Njeriu është bari në pasurinë e babait të tij dhe përgjegjës për kopenë e tij. Të gjithë jeni barinj dhe përgjegjës për kopetë tuaja”*.¹⁴⁴

Nuk është për t'u habitur nga ky kujdes i madh i Islamit për familjen, e cila është strehimorja e parë dhe më e rëndësishme në formimin e njeriut. Njeriu është krijesa më e ndershme. Ai është mëkëmbës në tokë. Për këtë ai ka nevojë për edukim dhe përgatitje. Fëmijëria e tij psikologjike dhe trupore merr një kohë të gjatë. Bile fëmijëria e tij është më e gjata nga të gjitha krijesat e gjalla. Ajo zgjat afër dy dekada, derisa të forcohet fizikisht dhe të kompletohet formimi i tij psikologjik dhe fizik. Ai gjatë kësaj periudhe pranon lloje të ndryshme të përkujdesjes, edukimit, arsimimit, këshillimit dhe trajnimit.

Për gjitha këto shkaqe kuptojmë se pse sheriatu islam i ka kushtuar formimit të familjes gjithë këtë përkujdesje të

¹⁴³Transmeton Ebu Davudi në Sunenin e tij. Shih:

Es-Sixhistanij, Sunenu Ebi Davud, vepër e cituar, vëll. 1, fq. 625, hadithi nr. 2050.

¹⁴⁴ Transmeton Buhariu dhe Muslimi nga Ibn Omeri radijallahu anhu. Shih: El-Buhari, Sahih'ul-Buhari, vepër e cituar, vëll. 2, fq. 902, hadithi nr. 2419.

El-Kushejri, Sahihu Muslim, vepër e cituar, vëll. 3, fq. 1459, hadithi nr. 1829.

madhe. Pse formimi dhe këshillimi i familjes është ngritur mbi natyrën e pastër dhe lidhshmërinë njerëzore me babanë dhe nënën? Pse familja islame është e ngritur mbi bazamente natyrore në qenien njerëzore, të cilat cilësohen si konstante? Për këtë, sheriatu islam ka folur gjerësisht duke vendosur bazamentet e paluhatshme në formimin e saj, si dhe përcakton marrëdhëniet e anëtarëve të ngritura mbi çështjet konstante të këtij formimi natyror.

Për këtë legjislacionet islame rreth familjes nuk mund të kuptohen e as të perceptohet urtësia e tyre, nëse nuk kuptohen aspektet natyrore në formimin e saj, të cilat përkufizojnë detyrat përballë anëtarëve të saj dhe natyrën e roleve përplotësuese mes tyre. Anashkalimi i studimit të ligjeve natyrore në formimin e familjes dhe përgjigjja ndaj kërkesave të saj, është ajo që sqaron mangësinë e shumë legjislacioneve islame bashkëkohore në ndjekjen e çështjeve të ndryshueshme dhe vrojtimin e ndikimit të saj në metodën se si anëtarët e familjes luajnë rolet e tyre.

Mosnjohja e parimit islam në përplotësimin e sojit njerëzor në përgjithësi dhe rolit të secilit anëtar në familje në veçanti, shpie në moskuptim të formimit të familjes islame dhe mosnjohjen e rolit të secilit anëtar në te. Për këtë, gabon ai që aktron në rolin e palëve në raportet familjare, sepse është një pikënisje e gabueshme nga aspekti i realitetit natyror, deformimi i detyrës familjare dhe padrejtësi ndaj nevojave dhe të drejtave të anëtarëve në familje.

Gjendja e dobët trupore dhe ndjeshmëria emocionale e gruas në krahasim me burrin dhe lidhshmëria e ngushtë e fëmijës me te materialisht dhe shpirtërisht, e bën atë dhe fëmijën e saj të nevojshëm për përkujdesje dhe mbështetje. Këtë e zëvendëson dhe i qëndron përballë dobësia e burrit para gjinisë tjetër në krahasim me gruan, sepse kontrollimi i saj ndaj dëshirave është mbrojtje për gruan dhe fëmijën e

saj. Kështu, Allahu në duart e gruas ka lënë mundësinë për të marrë vendimin seksual. Në vendimin e saj, në raport me burrin, nuk ndikon prezenca e as pamja e tij, por mbetet e fuqishme për marrjen e vendimeve në përputhshmëri me vullnetin dhe interesin e saj.

Bazuar në këto të vërteta në qenien e gruas dhe burrit, si dhe në interesin e tyre, ka rregulluar sheriatu islam marrëdhëniet martesore dhe përkatësinë familjare në mënyrë të veçantë, përmes së cilit fëmija i takon burrit, ndërsa besimi i burrit ndaj gruas dhe fëmijës. Duke u bazuar në këtë sistem të përpiktë, burri bart përgjegjësinë e vështirësive ndaj gruas dhe fëmijës -ngase Allahu ia ka dhuruar fuqinë për punë dhe bartjen e vështirësive. Duke u bazuar në këtë veçori, përkatësi dhe besim, raportet mes burrit dhe gruas janë ngritur mbi bazamentin e dashurisë dhe mëshirës, me qëllim që familja të jetë vendstrehim, dashuri dhe sigurim për fëmijët.

Fuqia fizike e burrit dhe mosangazhimi i tij me punët e nënës, i mundëson atij të sigurojë nevojat e gruas dhe fëmijës, si dhe të përkuajdeset për to. Në anën tjetër, butësia e gruas dhe gjendja e saj emocionale siguron rehati, mëshirë dhe strehim për fëmijën e dobët dhe burrin e lodhur. Për këtë, çështja e financimit është lënë në duart e burrit. Gruaja nuk punon, përpos me dëshirën e saj sipas gjendjes, fuqisë dhe natyrën e punës që i ofrohet. Çdo padrejtësi ndaj saj llogaritet padrejtësi ndaj të drejtave të saj në ndihmë dhe bamirësi.

Kjo natyrshmëri komenton konceptin islam dhe urtësinë e tij ndaj sasisë së avretit (pjesëve të turpshme) të burrit dhe gruas. Nuk është padrejtësi ndaj gruas, por mbrojtje për dy palët e familjes. Avreti i kufizuar i mashkullit është lehtësim për punën e tij. Ndërsa, përfshirja e avretit të gruas gjithë trupin e saj dhe obligueshmëria e mbulesës, është

mbrojtje për te nga keqpërdorimet dhe dëmet e burrave, por në të njëjtën kohë është edhe mbrojtje për burrin nga provokimet dhe dëmet në familje.

Këto qëllime të larta janë qëllime të synuara në dallimin mes avretit të gruas dhe të burrit. Ato burojnë nga natyrshmëria e secilit prej tyre. I përgjigjet nevojave të tyre dhe natyrës së rolit të secilit prej tyre. Krahas kësaj, kemi edhe ndalimin e mundësisë që gruaja të ketë më shumë se një burrë në të njëjtën kohë. Ngase një veprim i tillë shkatërron familjen, humbet gjeneza dhe anulon rolin e atësisë. Gruaja në një kohë mund të mbetet shtatzënë vetëm një herë me një burrë. Ndërsa urtësia e lejimit të martesës së burrit në të njëjtën kohë me më shumë se një grua, sepse një gjë e tillë nuk humbë gjenezë, as nuk shkatërron familje, por shton familje. Megjithatë, poligamia pa nevojë nuk është prej çështjeve që sjell dashuri dhe respekt në familje, bile mund të bartë me vete rreziqet e xhelozisë dhe urrejtjes mes grave dhe fëmijëve. Kështu, burri, në gjitha rastet, nuk do të jetë fitues as shpirtërisht e as familjarisht, përpos nëse poligamia justifikohet me ndonjë nevojë reale që prek jetën e individit apo interesin e umetit.

Për këtë, familja ngritët mbi bazën e dashurisë dhe mëshirës. Në ndjenja ngritët mbi dashuri, ndërsa në obligime mbi mëshirë. Burri nuk ngarkon gruan e tij përtej mundësive të saj, e as nuk kërkon gruaja prej burrit përtej mundësive të tij. Po ashtu nuk detyrohet asnjëri nga bashkëshortët të mbetet në lidhje bashkëshortore pa dëshirën dhe vullnetin e tij. Për këtë, në rast të mosmarrëveshjeve, Islami i ka lejuar burrit shkurorëzimin e gruas së tij dhe i ka lejuar gruas të kërkon shkurorëzim (el-hul'u) nga burri i saj, ngase humbja e dashurisë dhe mëshirës mes bashkëshortëve është më e dëmshme për ta dhe për fëmijët e tyre se sa ndarja. Humbja e fëmijës njërin prej dy prindërve në një pe-

riudhë të jetës së tij, është më e lehtë se sa jeta mes dy prin-dërve që janë në konflikt, urrejtje dhe ashpërsi mes tyre.

Kësaj çështje Islami i ka kushtuar kujdes të veçantë, Kur'ani ka folur gjerësisht duke i i këshilluar dhe vetëdijesuar bashkëshortët me natyrën e marrëdhënieve mes tyre, me të drejtat dhe obligimet e secilës palë kundrejt tjetrës, duke u lënë atyre në dispozicion lirinë e veprimit në trupin e njëri tjetrit dhe pasuritë e tyre, pa kryer ndonjë mëkat, mashtrim apo tejkalim të obligimeve. Mirëpo, e gjithë kjo, me dashuri, pëlqim dhe solidarizim mes tyre. Po ashtu Islami i ka mësuar dhe i ka udhëzuar në rrugën për zgjidhjen e problemeve dhe mosmarrëveshjeve para se të përfundon çështja në ndarje mes tyre. Urtësia e pëlqimit mes tyre është që pasuria të mos jetë shkak për kërkim të shkurorëzimit nga ana e gruas ose të ketë jetë dikush që ka ndikim nga të afërmit e saj shkak për përfitim. Ndërsa, në rast të shkuro-rëzimit nga ana e burrit, ai do të dënohet materialisht duke e dhënë mehrin dhe bartjen e shpenzimit gjatë idetit, krahas harxhimeve që do të bartë për të krijuar familje të re.

Në sistemin shoqëror islam, familja është institucioni bazë, i cili siguron për njeriun shkaqet elementare të ekzistimit. Për familjen, Islami ka caktuar një sistem të veçantë që përshtatet me detyrat e saj, si dhe për secilin anëtar të familjes ka caktuar detyrat dhe pozitën që përshtatet me rolin dhe nevojën, të ngritura mbi dashurinë, mëshirën dhe respektin reciprok.

5.1.1. Roli i individit mes familjes dhe shoqërisë

Përzierja mes roleve të individëve, në cilësinë e anëtarëve të familjes dhe roleve të tyre në shoqëri dhe institucione tjera shpie në shumë keqkuptime, gjë që shkakton konflikte, humbje të energjisë dhe shkelje të të drejtave.

Pozita e babës dhe roli i tij në familje, pozita e nënës dhe roli i saj në familje, si dhe pozita e fëmijëve dhe roli i tyre në familje, nuk kanë lidhje fare me pozitën dhe rolin e tyre në institucionet tjera shoqërore. Raporti prind-fëmijë në familje lidhet me pozitën e prindit që gëzon, përfshirë dashurinë dhe respektin. Sa i përket pozitës së secilit anëtar të familjes në shoqëri, ajo ndërlidhet me aftësitë, ku mund të ndodhë që aftësitë e fëmijës t'ia tejkalojnë aftësive dhe mundësive të prindërve. Përzjerja e këtyre roleve do të rezultojnë keqkuptime, harxhime të energjive, shkelje të të drejtave dhe destabilizim të familjes.

Pozita e burrit në familje ndërlidhet me identitetin e familjes dhe sigurimin e ndjenjave të sigurisë dhe qetësisë për të dhe për gjithë anëtarët tjerë. Besimi i burrit dhe lidhshmëria e tij me familjen, gruan dhe fëmijët, në esencë është e ndërlidhur me besimin e gruas dhe sinqeritetin e saj në marrëdhëniet me burrin, me atë se sa ajo i ofron atij siguri dhe besim në marrëdhëniet me të dhe atësisë së fëmijëve të saj, dhe me atë se sa i jepet në dispozicion roli i kontrollit në menaxhimin e raporteve me palë të huaja. E gjithë kjo reflektohet në përkatësinë e fëmijëve, besimin reciprok mes tyre dhe unitetin mes vete.

Po ashtu, është me rëndësi të dihet se natyra e gruas në përgjithësi dhe në pjesën dërmuese të periudhave të saj prodhuese, dallon nga natyra e burrit, me përjashtime shumë të vogla. Gruaja dallohet me atë se ka rol të dyfishtë në punë, interesa dhe fuqi. Ajo aq sa është e përgatitur për punë, prodhim dhe kreativitet, ajo në të njëjtën kohë është shumë e lidhur me rolin e saj si nënë e fëmijëve në familje.

Ndërsa, burri ka rol, interesim dhe fuqi të njëfishtë. Ai, në esencë ndërlidhet vetëm me punë dhe prodhim. Për këtë çështje ai është i përgatitur fizikisht dhe psikikisht. Për këtë duhet plotësuar gjitha kushtet e nevojshme që aftësitë e tij

për punë t'i vë në shërbim të gruas dhe fëmijëve, dhe ofrimin e kohës dhe mundit të nevojshëm për gruan që të kujdeset për fëmijët e saj, derisa të arrijnë periudhën e pjekurisë. E gjithë kjo në një ambient i mbushur me këshilla, përkujdesje dhe edukatë të shëndoshë. Kjo është esenca dhe pikënisja. Çdo ndryshim në drejtimin e secilit prej tyre duhet të realizohet pa anashkaluar obligimet dhe përgjegjësitë elementare të secilit prej tyre.

Për këtë, nuk ka hapësirë për dallime dhe konflikte mes rolit të mashkullit dhe femrës. Secila palë ka rol në formimin e familjes dhe shoqërisë. Gruaja në formimin e shoqërisë islame është nënë, e cila llogaritet themel i familjes dhe fole e sigurisë dhe dashurisë. Ajo është më meritorë për mirësi, ndihmë dhe mbështetje. Po ashtu, ajo është më meritorë për fuqinë e burrit për të mbrojtur follenë.

Gjitha ligjet në islam synojnë realizimin e këtij qëllimi. Çdo gjë tjetër për të kuptuar rolet e burrit dhe gruas në shoqëritë islame ndryshe nga ajo që u tha, është devijim nga qëllimet e Islamit dhe nga natyra e shëndoshë. Në këtë janë të barabartë orientimi drejt Perëndimit, ku sjell lodhje për femrën, detyrim për punë, tregtim me të seksualisht dhe llogaritja e saj mjet për argëtim, ose në drejtim të nënshtrimit ndaj traditave në disa shtete të Botës Islame, duke e lodhur, shtrënguar, burgosur, ngushtuar dhe duke e lënë pa shkollim dhe edukim, në kohë kur duhet shkolluar, përgatitur për bartjen e përgjegjësive në familje, edukim të mirë të fëmijëve, përkujdesin për burrin dhe investim i aftësive të saj në shërbim të umetit dhe shoqërisë.

Largimi i gruas muslimane nga kontributet e saj kulturore, fetare dhe shoqërore - në shumë sfera - flet për dobësinë e saj në edukimin e fëmijëve, dobësinë e rolit të saj në sferën shoqërore në krahasim edhe me gruan hinduse p.sh., edhe pse gruaja hinduse nuk ka asnjë të drejtë në krahasim me të

drejtat që i ka garantuar Islami për gruan muslimane. Dalli mi këtu është se gruaja hinduse ka role efektive dhe pjesëmarrje në aktivitete fetare dhe shoqërore hinduse. Për mendim atë që e kam dëgjuar nga Shejh Muhamed Gazali rahimehullah, duke folur për përkujtimet e tij të fëmijërisë dhe fshatit ku potencon se gruaja shihej në çdo vend në fshat, përpos në xhami!

Sa habitem kur shoh se shumica e xhamive në shumë vende nuk kanë vend të posaçëm për gra. Edhe nëse gjendet ndonjë vend, ai do të jetë pas perdeve që vështirëson pjesëmarrjen emocionale. Nuk kuptoj prej çkahit frikësohen ata që vënë rreshtat e grave pas perdeve kur dinë se të gjithë pas pak kohe, burra dhe gra, do të dalin nga xhamia në tregje dhe vendet e punës?! Bashkimi i tyre në xhami për edukim të pastër shpirtëror, a nuk është i mjaftueshëm për qetësim në bashkëveprim jashtë xhamisë?!

Sa është i çuditshëm fakti ku në shumë prej xhamive nuk ju lejohet grave pjesëmarrja në namazin e xhumasë, as nuk përgatitet vend i përshtatshëm për to. Sikur ligjërimi, praninë, përkujtimi dhe prezantimi i çështjeve të muslimanëve nuk ju intereson grave fare dhe të mos kenë asnjë rol në shoqëri. Pengimi i gruas nga pjesëmarrja në namazin e xhumasë dhe namazit me xhemat, është si rezultat i keqkuptimit ndaj lehtësimit që ka bërë Islami, duke mos obliguar femrën për prezantim në këto namaze. Ishte kjo për arsye se natyra e punës së saj në përkujdesje ndaj familjes nuk ia mundëson rregullimin e kohës për faljen e namazeve. Nëna nuk mund ta vonojë gjidhënien ndaj fëmijës, përkujdesin për te, e as lënien e tij pa e pritur askush kur të kthehet nga shkolla. Për këtë, gruaja nuk është obliguar me pjesëmarrje në namazet me xhemate, në veçanti në namazet që falën gjatë natës dhe në errësirë. Nëse nuk ka ndonjë pengesë ose nevojë që e pengon nga pjesëmarrja në xhemat, në veçanti

në namazin e xhumasë, atëherë burri dhe gruaja janë të barabartë si anëtarë në shoqëri. Pra, çështja është çështje lehtësimi dhe çështje e lejuar, e jo çështje ndalimi. Muhamedi alejh'is-selam ka thënë: “Mos i ndalni robëreshat e Allahut nga xhamitë e Allahut”.¹⁴⁵

5.1.2. Të qenët nënë dhe puna në sistemin bashkëkohor islam

Prej sprovave më të rrezikshme me të cilën janë sprovuar sot muslimanët, është imitimi ndaj Perëndimit në gjitha çështjet, pa qenë të vetëdijshëm me veçoritë e tyre dhe veçoritë tona, e as me qëllimet e legjislacionit të tyre dhe legjislacionit tonë!.

Dalja e gruas për punë, me të njëjtat kushte që kërkohen edhe nga burri dhe me të njëjtat kërkesa me të cilat trajtohet gruaja në Perëndim, ka shpjer në shkatërrimin e familjes, lodhjen e gruas, keqpërdorimin e nderit, tregtimin me të dhe ekspozimin e saj para gjitha llojeve të shfrytëzimit dhe devijimit.

Gruaja nuk është e njëjtë me burrin. Secili prej tyre ka natyrën, karakteristikat dhe nevojat e veta. Ata përplotësojnë njëri-tjetrin, e nuk janë të njëjtë. Trajtimi i tyre si të njëjtë është padrejtësi ndaj secilit prej tyre. Padrejtësi ndaj burrit në aspektin psikologjik dhe të qenët baba në raportin e tij dhe rolin qendror si “përgjegjës kryesor” në jetën familjare dhe sjelljen e sigurisë. Padrejtësi edhe për gruan, në mënyrë të veçantë, në rolin e saj qendror si nënë në jetën dhe zhvillimin e njeriut, edukimin e fëmijës dhe përkujdesjes për shtëpinë, rehatinë dhe lumturinë në familje.

Për këtë, shoqëria islame dhe mendimtarët e saj duhet të pyesin veten rreth natyrës së rolit të burrit dhe gruas në

¹⁴⁵ - El-Buhari, *Sahih'ul-Buhari*, vepër e cituar, vëll. 1, fq. 305, hadithi nr. 858.

El-Kushejri, *Sahih'ul-Muslim*, vepër e cituar, vëll. 1, fq. 326, hadithi nr. 442. “Mos i pengoni gratë nga pjesa e tyre që u takon në xhami”.

legjislacion dhe shoqërinë muslimane bashkëkohore, mënyrën e mbrojtjes së veçorive të secilit prej tyre dhe realizimin e qëllimeve të shariatit islam, krahas realizimit të ekuivalencës. Në të njëjtën kohë, shfrytëzimin e energjive të gruas dhe burrit në mënyrën më të mirë të mundshme në shërbim të shoqërisë, duke realizuar qëllimet me metoda të matura, gjë që i mundëson përballimin e sfidave në mënyrën më të mirë.

Për realizimin e kësaj çështje duhet studiuar tregun e punës, përgatitjen për te, sistemimin e tij, lehtësimin e prioritetit sipas nevojave, aftësive dhe roleve që luajnë individët dhe grupet në shoqëri, qofshin burra apo gra, të cilat përputhen me qëllimet e shoqërisë dhe realizojnë veçoritë e tij.

Sa i përket gruas, roli i saj jetik si nënë llogaritet bazament i rëndësishëm i shoqërisë. Ruajtja dhe vazhdimi i këtij roli në mënyrë efektive është prej çështjeve më të rëndësishme, në bazë të së cilës duhet të organizohet tregu i punës në shoqërinë muslimane. Gruaja në rolin e saj si nënë ka nevojë për përkujdesje materiale që të luan rolin e saj në shërbim të familjes. Po ashtu ka nevojë për përkujdesje shpirtërore për të ruajtur esencën e të qenët nënë, duke ruajtur nderin dhe dinjitetin e saj.

Ekzistojnë sfera të shumta në shoqërinë muslimane ku duhet dhënë përparësi gruas. Vend më i përshtatshëm për te është arsimimi në fazën parashkollore dhe në çerdhe edukative, si dhe arsimimi në fazën fillore, ngase aty gruaja nga natyra e saj është më e përshtatshme për të bashkëvepruar me fëmijët.

Duke u nisur nga natyra e gruas dhe roli i saj jetik dhe shoqëror, ajo kur të arrijë moshën diku mbi njëzetvjeçare ka përfunduar ose është në përfundim e sipër të përgatitjes së saj profesionale, duke kryer shkollën e lartë ose studimet e ciklit të parë. Ajo në këtë moshë është më e përgatitur për të

kryer edhe rolin e nënës dhe është më e fuqishme -për nga aspekti i trashëgimisë dhe energjisë fizike dhe psikike- për lindjen e fëmijëve të shëndoshë, si dhe edukimin e tyre fizikisht dhe psikikisht. Për këtë është e rëndësishme gjetja e vendeve të punës që janë të përshtatshme për te, për shkak të angazhimeve me rolin e nënës në këtë periudhë e që zgjatë deri afër moshës dyzetvjeçare. Në këtë moshë edhe fëmija më i vogël mund të mbështetet në veten e tij, ndërsa ajo i ka tejkaluar periudhat e vështira fizikisht dhe psikikisht.

Kjo nënkupton se duhet të jenë të mirëpritura në atë moshë për të punuar. T'u jepet përparësi dhe të vlerësohen veçoritë e tyre. Bile periudha e kaluar si nënë, të llogaritet si shërbim, ku çdo dy vjet ose tre vjet të llogariten sikur një vjet punë, sipas llogaritjes së shërbimeve që realizohen në vendet e punës. Në veçanti, duhet marrë parasysh se grua-ja, me përvojën e saj nga njëra anë dhe natyrën e ndryshimeve biologjike që i ndodhin diku rreth moshë dyzetepesë, për shkak të ndërprerjes së menstruacioneve dhe përfundimit të mundësisë për shtatzëni, bëhet më e fortë dhe më pozitive, për shkak se shtohen hormonet mashkullore dhe zvogëlohen hormonet femërore, në të kundërtën e asaj që i ndodhë burrit sikur në këtë moshë, i cili është më i butë dhe më i mëshirshëm. Për këtë, është e përshtatshme që gruas t'i jepet e drejta e pensionimit në moshën 65 vjeçare ose 70 vjeçare. Dihet se gratë janë më jetëgjatë dhe më të fuqishme në këtë moshë të shtyrë.

Ne, duke imituar Perëndimin, i cili bën tregti me gruan dhe zhvlerëson rëndësinë e rolit të gruas, jemi duke e lodhur gruan dhe jemi duke e larguar nga roli i saj si nënë qysh në rininë e saj. Më pas, kur ajo arrin moshën që është e mundur për punë dhe lirohet nga angazhimet si nënë, i mbyllim dyert para saj dhe mbetet e papunë dhe bëhet burim i konflikteve dhe problemeve familjare.

Nga ana tjetër, rregullimi i tregut të punës, ku sektori u punës së grave është i pavarur nga sektori i punës së burrave është çështje e mundshme, tamam siç ndodhë me pavarësinë e shumë sektorëve të ndryshme. Në esencë, kjo çështje është një proces i sistemuar, të cilin e ndihmon formimi psikologjik dhe i vlerave njerëzore në shoqërinë muslimane. Është e rëndësishme që gruaja në tregun e punës mos t'i nënshtrohet drejtpërdrejtë autoritetit të burrit të huaj. Kështu, nga njëra anë, do të pamundësohet vënia e lidhjeve personale dhe emocionale mes tyre, si dhe do të pamundësohet mashtrimi material që mund të shfrytëzohet për të ndikuar ose bërë shtypje ndaj gruas. Sikur të thellohemi pak në raportin udhëheqës - masë e thjeshtë ose punëdhënës - punëmarrës - edhe mes burrave - do të habitemi se çfarë ndikimi ka, ku shumë burra nxiten për nënshttrim, hipokrizi dhe kryerje të shumë punëve të ndaluara, duke bërë përpjekje që të kënaqin udhëheqësit ose punëdhënësit, ose duke pasur frikë nga hidhërimi për moslargim nga puna dhe duke shpresuar për ngritje të pozitës apo avancim.

Natyra e dobësisë njerëzore, qëndrimi i gjatë bashkë mes burrit udhëheqës dhe gruas e udhëhequr, njohja e pikave të forta dhe të dobëta mes tyre, ballafaqimi i individit me vështirësi dhe lodhjet në raportet familjare dhe pushtetin pozitiv apo negativ që ka udhëheqësi, gjithë këto mund të bëjnë që nderi i gruas të jetë qëllimi më i rëndësishëm i burrit, dhe në disa raste, nderi mund të jetë çështja më e lehtë që ia jep gruaja e udhëhequr burrit udhëheqës. Statistikat që dalin nga jeta e punës në Perëndim rreth dhunës seksuale, duhet të jetë një mësim i madh për neve. Sidomos, kur dimë se sheriat, vlerat dhe veçoritë tona bëjnë që pasojat nga këto veprime në shoqërinë tonë janë më të mëdha dhe më të neveritshme, edhe krahas asaj se edhe te ata janë të papëlqyera.

Ne duhet të kujdesemi për planifikim shoqëror, siç kujdesemi për planifikim ekonomik që të mos dështojmë para se të fillojmë. Planifikimi i mirë shoqëror dhe efektuimi i tij, edhe nga ana materiale, jo vetëm që është i lehtë, por ka edhe të ardhura ekonomike, i cili në shumë raste shpie në përdorim të drejtë të resurseve dhe realizon prodhim të mirë.

5.2. Shenjat e rrugës në “Sinan” e kohës

5.2.1. Roli i familjes

Mësuam më parë se kujdesi dhe edukimi i fëmijës, zhvillimi i programeve për këtë edukim dhe pastrimi i kulturës dhe koncepteve që ndërlidhem me moshën fëmijërore nuk ishin në qendër të interesave shkencore dhe zhvillimit të punës për njohësit, mendimtarët dhe personat vendimarrës në Botën Islame.

Si është e mundur një popull të fiton luftën në fushën e edukimit dhe të realizojë zhvillimin e bijve të tij në mënyrë islamike, kur ai vuan nga deformime kulturore të trashëguara, kultura sipërfaqësore dhe e huaj e njerëzve të veçantë, krahas mangësisë dhe rënies së kulturës së masës së thjeshtë. Në të njëjtën kohë, ai vuan nga sulmi i luftës ideologjike nga të huajt, mediat botërore, qëllimet okupuese dhe mjeteve imponuese, duke shfrytëzuar fuqinë e tyre ushtarake, injorancën e muslimanëve dhe çrregullimin e tyre politik dhe shoqëror?

5.2.2. Sistemet dhe institucionet: rol pasues

Është e qartë se pjesa islame reformuese e umetit është ajo që shpreh ndjenjat dhe ndërgjegjen e tij. Në duart e saj janë çelësat që lëvizin energjinë. Posedon fuqi për t’iu drejtuar shpirtit të popullit, për të ofruar projekt të sukses-

shëm për reforma, rindërtim dhe kthimin e lidhjeve me periudhën e shpalljes, me vizionin natyror dhe gjithëpërfshirës dhe shpirtin e xhihadit reformues.

Kjo pjesë e umetit nuk mund të mbështetet në sistemet dhe elitat politike për të reformuar edukatën dhe arsimin në mënyrë rrënjësore dhe në përputhshmëri me këndvështrimin islam, sepse interesat e sistemeve janë që gjendja të mbetet ashtu siç është, për të mbrojtur interesat dhe beneficionet e tyre. Ata kujdesen për të ruajtur këto sisteme me anë të sjelljes së fuqive të mëdha botërore, të cilat janë dominuese, nuk preken interesat e tyre, pasuritë dhe sistemet e tyre. Kjo nuk nënkupton se duhet lënë pas dore drejtimin e këtyre sistemeve dhe udhëheqësve të tyre me këshilla dhe vërejtje, as ndaljen nga përpjekjet për t'i këshilluar dhe përfituar bindjen e tyre, as bashkëveprimin me ta në kufijtë e mundshme, e as angazhimin për zvogëlimin e rezistencës ndaj përpjekjeve në rrugën e reformave.

E njëjta gjë thuhet rreth mediave dhe rrjeteve mediatike. Kultura dhe interesat që kontrollojnë mediat dhe institucionet, pengojnë entuziazmin për projektin e edukatës islame dhe realizimin e qëllimeve. Mirëpo, mbetet një hapësirë e madhe ku mund mendimtarët dhe të sinqertit e umetit të veprojnë, me qëllim që përpjekjet për reforma islame dhe civilizuese të jenë të mundshme. Duhet shfrytëzuar mjetet e informimit dhe rrjeteve elektronike të cilat japin hapësirë të madhe individëve dhe organizatave për komunikim të lirë me masën, duke mënjanuar gjitha kufijtë dhe pengesat.

Nëse për shkak të rrethanave që sundojnë nuk është i mundur aktivizimi i sistemeve në mënyrë efektive për aktivizimin e projektit reformues islam, dhe pasi në botën e globalizimit dhe komunikimit satelitor dhe elektronik, nuk ka vend për mbrojtje kulturore, atëherë është patjetër që projekti islam të përballet me realitetin ballë për ballë, fuqi

me fuqi, kulturë me kulturë, në atë mënyrë që ndryshimi të ndodhë në rrafshin praktik, në shoqëri, para syve të sistemeve, duke anashkaluar fuqitë e prapambetura të huaja dhe tradicionale, në rrafshin kulturor dhe ideologjik në mënyrë të barabartë. Duhet potencuar se atyre që thërrasin për reforma pedagogjike, nuk mund të bëjnë një vend të veçantë ku do të grumbullonin të vegjlit e tyre për t'i edukuar dhe aftësuar në mënyrë të drejtë dhe të shëndoshë, ashtu siç bëri më parë Musa dhe vëllai i tij, Haruni alejhim'as-salam në "Sina".

Zgjidhja që mund të realizohet në rrethana të tilla, është patjetër të mbështetet në motivin e brendshëm natyror dhe efektiv. Ky është motivi i vetëm që bën njeriun musliman të ketë dëshirë për të kryer punën me përpikëri, e bën të fuqishëm, pa marrë parasysh gjendjen e tij materiale dhe shoqërore. Me anë të këtij motivi riformon veten e tij, edukon gjenerata, i furnizon ata me energji dhe fuqi civilizuese reformuese islame dhe ofrojnë modelin për reforma në civilizimin e njeriut bashkëkohor. Cili është ky motiv natyror? Cili është çelësi i nxitjes së ndryshimit në shoqëri?

5.2.3. Motivi natyror prindor është çelësi i nxitjes së ndryshimit shoqëror

Litari i shpëtimit, "Sinai" i kohës së globalizimit, motivi vetjak i muslimanit dhe çelësi i nxitjes për ndryshim pozitiv tek umeti, duhet të buron nga vet muslimani dhe nuk duhet mbështetur te askush, përpos tek Allahu dhe më pas në veten e tij, pa marrë leje nga elita politike që janë të privuar nga vullneti. Ky litar, çelës dhe "Sina" është "familja" vendstrehim i fëmijës dhe ndjenjave të tij, vend i formimit të tij psikik, i cili ngritët mbi shtyllat e motivit natyror, motivi i "atësisë" ose "lidhjes amnore", i cili gjithnjë synon interesin e fëmijës, duke u bazuar në koncepte të qarta për

prindërit, qofshin meshkuj apo femra dhe të bindur në atë që u sjell interes fëmijëve të tyre.

Motivi amnor natyror që u sjell interes fëmijëve, është çelësi i vetëm që ka mbetur në këtë kohë, i cili mund të merret si pikënisje efektive për reforma kulturore dhe pedagogjike islame. Në këtë rast çështja mbështetet te mendimtarët, pedagogët dhe reformatorët mysliman, që të kryejnë obligimin e tyre për t'i pajisur prindërit me kulturë të shëndoshë pedagogjike dhe shkencore islame, për t'i bindur prindërit rreth interesit të fëmijëve dhe mënyrës së riformimit të tyre psikik dhe emocional mbi baza të shëndosha islame që u sjell atyre lumturi në dy botët, gjë që u sjell atyre besim, fuqi dhe dinjitet.

Nëse shkolla dëshiron të luajë rol të rëndësishëm dhe efektiv në shërbim të umetit dhe në zhvillim të dalluar të gjeneratave, atë mund ta bëjnë duke ofruar programe pedagogjike për prindërit, duke i përgatitur për të kryer rolin e tyre në atë mënyrë që lejojnë kushtet e vendit ku jeton. Po ashtu, duke synuar ngritjen e vetëdijes dhe kulturës së prindërve, duke i furnizuar me koncepte dhe aftësi të nevojshme si pjesë e pandarë e programit të punës së shkollës dhe rolit të saj shoqëror.

Arsimi i lartë mund të ndihmon në këtë çështje dhe atë përmes programeve studimore obligative për studentët. Përmes këtyre programeve bën përgatitjen e tyre për formimin e familjeve të suksesshme islame, duke kryer obligimet e tyre në edukimit e fëmijëve dhe orientimin e tyre drejt drejtimit islam të shëndosh dhe civilizues.

Shkollat dhe universitetet islame janë institucione të fuqishme për të kontribuar në realizimin e këtij qëllimi. Ato kanë mundësi për përpilimin e programeve plotësuese, të cilat duhet të merren me përgatitjen e prindërve (studentë dhe studente) për edukim të mirëfilltë të fëmijëve si prio-

ritet më i madh në shërbim të ardhmërisë së umetit dhe avancimin e tyre. Sidomos, kur dihet se prindërit e fëmijëve në këto shkolla, zakonisht janë persona të kulturuar dhe të fuqishëm për të kryer këtë obligim, normal nëse orientohen drejt në aspektin pedagogjik nga këndvështrimi shkencor islam në formë të ligjëratave, debateve dhe punëtorive. Po ashtu duhet përgatitur bashkëveprimin e prindërve me të si kusht për praninë në këto shkolla.

5.2.4. Roli pedagogjik dhe emocional i prindërve

Aktivizimi i roleve në edukimin e fëmijëve, qoftë në shkollë, mjetet e informimit apo shoqëri, varet nga qëndrimi i prindërve. Ata janë që u japin gjitha organizatave dhe institucioneve shoqërore mundësinë e arritjes deri te fëmija përmes kryerjes së rolit që kanë marrë përsipër në inspektimin pedagogjik efektiv dhe përgatitjen e tyre drejt orientimit që dëshirojnë. Prindërit, këtë e bëjnë edhe përmes heqjes dorë nga rolet e tyre pedagogjike, duke ua dorëzuar kështu udhëheqjen e fëmijëve këtyre institucioneve pa asnjë kontroll dhe përgjegjësi.

Familja ka në dorën e saj fuqinë dhe legjitimitetin që përcakton llojin e ndikimit që mund ta ushtrojë institucionet dhe organizatat tjera shoqërore ndaj fëmijës, ndaj formimit të tij psikik dhe emocional dhe aftësive të tij njohëse. Familja është në pozitën e syzave të ngjyrosura në sytë e fëmijës. Nuk është me rëndësi çka dëgjon dhe çka sheh fëmija, por me rëndësi është si kupton ai?! Si e kupton atë që e sheh dhe e dëgjon? Për këtë dallojnë fëmijët mes veti, përveç aftësive të tyre natyrore, në shumë prej orientimeve dhe sjelljeve të tyre, edhe pse ata mësojnë në një shkollë, në një klasë, me të njëjtin program mësimor dhe nga i njëjti mësues. Shkaku kryesor për këtë është ndikimi i familjes, ambienti familjar dhe llojet e shokëve, për të cilët duhet të

ndihmojnë edhe prindërit në zgjedhjen e tyre, në formimin psikik të fëmijës dhe energjinë dhe orientimet e tij emocionale.

5.2.5. Dobësia e edukatës dhe arsimimit tek umeti

Nëse dimë rëndësinë e fëmijërisë dhe edukimit në sjelljen e ndryshimeve rrënjësore njohëse dhe emocionale, gjë e parë që bie në mendje është shkolla dhe arsimimi. Në rend të dytë mund të vijnë mjetet e informimit. Ndërsa familja renditet si e fundit. Roli i saj pothuaj përkufizohet në kujdesin për ushqim, sigurimin e nevojave dhe kërkesave materiale të fëmijës, siç janë: banimi, ushqimi dhe veshja.

Nëse krahasojmë investimin që bëhet në shkolla dhe arsimim, edhe pse në shtetet islame relativisht është i vogël, po ashtu me investimin që bëhet për mjetet e informimit me investimin që bëhet për rolin pedagogjik të familjes, do të vërejmë se pothuaj nuk ekziston fare, me përjashtime të vogla, që flasin për rëndësinë e rolit të prindërve si model për fëmijët e tyre. Çështja përfundon këtu. Prindërit janë të pafuqishëm për të ndryshuar veten e tyre, e as nuk dinë se si mund me metoda praktike të përmirësojnë gjendjen e fëmijëve të tyre, edhe pse, natyrisht, janë të kujdesur për të vepruar me gjithë fuqinë e tyre për interesin dhe ngritjen e nivelit të tyre.

Është për të ardhur keq se pikëpamjet e prindërve për ardhmërinë e fëmijëve në dritën e kulturës dhe përvojës së tyre, është i ndikuar fuqishëm nga orientimet materiale, individuale dhe konsumuese të qarta të kulturës perëndimore, nga periudha në të cilën jemi duke kaluar, nevojat, qëllimet dhe perceptimet që e sundojnë atë. Gjithë kësaj duhet shtuar edhe sëmundjet e kohëve të prapambetjes sonë kulturore. Shumica e prindërve tanë nuk merren përpos me interesimet dhe egon e tyre, kujdesin për kafshatën e gojës,

konsumimin dhe akumulimin e pasurisë sa të jepet mundësia. Sa i përket shoqërisë, sistemit publik, interesit publik, solidaritetit shoqëror, vëllazërisë islame dhe njerëzore, dinjitetit njerëzor, shoqërisë së ligjit, vlerave, drejtësisë, bamirësisë dhe kënaqësisë së njohjes dhe kreativitetit, të gjitha këto janë bërë çështje të pavlera, të pakuptimta në botën e hipokrizisë, konfliktit, padrejtësisë, korrupsionit dhe autokracisë.

Nuk duhet të habitemi kur vërejmë se shkollat dhe institucionet e arsimit, si dhe mjetet e informimit në vendet tona, nuk luajnë rolin e shpresuar prej tyre në nxjerrjen e gjeneratave të dinjitetit, qytetarë të fuqishëm dhe besnik, të cilët posedojnë fuqi, iniciativë, kryerje të punës me përpikëri të dalluar që ec baras me kohën dhe sfidat e saj.

Nëse shikojmë institucionet e arsimit të lartë dhe përpjekjet e tyre në përgatitjen e kuadrove dhe shkathtësive pedagogjike, do të vërejmë se ato janë të varfra dhe të kufizuara, që merren me nxjerrjen e grupeve të mësimdhënësve, të cilëve ju mungojnë mjetet, programet, hulumtimet dhe fuqitë efektive të nevojshme për ta në procesin arsimor. Poshtërimi i pozitës së mësimdhënësit, niveli i ulët jetësor dhe shërbimet arsimore që kanë në dispozicion, po largojnë kuadrot e dalluar nga profesioni i mësimdhënësit, si dhe po ndikon negativisht tek ata që merren me këtë profesion në kryerjen e detyrës me përpikëri.

Nëse krahasojmë përqindjen e asaj që e investojnë popujt e gjalla dhe të zhvilluara në edukim dhe arsimim në krahasim me buxhetin e përgjithshëm dhe prodhimin kombëtar, do të vërejmë se sa pak investojnë shtetet e Botës Islame në këtë sferë. Në përgjithësi, investimi në arsim përfshinë vetëm rrogat e ulëta të mësimdhënësve që prekin dinjitetin e tyre, shkatërrojnë shpirtin e kontributit dhe e detyrojnë të merret me punë të lodhshme, me qëllim që të plotëson

hyrjet që i nevojiten për të mbuluar harxhimet. Sa i përket pjesës tjetër të resurseve të dedikuara për arsim, ato shpenzohen në objekte të shkatërruara që assesi nuk mund të zhvillohen.

Nëse shikojmë programet mësimore, mjetet pedagogjike, nivelin e ulët të vetëdijes për rëndësinë e formimit psikik dhe emocional të fëmijës dhe përputhshmërinë me fazat dhe sfidat me të cilat kalon fëmija dhe ballafaqohet me to umeti, do të kuptojmë shkakun në kryerjen e keqe të punës pedagogjike, uljen e nivelit të praktikave dhe programeve mësimore, të cilat shkaktojnë vetëm lodhje, terrorizim dhe mësim mekanik, që nuk ndihmojnë fare në zhvillim emocional, njohës dhe fizik të fëmijës. Po ashtu pengojnë zhvillimin e aftësive në nivelin që e kërkon koha dhe sfidat e tij.

Nëse shikojmë prindërit, meshkuj dhe femra, dhe nivelin e kulturës dhe përgatitjes pedagogjike do të shohim se kemi një analfabetizëm pedagogjik që pothuaj përfshinë të gjithë, përfshirë edhe të kulturuarit. E gjithë kjo, për shkak të mungesës së përvojës në praktikat pedagogjike, të cilat i kanë përfituar nga familja dhe shkolla, si dhe për shkak të këshillimeve të vogla shkencore dhe pedagogjike që u drejtohen prindërve, të cilat pothuaj janë të përkufizuara në sferën e fikhut dhe legjislaturës, sferën e këshillave tradicionale dhe përkthimeve të huaja, të cilat nuk ndërliken fare me besimin, kulturën dhe ambientin ku jetojnë, e as nuk iu ndihmojnë në formimin e personalitetit islam, përpikërinë e kryerjes dhe përballimin e sfidave të kohës.¹⁴⁶

¹⁴⁶ Personalisht kam parë një ngjarje që përshkruan nivelin e prapambetjes së disa dijetarëve rreth rolit të gruas dhe nënës në formimin e shoqërisë. Ky shembull përfaqëson raste të shumta që flasin për mangësinë e këtij mendimi në përballimin e shumë prej çështjeve të reja dhe të ndryshueshme, perceptimin e dimensioneve dhe mënyrat e përballimit të tyre. Gjatë fëmijërisë, dëgjoja radio, i cili në atë kohë ishte diçka e re dhe interesante. Ishte mëngjesi i ditës së premte ku kishin traditë të dëgjonim pas fillimit me Kur'an, programin fetar të mëngjesit, të cilin e realizonte njëri nga dijetarët e njohur të Mekës. Tema e asaj dite ishte rreth arsimimit të femrës. Nënën time e dëgjoja duke thënë: A paska ndryshuar feja? E

5.2.6. Rëndësia e përgatitjes pedagogjike të prindërve

Hallka më e rëndësishme në zinxhirin e shkaqeve të reformave që duhet të merren me to mendimtarët dhe të shkolluarit është hallka e familjes dhe prindërve: baballarë dhe nëna.

Për këtë çështje ka disa shkaqe:

1. Familja ka një rëndësi vendimtare në formimin e fëmijës në aspektin psikik dhe mental, si dhe mënyrën e përgatitjes së tij. Është kështu, sepse familja është çerdhe, vendstrehim për rritjen dhe zhvillimin e fëmijës. Në bazë të vizionit dhe këshillave të saj, pozitivisht dhe negativisht, fëmija formon natyrën e koncepteve dhe vizionin e tij.

2. Motivi i prindërve, të cilët përkujdesen për të realizuar interesin e fëmijëve dhe ngritjen e nivelit të jetës dhe të performansave të tyre. Roli i prindërve dhe familjes është prej roleve më të rëndësishme që përcakton edhe nivelin e ndikimit të roleve tjera dhe institucioneve edukativo-arsimore tek fëmija.

3. Mendimtari, shkrimtari dhe reformatori janë të fuqishëm për t'iu drejtuar me fjalë ose forma tjera prindërve. Këtë e ndihmon edhe natyrshmëria e prindërve, të cilët angazhohen për atë që mendojnë se është në interes të fëmijëve. Për këtë çështje ata harxhojnë energji. Kjo është e kundërt me organizatat dhe institucionet të cilat kanë interesat dhe orientimet e veçanta të tyre. Familja përkujdeset për të ruajtur gjendjen reale dhe stabilitetin e saj. Çdo ndryshim duhet të realizohet brenda kornizave për të ruajtur gjendjen faktike, me qëllim të ruajtjes së tij dhe mosprishjen e baras-

pyeta për shkakun e kësaj pyetje. Ajo tha: Ky që po flet, a nuk është filan dijetari? Thashë: Po. Tha: "Ai është që ka dhënë fetva më herët se është haram femra të mësojë shkrimin, sepse kjo do t'i ndihmojë për të shkruar letra rreth dashurisë". Derisa ajo duke zbatuar këtë fetva e ka rrahur vajzën e madhe të saj në duar, e cila kishte mësuar shkrimin në mekteb në atë kohë me qëllim që ta ndalojë nga vazhdimi i arsimimit. Pastaj tha: "Si mund sot të këshillojë dhe të nxitë për arsimimin e femrave?" pyeti e habitur, me dhembje dhe me ironi nëse ka ndryshuar feja.

peshave të ndërlikuara. Çdo ndryshim nga ana e institucioneve realizohet për të ruajtur institucionet dhe gjendjen faktike. Në rastet më të mira, ato i përgjigjen kërkesave të ndryshimeve bazike nga ana e umetit, mirëpo, me siguri nuk janë ato që fillojnë ndryshimin, që marrin iniciativë dhe që shpërthejnë energjitë. Për këtë, mendimtarët dhe reformatorët duhet të kujdesen për familjen, rolin e saj pedagogjik, prodhimin e programeve të nevojshme, bindëse dhe praktike për vetëdijesimin e prindërve, arsimimin e tyre se si mund të jenë të fuqishëm për të luajtur rolin e tyre pedagogjik mbi baza shkencore të shëndosha dhe të provuara dhe mbi bazamente konstante kulturore dhe me vlera të shëndosha islame.

Familja duhet shikuar se është “Sina” e umetit dhe kohës. Mendimtarët dhe edukatorët që përkujdesen për reformat civilizuese islame, kanë mundësi me seriozitet dhe sinqeritet të bazuar në dituri dhe aftësi, t’iu drejtohen prindërve, nëse ato janë pala më e interesuar për edukimin e fëmijëve, në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa pengesa dhe me kosto më të vogël.

Në jetën e gjeneratës sonë ka shembuj dhe raste të shumta që sqarojnë se si prindërit kanë arritur të tejkalojnë këto pengesa dhe të bëjnë hapa të mëdha drejt civilizimit, ngase atyre iu janë ofruar koncepte që i kanë bindur për vlerën e ndryshimit të kërkuar dhe në të njëjtën kohë iu janë ofruar informacionet dhe përvojat e kërkuara.

Me bindjen e prindërve rritet ndikimi dhe shtypja praktike ndaj institucioneve shoqërore dhe edukativo-arsimore për të përmirësuar nivelin e performansave, gjë që kontribuon në përmirësimin e punës së këtyre institucioneve në edukimin e gjeneratave.

Dashuria, përkujdesi dhe siguria janë kushte elementare për suksesin e përpjekjeve shkencore dhe shfrytëzimin e

dashurisë në orientimin pozitiv të fëmijëve. Dashuria e prindërve nxit tek fëmija ndjenjat e dashurisë dhe lidhjen më të ngushtë të fëmijëve drejt prindërve. Sikur që dashuria nga ana e prindërve prodhon përkujdesin ndaj fëmijës, po ashtu raporti i dashurisë nga ana e fëmijës kundrejt prindërve nxitë tek ai dëshirën për t'iu përgjigjur këshillave të tyre dhe frikën nga hidhërimi i tyre. Energjia e dashurisë me dy anët e saj: pozitiv, që përfshinë dëshirën për të përfituar dashurinë e prindërve dhe negativ, që përfshinë frikën nga humbja e dashurisë dhe besimit prej tyre. E gjithë kjo e nxitë atë që të përgjigjet dhe të përpiket për të përfituar pëlqimin dhe kënaqësinë e tyre.

Për këtë, duhet ngritur vetëdijesimin e bashkëshortëve, përgatitjen e tyre për role pozitive dhe ngritjen e raporteve mes tyre, fillimisht mbi parimin e dashurisë dhe mëshirës. E gjithë kjo, nëse dëshirojnë që këto cilësi të jenë cilësi të fëmijëve të tyre, ngase ai që nuk posedon diçka, nuk mund t'ia jep tjetrit. Shtëpia e shpartalluar që ngritët mbi çështjet e nënçmimit, konfliktit, urrejtjes dhe kurtheve, është vend ku nuk shpresohet edukim i mirëfilltë i fëmijëve, e as të siguron ambient që do të zhvillojë te fëmijët ndjenjat e tyre, kuptimet e mirësisë, iniciativës dhe kreativitetit. Një ambient i tillë është vend i përshtatshëm për urrejtje, keqbërje dhe shkatërrim që shpie drejt devijimit, krimin dhe urrejtjes në shoqëri.

Ky vetëdijesim dhe kjo përkujdesje për familjen duhet të jetë pjesë e rëndësishme e përpjekjeve të mendimtarëve dhe reformatorëve, si dhe të jetë pjesë e programeve pedagogjike, vetëdijesuese dhe arsimore të umetit, në atë mënyrë që të mos ketë analfabetizëm rreth rregullave të raporteve familjare, përgjegjësi, të kuptuarit dhe bindjes në to mbi baza të shëndosha shkencore. Prej çështjeve që ndihmojnë në këtë drejtim, janë edhe ofrimi i programeve studimore

që ndërliken me familjen, duke filluar me plan-programet e shkollave të mesme dhe me caktimin e lëndëve të veçanta universitare që merren me formimin e familjes. E gjithë kjo me qëllim të përgatitjes së të rinjve për një jetë të suksesshme familjare, që mbështetet në arritjet shkencore që i prodhojnë mendimtarët, specialistët dhe qendrat për hulumtim shkencor.

Natyrisht se vetëm ndjenja e dashurisë dhe përkujdesi për fëmijën, pa njohje të ligjeve psikike dhe shoqërore mbi bazamente shkencore të studiuara, nuk siguron edukatë të mirë dhe sukses në të. Përkundrazi, dashuria e pakontrolluar, e cila kalon në lazdrim të tepërt, mund të jetë shumë e dëmshme për të dyja palët dhe mund të sjellë te fëmija paaftësi dhe egoizëm, si dhe pasojat që mund të lindin prej tyre e që janë deformimi i aftësive, ndjenjave dhe mundi-meve të fëmijës, të cilat në fund të fundit mund ta shtyjnë drejt rebelimit, çrregullimit dhe krimit.

5.2.7. Efektiviteti i njohjes pedagogjike: përvojë familjare

Ndoshta është e dobishme të sjell një shembull për një mësim edukativ që e kam përjetuar personalisht. Ky shembull sqaron se si edukatori, i cili përkujdeset që fëmijët e tij të cilësohen me cilësitë mira, gjen në metodat pedagogjike mbështetje të rëndësishme për realizimin e qëllimeve dhe mënjanimin e fëmijëve nga shumë gabime dhe tradita të këqija. Pa kuptim dhe kontakt pedagogjik, vetëm shëmbëlltyra dhe modeli nuk do të japin efektin e kërkuar. Shumë prej personaliteteve që mund të konsiderohen si model në sjelljet e tyre, nuk kanë kontakte edukative me fëmijët e tyre. Kjo sqaron devijimin e shumë prej fëmijëve të këtyre prindërve që nuk iu ka ndihmuar gjendja e mirë edukative në edukim të mirëfilltë të fëmijëve dhe orientim të shëndoshë.

Më kujtohet një rast që ka ndodhur mes nënës sime dhe vëllait tim të vogël. Një ditë vëllai hyri në shtëpi me reaksione të çuditshme, ngase nuk gjente fjalë se si të shpreh ndjenjat e gëzimit për atë që kishte në dorën e tij. Ai barte një vegël në formë të lugës që kapësja e saj ishte e ngjyrosur. E kishte gjetur në rrugën e ngushtë para shtëpisë, që ka mund t'i bjerë ndonjë udhëtari kalimtarë që vinte në Mekë. Nëna e mirëpriti fëmijën. Unë e shikoja se si do të veprojë me këtë vegël të gjetur. E pashë i habitur se si e mori fëmijën në krahët e saj së bashku me veglën në dorë. E ngriti dorën e fëmijës dhe e ktheu përsëri veglën aty ku e kishte marrë, duke i treguar se kjo vegël nuk është e jona dhe nuk kemi të drejtë ta marrim. Ishte e qartë se qëllimi i saj ishte të mos mësohet fëmija të sjell në shtëpi gjëra që nuk janë tonat.

Kur mendova më thellësisht në këtë leksion, kuptova se një fëmijë i tillë kurrë nuk mund ta zgjasë dorën e tij në gjërat që nuk janë të tij. Një ves i tillë do të thellohet në brendinë e tij - në një gjuhë edukative - për të mos marrë pasurinë e huaj, edhe nëse është e hedhur në rrugë. Sa fëmijë janë shndërruar në vjedhës pasi kanë marrë diçka nga pasuritë e të tjerëve dhe e kanë sjellë në shtëpi. Pasi në shtëpi nuk kanë hasur në dikë që kontrollon sjelljet dhe aktivitetet e tyre, ata dalëngadalë me sjelljet e tyre devijon-te, si vjedhja dhe rrena, janë shndërruar në hajna.

Fëmija e di se ambienti i dashurisë, pëlqimit, kujdesit dhe sigurisë në shtëpi qëndron pas reagimit pozitiv që u ka mundësuar prindërve të ndikojnë te fëmijët, të cilët qëndronin pranë prindërve të tyre dhe larg shoqërimit me shokë të këqij. E gjithë kjo u ka mundësuar që fëmijët e tyre t'i ngrenë në një nivel të lartë civilizues, gjë që tregon se metodat edukative kanë fuqi të madhe në përmirësim dhe ndryshim.

Në aspektin pedagogjik e di se fëmijës gjithnjë i intereson të dijë mendimin e prindërve rreth çështjeve që lindin në mendjen e tij dhe rreth çështjeve me të cilat ballafaqohet për të pasur qëndrim. Për këtë -sa kam pasur mundësi- kam qenë i kujdesur të jem afër fëmijëve kur shikojnë televizor. Rolin më të rëndësishëm që e kam kryer është se kur kam vërejtur ndonjë skenë negative, kam dhënë një koment të shkurtë dhe të kufizuar, me një metodë të përshtatshme për të zbuluar falsifikimin e mesazhit dhe, duke i përmirësuar gabimet, pa i privuar fëmijët nga dëshira për të përcjellë programin. Nëse kishte nevojë për ndonjë koment dhe diskutim më të gjatë, atëherë atë e realizonim pas programit. Atë e bënim me një metodë të hapur për të diskutuar çështjet më të rëndësishme, me qëllim të sqarimit dhe përmirësimit dhe njohjen e fëmijës me mendimin e prindërve, duke e lënë çështjen që ajo vet në mënyrë të qetë të gjejë vendin e saj në kokën e fëmijës.

Kjo metodë, sipas përvojës time, ka pasur një ndikim efektiv në luftimin e shumë prej pasojave negative të programeve televizive. Pedagogët dhe edukatorët duhet të furnizojnë prindërit me këshilla pedagogjike rreth sjelljes së mirë praktike dhe efektive me situata pedagogjike, me të cilat ballafaqohen fëmijët, si dhe me situata dhe sfida të ndryshme në rrjetet e informimit dhe ato sociale.

Element më i rëndësishëm i projektit pedagogjik, për të cilin thërret ky libër, është shfrytëzimi i një pjese të rëndësishme të përpjekjeve të mendimtarëve, pedagogëve dhe reformistëve islamë, si dhe sigurimin i mbështetjes morale për studimet shkencore të cilët drejtojnë diskursin shkencor islam te prindërit, për t'i ngritur ata në mënyrë pedagogjike dhe për t'ua mësuar atyre format e deformimit kulturor dhe mangësive pedagogjike, si dhe ndikimin e gjithë kësaj në formimin e fëmijëve dhe mbarë umetit, në aspektin fetar,

psikik, njohës dhe civilizues. Po ashtu, duhet mësuar prindërit për informacionet, mënyrat dhe mjetet që u mundësojnë atyre kryerjen e rolit në edukimin e fëmijëve, përkujdesin e zhvillimit dhe formimin e drejtë të tyre psikik, emocional dhe njohës. Në këtë mënyrë shpërthejnë energjitë e dashurisë, drejtësisë, aktivitetit dhe durimit, të cilat janë të natyrshme në brendinë e prindërve dhe i orientojnë drejt fëmijëve.

Është turp të shohësh se si bibliotekat e popujve janë përplot të mbushura me qindra apo mijëra libra dhe hulumtime shkencore pedagogjike, të cilat vetëdijesojnë prindërit për mjete kulturore dhe pedagogjike që u ndihmojnë për të kryer rolin e tyre në edukimin e fëmijëve, në kohë kur biblioteka islame rreth çështjeve familjare dhe pedagogjike, pothuaj janë të zbrazura nga librat dhe hulumtimet shkencore serioze. Shumica e këtyre librave, të pakta të botuara, janë përsëritje të ligjëratave këshilluese ose libra të fikhut që kanë të bëjnë me dispozitat e kontratës së martesës, dispozitat e shkurorezimit, e drejta e përkujdesit për fëmijët dhe ndarja e pasurisë. Pjesa dërrmuese e këtyre çështjeve nuk lidhet me esencën e edukatës dhe raportet ndërnjerëzore. As nuk ofrojnë shkencë të bazuar në ligje natyrore, e as njohje shkencore, kulturore dhe pedagogjike. Këto janë çështje që masa e thjeshtë nuk ka nevojë t'i njohë hollësisht, sepse personi që kryen aktin e kurorëzimit, gjykatësi dhe sunduesi do të merren me imtësi në raste nevojë dhe do të kryejnë procedurat për të nxjerrë dispozitat e nevojshme në lidhje me to.

Trajtimet dhe kulturat e nevojshme që duhet prodhuar, me qëllim të avancimit dhe zhvillimit të çështjeve familjare, pedagogjike dhe arsimore duhet të vazhdojnë pa ndërprerje, duke realizuar studime, hulumtime, eksperimente, përcjellje të sfidave, rrethanave dhe sfidave dhe njohuritë dhe

informacionet e reja, duke përfshirë edhe studimet psikologjike, studimet rreth mendjes së njeriut dhe gjenealogjisë.

5.2.8. Pas familjes, mësuesi

Nëse motivi natyror te prindërit për t'u përkujdesur për interesin e fëmijëve është bazamenti i parë dhe i fortë, mbi të cilin duhet mbështetur çdo përpjekje serioze për përmirësimin e njeriut musliman, duhet ditur se mësuesi, gjithashtu ka një rol të madh në këtë çështje. Është kështu, ngase mësuesi është mbështetësi i parë i familjes në një hapësirë më të madhe dhe është elementi të cilit shoqëria ia ka lënë në duar çështjen e arsimimit të fëmijëve, përkujdesin ndaj tyre, këshillimin dhe zhvillimin e aftësive dhe shprehive.

Kultura e mësuesit, plan-programet pedagogjike dhe mjetet që ka në dispozicion kanë një rol të madh në zhvillimin e fëmijës në aspektin njohës dhe emocional. Sa më shumë të përputhen konceptet mes prindërve dhe mësuesve, dhe të bashkohen përpjekjet, aq më efektive do të jenë ato dhe rezultatet pozitive do të jenë më të mëdha.

Pjesa dërrmuese e gabimeve te mësuesit, shkollat dhe plan-programet edukativo-arsimore në shumë prej shteteve në "zhvillim" nuk është detyrimisht si rezultat i menaxhimit të keq ose qëllimit të keq, por është si rezultat i mangësisë në performansë dhe imitimit të verbër ndaj Perëndimit në përpilimin e plan-programeve dhe aktiviteteve mësimore.

Përkujdesi për çështjen e përgatitjes së mësuesit, për arsimin publik, plan-programet, mjetet dhe mangësitë në to, do të ndihmojnë shumë në përmirësimin e pikëpamjeve të autoriteteve përgjegjëse në fushën e edukimit dhe arsimin. Po ashtu do të ndikojnë në investim përmes saj edhe në gjenerata e ardhshme me një metodë pedagogjike të ekuilibruar, sidomos kur umeti vëren gjurmët e këtyre refor-

mave dhe programeve në zhvillimin e aftësive të fëmijëve dhe përmirësimin e performansave.

Mësuesi është sikur prindi në përkujdesin për interesin e fëmijës dhe për sukses në punën e tij. Ai nuk do të mund të luajë rolin e tij, përpos nëse realizohet vetëdijesimi i tij, përmirësohen kushtet e tij jetësore dhe pozita e tij shoqërore, mbështetet roli i tij me hulumtime pedagogjike shkencore dhe me libra dhe mjete mësimore të zhvilluara dhe efektive. Në mbështetjen e mësuesit, zhvillimin e tij pedagogjik dhe mjetet pedagogjike gjithashtu mund të kontribuojnë edhe mendimtarët, institucionet zyrtare dhe jozyrtare dhe përpjekjet e reformistëve.

5.2.9. Diskursi i shenjtë fetar: raporti mes çështjes njohëse dhe ndjenjës

Derisa jeta të vazhdon, edhe njohuritë dhe zbulimet nuk do të ndalen. Nuk do të ndalen as kërkimet, rishikimet dhe zhvillimet e shkencave. Njohuritë kërkohen dhe ripërtërihen që nga djepi deri në varr. Sa i përket aspekteve ndjenjës, psikike dhe pedagogjike, edhe ato e kanë kohën dhe hapësirën në fazat e jetës dhe zhvillimit njerëzor. Për këtë, aspekti ndjenjës psikik duhet të jetë bazamenti mbi të cilin ngritët aspekti njohës dhe metodat e të mësuarit të tij, edhe në fushën e besimit, vlerave dhe etikës.

Çdo gjë që i ofrohet fëmijës prej diturive -qoftë edhe në sferën e Kur'anit - duhet të shihet efekti i tij në formimin intelektual, psikik dhe ndjenjës të fëmijës, dhe atë në çdo fazë prej fazave të fëmijërisë.

Ndoshta prej sferave më të rëndësishme që duhet të sqarojmë lidhshmërinë mes aspektit njohës dhe atij ndjenjës dhe ndikimit reciprok mes tyre, është sfera e arsimit fetar, përfshirë edhe mësimin e Kur'anit. Plan-programet tradicionale rreth mësimin të Kur'anit janë të paplanifikuara

mirë. Ata qysh në fëmijëri ua mësojnë fëmijëve xhuzin tridhjetë të Kur'anit. Ndoshta këtë e bëjnë duke menduar se suret e shkurtra janë më të lehta për t'u mësuar se sa suret e gjata dhe se shumica e këtyre sureve mekase përmbajnë çështje të gajbit dhe të besimit.¹⁴⁷ Sipas neve, kjo metodologji duhet përmirësuar dhe duhet ofruar mësimin e Kur'an për fëmijën sipas bazamenteve metodologjike, shkencore dhe pedagogjike.

Xhuzi tridhjetë përmban fjalën e Allahut që në të shumtën e rasteve i drejtohet jobesimtarëve tiran dhe mohuesve të Zotit, si dhe kërcënim ndaj tyre në formën më të vrazhdë me poshtërim, dënim dhe përfundim të keq, duke i ftuar këta mendjemëdhenj të kuptojnë realitetin e gjendjes së tyre. Ky lloj i përmbajtjes përshtatet me aftësitë e të rriturve mendjemëdhenj që t'i ngarkojë me përgjegjësi, t'ua bëjë me dije pasojat e qëndrimit të tyre, me qëllim që të kthehen në gjendjen reale dhe të drejtë. Ky lloj i përmbajtjes që i drejtohet të rriturve nuk ka pasoja të shndërrimit të tyre në burra të dobët, e as nuk do të shkatërron fuqinë dhe guximin e tyre, por i udhëzon dhe i thërret për të menduar dhe medituat.

E njëjta përmbajtje nëse i drejtohet fëmijës së vogël, nuk do të ketë të njëjtin ndikim, ngase fëmija nuk ka nevojë për kërcënim. Nëse gabojmë dhe i drejtohem me të njëjtën formë që iu ka drejtuar Allahu mohuesve mendjemëdhenj, atëherë ndikimi psikik dhe ndjenjës do të shkatërron formimin e tij psikik, ngase ai do të frikësohet dhe do të vdes cilësia e fuqisë dhe guximit. Kështu, jeta para tij do të bëhet me frikë, ku do të merr qëndrim negativ dhe lëvizjet e tij nuk do të jenë sipas shpirtit të të qenët mëkëmbës në tokë,

¹⁴⁷ Xhuzi tridhjetë i Kur'anit përmban 37 sure. Të gjitha janë mekase përveç tri sureve: En-Nasr, Ez-Zelzele dhe El-Bejjineh dhe tre ajetet e para të sures El-Maun. Shih: Hasanejn Mahluf, *Safvet'ul-Bejan li mean'il-Kur'an*, Kuvajt: Ministria e Vakufit dhe Çështjeve Islame Kuvejtiane, bot. 3, 1407 h./ 1986.

por me shpirt frike. Te personi i frikësuar nuk mund të zhvillohet cilësia e kreativitetit e as nuk pritet që raportet me Allahun dhe Ditën e Kiametit të ngitet mbi ndjenjat e dashurisë dhe energjive pozitive.

Kjo, në masë të madhe, mund të komenton negativitetin e psikës muslimane në periudhën e rënies. Atëkohë u dobësua dashuria ndaj Allahut dhe u fsheh serioziteti i jetës. Këta njerëz jetën e ahiretit nuk e shohin ndryshe pos xhehenem i ndezur, edhe pse fundi i muslimanit -me mëshirën e Allahut- është në xhenet, “edhe nëse bën amoralitet, po edhe nëse vjedh”.¹⁴⁸ Sepse, Allahu llogaritë njerëzit për veprat e përgjithësuara, e jo vetëm për gabimet që bëjnë. Te shumica e njerëzve dominon e mira ndaj të keqes në jetën e tyre. Nuk është për t’u habitur kur shohim se si në periudhën e prapambetjes kanë mbisunduar ndjenjat e frikës ndaj shumicës së muslimanëve në çdo gjë. Ishte kështu, sepse ata nuk kishin kuptuar pasojat e diskursit të gabuar pedagogjik që i ishte drejtuar muslimanëve, në veçanti fëmijës, i cili ishte ngritur mbi ndjenjën e frikës, terrorizmit dhe ndëshkimit, e jo mbi ndjenjën e dashurisë, respektit, vetëbesimit, nxitjes, këshillimit dhe bartjes së përgjegjësive.

Pedagogu, bazuar në udhëzimet pejgamberike për fëmijërinë dhe hulumtimet shkencore pedagogjike të ngritura mbi bazën e vizionit, vlerave dhe qëllimeve kur’anore, duhet t’i ofron fëmijës opsionet kur’anore që përshtaten me natyrën e tij në fazat psikike nëpër të cilat kalon. E gjithë kjo, me qëllim që ta ofrojë drejt Allahut, t’i zhvillojë tek ai ndjenjat e dashurisë pozitive dhe t’ia bëjë të dashur vlerat

¹⁴⁸ Ahmed i transmeton në Musnedin e tij se Ebu Derdai radijallahu anhu ka thënë: Muhamedi alejh’is-selam ka thënë: “Kush thotë ‘La ilahe il-lal-l-lahu vahdehu la sherike lehu’ do të hyjë në xhenet. Thashë: Edhe nëse bën amoralitet dhe vjedh? Tha: “Edhe nëse bën amoralitet dhe vjedh”. Thashë: Edhe nëse bën amoralitet dhe vjedh? Tha: “Edhe nëse bën amoralitet dhe vjedh”. Thashë: Edhe nëse bën amoralitet dhe vjedh? Tha: “Edhe nëse bën amoralitet dhe vjedh për inat të Ebu Derdasë”. Shih: Esh-Shejbani, *Musned’ul-imam Ahmed ibn Hanbel*, vepër e cituar, vëll. 45, fq. 483, hadithi nr. 27491.

dhe qëllimet e Islamit. Kështu, ai kur të arrijë periudhën e para-pubertetit, duhet ta motivojmë -sipas opsioneve të përshtatshme kur'anore - për të kërkuar të mirën dhe të drejtën dhe për t'u larguar nga e keqja dhe e dëmshmja, duke mbjellë tek ai parimet dhe vlerat. Në të njëjtën kohë, heqim prej vetes së tij të njomë frikën dhe trishtimin kur bie në gabime të vogla, siç janë: gënjeshttrat e vogla ndonjëherë, dëmtimi i shokëve etj. Kështu, i japin atij mundësinë e kontrollit të vetes, largimin nga gabimi, edukimin e vetes me çështjet e pendimit, faljes dhe mëshirës hyjnore. Kështu, ai nuk ndjen ndjenjën e zhgënjimit, e cila do ta çojë në demoralizim psikik, dorëzim ndaj gabimeve dhe nënshtrim ndaj tyre.

Kur fëmija të arrijë moshën e pubertetit dhe hyn në grupin e të rriturve, ai - sipas opsioneve kur'anore - gjendet para përgjegjësive dhe i qartësohen pasojat e veprave të tij, tamam siç u vunë para përgjegjësive burrat arabë, të lirë dhe të fortë prej shokëve të Muhamedit alejh'is-selam.

Reformat kulturore dhe pedagogjike duhet të përfshijnë gjitha anët e formimit njohës, psikologjik dhe emocional të fëmijëve dhe adoleshentëve, si dhe të vihen në shërbim të formimit të shëndoshë të mentalitetit dhe psikikës së fëmijës. Aspekti i besimit dhe ai fetar janë prej elementeve më të rëndësishme të këtij formimi. Diskursi dhe komunikimi pejgamberik i ngritur mbi bazën e meditimit dhe kuptimit shkencor ndaj ligjeve, duhet të jetë udhërrëfyes dhe bazament për përpilimin e plan-programeve pedagogjike që përfshijnë aspektet njohëse, psikike dhe emocionale të fëmijërisë.

Duhet të kuptojmë lidhshmërinë mes aspektit njohës dhe atij psikik dhe emocional në gjitha çështjet që ia mësojmë fëmijës, përfshirë edhe Kur'anin, për të cilin nuk mendoj se gjatë arsimimit të tij kemi zbatuar metodologjinë pedagogji-

ke të shëndoshë, për të zgjedhur përmbajtjet e përshtatshme në çdo fazë, prej fazave të zhvillimit të fëmijës dhe formimit të tij psikik. Kështu, në fillim duhet t'ia shtojmë dashurinë ndaj Allahut subhanehu ve teala, dashurinë ndaj fesë, umetit, lidhshmërinë me Zotin dhe besimin e tij. Me zhvillimi dhe pjekurinë e tij në mënyrë graduale ia mësojmë çështjet që ndërlidhen me përgjegjësitë dhe pasojat e veprave përballë vetes dhe umetit të tij. Atij, në këtë periudhë, duhet drejtuar me gjuhën e përgjegjësisë dhe duhet këshilluar për çështjet që janë si pasojë e veprave të tij.

Ky koncept pedagogjik që merr parasysh gjurmët emocionale përshtatet me çdo gjë që i ofrohet fëmijës, qoftë mendim, kulturë apo njohuri, që përshtatet me secilën fazë të zhvillimit të tij, pa pasur asnjë dallim mes një grupi dhe tjetër, mes elitës dhe popullatës së thjeshtë, ngase të gjithë janë vëllezër, sepse ata janë ushtri e umetit islam.

Gjitha, shtresat e umetit, mendimtarë dhe reformatorë, baballarë dhe nëna, edukatorë dhe mësues, individë dhe institucione, duhet që procesit edukativo-arsimor t'i japin prioritetin, kujdesin dhe mundin e kërkuar. Po ashtu të rishikojnë bazamentet e formimit të umetit, shpërthimin e fuqisë në fëmijërinë e formimit dhe zhvillimin e resurseve njerëzore të ngritura mbi baza njohëse dhe emocionale islame, shkencore dhe të shëndosha.

Që fjala të shndërrohet në vepra dhe ideja në veprim, duhet filluar duke vënë plane të përgjithshme për veprim, në të cilin do të bashkëpunojnë gjithë njerëzit e sinqertë, me qëllim të nxjerrjes së një gjenerate të besimit, fuqisë, krenarisë dhe reformimit.

KAPITULLI I GJASHTË

Plani i punës

6.1. Frontet e veprimit

Çdo plan i punës, nëse dëshirojmë të jep frutat e shpresuara, në esencë duhet të jetë shumëdimensional dhe duhet të realizohet në fronte të ndryshme, të baraspeshuara, të përplotësuara dhe të koordinuara. Kur flitet për fëmijën, qëllimi i këtij plani është të sjellë ndryshim psikik dhe emocional, me qëllim që muslimani të bëhet i fortë, ndikues dhe kreativ. Kjo nënkupton riformimin e mentalitetit të myslimanit, me qëllim që të jetë mentalitet i shëndoshë, i fortë, shkencore dhe serioze.

Nëse dëshirojmë realizimin e këtij qëllimi, është patjetër të rikthejmë vizionin islam të periudhës së shpalljes. Kjo mund të arrihet përmes pastrimit kulturor nga ajo që e ka goditur vizionin dhe kulturën islame në periudhat e përçarjes dhe autokracisë. Në këtë drejtim ndihmon fuqishëm edhe rikthimi i diskursit dhe komunikimit pejgamberik drejtuar fëmijëve, me qëllim që të jetë bazament për reforma pedagogjike, përmes së cilave mbillen farat e reformave njohëse dhe emocionale në edukimin e fëmijës mbi baza të forta, që do t'ia kthen umetit “dimensionin e humbur” në projektin e reformave islame dhe civilizuese.

6.1.1. Vetëdijesimi i mendimtarëve dhe njerëzve të kulturuar

Hapi i parë në këtë plan është vetëdijesimi rreth natyrës së problemit dhe dimensionet e saj kulturore dhe historike. Krahas sinqeritetit të madh, me të cilin cilësohen shumë prej mendimtarëve dhe njerëzve të kulturuar, si dhe krahas

përpjekjeve të shumta dhe të lodhshme që janë harxhuar gjatë shekujve brenda rrethanave dhe sfidave me të cilat është ballafaquar umeti, gjitha këto përpjekje kanë pasur efekt të kufizuar që nuk kanë dhënë frutat e synuara e as nuk janë realizuar qëllimet për rikthimin e fuqisë dhe energjisë së umetit. E gjithë kjo, për shkak të nevojës për vizion gjithëpërfshirës, anashkalimit të rolit të mendjes që bazohet në ligje të sakta për hulumtim dhe studim psikik dhe shoqëror, dhe për shkak depërtimit të ideologjisë metafizike greke që ka depërtuar në mendjen e muslimanit dhe ka dominuar në ideologjinë dhe horizontet njohëse të umetit. E gjithë kjo, krahas konflikteve politike që shumë dije-tarë janë detyruar të përballen me elitën politike autokrate, për të mbrojtur çështjet e shenjta dhe për të ruajtur trashëgiminë, gjurmët e të së cilës -deri më sot- dominojnë në mendimin fetar tradicional dhe dobësojnë formimin psikik dhe energjinë emocionale të umetit.

Nëse vetëdijesimi në një sasi të përshtatshme të interesimit të mendimtarëve, pedagogëve dhe reformistëve për rëndësinë e fëmijërisë dhe familjes në aspektin pedagogjik, përpjekja e mjaftueshme për pastrimin kulturor, zhvillimin e koncepteve dhe mjeteve pedagogjike dhe rritjen e studimeve serioze në këto sfera është i suksesshëm, atëherë ndryshimi brenda një gjenerate është i mundur. Këtë e ka argumentuar metoda pedagogjike, të cilin e ka zbatuar Musa alejh'is-selam në lirim të robëruarve nga Beni Israilët.¹⁴⁹ Po ashtu metodën që e përfaqëson diskursi dhe

¹⁴⁹ Është e rëndësishme të kuptojmë dallimin mes natyrës së popullit në të cilin është dërguar Musa alejh'is-selam dhe popullit që barti mesazhin islam deri të popujt e ndryshëm, si dhe ndikimin e gjithë kësaj në metodat që përdori Musa alejh'is-selam gjatë bashkëveprimit me popullin e tij dhe mënyrën e komunikimit që e drejtoi Muhamedi alejh'is-selam para popullit të tij, duke mësuar nga kjo për metodat dhe komunikimin e kërkuar për t'iu drejtuar popujve musliman. Musa alejh'is-selam u dërgua te Beni Israilët të cilët ishin të robëruar në Egjipt. Metodën që përdori Musa alejh'is-selam ishte formimi i një gjenerate të re, të lirë, fisnike dhe trime në "Malin Sina" gjatë dyzet viteve. Ndërsa, Muhamedi alejh'is-

shëmbëlltyra pejgamberike në edukimin e fëmijëve dhe adoleshentëve, krahas asaj që e kanë vërtetuar eksperimentet e popujve bashkëkohor. Shumë prej neve e dinë ndryshimin e madh që ka ndodhur në koncepte dhe njohuri brenda vetëm një gjenerate, e që është gjenerata jonë. Kjo tregon se një ndryshim i tillë, bile edhe më i madh, mund të ndodhë në një gjeneratë pas nesh. E gjithë kjo nëse përpikemi dhe nëse sjellim gjëra të reja gjatë dyzet ose pesëdhjetë viteve të ardhshme, inshaAllah.

6.1.2. Zhvillimi i mendimit islam, shoqëror dhe kritik

Janë bërë përpjekje të mëdha dhe janë mbrojtur disertacione të shumta, me qëllim të reformave ideologjike dhe përplotësisimit njohës mes udhëzimeve hyjnore, respektivisht ajeteve kur'anore, nga njëra anë dhe hulumtimeve mendore, argumenteve në hapësirë, ruajtja e çështjeve konstante dhe aktivizimi i çështjeve të ndryshueshme, nga ana tjetër. Mirëpo, izolimi i dijetarëve dhe praktikantët e tyre shkencore tradicionale ka bërë që baza kulturore dhe ideologjike islame të mos ndihmon në zhvillim dhe aktivitet deri më sot. E gjithë kjo, pa hetuar -me gjithë sinqeritetin dhe mendimet e mira- shumë prej specialistëve, reformistëve dhe masës së thjeshtë.

Për të aktivizuar mendjen e shëndoshë dhe për t'i bërë kushtet e pjekura, nevojitet patjetër nxitja e mendimit islam,

selam u dërgua tek arabët të cilët ishin të ndarë në fise të lira dhe fisnike, që nuk iu kishin nënshtruar cezarëve e as mbretërve. Për këtë, Muhamedi alejh'is-selam iu drejtua besimtarëve në formë të përgëzimit dhe përgjegjësisimit, ndërsa mohuesve dhe jobesimtarëve në formë vërejtjeje dhe kërcënimi. Ata bartën mesazhin fuqishëm dhe me plot besnikëri, ngritën flamurin islam dhe ngritën shtyllat e civilizimit. Kur mbretërit nënshtruan popujt islam, rizgjimi i dytë i tyre ishte në duart e fiseve turke, të lira dhe trime të cilat kishin hyrë në islam dhe kishin ngritur Shtetin Osman. Sot, metodën që ka përdorur Musa alejh'is-selam me popullin e tij është i përshtatshëm për gjendjen e popujve musliman. Është patjetër ripërtëritja e bazamenteve dhe reformimin e mentalitetit të muslimanit, në atë mënyrë që do të rikthehen vetitë e diskursit dhe komunikimit pejgamberik, drejtuar fëmijëve dhe adoleshentëve. Po ashtu, duhet vrojtuar të islamizuarit e rinj nga popujt e lira dhe të përparuar që cilësohen me fuqi dhe trimëri, e që mund të jenë fuqi për islam, dhe në të njëjtën kohë duhet ruajtur cilësitë e fuqisë dhe trimërisë tek ata.

shkencor, shoqëror dhe kritik, i cili synon rikthimin e vizionit të përgjithshëm islam, përplotësimin e burimeve të njohurive, siç janë: shpallja, mendja dhe hapësira. Më pas - në bazë të këtij vizioni dhe kësaj metode - të realizohet pastrimi i kulturës islame nga ndyrësitat dhe zhvillimi i plan-programeve mësimore për rikthimin e formimit psikik dhe intelektual islam.

Janë bërë shumë përpjekje të rëndësishme për reforma, por, për shkak të mosinteresimit për ndryshim pedagogjik të fëmijës, nuk kanë pasur sukses në realizimin e qëllimeve dhe ngritjen e umetit. Ka mbetur vetëm një diskurs dhe komunikim frikësues, dhe thirrje për njohje drejtuar të rriturve. Prej këtyre përpjekjeve në historinë e umetit është përpjekja e imam Ebu Hamid Gazaliut (vd. 1111). Gazaliu shumë herët kishte kuptuar nevojën për reforma njohëse, të cilat i kishte prezantuar në librin e tij “Tehafut’ul-felasife”, me qëllim të pajtimit mes fetares dhe racionales. Ndërsa në librin e tij, “Thjau ulum’id-dini”, ka synuar pajtimin mes çështjeve legjislative racionale dhe emocionale. Mirëpo, kjo thirrje dhe ky orientim nuk kishte sukses në sjelljen e ndryshimit dhe reformave njohëse, ngase sukcesi është i kushtëzuar në formim mbi baza metodologjike, nga njëra anë dhe nga ana tjetër, sukcesi i reformave emocionale dhe pedagogjike është i kushtëzuar që të orientohet në mënyrë shkencore dhe të studiuar drejt fëmijërisë.

Po ashtu, Imam Tekijuddin Ahmed ibn Tejmije (vd. 1328) vërejt një çështje të rëndësishme në formimin e personalitetit njerëzor, e që është çështja e besimit. Mirëpo, dominimi i mendimit teorik dialektik -të cilin e kishin imponuar rrethanat dhe kultura e kohës- nuk i kishte mundësuar këtij dimensionin njohës të merr rrugën drejt anës pedagogjike dhe investimin e tij në plan-programe pedagogjike, praktike dhe efektive, me qëllim të ndryshimit dhe formi-

mit të fëmijërisë. Bile shumë prej atyre që qenë ndikuar me mendimet e Ibn Tejmijes, ishin njerëzit më të largët nga perceptimi dhe përkujdesi ndaj mjeteve psikike, emocionale dhe pedagogjike.

Imam Ali ibn Ahmed ibn Hazm (vd. 1064) ka kontribuar në formimin e bazamenteve të metodologjisë shkencore dhe shoqërore. Po ashtu, dijetari i famshëm Ebu Zejd Abdurrahman ibn Haldun (vd. 1406) kishte vënë themelet e kësaj metodologjie. Mirëpo, mendimet e këtyre dy imamëve janë anashkaluar, siç janë anashkaluar mendimet e shumë prej dijetarëve kreativ në periudhën e imitimit dhe ngurtësisë ideologjike. I pari prej tyre është Dhahiri, ndërsa shkrimet e të dytit nuk ishin në interesimet e mendimit tradicional. Për këtë, ky mendim nuk është shfrytëzuar në formimin e njohurive shoqërore islame, e as në zhvillimin e studimeve shkencore pedagogjike për të sjellë ndryshimin e shpresuar në esencën e formimit të fëmijërisë muslimane.

Prej dijetarëve të mëvonshëm kemi imam Muhamed Abduhu (vd. 1905) dhe pas tij personalitete nga shkolla "El-Menar". Që të gjithë janë përpjekur për rëndësinë e besimit të shëndoshë, dhënies hapësirën e merituar mentalitetit shkencor dhe pastrimin e kulturës islame nga konceptet mitologjike dhe magjike. Po ashtu Shejh Abdurrahman Kevakibij (vd. 1902) kishte kuptuar rëndësinë e dimensionit të përgjithshëm dhe politik dhe domosdoshmërinë e theme- limit të tij mbi baza të shëndosha dhe të forta të parimeve dhe vlerave islame, si dhe domosdoshmërinë e çrrënjosjes së autokracisë në shoqëri. Megjithatë, gjitha këto reforma nuk kanë arritur nivelin e kërkuar, e as nuk i kanë realizuar synimet e shpresuara, sepse ato kishin mbetur brenda kornizave të njohjes dhe brenda kornizave të komunikimit me të rriturit, e nuk ishin drejtuar në drejtim të fëmijërisë, edukimit dhe ndryshimit në bazamentin e formimit të personalitetit njerëzor.

Gjitha këto përpjekje, si dhe ato që erdhën më pas, nuk sollën ndryshimin e kërkuar, sepse mendimi i ngurtë, ngurtësia shkollore dhe imitimi kishin anashkaluar gjitha këto përpjekje dhe nuk kishin lejuar zhvillim dhe bashkëveprim për themelimin e mendimit shkencor islam, i cili ngritët mbi përplotësimin e metodologjisë njohëse, formimin e shkencës psiko-shkencore dhe zhvillimin e metodologjisë pedagogjike.

Nga ana tjetër, mendimi i importuar perëndimor mbeti i papranueshëm për ndjenjat dhe psikën e umetit dhe bazamentet e formimit të tij akaidologjik (të besimit), gjë që po ashtu, në mënyrë mekanike dhe për shkaqe objektive ka anashkaluar ndikimin e tij në ndjenjat e umetit.

6.1.3. Reformat pedagogjike dhe rregullat pedagogjike në familje¹⁵⁰

Nëse kuptuam rëndësinë e pastrimit kulturor dhe metodës pedagogjike të fëmijës, po ashtu është e rëndësishme

¹⁵⁰ Prej formave të interesimit të shkollës "Islamizimi i njohurive" për aspektin pedagogjik dhe rregullat pedagogjike të familjes muslimane, Instituti Botëror i Mendimit Islam ka botuar një numër të librave të rëndësishme dhe ka organizuar seminare shkencore rreth çështjeve pedagogjike përgjatë më shumë se një dekade. Prej këtyre botimeve kemi tre botime të librit "*Delilu mektebet'il-usret'il-muslimet*", të cilin e kisha planifikuar dhe kisha mbikëqyrë përgatitjen e tij kur isha Sekretar i përgjithshëm i WAMY-t (1973-1979). Përmbajtja e këtij libri orientues është njohje rreth veprave më të mira që gjenden në bibliotekat arabe që përmban libra dhe shkrime të dalluara për periudha të ndryshme të jetës të anëtarëve të familjes, rolet e ndryshme familjare. Këtij libri orientues i është bashkëngjitur edhe një shtojcë që ndihmon lexuesin të arrijë atë që dëshiron, sipas periudhës, rolit, specializimit, në mënyrë të lehtë, duke dhënë një biografi të autorëve të këtyre librave.

Instituti po ashtu është duke përgatitur një vepër enciklopedike dhe të përgjithshme. Kjo vepër është "*Delil'ul-Kissat'il-islamijet*" për t'i shërbyer familjes. Ky udhërrëfyes ofron tregime të pastra argëtuese, ndihmon për pjekuri shoqërore, mbjell vlerat e larta dhe i mbështet ato tek anëtarët e familjes dhe atë në fazat e ndryshme të jetës. Ai përfshin të gjitha llojet e tregimeve dhe të gjitha llojet e shkrimtarëve, pa marrë parasysh temën e tregimit ose identitetin e shkrimtarit, ngase kriter ishte lloji i tregimit nga aspekti artistik, vlera e saj, ndikimi pedagogjik dhe ndikimi i saj në suksesin e projektit të synuar reformues islam. Instituti po ashtu është duke përgatitur pjesë të zgjedhura letrare të dalluara në fushën "En-Neshid'ul-islami" për qëllime të ndryshme shoqërore dhe emocionale, sepse poezitë kanë ndikim në formimin e aspekteve emocionale dhe estetike në psikikën njerëzore në përgjithësi dhe atë islame në veçanti.

të kuptojmë rëndësinë e përqendrimit nga ana e mendimtarëve, sociologëve, psikologëve dhe pedagogëve për të ofruar rregullat shkencore për të mësuar prindërit se si duhet realisht të jenë prindër, duke iu ofruar atyre konceptet islame-shkencore dhe shoqëroro-pedagogjike, të cilat do të ndihmojnë në formimin e familjes së shëndoshë, duke u përkujdesur për te si vendstrehim pedagogjik dhe efektiv për rritjen e fëmijës.

Përderisa jemi duke folur për letërsinë në përgjithësi dhe për tregimin dhe letërsinë e fëmijëve në veçanti, është e rëndësishme këtu të theksojmë se letërsia është prej metodave më të rëndësishme artistike që ndikojnë te fëmijët. Letërsia artistike shpalos karakteristikat dhe kulturat e popujve. Njohja e këtyre karakteristikave dhe simboleve kanë rëndësi të madhe në komunikim me shpirtin e civilizimit. Në anën tjetër, keqkuptimi i këtyre karakteristikave dhe simboleve, në veçanti në periudhat e rënies, llogaritet prej çështjeve që fuqishëm ndikojnë në deformimin ideologjik dhe kulturor të popujve.

Shembull në lidhje me to kemi keqkuptimin e simboleve islame, të cilat janë përfshirë në tregimet historike, në veçanti tregimet e “njëmijë e një natë” dhe të ngjashme me to. Në këto tregime shpesh here paraqiten simbole të këqija dhe të dëmshme në formë njerëzve, egërsirave dhe zvarranikëve, siç janë luajt dhe gjarpërinjtë. Qëllimi i këtyre simboleve në këto tregime është të jenë barrierë për arritjen deri të thesaret dhe çështjet e çmuara. Mirëpo, këto fuqi të dëmshme zhduken para trimërisë së trimave prej kërkuesve të thesareve, sepse këto simbole brenda realitetit të kornizave të imagjinatës islame janë simbole të së keqes, korrupsionit dhe tiranisë që vijnë si barrierë para thesareve të së vërtetës dhe hajrit. Po ashti se si trimëria dhe qëndrimi i paluhatshëm i kërkuesve të së vërtetës dhe hajrit e

mposhtë fuqinë e sherrit dhe tiranisë, si dhe dominimi i të keqes dhe korrupsionit në realitet është iluzion.

Është për keqardhje që karakteristikat dhe simbolet letrare të civilizimit dhe kulturës islame për shkak të injorancës, të shndërrohen dhe të bëhen hyrje dhe bazë për mendime mitologjike, iluzione dhe imagjinata të rrejshme, përmes të cilave në zemrat e fëmijëve depërton frika dhe trishtimi nga bota e xhinëve. Kështu, këto simbole shndërrohen nga imagjinata dhe simbole letrare dhe kreative, fotografi artistike dhe mjete argëtimi që mbështesin energjinë e besimit dhe trimërisë, zhvillojnë energjitë e rezistencës ndaj padrejtësive dhe korrupsionit tek adoleshentët dhe të rinjtë, në mjete për përralla që do të shndërron energjitë civilizuese pozitive në kazma për prishje dhe prapambeturi, në mjete efektive për terrorizëm psikik, mbështet sistemet e poshtërimit dhe autokracisë, si dhe ndihmon në reklamimin e prodhimit të fallxhorëve.

6.1.4. Reformat në arsimin e lartë

Reformat metodologjike, ideologjike dhe kulturore, për të pasur sukses janë të domosdoshme reformat në arsimin e lartë, sidomos universitetet private, të cilat kanë më shumë liri dhe motiv për ripërtëritje dhe ndryshim. Këtu përfshihen edhe universitetet që gjenden në shtete që respektojnë lirinë, pavarësinë në vendime dhe respektojnë punën akademike. Universitet janë institucione të autorizuara për përgatitjen e kadrove kulturore, shkencore, teknike dhe artistike, në veçanti në sferën e shkencave të besimit, fikhut (legjislacionit, shoqërore dhe humane. Për realizimin e këtyre qëllimeve janë të domosdoshme reformat në plan-programet shkencore, të cilat studiohen në periudhën e arsimit të lartë. Unifikimi i këtyre plan-programeve me burimet e njohjes dhe përplotësimi i tyre në mënyrë islamike

dhe shkencërisht, mundëson të shkolluarit dhe ekspertët islam të kenë alternativa tjera në gjitha sferat e njohurive humane dhe fizike. E gjithë kjo me qëllim që të kenë mundësi të prodhojnë mendim dhe kulturë islame, të unifikuar dhe me qëllime të caktuara.

Ndërkombëtarizimi i komunikimit dhe mundësitë e mëdha elektronike në fushën e mjeteve të komunikimit dhe arsimimit, krahas hapjes së mundësisë për arsimim para përpjekjeve të reformistëve dhe biznesmenëve të sinqertë, japin një mundësi të madhe për pjesëmarrje për reforma në arsimin e lartë, nxitjen e hulumtimit shkencor dhe përmirësimin e nivelit në cilësi dhe sasi, ku si rezultat i saj do të arrihet përgatitja e kuadrove dhe hulumtimeve të cilat i përgjigjen nevojave të umetit, përballojnë sfidat e kohës, veprojnë në pastrimin dhe mënjanimin e deformimeve dhe në fund çrrënjosjen e perëndimizimit, ngurtësisë dhe copëtimit kulturor.¹⁵¹

¹⁵¹ Është e dobishme të potencojmë këtu rëndësinë e mësimit të të gjitha llojeve të njohurive, qofshin humane, shoqërore, fizike dhe teknike, në universitetet tona në gjuhën arabe si pjesë e reformave në arsimin universitar. Themi kështu sepse gjuha arabe është gjuha e parë në botën arabe dhe atë islame. Duhet pasuruar atë me të gjitha arritjet dhe zbulimet shkencore që ka arritur të realizon civilizimi njerëzor, ngase kreativiteti vjen vetë përmes gjuhës së parë, e cila në këtë rast është gjuha arabe. Nuk ka dyshim se prej shkaqeve të dështimit në përballimin e sfidave shkencore dhe teknologjike gjatë dy shekujve është edhe ajo se ne ua mësonim - dhe vazhdojmë- studentëve shkencat fizike dhe teknologjike në universitetet tona në gjuhë të huaja. Kur ua mësojmë shkencat humane në gjuhën arabe, vërejmë se nuk ka lidhshmëri mes kulturës sonë dhe institucioneve arsimore me prodhimin e civilizimit njerëzor përmes përkthimit të revistave shkencore të rëndësishme të cilat botojnë hulumtimet dhe zbulimet e reja, duke mjaftuar me përkthimin e disa veprave letrare klasike dhe romaneve tregtare.

Arsimimi në gjuhën e parë është i rëndësishëm, mirëpo, me kusht që të mbështetet me përkthime shkencore të hulumtimeve dhe zbulimeve të reja. Kjo mund të realizohet përmes institucioneve për përkthime shkencore dhe kuadrove që përbëhen nga studentët, profesorët e studimeve të larta dhe qendrave për hulumtime shkencore, të cilat kushtëzojnë përgatitjen e mirë në gjuhët botërore.

Shpresoj të themelohen fakultete për përkthim dhe institucione kombëtare për përkthim dhe publikim shkencor për të pasuruar kulturën e umetit dhe për të zgjeruar rrethin e kulturës shkencore që të sjell të ardhura materiale dhe të nxisë biznesmenët të japin kontributin e tyre në pasurimin e kulturës së umetit. Shpresoj të fillojmë me veprime dhe të heqim dorë nga dialogjet shterpe rreth fuqisë së gjuhës arabe për të gëlltitur njohuri dhe shkencat. Gjuha arabe këtë e ka bërë më parë ashtu siç bëjnë sot popujt e përparuar, krahas asaj se gjuha arabe është shumë më e pasur se gjuhët tjera. Qendrat gjuhësore dhe

Puna serioze për realizimin e gjithë asaj që u tha, në veçanti përkujdesi i shpejtë për prodhimin e kulturës familjare islame, i ngritur mbi vizione dhe koncepte kulturore, pedagogjike dhe shkencore islame të shëndosha, si dhe sigurimi i tyre në rrugë më të lehta, të botuara, audio, vizuale dhe elektronike, duke i motivuar të rinjtë për lexim, është një çështje që duhet marrë iniciativë me shpejtësi. Krahas saj, duhet bërë vetëdijesimin e mendimtarëve, pedagogëve, të shkolluarve, botuesve dhe gjithë atyre që merren me procesin edukativo-arsimor për rëndësinë e madhe në këtë periudhë që të jetë një pjesë e pandarë e interesimeve të umetit deri sa të depërton në esencën e kulturës dhe praktikave të umetit.

6.2. Plani i shkollës “islamizimi i diturive” dhe zhvillimi i mendimit bazik islam

Nuk mund të kuptojmë plotësisht rrymat ideologjike bashkëkohore në Botën Islame, as nuk mund të plotësohen perceptimet rreth përpjekjeve për reforma civilizuese islame dhe ripërtëritjen e formimit të umetit dhe rolin e saj civilizues, deri sa nuk kuptojmë natyrën e shkollës “islamizimi i diturive”, qëllimet të cilat dëshiron t'i realizojë dhe përpjekjet që janë realizuar gjatë dekadave të kaluara për të nxitur aspektet ideologjike, kulturore dhe pedagogjike në projektin e reformave civilizuese islame.

Sidoqoftë, atë që do ta cekim këtu rreth shkollës “islamizimi i njohurive”, nuk kemi për qëllim detajizimin e përpjekjeve dhe eksperimenteve, por qëllimi është dhënia e një pasqyre të shkurtër rreth dimensioneve të këtyre përpjekjeve dhe horizonteve të cilat synon realizimin e tyre.

mjetet e informimit duhet të luajnë rolin e tyre në formimin, unifikimin dhe reklamimin e terminologjisë në arsimimin e të rinjve të umetit.

6.2.1. Themelimi dhe rruga

Këtë shkollë e kanë themeluar disa të rinj që kanë bashkuar dy kultura: islame dhe atë pozitive. Mendimet e para janë shfaqur në aktivitetet, shkrimet dhe disertacionet e tyre të hershme, para se të bashkohen dhe të përplotësohen përpjekjet e tyre në sferën e punës islame dhe shërbimin e ripërtëritjes islame. Prej këtyre librave të hershme është edhe libri “Teoria ekonomike islame: filozofia dhe mjetet bashkëkohore” e autorit të këtij hulumtimi. Librin e ka botuar Darul Hanxhi në Kajro më 1960.¹⁵² Në këtë libër, autori ka theksuar themelet e metodologjisë së mendimit të kërkuar islam, rëndësinë dhe mundësitë për ringjalljen e mendimit islam bashkëkohor.

Mendimet e këtyre të rinjve, gjatë viteve të gjashtëdhjeta të shekullit të kaluar, kur u takua grupi i parë i tyre, u shndërruan në program pune. Kjo ndodhi gjatë delegimit të studentëve për studime në Amerikë nga shtetet e Botës Islame, të cilat shumë prej tyre sapo ishin pavarësuar. Fillimi i tubimit të këtyre grupeve ishte angazhimi për themelimin e shoqatave studentore kulturore dhe islame, që do të grumbullonin studentët e deleguar atje në kurbet, ku ndjeheshin si të huaj në aspektin fetar, kulturor dhe shoqëror. E gjithë kjo ishte me qëllim që të ruaj identitetin e të rinjve musliman të deleguar, për të mbrojtur besimin e tyre dhe për t’i këshilluar se ku duhet drejtuar energjinë dhe përpjekjet e tyre, gjë që do të ndihmon në shërbimin e umetit dhe realizimin e qëllimeve dhe ambicieve.

¹⁵² Si rezultat i perceptimit nga ana e autorit rëndësinë e zbulimit në metodologji është se ai u përcaktua që tema e hulumtimit të tij shkencor për arritjen e doktoraturës në marrëdhëniet ndërkombëtare në Universitetin Pansilvani në Filadelfi me titull: “Teoria islame në marrëdhëniet ndërkombëtare: orientime të reja në mendim dhe metodologji”. (1973). Në të ka folur gjerësisht për aspektet inovative në metodologji. Ka argumentuar në këtë hulumtim për fuqinë e kësaj metodologjie në rinovim ideologjik dhe zhvillimin e mendimit islam në këtë sferë. Profesi i shkencave politike në universitetin Melik Saud në Rijad në Saudi, dr. Nasir Burejk ka përkthyer librin në arabisht dhe e ka botuar.

Bazuar në përgatitjen e këtij grupi të të rinjve dhe në diapazonin e tyre kulturor, ata kuptuan rëndësinë e dimensionit ideologjik në krizën e prapambetjes shkencore dhe civilizuese të umetit. Po ashtu kuptuan rëndësinë e riaftësimin të umetit me anë të reformave në metodologjinë e mendimit, pastrimin e kulturës dhe zhvillimin e plan-programeve pedagogjike dhe metodave mësimore. E gjithë kjo me qëllim të zhvillimit të energjive psikike dhe emocionale, si dhe zhvillimin e fuqisë së nevojshme njohëse dhe teknologjike për bartjen e vështirësive në rrugën e reformave islame dhe ndryshimit civilizues.¹⁵³

Bazuar në vullnetin dhe vizionin e këtyre të rinjve, u themelua në fillim, më 1963, "Unioni i studentëve musliman ne SHBA dhe Kanada" (MSA of the US and Canada). Brenda një dekade, ky union u bë shoqata më e madhe kulturore-studentore-islame në Perëndim. Anëtarët e saj kishin arritur në mijëra nga e gjithë Bota Islame, ku shumica e tyre ishin të deleguar për studime të larta.

Nga Unioni i studentëve musliman dolën disa shoqata islame profesionale dhe shkencore. Më e rëndësishme ishte "Shoqata e Shkencëtarëve Social Muslimanë" (Association of Muslim Social Scientists), e cila është themeluar zyrtarisht më 1972. Qëllimi i kësaj shoqate ishte unifikimi i përpjekjeve të studentëve musliman prej studentëve të shkencave shoqërore dhe humane për të shfrytëzuar njohuritë dhe aftësitë e tyre shkencore në zhvillimin e mendimit bazik islam, reformimin e plan-programve, veprimi për themelimin e shkencave shoqërore dhe humane islame të ngritura mbi qëllimet e sheriatit dhe çështjet konstante,

¹⁵³ Disa njerëz nga injoranca ose shtiren si të tillë thonë se si është e mundur të ketë shkenca islame dhe joislame?! Përgjigjja në lidhje me te është se qëllimi i islamizimit të njohurive është çdo gjë që ndërlihet me filozofinë e shkencave dhe me qëllimet nga veprimi në këto sfera, metodat e orientimit, duke përfutur prej tyre në mënyrë pozitive dhe me ndjenjë përgjegjësie, dhe për të mos lejuar të jenë mjete për shtypje, padrejtësi, shkatërrimin e ambientit dhe keqpërdorimin e resurseve.

konceptet dhe pikënisjet e islamit, gjetja e një gjuhe të përbashkët me studentët e shkencave shoqërore dhe humane bashkëkohore.

Për shkak të mungesës së specializimit shkencor dhe sipërfaqësimit, te shumica e shkrimtarëve në sferat islame, në shkrimet e tyre ka dominuar fryma mbrojtëse dhe supozimet e pakuptimta. Kjo çështje shkaktoi një zbrazëtim mes mendimtarëve islam, reformistëve islam dhe studentëve të studimeve shoqërore, perëndimore dhe bashkëkohore, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, udhëheqësve, elitës politike dhe thirrësve për modernizim. E gjithë kjo për shkak të formimit ideologjik perëndimor dhe përgjegjësive të tyre praktike te këta të fundit.

Në dekadat që pasuan, një numër i madh i të deleguarve musliman mbetën në SHBA. Kështu, për shkak të rënies së gjendjes politike dhe shoqërore në shumë prej vendeve islame, ndodhi një emigrim i madh i kokave intelektuale muslimane në SHBA. Nga Unioni i studentëve musliman, më 1980 lindi “Shoqata Islame për Amerikën Veriore” (Islamic Society of North America -ISNA). Qëllimi kësaj shoqate ishte shërbimi i kulturës dhe identitetit islam për popullatën islame në Amerikën Veriore dhe Kanada.

Nga fillimi i shekullit XV hixhri, respektivisht më 1981, Instituti Botëror i Mendimit Islam u themelua si institucion shkencor-ideologjik-islam, i specializuar dhe i pavarur. Ai vepron në shërbim të mendimit islam dhe ripërtëritjen e formimit të tij në aspektin metodologjik dhe njohës, pas-trimin e kulturës islame mbi baza të shëndosha islame dhe shkencore, duke evituar deformimet që janë ngjitur në te. Ai ripërtërin formimin psikologjik islam dhe e liron njeriun në aspektin njohës, psikik dhe emocional, duke e rikthyer dimensionin e tij kolektiv, fuqinë civilizuese dhe kreative. Në gjitha këto çështje, instituti bashkëpunon dhe përplotë-

sohet me shoqatat e dijetarëve musliman të sociologjisë në shërbim të mendimit dhe kulturës islame.

Në drejtim të përgatitjes së hapësirës kulturore dhe akademike për të luajtur rolin e ripërtëritjes së formimit të metodologjisë së mendimit islam dhe pastrimit të kulturës islame, Instituti Botëror i Mendimit Islam ka bërë hapa serioze. Bazament i tij është reformimi metodologjik dhe përplotësimi i burimeve të njohurive islame. Njohja islame sipas konceptit të shkollës “islamizimi i njohurive”, nuk është vetëm njohje mekanike, por është njohje gjithëpërfshirëse dhe proces që përkujdeset për jetën politike, shoqërore, ekonomike, pedagogjike dhe shkencore, që depërton në brendinë e karakterit dhe rruga e saj ecë mbi dritën e çështjeve konstante të bazuar në shpalljen hyjnore islame dhe qëllimet e larta.

Instituti deri më sot ka botuar diku pesëqind libra në fusha të ndryshme të shkencave fetare, shoqërore, ekonomike dhe pedagogjike. Ai përkujdeset vazhdimisht për trajtimin e mënyrës së bashkëveprimit me Kur’anin Famëlartë dhe sunnetin e Muhamedit alejh’is-salam, bashkëveprimit me trashëgiminë kulturore, bashkëveprimit me mendimin perëndimor, bashkëveprimit me shkencat natyrore, përfshirë jetën dhe hapësirën, krahas trajtimit të çështjeve të metodologjisë së mendimit, rrugët e aktivizimit të mendimit islam dhe shfrytëzimin e burimeve të tij për formimin e shkencave shoqërore, humane, pedagogjike dhe ekonomike islame.

Për të njëjtin qëllim, Instituti ka organizuar qindra ligjërata, simpoziume dhe konferenca shkencore në shumë prej qendrave shkencore në vende të ndryshme të botës islame. Për këto qëllime ka vënë në shërbim një numër të zyrave kulturore të tij, për të përcjellë mesazhin e Institutit. Ka paraqitur para mendimtarëve, akademikëve dhe profesorëve universitar në fusha të ndryshme, çështje të kulturës

islame, probleme të mendimit islam dhe format e reformimit të tyre.

Instituti Botëror i Mendimit Islam në shërbim të lapsit për çështjet e “islamizimit të njohurive”, reformimin e metodologjisë së mendimit islam dhe formimin e shkencave shoqërore islame, ka nxjerrë dy revista. Njëra në gjuhën arabe (revista islamizimi i njohurive: revistë e mendimit bashkëkohor islam), dhe tjetra në gjuhën angleze (Revista Amerikane për Shkencat Shoqërore Islame) (American Journal of Islamic Social Sciences AJISS). E gjithë kjo krahas botimeve që vijnë nga disa nga zyrat e institutit, përfshirë broshura dhe revista periodike.

6.2.2. Institucionet e specializuara për studimin dhe përkujdesin e fëmijërisë

Kuptuam se roli i “islamizimit të diturive”, institucioneve kulturore dhe ideologjike, institucioneve të hulumtimit akademik dhe arsimit të lartë është bazament për riformimin e hapësirës ideologjike, aftësimin e mendjes së muslimanit, zgjidhjen e problemeve metodologjike, pastrimin e kulturës dhe përgatitjen e kuadrove kulturor në aspektin fetar dhe shkencor. Po ashtu duhet pasur parasysh se nevoja është tejet e madhe dhe urgjente për aktivitet shkencor, pedagogjik dhe të përqendruar në sferën e çështjeve pedagogjike islame, i cili do të furnizonte umetin, prindërit, mësimmshënësit, udhëheqësit dhe përgjegjësit me hulumtime, të cilat do të bëjnë të qartë vizionin, do të ofrojnë përvojën dhe mjetet e nevojshme dhe të domosdoshme për t’u përballuar me risitë dhe sfidat, si dhe do të vetëdijeson prindërit, mësimmshënësit dhe përgjegjësit për çështjet e reja dhe efektive. E gjithë kjo me qëllim të përmirësimit të gjendjes së fëmijëve dhe adoleshentëve në aspektin emocional dhe njohës si dhe ngritjen e nivelit të kryerjes së detyrave.

6.2.3. Fondacioni i zhvillimit të fëmijërisë

Për të shfaqur rëndësinë e aspektit pedagogjik dhe rolin e tij në reformat islame, si dhe për të shpallur një aktivitet islam pedagogjik për grumbullimin e energjive ideologjike të nevojshme në shërbim të mendimit pedagogjik dhe ripërtëritjes shoqërore, për themelimin e institucioneve shkencore të specializuara pedagogjike që do të punonin në shërbim të hulumtimeve dhe studimeve në sferën e edukimit të fëmijëve dhe adoleshentëve, Instituti Botëror i Mendimit Islam, krahas përvojës së Universitetit Islamik Botëror në Malajzi, për këtë qëllim ka dhënë kontribut në themelimin e Fondacionit islam, hulumtues dhe pedagogjik të pavarur në SHBA me emrin: Fondacioni i Zhvillimit të Fëmijërisë (Child Development Foundation CDF), i cili më pas projektet e tij pedagogjike i ka shkruar në kuadër të Institutit Botëror të Mendimit Islam.

Instituti sot merret me çështjen e reformave pedagogjike, ndryshimin në rrënjët shoqërore dhe përgatitjen e kushteve të nevojshme për realizimin e tyre. Këtë mundohet ta realizojë me formimin e vizionit islam në çështjet e imanit (besimit), tevhidit (njëshmërinë e Zotit), istihlafit (mëkëmbësisë në tokë) dhe etikës. Po ashtu, me anë të formimit të mentalitetit shkencor islam, pastrimit të kulturës dhe trashëgimisë nga mitologjitë dhe ruajtja e mendjes së muslimanit nga keqpërdorimi në çështjet e gajbit (botës metafizike), si dhe çështjet që ndërlidhen me pejgamberët e mëhershëm dhe mrekullitë e tyre, në atë mënyrë që të mos keqkuptohen dhe keqkomentohen në kundërshtim me qëllimet e përgjithshme të shariatit islam.

Në këtë periudhë të rëndësishme, studimet akademike patjetër duhet të synojnë arritje praktike. Po ashtu qëllimet, përgjithësimet, parimet dhe konceptet kur'anore të vënë kriter për mendimin islam, mbrojtës për mendjen e musli-

manit nga devijimi, mangësia dhe mitologjia, motiv për punë, përpjekje dhe përpikëri. E gjithë kjo, me qëllim të formimit të shoqërisë së drejtë, me dinjitet, bamirëse dhe formimin e civilizimit etik, shkencor dhe përparues.

Mendja e muslimanit duhet të përfitojë nga trashëgimia civilizuese njerëzore, të cilin e ka para vete në gjitha sferat e njohurive njerëzore, në shkencat shoqërore, humane, fizike dhe përvojat civilizuese. Mendja e muslimanit bashkëkohor duhet të kupton mësimin nga të parët e tyre për të cilin pagan çmim të shtrenjtë. Ky mësim është kur mendja e mëhershme islame bashkëveproi me trashëgiminë e hershme të mendimit njerëzor dhe civilizues, në veçanti mendimin filozofik grek, mirëpo në mënyrë të pakontrolluar dhe pa metodologji të shëndoshë shkencore, gjë e cila përfundoi në devijime filozofike në fushën metafizike. Kjo e lodhi mendjen e muslimanit në çështje të panevojshme dhe shkaktoi përçarjen e unitetit të umetit.

Do të ketë shumë personalitete të përgatitura që qëndrojnë në dy anët e rrugës, të cilët kanë përgatitje profesionale dhe kulturore për të kuptuar dimensionet, qëllimet dhe mjetet e ndryshimit të kërkuar. Këto personalitete duhet të cilësohen me guxim, të zbresin në mejdan dhe të përvilen për punë. Ata janë burrat e punës në këtë periudhë. Ata obligohen të përgatisin gjeneratën e re dhe të aftë në aspektin njohës dhe psikik, që të jetë i fuqishëm për bartjen e mesazhit hyjnor, bartjen e flamurit dhe vazhdimin e udhës.

6.2.4. Përvoja e "islamizimit të diturisë" në përgatitjen e kuadrove

Përvoja e islamizimit të diturisë në Universitetin Islamik Botëror në Malajzi (1988-1999) dhe planet për përgatitjen e kuadrove kulturore, shkencore dhe akademike islame llogaritet përvojë prijatare, shkencore dhe praktike në këtë

drejtim. Kjo përvojë i është lënë në dispozicion njërit nga themeluesit e Institutit Botëror të Mendimit Islam, i cili kësaj përvoje i dha dimensione të rëndësishme, ngase ishte zbatim i islamizimit të diturisë, metodologjisë dhe rezultateve të përvojës.¹⁵⁴

Është me rëndësi të kuptojmë se puna e “Institutit Botëror të Mendimit Islam” dhe puna e “Fondacionit për zhvillim të fëmijërisë”, në kuadër të përvojës së shkollës “islamizimi i diturive”, janë dy punë që përplotësojnë njëra-tjetrën, ngase reformat kulturore dhe ato pedagogjike janë përplotësuese të njëra-tjetrës. Nëse puna e Institutit, kryesisht është në fushën e mendimit metodologjik dhe pastrimit kulturor, puna e Fondacionit -në bashkëpunim me Institutin- është pedagogjike. Fondacioni synon specializimin në punën e reformave kulturore në esencën e formimit të personalitetit të njeriut musliman në periudhat e ndryshme të fëmijërisë, me metoda efektive pedagogjike.

Metoda efektive shkencore, e cila shërben për reforma dhe ndryshim në këtë periudhë të historisë së umetit, fshihet në përpjekjet pedagogjike që shfrytëzojnë vizionin e shëndoshë shoqëror, mbjell mendime, vlera dhe parime të vërteta dhe të sakta, punën në ruajtjen e baraspeshës mes anëve individuale dhe kolektive në personalitetin islam, zhvillon guximin letrar, në bazë të së cilës formon mentalitetin shkencor dhe në fund -në periudhën e fëmijërisë- nxitë shpirtin iniciues dhe kritikën kreative, të cilën në periudha tjera vetëm sa vjen e zhvillon edhe më shumë.

¹⁵⁴ Për të kuptuar dimensionet e përvojës së islamizimit të diturisë dhe orientimin e saj ideologjik mund të shfrytëzohen botimet e Institutit Botëror të Mendimit Islam, botimet e autorit të këtij hulumtimi si p.sh.: “Nadharijet’ul-islam ‘il iktisadijeh: el-felsefetu ve’l-vesailu muasire” (1960); “En-Nadharijet’ul-islamijetu fi’l-alakat’id-Devlijeti: ittixhahatun xhedidetun fi’l-fikri ve’l-menhexhijjet’il-islamijeti” (1972); “Es-Sijasetu ve’l-Hukmu” (1973); “Islamijet’ul-ulum’is-Sijasijeti” (1977); “Islamijet’ul-ma’rifeti: menhexhun xhedidun li islah’il-me’rifet’il-muasire” (1982); “Islamijet’ul-me’rifeti: el-hittatu ve’l-inxhazatu”; libri “Ezmet’ul-akl’il-muslimi” (1986) i botuar nga ana e Institutit Botëror të Mendimit Islam.

Nëse hapi i *parë* është islamizimi i diturive, duke bërë reforma në plan-programet mësimore ideologjike dhe pastrimin kulturor, dhe nëse hapi i *dytë* është puna për reforma në formimin familjar dhe raportet me prindërit mbi baza islame që përfshihen në dashuri, besim reciprok, siguri, duke përgatitur kështu vendstrehimin pedagogjik të nevojshëm për zhvillimin e gjithanshëm të personalitetit të fëmijës, atëherë duhet kuptuar se hapi i *tretë* është vetëdijesimi pedagogjik, i cili shndërron mundësitë familjare nga burimi i dashurisë, besimit reciprok dhe sigurisë në program pedagogjik, pozitiv dhe efektiv. Ky program do të kujdeset për fëmijën për të zhvilluar aftësitë e tij dhe për të formuar mentalitetin e tij shkencor dhe ndjenjat e tij të gjalla shoqërore.

Hapi i *katërt* është sigurimi i mjeteve shkencore dhe pedagogjike për mësimdhënësit. Këto mjete do t'ju ndihmojnë për të kryer detyrën e tyre në formën më të mirë. Ata duhet të furnizohen me mjetet mësimore më të reja dhe më të dobishme në fushën edukativo-arsimore. Po ashtu duhet përgatitur për ta plan-programet mësimore që ofrojnë njohuritë dhe shkencat e përshtatshme për çdo periudhë të fëmijërisë.

Këto katër hapa patjetër duhet të jenë të ndërlidhura mes veti, të baraspeshuara dhe të njëkohësishme me rikthimin e dimensionit të humbur në ripërtëritje dhe ndryshim në historinë e umetit dhe përpjekjet e tij civilizuese. Këto katër hapa duhet të formojnë dimensionin pedagogjik bazik për edukimin e fëmijës, duke marrë për model në këtë çështje komunikimin pejgamberik në sferën e edukimit.

Plani punues i Institutit shpreson të plotëson projektin e tij të dalluar. Kjo nënkupton që në momentin e duhur të themelon një institucion edukativo-arsimor botëror, në bazë të së cilës do të ngrihen një sërë shkolla islame (medrese).

Këto shkolla do të jenë bërthamë e filozofisë, programeve dhe metodave për aktivizimin e rolit të familjes dhe shkollës, duke iu ndihmuar për të luajtur rolin e tyre. Këto shkolla islame, në programet e tyre nuk do të përfshijnë vetëm aktivitetin e fëmijëve brenda mureve të tyre, por ndikimi, interesimet dhe përkujdesi do të përfshijë edhe familjen dhe konceptet pedagogjike.

Instituti përpilon plan-programet edukativo-arsimore dhe aktivitetet shkollore, duke përfshirë sferat emocionale, kulturore, shkencore dhe fizike. E gjithë kjo duke u bazuar në vizionin e shëndoshë hapësinor kur'anor, modelin pejgamberik dhe kulturën e pastër dhe të shëndoshë islame, që kujdeset për formimin psikik, emocional dhe njohës, në mënyrë të përplotësuar dhe të koordinuar, me qëllim të përfshirjes së gjitha sferave dhe periudhave për të realizuar qëllimin e kërkuar pedagogjik.

6.2.5. Shkollat islame botërore

Instituti Botëror i Mendimit Islam ka filluar këtë rrugë përmes përvojës së Universitetit Islamik Botëror në Malajzi. Universiteti ka themeluar një qendër për hulumtim rreth programeve edukativo-arsimore publike. Në të njëjtën kohë ka punuar për të ndërtuar një shkollë model në kuadër të universitetit. Përmes profesorëve ekspertë të pedagogjisë, duke u bazuar në planin e përgatitur më parë, në mbikëqyrje të drejtpërdrejtë nga drejtoria e universitetit dhe në bashkëpunim me disa komisione të specializuara prej profesorëve universitar në sfera të ndryshme, kjo Qendër ka vënë plan-programet ideore për periudha të ndryshme të arsimit publik. Edhe praktikisht u realizuar ngritja e një shkolle në kuadër të Universitetit që përfshinë periudhat e ndryshme të arsimit publik. U zbatuan në to plan-programet që shpresohet të veprojnë sipas normave dhe qëllimeve

për të cilat edhe janë themeluar. Qendra për hulumtime pedagogjike të vazhdon në zhvillimin e këtyre plan-programeve dhe të arrijë sukses në përpilimin e teksteve mësimore metodologjike të kompletuara sipas plan-programeve pedagogjike të zhvilluara.

Qëllimi i ndarjes së Qendrës për hulumtime në plan-programet edukativo-arsimore në Universitet nga drejtoria e shkollës, ishte mbrojtja e Qendrës nga dominimi i intereseve administrative ndaj anëve hulumtuese, shkencore dhe pedagogjike, duke qenë tepër të kujdesshëm për të ruajtur lidhjet e bashkëpunimit shkencor dhe pedagogjik mes tyre. Kjo realizohet përmes një drejtorie të lartë për dy institucionet. Një gjë e tillë shpresohet të realizohet në të ardhmen mes “Institutit” dhe “shkollave islame botërore” ose “shkollave të përparimit civilizues” ose “pedagogjik”. Instituti Botëror i Mendimit Islam -me ndihmën e Allahut- në bashkëpunim me gjitha palët e interesuara në Botën Islame, do të vazhdon punën, hulumtimin shkencor për zhvillimin e përpjekjeve pedagogjike, zhvillimin e teksteve mësimore metodologjike të kërkuara, punën për themelimin e një sërë shkollash islame botërore, themelimin e institucionit pedagogjik për mbikëqyrje të përgjithshme dhe përpilimin e planeve organizative të nevojshme për arritjen e suksesit.

Me qëllim të përplotësimit të projektit “islamizimi i diturive” dhe reformimit të metodologjisë së mendimit islam në shërbim të projektit të reformimit islam dhe civilizues, është me rëndësi që Instituti Botëror i Mendimit Islam, së bashku me Fondacionin e shkollave islame botërore, të punojnë nën ombrellën e Unionit të përgjithshëm të institucioneve të mendimit dhe civilizimit islam, si dhe në bashkëpunim me qendrat e ndryshme të mendimit dhe civilizimit që punojnë për të njëjtin qëllim.

Është e rëndësishme për projektin më të madh të “islamizimit të diturive”, përmes atyre që pranojnë vizionin dhe programet e tij në çdo vend të botës, që të përhapen përpjekjet shkencore në fazën e dytë prej fazave të zhvillimit të mendimit civilizues, duke u shfrytëzuar reformat ideologjike, kulturore dhe metodologjike në mënyrë efektive. E gjithë kjo kristalizohet në studime dhe libra metodologjike, përmes hulumtimeve periodike në studime shoqërore, humane, ekonomike dhe strategjike, normal nga pikëpamja islame. Aktivitetet e institucioneve shkencore në mënyrë të veçantë duhet të përfshijnë sferën e filozofisë së shkencave, kontrollimin e aktiviteteve shkencore dhe teknologjike si dhe orientimet civilizuese dhe prezantimin e vizionit islam në to. Përveç kësaj, hulumtuesit duhet të përfshijnë edhe çështjet e të drejtave të njeriut musliman, duke ofruar studime dhe informacione të sakta dhe duke i prezantuar me sinqeritetin dhe besnikërinë më të lartë para umetit, udhëheqësve dhe mjeteve të informimit.

6.2.6. Nevoja për shpalljen e parimeve metodologjike dhe ideologjike

Në këtë periudhë në të cilën ka arritur mendimi islam dhe në gjendjen në të cilën janë popujt islame dhe institucionet shoqërore dhe edukativo-arsimore, jam i mendimit se ka ardhur koha që elita e mendimtarëve, dijetarëve dhe të shkolluarve, të tubohen në një konferencë të organizuar ku do të nxjerrin para umetit një Deklaratë me parime të përgjithshme që përfshinë sferat bazike. Do të vendosen themelet, do të përcaktohen qëllimet, çështjet universal, parimet, çështjet konstante të pandryshueshme, prioritetet dhe sfidat. Kjo Deklaratë do të jetë udhërrëfyes për punë që do të vendosë rregullat e metodologjisë, përcakton kornizën, ndriçon rrugën e ndryshimit, lëvizjes dhe reformave në

sferën e njohurive, kulturës dhe atë edukativo-arsimore, si dhe mbyll rrugën para keqkuptimeve dhe devijimeve.

Mungesa e këtij udhërrëfyesi deri më sot, është një gabim i madh dhe çështje që nuk falet. Lusim Allahun subhanehu ve teala t'i inspirojë mendimtarët dhe të urtit e umetit të përshpejtojnë në hapjen e kësaj rruge me udhëzimet e tyre, duke qenë kështu në shërbim të umetit dhe të njerëzisë, dhe në të njëjtën kohë, duke zbatuar misionin e komunikimit të mesazhit. Allahu për çdo gjë është i plotfuqishëm.

Përfundim

Me qëllim që të dimë dhe të veprojmë

Në fund, është e rëndësishme që në pika të shkurtra të nxjerrim pikëpamjet elementare të librit, vijat e trasha dhe të përgjithshme që ka synuar t'i paraqes para lexuesit, të cilat në esencë paraqesin krizën e umetit, faktorët elementarë që ndikojnë në këtë krizë dhe shfaqjen e elementeve të humbura në projektet reformuese islame të synuara.

Umeti islam është bartës i mesazhit udhëzues për mbarë njerëzinë. Përmes këtij mesazhi, në të kaluar, ka përmirësuar ecurinë e civilizimit njerëzor, duke e ngritur atë në horizonte të larta morale, shkencore dhe botërore, si dhe duke e furnizuar me pikënisje që qëndrojnë pas gjitha arritjeve civilizuese dhe njerëzore bashkëkohore. Krahas asaj se Islami shpërtheu energjinë e besimit dhe civilizimit të madh, megjithatë, traditat, kulturat dhe filozofitë, si dhe ndryshimi i bazës politike në fisnore dhe nacionale, ka ndikuar në deformimin e vizionit islam, shkatërrimin e metodologjisë së mendimit dhe njohurive islame dhe ndotjen e kulturës islame, gjë që ia humbi umetit dimensionin e përgjithshëm dhe mundësoi të dominon mentaliteti i mitologjisë dhe fallit.

I gjithë ky mashtrim akaidor (besim) dhe ideologjik, si dhe deformimi kulturor, përfunduan në ngurtësim dhe prapambeturi. Udhëheqësve të umetit iu trashëguua dobësi dhe si rezultat i kësaj lindi prapambetja dhe terrorizmi politik dhe fetar.¹⁵⁵ Umetit i trashëgoi “mentalitetin dhe psikikën e

¹⁵⁵ Abdulhamid Ebu Sulejman, “*Ishkalijet’ul-istibdadi ve’l-fesadi fi’l-fikri ve’t-tarih’is-sijasij’il-islamijj*”, Mexhel-let’ul-muslim’il-muasir, nr. 22, viti. 31, 2006. Libri është botuar në gjuhën shqipe nga Logos-A më

robërve”, i cili cilësohet me individualizëm, frikë dhe mosmarrje të iniciativës. Umetin e ka bërë një trup të zhveshur nga shpirti i unitetit dhe solidarizimit, nga shpirti i trimërisë, nga fuqia dhe kreativiteti. Kështu umeti u bë viktimë i çdo armiku.

Krahas sinqeritetit dhe sakrificave, përpjekjet për reforma ishin të pjesshme dhe politike. Edhe pse këto përpjekje kishin për qëllim ngritjen e interesimeve dhe mbrojtjen nga sulmet, megjithatë nuk kishin vetëdijen e duhur rreth realitetit të sëmundjeve njohëse, kulturore, psikike dhe emocionale të umetit.

Natyra e diskursit politik është se ai punon për të bashkuar rreshtat dhe për të ngjallë shpresë. Mirëpo, nëse nuk i jepet hapësirë diskursit kritik, atëherë umeti nuk do të mund të ripërtërijë dhe të zhvillojë energjinë e përballimit të sfidave. Kështu, përpjekjet për reforma do të përfundojnë në lodhje dhe dobësi të vazhdueshme.

Mosnjohja e problemit njohës dhe mosperceptimi i raportit njohës me atë psikik dhe emocional, është shkakun më i rëndësishëm i ndarjes së njohurive islame në njohuri fetare dhe civile, njëra përballë tjetrës dhe në konflikt mes tyre. Çështja ka përfunduar në “humbjet e filozofëve” dhe vdekjen e “shkencave fetare”, pra në ngurtësim të përgjithshëm, tkurrjen e rolit të tyre, sterilizimin e ligjeve natyrore dhe njerëzore, si dhe ngurtësimin e shkencave dhe njohurive që ndërliken me to. E gjithë kjo ka rezultuar në përkujdesje për sasinë rreth informacioneve sterile dhe mosnjohjen e raporteve me atë praktike dhe emocionale si dhe pasojave psikike. Kështu lamë pas dore shkencat humane, fëmijërinë dhe edukatën që janë sferë e ndryshimit, sferë e zhvillimit të energjisë, nxitje të fuqisë dhe furnizim të ume-

tit me energji të dalluar dhe të nevojshme për të përballuar ndryshimet dhe sfidat.

Është patjetër rikthimi i vizionit islam, i cili ngritet mbi tevhidin (besimin në një Zot), mëkëmbësinë (el-istihlaf), civilizimin dhe mirësinë. Po ashtu, është patjetër reforma në metodologjinë e njohjes, duke përfshirë dy krahet e tij: atë fetar dhe njerëzor, si dhe pastrimin e kulturës islame nga ndyrësira dhe steriliteti që e ka goditur.

Më pas vjen roli i bashkëveprimit mes aspektit njohës, psikik dhe emocionues në aspektin pedagogjik në formimin e njeriut musliman, në atë mënyrë që vazhdimisht të jetë i dobishëm, kreativ dhe i fuqishëm për sigurimin e energjive dhe aftësive të nevojshme për përballimin e sfidave.

Mendimi dhe mendimtarët janë pikënisja njohëse për reformim. Më pas vjen pedagogjia dhe pedagogët si pikënisje për reforma psikike dhe emocionale. Kështu, profesorët universitar dhe arsimit i lartë bëhen mjete të rëndësishme në procesin e reformave ideologjike, ndërsa edukata dhe arsimit publik bëhen mjete mbështetëse të familjes në sferën e reformave psikike dhe emocionale.

Institucionet në format e tyre të ndryshme veprojnë në mënyrë të vazhdueshme për të ruajtur gjendjen aktuale, si dhe kujdesen për atë se çdo ndryshim, realizohet brenda kornizave të kësaj gjendje. Për këtë, është patjetër për kërkuesit e reformave dhe ndryshimit të njohin çelësin që ndez lëvizjen e procesit të ndryshimit. Pa njohur këtë çelës dhe pa njohur natyrën e procesit të ndryshimit, nuk mund të ndodhë ndryshimi i kërkuar. Në këtë mënyrë reformatoret bëhen si ata që dëshirojnë të lëvizin rrotat e makinës me duart e tyre.

Çelësi për sjelljen e ndryshimit paqësor në shoqëri fshihet pikërisht në motivin natyror në brendinë e prindërve dhe kujdesin e tyre për interesin e fëmijëve. Ky motiv

gjendet natyrisht në brendinë e prindërve dhe ka fuqi dhe ndikim të madh në formimin e mentalitetit dhe psikikës së individit në periudhën e fëmijërisë. Bazuar në këtë, bashkëpunimi i mendimtarëve dhe pedagogëve në kryerjen e roleve në të kuptuarit e atërisë dhe fëmijërisë, si dhe humlumtimet shkencore dhe pedagogjike në kuadër të pikënisjeve dhe problemeve të mendimit dhe kulturës islame, janë çështje të domosdoshme për të luajtur rolin në ofrimin e çështjeve shkencore dhe efektive për prindërit musliman, duke i bërë të vetëdijshëm për çështjet që kërkohen prej tyre. Për këtë, Universiteti Islamik Botëror në Malajzi ka zhvilluar tre lëndë mësimore, bazuar në “islamizimin e diturive”. Po ashtu ka themeluar programe për përgatitjen e kuadrove mësimdhënës për këto lëndë, të cilat do të jenë lëndë obligative për të gjithë studentët e universitetit. Këto tri lëndë janë: “Familja dhe atëria”, “Mendimi kreativ dhe zgjidhja e problemeve” dhe “Ngritja e civilizimeve dhe rënia e tyre”.

Roli njohës i shkollës dhe mësuesit vjen si përplotësues i rolit emocional dhe pedagogjik të prindërve. Nëse vetëdija është në nivelin e duhur, atëherë roli i mësuesve përplohtësohet me rolin e prindërve, ngase mësuesi, zakonisht, bartë me vete dëshirën për përkujdesje ndaj nxënësve dhe përgatitjen e tij për të qenë i fuqishëm në arritjen e suksesit në jetën e tij, si dhe përdorimin e fuqive të tij në përballimin e sfidave.

Kështu, në fund, na bëhet e qartë se prej shkaqeve më të rëndësishme të mangësive të lëvizjeve reformiste në historinë e umetit, në realizimin e qëllimeve është mosperceptimi i rëndësisë së anës emocionale në përmirësimin e mangësive psikike që kanë goditur umetin. Më pas, mosperceptimin e rëndësisë së rolit të fëmijërisë në sjelljen e reformave psikike dhe emocionale, lirimin e umetit nga

kriza e “mentalitetit dhe psikikës së robërve” dhe transferimi në rolin e fuqisë dhe kreativitetit, siç kishte bërë Musa alejh’is-selam me Beni Israilët në Sina.

Po ashtu në fund, na bëhet e qartë përgjegjësia e mendimtarëve, pedagogëve, profesorëve dhe mësuesve në marrjen e iniciativës në duart e tyre, lëvizjen e çelësit për ndryshim paqësor dhe reformësim rrënjësor, njëjtë sikur rolin që e luan vozitësi i makinës në procesin e ecjes drejt qëllimit të caktuar. Këtu pra është për qëllim aktivizimi i elementit të humbur, e që është fëmijëria dhe i nevojshëm për aktivizimin e ndjenjave të umetit, përplotësimin e mjetëve për reformimin, lirin dhe zhvillimin e fuqive për interesin e fëmijëve. Është patjetër të jetë diskurs shkencor dhe bindës, për të cilin themelohen qendra për hulumtim shkencor, të cilat do të ofrojnë programe pedagogjike shkencore. Këto qendra i ngrenë dhe i reklamojnë gjithë njerëzit e sinqertë prej njerëzve të shkolluar dhe të pashkolluar, si dhe prijësit e lëvizjeve reformiste dhe udhëheqësit e shoqërisë dhe institucionet e shoqërisë civile. Kjo është rruga e vetme që i mundëson muslimanit marrjen në duart e tij iniciativën e formimit dhe lirit. Vetëm në këtë rast, institucionet zyrtare do t’i përgjigjen kërkesave dhe orientimeve të tyre dhe domosdoshmërisht do të bëhen ndihmesë për realizimin e qëllimit, “ashtu siç jeni ju, do të jenë edhe të prijësit tuaj”.

Një fjalë të fundit drejtuar mendimtarëve dhe reformistëve në lidhje me llojin e përpjekjeve dhe rolin e tyre. Për të pasur sukses në përpjekjet e tyre, është e rëndësishme puna serioze për luajtjen e rolit udhëheqës në lëvizjen e çelësit për ndryshimin tek umeti. Kjo arrihet përmes ofrimit të vizionit civilizues islam, pastrimin e kulturës së umetit dhe aftësimin për sëmundjet emocionale dhe mënyrat e trajtimit dhe asgjësimit të tyre. Jeta e Muhamedit alejh’is-selam,

është shembull më i mirë për frutat e durimit dhe këmbënguljes. Ai, së bashku me shokët e tij, gjatë trembëdhjetë viteve në Meke veproi dhe duroi në vënien e bazave, ngritjen e themeleve dhe përgatitjen e kuadrove. Më pas, gjatë dhjetë viteve, prej tyre lindi energjia e reformave që do të ndryshojnë rrjedhën e historisë njerëzore, për të evituar gjitha pengesat para formimit të një umeti civilizues. Kjo është forma e ndryshimeve të mëdha në histori.

Pa u mbështetur ne vete, pa hequr dorë nga ëndrrat e “tjetrit shpëtues” dhe zgjidhjes se lehtë dhe të shpejtë, do të kalojnë dekada dhe shekuj dhe nuk do të ketë asnjë ndryshim në gjendjen tonë. Ne nuk mund të presin në të ardhmen -ashtu siç ka ndodhur në të kaluarën- përpos rritje të krizave dhe katastrofave që sjellin çdo ditë gjakderdhje dhe harxhim të energjive, për të cilat ne jemi më të nevojshëm për to. Shpresojmë të vetëdijesohen mendimtarët dhe reformatorët për të kryer rolin e tyre për të vënë lëvizjen e reformave të umetit në rrugën e duhur, përmes reformave që duhet të bëhen tek individit në aspektin njohës dhe emocional, si dhe përmes vënies së themeleve për formimin e gjeneratave, të cilat do të posedojnë mendje dhe ndjenja të lira dhe të shëndosha. Allahu e ka thënë të vërtetën kur thotë:

(إِنَّ اللَّهَ لَا يُغَيِّرُ مَا يَقُومُ حَتَّىٰ يُغَيِّرَ مَا بِأَنفُسِهِمْ)

“Allahu nuk ndryshon gjendjen e një populli derisa ai nuk ndryshon gjendjen e tij”.¹⁵⁶

Po ashtu thotë:

(وَالْعَصْرُ إِنَّ الْإِنْسَانَ لَفِي خُسْرٍ إِلَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَتَوَّصَوْا بِالْحَقِّ وَتَوَّصَوْا بِالصَّبْرِ).

¹⁵⁶ Err-Rra’d: 11.

*“Pasha kohën. Njeriu është në humbje. Në përjashtim të atyre që besojnë, bëjnë vepra të mira, porosisin njëri-tjetrin drejt të vërtetës dhe për durim”.*¹⁵⁷

Lusim Allahun e Madhëruar për ndihmë dhe sukses. Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve.

¹⁵⁷ El-Asr: 1-3.

Literatura

Në gjuhën arabe:

- El-Buhari, Muhamed ibn Ismail, *Sahih'ul-Buhari*, Recensent: Mustafa El-Buga, Bejrut: Daru ibn Kethir, 1407 h/ 1987.
- El-Bezzaz, Seid ibn Mensur, *Sunenu Seid ibn Mensur*, Recensent: Haburrahman El-A'dhamij, Bejrut: Dar'ul-kutub'il-ilmijeti, bot. 1, 1985.
- Ebu Hajjan, Muhamed ibn Jusuf, *El-Behr'ul-Muhit*, Bejrut: Dar'ul-Fikr, 1992.
- Et-Tirmidhij, Muhamed ibn Isa, *El-Xhami'us-Sahih "Sunen'ut-Tirmidhij"*, Recensent: Ahmed Muhamed Shakir, Bejrut: Daru Ihja'it-Turath'il-Arabiji, (pa vit botimi).
- Ed-Darimij, Abdullah ibn Abdurrahman, *Sunen'ud-Darimij*, Recensent: Fevaz Zemerli & Halid Es-Sebe', Bejrut: Dar'ul-kitab'il-Arabiji, bot. 10, 1407 h.
- Es-Sexhistanij, Sulejman ibn El-Esh'ath, *Sunenu Ebi Davud*, Recensent: Muhamed Muhjedin Abdulhamid, Bejrut: Dar'ul-Fikr (pa vit botimi)
- Ebu Sulejman, Abdulhamid Ahmed, *Ezmet'ul-akl'il-muslimi*, Rijad: Ed-Dar'ul-Alemijetu li'l-kitab'il-islamiji, 1994.
- Ebu Sulejman, Abdulhamid Ahmed, "Ishkalijet'ul-istibdad ve'l-fesad fi'l-fikri ve't-tarih'is-sijasij'il-islamiji", *Mexhel-let'ul-muslim'il-muasir*, nr. 22, viti 31, 2006.
- Ebu Sulejman, Abdulhamid Ahmed, *El-Islah'ul-islamij'ul-muasir*, Kajro: Dar'us-Selam, 1427 h./ 2006.
- Ebu Sulejman, Abdulhamid Ahmed, "El-Emnu ve's-selam'ul-ixhtimaiju hedefu nidham'il-ukubat'il-islamiji: teemmulatun fi netaixhi dirasetin ixhtimaijjetin liseken'it-tulab'il-xhamiijine", *Mexhel-letu islamijet'ul-ma'rifeti*, nr. 14, 1998.
- Ebu Sulejman, Abdulhamid Ahmed, "El-Ummetu bejne sheriatejni", *Mexhel-letu islamijet'ul-ma'rifeti*, nr. 28, 2002.
- Ebu Sulejman, Abdulhamid Ahmed, *Delilu mektebet'il-usret'il-muslimeti*, Hernden: Instituti Botëror i Mendimit Islam, Kajro: Dar'us-Selam, bot. 3, 2008.

- Ebu Sulejman, Abdulhamid Ahmed, *El-Unfu ve idaret'us-Sira'is-Sijasiji fi'l-fikr'is-sijasij'il-islamijji bejne'l-mebdei ve'l-hijari: ru'jetun islamijetun*, Damask: Dar'ul-Fikr, Hernden: Instituti Botëror i Mendimit Islam, 2002.
- Ebu Sulejman, Abdulhamid Ahmed, *Nadharijet'ul-islam'il-iktisadijeh: el-felsefetu ve'l-vesail'ul-muasireh*, Kajro: Mektebet'ul-Hanxhi, 1960.
- Ebu Sulejman, Abdulhamid Ahmed, *En-Nadharijet'ul-islamijjetu li'l-alakat'id-devlijjeti: ittixhahatun xhedidetun li'l-fikri ve'l-menhexhijet'il-islamijjeti*, përkthim: Nasir Ahmed Murshid Burejk, Rijad: Metabiu Firezdek Tixharijeti, (pa vit botimi).
- Esh-Shejbanij, Ahmed ibn Hanbel, *Musned'ul-imam Ahmed ibn Hanbel*, Recensent: Shuajb El-Arnaut, Bejrut: Muesseset'urr-Risaleti, bot. 20, 1420 h./ 1999.
- Salih Subhi, *Menhel'ul-varidine sherhu Rijad'is-Salihine*, Stamboll, (pa vit botimi).
- El-Kazvini, Muhamed ibn Jezid, *Sunenu ibn Maxheh*, Recensent: Muhammed Fuad Abdalbaki, Bjerut: Dar'ul-Fikr (pa vit botimi).
- El-Kushajri, Muslim ibn'ul-Haxhaxh, *Sahihu Muslim*, Recensent: Muhammed Fuad Abdalbaki, Bejrut: Daru Ihja'it-Turath'il-Arabiji, (pa vit botimi).
- Mehluf, Hasanejn, *Safvet'ul-Bejani li mena'il-Kur'ani*, Kuvajt: Ministria e Vakëfit dhe Çështjeve Islame, bot. 3, 1407 h./ 1986.
- En-Nisaj, Ahmed ibn Shuajb, *El-Muxhteba mine's-suneni*, Recensent: Abdulfettah ibn Guddeh, Alep: Mektebet'ul-metbuat'il-islamijeti, 1406 h./ 1986.

Në gjuhë angleze:

- Habibul, Sayed, "Al-Iqta: A Historical Survey of Land Tenure and Land Revenue Administration in Some Muslims Countries, with Special Reference to Persia", in *the Contemporary Aspects of Ekonomik and Social Thinking in Islam*, Plainfield, ind.: the Muslim Students Association of USA and Canada, 1970.
- Abu Sulejman, AbdulHamid Ahmed, "The Theory of the economics of Islam", *Journal of Economics and Management*, 6, no. 1 & 2, Kuala Lumpur: International Islamic University, 1998.

Shënimi i katalogut CIP të këtij libri ndodhet në Bibliotekën Kombëtare Universitare "Shën Kliment Ohridski", Shkup

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

28:001
37.018.1:28

EBU SULEJMAN, Abdulhamid Ahmed
Civilizimi Islam, Rënia dhe ripërtëritja e tij: - rrënjët kulturore
dhe edukative - / Abdulhamid Ahmed Ebu Sulejman; e përktheu nga gjuha
arabe Naser Ramadani. - Shkup; Prishtinë; Tiranë: Logos-A, 2021. -
284 стр. ; 21 см. - (Biblioteka Mendimi islam)

Prevod na deloto: Inhijar'ul-hadaret'il-islamijeh:
El-Xhudhur'eth-thekafijetuve't-terbevijjeh / Abdulhamid Ahmed
Ebu Sulejman. - Фусноти кон текстот. - Библиографија: 281-282.


ISBN 978-9989-58-849-5

а) Ислам -- Етика б) Ислам -- Семејство в) Семејно воспитување --
Исламски аспекти

COBISS.MK-ID 53811973

www.logos-a.com

Copyright©Logos-A, 2021



LOGOS-A



MENDIMI ISLAM



LOGOS·A



“Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli derisa ai nuk e ndryshon gjendjen e tij”. (Err-Rra'd:11)

“Njerëzit janë sikur xehet. Të dalluarit në periudhën e xhahilijetit (injurancës) janë të dalluar edhe në Islam, nëse bëhen të kuptueshëm (mësojnë)” (Muhamedi a.s.)

Ky libër është një përpjekje për të kuptuar mungesën e anës psikologjike dhe emocionale në shkrimet edukative islame rreth fëmijës, me qëllim që ky kuptim të jetë një bazament për ngritjen e fuqisë kreative në formimin psikologjik dhe emocional. Ky libër gjithashtu është një përpjekje për të njohur dimensionet kulturore dhe mendore që sollën këtë çrregullim, si dhe për të mësuar konceptet dhe pikënisjet që i mundësojnë umetit plotësimin e kësaj mangësie. Rikthimi i këtij faktori është i patjetërsueshëm në procesin e ndryshimit shoqëror dhe civilizues, i cili shpie në rikthimin e unifikimit mes anëve njohëse, psikike dhe emocionale në formimin e personalitetit të fëmijës. E gjithë kjo do të ndihmonte në ngritjen e energjisë kreative dhe shkencore në esencën e natyrës së fëmijës musliman dhe formimin e tij psikoemocional. Autori potencon se është i domosdoshëm ballafaqimi serioz me tri krizat: kriza e mendjes dhe metodologjisë, kriza e mendimit dhe kulturës dhe kriza e emocioneve dhe edukatës.

Pa tejkalimin e këtyre krizave, nuk ka asnjë mundësi për të realizuar mundësinë e umetit për rritjen e energjisë, ripërtëritjen dhe realizimin e qëllimeve të larta, duke u bazuar në ruajtjen e baraspeshës mes anës politike, mendore dhe edukative në përpjekjet e lëvizjeve reformiste, me qëllim të realizimit të fuqisë, lirimit psikologjik të muslimanit dhe ngritjes emocionale të tij.